

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE,
LIDHUR ME 28 TEMA TË DISKUTUESHME
(III)**

Recensues

Prof. Dr. Abdullah Zymberi

Prof. Dr. Begzad Baliu

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES
STANDARDE
LIDHUR ME 28 TEMA TË
DISKUTUESHME
(III)**

Prishtinë, 2016

P ë r m b a j t j a

Para th ë n i e	11
a) Nga punimet e viteve të '80-a	11
b) Nga punimet e viteve të '90-a	12
c) Nga punimet e fillimviteve të shek. XXI	13
1. Rreth drejtshkrimit të emërtimeve të rrugëve (1984)	15
2. Tubimi i punëtorëve, këshilli i punëtorëve e jo tubimi punëtor, këshilli punëtor (1984)	19
3. Shprehja "i pazhvilluar sa duhet" si shkarje semantike (1985).....	24
4. Rreth kristalizimit të kuptimit të fjalës nismë/nisma (1985).....	27
5. Banorët e Ferizajt apo banorët e Ferizajit? (1986)	29
6. Aktroj (aktrim) apo aktorj (aktorim) (1986).....	31
7. Nismë e shkëlqyer që lyp kurorëzim (1987).....	37
8. Trajta vuarje si lajthitje fjalëformuese (1992)	42
9. Jo trupa po organizma (politikë, shtetërorë) (1994)	44
10. Jo përfolet po ritregohet rrëfesa popullore (1994)	47
11. Raste të ngatërrimit të historizmës njësit me fjalë-termin njësi (ushtarake) te ne (1995)	48
12. Sllavizma "trojka" të mos përdoret pa kriter (1995)	51
13. Prirje e vërejtshme në diferencimin semantik të prejfoljorëve përbërës të "treshit emëror sinonimik"(1995)	55
Pasqyra e raportit fjalëformues të emrave të veprimit dhe atyre të vepruesit në gjuhën shqipe:.....	61
Përfundim	66
14. Edhe njëherë rreth lajthitjes kontekstore "deri atëherë mirupafshim!" (1995)	68

15. Trajta "nisjativë" si kontaminim dështak i sinonimeve nismë / iniciativë (1995)	75
Përfundim	78
16. Rreth formëzimit të fjalë-termit e pame / e pamja(1995).....	80
1. "E pamja" si institucion	80
2. Formëzimi i fjalës "e pame" si term etnografik	83
Përfundim	85
17. Rreth përdorimit të fjalës zot në gjuhën shqipe (1995)	86
Hyrje.....	86
1) Përhapja vertikale dhe horizontale e fjalës Zot	87
2) Raporti i fjalës Zot me trajtat sinonimike të stilit hyjnor	90
3) Fjala Zot në raport me trajtën zoti, zotëri e zotni.....	96
Përfundim.....	103
18. Rreth kontaminimit homonimik të fjalës emën ose emër1 me fjalë-termin kuranor emër2 (*el ämr) në gjuhën shqipe (1996)	105
Hyrje.....	105
I. Shqiptimi dhe përhapja e këtyre dy-tri fjalëtermave.....	107
II) Rreth fushës kuptimore që mbulojnë tradicionalisht dy fjalë-termat në shqyrtim.....	108
a) Rreth fjalës emër1 (ose emën) si fjalë autoktone e shqipes.....	108
b) Rreth fushës kuptimore të fjalëtermit kuranor emër2 (*el-emrun).....	109
III) Dallimi dhe përkimi semantik në shqipe i fjalë-termave në shqyrtim	113
a) Cili është reflektimi i zakonshëm i fjalëtermit emër2 (*el emr) në disa gjuhë të huaja si term administrativ dhe ndikim-përftimi i tij në shqipe	114
b) Trajta e fjalëtermit emër2 dhe barasvlerësit në shqipe sipas burimeve përkatëse	116
1. Nga Fjalori i “Bashkimit “	116
2. Nga Mevludat në gjuhën shqipe.....	117
a. Teksti gegnisht, ku dallimi del qartë nga forma shkrimore:	118
b. Teksti toskërisht, ku dallimi del vetëm nga ana kontekstore:.....	118
c. Shembuj jo të qartë kontaminues ose me kuptim alternativ:	118
3. Nga “Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare”	119
4. Nga Fjalori i H. Bariqit	119
5. Nga revista Takvim (1997)	119
6. Nga Fjalori i M. Elezit.....	120

c) Në cilat burime normative të shqipes së sotme shihen reflekse kontaminimi të fjalëtermave në shqyrtim emër ¹ dhe emër ²	120
IV. ÇFARË DUHET NDËRMARRË PËR ZGJIDHJEN E KËSAJ ÇËSHTJEJE?	123
1. Rishikimi dhe përplotësimi i detajuar i përkufizimit të koncepteve të fjalë-termave në shqyrtim.....	123
A) Konceptet e fjalës emnoj dhe emëroj ¹	123
1) Disa shembuj, konceptet e të cilëve shprehen me trajtën emnoj:	124
2) Disa shembuj, konceptet e të cilëve shprehen me trajtën emëroj ¹ ...	125
B) Koncepti i fjalë-termi emër ²	125
1) Emër emëroj ² si fjalë-term kuranor (*el emrun)	125
2) Emër emëroj ² në stilin administrativ	126
2. Rishikimi dhe harmonizimi i barasvlerësisë në gjuhën tonë dhe në krahasim me gjuhë të huaj i domosdoshëm.....	127
Shembuj në disa gjuhë.....	127
Përfundim	130
19. Rreth shprehjes trivariantëshe të bismeles në gjuhën shqipe.....	133
a) Rreth versionit të parë: <i>Bismil-Lah-i</i>	135
b) Rreth versionit të dytë: <i>Me emër të All-llahut</i> ...	136
c) Rreth versionit të tretë: <i>Në emër të All-llahut</i> ...	137
Përfundim.....	140
20. Rreth përcaktimit të trajtës foljore lidhur me ndërkombëtarizmën asociacion në shqipe	141
21. Alfabetim apo alfabetizim?	148
22. Libri <i>Filozofia e gjuhës, veprë interesante</i>	153
me shqipe të përdëshiruar	153
Hyrje.....	153
1) Vërejtje rreth raportit gjuha e veprës / shqipja letrare	155
2) Rreth kategorizimit të “lëshimeve” gjuhësore të veprës	156
a) Si lapsus calami	157
b) Si lajthitje të normës leksiko-semantike,.....	157
c) Lajthitje si pasojë e përvojës së pamjaftueshme të shkrimit në shqipe	
158	
3) Konstatime rreth disa vlerave të çmuara të kësaj veprë	159
4) Rileximi i veprës i domosdoshëm	161
Përfundim	162
23. Fjalë-termi <i>spirt</i> sajesë e trilltë në shqipe.....	163
Përfundim	174

24. Rreth përlijjes së foljes kalëroj dhe parapëlqimit të emrit kalërues në shqipen e sotme.....	175
Skemë shembujsh në shtatë gjuhë	179
25. Kalku <i>binjakëzim</i> (<i>qytetesh</i>) - rast i diskutueshëm	181
26. Infiksi <i>-ir</i>, formant i shpifur foljor në gjuhën shqipe	186
1. Skemë shembujsh në disa gjuhë	187
2. Kur mund të arsyetohet elementi –IR- si pjesë e nevojshme	188
Skemë shembujsh në tri gjuhë	190
3. Çfarë qëndrimi duhet mbajtur për rastet e tilla?	191
Përfundim	191
27. Rreth identifikimit të formantit –av si prapashtesë e specifikuar foljeformuese në shqipe	192
1. Nga konstatimet e Dom Nikollë Gazullit dhe Xhuvani–Çabejt rreth formantit -AV	193
a) Konstatime nga <i>Fjalorthi</i> i D. Nikollë Gazullit (1941)	194
b) Nga konstatimet e Xhuvani-Çabejt.....	196
2. Raporti ndërndikues shqip - serbisht i shembujve me.....	199
formantin -AV	199
a) Versioni shqip – serbisht:	202
b) Versioni serbisht – shqip	203
Skemë shembujsh në disa gjuhë	204
a) Krahaso mbiemër / folje në serbisht:	207
b) Krahaso: mbiemër /folje në trajtën përfaqësuese serbisht e shqip:	207
c) Krahaso barasvlerësit (mbiemër e folje) serbisht - shqip	208
ç) Krahaso mbaresat optimore	209
3. Del, apo jo, i identifikuar formantI –AV në shembuj përkatës në kuadër të fjalorëve tanë normativë?.....	210
a) Disa shembuj nga sistemi emëror (emra, mbiemra e ndajfolje):	210
b) Disa shembuj nga sistemi foljor që asociacionojnë:.....	211
4. Po në cilat burime leksikografike vërtetohet formanti	213
-AV(Ë) si prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese?.....	213
a) Konstatime nga <i>Fjalorthi</i> i Abdullah Zymberit (1979).....	213
b) Konstatime nga “Fjalor fjalësh e shprehjes popullore”	215
të IAP 1982	215
c) Konstatime nga <i>Fjalori</i> i M. Elezit (2006).....	217
ç) Disa shembuj foljesh nga realiteti ynë gjuhësor si dëshmi personale	220

5. Pse ka mbetur e patrajtuar nga standardologët tanë deri tashti një dukuri e tillë foljeformuese?	221
6. Çfarë i imponohet shqipes së sotme dhe standardit të saj lidhur me krijimet me formantin –AV(Ë)?	223
Përfundim	229
28. RRETH RRËNJËSISË DHE SHTRIRJES SË FJALËS	233
KALË NË SHQIPEN E DOKUMENTUAR	233
1. Rreth rrënjësisë së fjalës kalë të shqipes	233
2. Shtrirja e fjalë-konceptit kalë me rrjedhojat përkatëse në kohë-hapësirën e gjuhës shqipe	236
1) Nga sistemi foljor	236
2) Nga sistemi emëror:	238
3. Larushia e shembujve nga pikëpamja ndërtimore, paradigmore e fjalëformuese si dëshmi autoktonie e fjalës kalë	241
1) Larushia në ndryshimin e tingujve si dukuri të fonetikës historike	241
a) Rreth foljes ngalkoj (me ngalkue)	242
b) Rreth foljes kaloj (me kalue)	243
c) Rreth foljes kalëroj (me kalërue)	244
2) Larushia paradigmore ndajshesore, fjalëndërtuese e	244
fjalëformuese të disa shembujve rreth fjalës kalë	244
1. Prapashtesat foljore	244
2. Disa raste karakteristike të ndajshesimit emëror	245
3. Gjymtyrëzimi i trajtës kalë në togfjalësha e kompozita	246
a) Emra të përbërë të përgjithshëm me fjalën <i>kal-i</i>	246
b) Emra të përveçëm të përbërë gjeografikë me trajtën <i>kal-i</i>	247
Përfundim	250
Të dhëna bio-bibliografike për autorin:	254

Parathënie

Në këtë përmbledhje *Çështje të shqipes standarde* III janë përfshirë 28 punime me tematikë paksa të ndryshme, por që i bashkojnë të veçantat përmbajtësore në kuadër të tyre si "**tema të diskutueshme**". Në të vërtetë, ne, duke u mbështetur në periudhën, përkatësisht dhjetëvjetshin, kur u shkruan ose u botuan bëmë mbarështrimin e tyre në tri pjesë, e para, 7 tituj artikujsh të viteve të '80-a, e dyta, 17 sosh të viteve '90-a dhe e treta 4 punime shkruar në fillimvitet e shekullit XXI.

Për të tri periudhat po cekim paksa ndonjë pikë të veçantë nga veçoritë përmbajtësore të tyre.

a) Nga punimet e viteve të '80-a

Kështu në vitet e '80-a, në vazhdë të entuziazmit të pashuar për t'i dalë krah zbatimit të normës së gjuhës sonë letrare kombëtare, para e pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972) dhe pas një përvoje a ballafaqimi që kishim në këtë fushë, sidomos në raportin shqip/serbokroatisht, qoftë si mësues gjuhe në shkolla të mesme profesionale (ekonomike e teknike), qoftë si lektor, për një kohë të shkurtër, në Radio-Prishtina, e aq më tepër si përkthyes në Uzinën e Amortizatorëve të Prishtinës, interesimi ynë nuk mbeti vetëm sa për të bërë përkthim, por të ngrenin edhe cilësi dhe së këtejmi u zgjerua edhe në gjetjen dhe trajtimin e temave të diskutueshme me interes të kësaj fushe. Kështu, temat që trajtonim nuk kishin të bënim vetëm me përshtatje trajtash e termash në raportin, si të themi, **kosovarishte** (ish-shqipe letrare mbi bazë gegnishte) / **shqipe e njëzuar**, por edhe me ndonjë çështje edhe të vetë "shqipes letrare në përgjithësi", andaj morëm guximin që vënerimet tona të kësaj natyre t'i trajtonim dhe t'i ofronim në shtypin e ditës. Ndër të tjera u trajtua edhe çështja *Rreth emërimit të rrugëve*, e cila, për ndonjë pikë edhe sot e kësaj dite ka mbetur e hapur, ashtu si edhe përdorimi pa vend te ne i fjalës **nismë –nisma**, dhe të tjera si: **tubimi i punëtorëve (këshilli i arsimtarëve)** jo tubimi punëtor! (këshilli arsimtar!), jo "**rajon i pa zhvilluar sa duhet**", po "**rajon**

jo i shvilluar sa duhet”, madje u diskutua edhe shquarsia e vendbanimeve me –AJ fundore: “*Banorët e Ferizajit*” apo “**banorët e Ferizajt**”? si dhe trajta ende e pasaktësuar: *aktroj aktrim/aktorj aktorim*(!). Ndërkaq tema e shtatë me elemente recensionit që u botua atëherë i tërhiqte vërejtjen autorit dhe përgjithësisht studuesve të rij të *specializuar* për seriozitetin që duhej pasur në trajtimin e çështjeve kulturore e shkencore, siç ishte edhe hartimi i *fjalorthit shqip-latinisht* mbi bazë të Fjalorit të Frang Bardhit, ku autori, si duket, nga nxitimi apo mbase edhe nga pakujdesia, *kishte lejuar* shumë lëshime si nga pikëpamja gjuhësore-drejtshkrimore, ashtu edhe nga ajo metodologjike - shkencore.

b) Nga punimet e viteve të ‘90-a

Edhe lënda e trajtuar në vitet e ‘90-a që kap 17 trajtesa të përfshira në këtë vëllim, sa i përket përmbajtjes në parim është vazhduese e vënerimeve tona të mëparshme, që kishin të bënin me tema praktike gjuhësore, por jopak serioze, ngase ishte dhjetëvjetëshi, kur në shoqërinë tonë këtej, filluan të duken filiza të mëvetësishme cilësore të administratës shqipe, edhe pse ndikimi kalkëzues i serbishtes ishte gjithnjë i pranishëm me forcën e vet parësore zyrtare tradicionale, prandaj ne tërhiqim vërejtjen në disa raste karakteristike, me qëllim të qartë, që ne këtej ta zotëronim e praktikonim sa më mirë shqipen e përbashkët letrare, sidomos të harmonizonim *kosovarizmat* (*gegizmat*) me trajtat e termave që i dinim që përdorëshin në Shqipëri, me qëllim që të sforcohej njëfarë pavarësie e shqipes administrative e teknike te ne, po jo gjithnjë nën hijen e asaj të vendit amë etj. Për këtë, për seriozitetin e çështjeve që trajtuam mjafton të shikohen vetëm titujt e 17 artikujve të shkruar (publikuar) në atë periudhë, ku çështjet e caktuara terminologjike nga trevat tona me të cilat ballafaqoheshim nuk dilnin të zgjidhura, po ne përfshim edhe ndonjë temë që impononte zgjidhje në plan kombëtar, siç janë temat “**Rreth favorizimit të fjalë-termit: “E pame ...”**” por edhe tema me tematikë gjithpërfshirëse, siç është tema “**Rreth përdorimit të fjalës Zot (zotni)...**”, si dhe “**Rreth kontaminimit homonimik emën emnoj, emër1 ndaj emër2 emëroj**”, të cilat ndërkohë si edhe ndonjëra nga temat e tjera paksa u ripunuan. Ndër të tjera, në këtë kontekst dallohet vlerësimi (recensionit) që iu kushtua veprës *Filozofia e gjuhës...* me qëllim që të ndihmoheshin kuadrot tanë deficitarë, të shkolluar në gjuhë të huaja, që sa më mirë të orientohen në njohjen dhe zotërimin e gjuhës shqipe dhe të terminologjisë së saj. Kështu ne duke vënë theksin në lajthitje jo të lehta gjuhësore të shpëtuara në atë libër,

por edhe duke spikatur risimet që e nderonin punën cilësore të autorit, përpiqeshim të jepnim ndihmesën tonë. Kësaj natyre i përket edhe trajtesa kushtuar trillit *spirt*.

Sidoqoftë, në këtë fazë, pra, jo vetëm u rrahen tema me interes rreth harmonizimit të termave me prurje nga Qendra, por edhe aso rreth formimit të fjalë-termave përkatëse për mbulimin e disa koncepteve të caktuara që mjerisht, disa prej tyre, edhe sot e kësaj dite kanë mbetur të pazgjidhura jo vetëm në domenin ndërdialektor te ne, por edhe në kuadër të shqipes standarde, siç janë disa prurje nga gegnishtja, zgjidhja e të cilave paraqet interes begatues për mbarë truallin shqipfolës.

c) Nga punimet e fillimviteve të shek. XXI

Katër temat e fundit, shkruar në shekullin e ri “2000”, të përfshira në këtë përmbledhje, ashtu siç e pamë edhe te ndonjë temë nga periudha e mëparshme, prekin, si me thënë, jo kryekëput çështje *kosovarishte*, por tema të diskutueshme të shqipes standarde, siç janë: kalku “**Binjakëzim qytetesh...**”, pastaj “**Infiksi –IR...**”, dhe sidomos dy temat e fundit në radhë “**Foljet me –AV(ë)...**” dhe “**Rreth rrënjësisë dhe shtrirjes së fjalës kalë...**”, tek të cilat, shtrohen ide të reja rreth të bërit me dije dhe të zgjidhjes së problemeve aktuale fjalëformuese, formëzuese, madje edhe historike e të tjera të shqipes standarde, e përgjithësisht, duke shfrytëzuar natyrën dhe historinë e zhvillimit të gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të standardit të saj në veçanti.

Sidoqoftë, pasi të gjitha këto punime u rilexuan, ndonjëra madje edhe u përpunua, besojmë se çdo lexues i rëndomtë do të jetë në gjendje të kuptojë dhe të dallojë si të kaluarat, d.m.th. punime që mund të arsyetohen fundja edhe si dokumentacion i shkruar, por edhe për nga përmbajtja jo pa vlerë aktuale në dobi të zgjidhjes së çështjeve të hapura, që ne vetëm sa i prekëm, të cilat mund të sfidojnë studiuesit e standardologët e sotëm për t’i vlerësuar dhe për t’i zgjidhur edhe më mirë me kompetencën e duhur.

Prishtinë, nëntor 2016

1) RRETH DREJTSHKRIMIT TË EMËRTIMEVE TË RRUGËVE

(Artikull i botuar në gazetën "Rilindja", Prishtinë, më 10.III.1984)

Nuk është gjë e rastit kur emërtimi i një rruge në adresë, në gjuhën e shkrimeve tona, të dalë e shënuar në pesë a më shumë trajta. P.sh. për **Lenjinova ulica** ose **Skenderbegova ulica**, në gjuhës serbokroate në gjuhën tonë jepen ndër të tjera edhe këta barasvlerës:

Rruga e Leninit, rruga "Lenin", rr. Leninit. rr. "Leninit". (rruga) e Leninit, rruga Leninit, rr. "Lenin"-it, rruga "Lenini", e "Lenjinit", rr. "Lenjin";

përkatësisht:

Rruga e Skënderbeut, rruga "Skënderbeu", rr. Skënderbej, rr. Skënderbejit, Rruga "Skenderbeg", rr. Skënderbe, e ndonjë trajtë tjetër.

Një mishmash i tillë drejtshkrimor vjen, jo vetëm si rezultat i mosnjohjes së rregullave të drejtshkrimit të gjuhës sonë ose nga ndikimi i gjuhës serbokroate te ne, por edhe si pasojë e trajtimit jo të mjaftueshëm të problemit të tillë nga studiuesit tanë.

Me sa di, deri më tash nuk kemi asnjë punim të veçantë që do ta shkoqiste e zbërthente në hollësi këtë çështje, e cila imponohet si problem specifik, sidomos për shkrimet tona në Kosovë, në veçanti. Në të vërtetë, kur kemi të bëjmë me shquarsinë e emrit si emërtim rruge etj. kjo çështje paraqitet si një problem i hapur edhe për mbarë shqipen, apo jo?

Siç dihet emërtimi i rrugëve bëhet në radhë të parë, për saktësim adrese, për nevoja të administratës shtetërore, por që lehtëson edhe komunikimin ndërqytetarë etj., ndërkaq vetë emërtimi zyrtar shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera të natyrës ideologjike ose propagandistike politike. Zakonisht në raste të tilla kihet kujdes rreth gjetjes së emërtimeve të rrugëve, qofshin emrambiemra-njërëzish, emra gjeografikë ose emërtim i ndonjë ngjarjeje të veçantë historike. Gjithsesi me emërtimet e tilla do të kujtohet një shembëlltëri, ndonjë vend a ngjarje me qëllim patriotik-politik, me siguri me levërdi që i përgjigjet sistemit shoqëror-politik ekzistues në fuqi. Së këtejmi

pasi kemi të bëjmë me fjalë-emërtime dhe me një procedure paksa të veçantë administrative, çështja në shqyrtim gjithsesi ka edhe rëndësi gjuhësore. Dhe si rrjedhojë emërtimet e tilla qoftë si emra-mbiemra njerëzish të dalluar, qoftë si emërtime njëfjalësha ose togfjalësha gjeografikë apo të ngjarjeve me rëndësi historike me kuptim jo gjithherë të zakonshëm, të cilët, në emërtime rrugësh a sheshesh, gjuhësisht bëjnë pjesë në kuadër të emrave të përveçëm dhe si të tillë shkruhen me shkronjë të madhe.

E thamë më sipër se kjo problematikë me sa dime, nuk është trajtuar në hollësi si temë e veçantë në gjuhësinë tonë, megjithatë, ç'është e vërteta, çështja e drejtshkrimit të rrugëve në tekste përkatëse normative edhe pse nuk është shënuar si pikë më vete, si rregull drejtshkrimor, por nga lënda e shtruar në "Drejtshkrimin e gjuhës shqipe" (1974) dhe nga "Rregullat e pikësisimit në gjuhën letrare shqipe" del se emërtimi i rrugëve në gjuhën tonë bëhet dy mënyrash:

1. Emri i përgjithshëm **rrugë** shënohet (me shkronjë të vogël) para "një emri a emërtimi në rasën emërore që si emër i përveçëm shënohet me shkronjë të madhe dhe vihen ndërmjet thonjzash", p. sh. rruga "Bardhyl", rruga "Asim Vokshi" etj.;

2. Kur emri **rrugë** hyn në përbërje të emërtimit si "pjesë e emërtimit të përveçëm" në tekst shkruhet me shkronjë të madhe dhe "vihet në thonjza veçan" edhe emri rrugë si p.sh. "Rruga e Dritës", "Rruga e Barrikadave", "Rruga e Partisë" etj. dhe

3. Dihet fakti, si rregull, që në tabelat e rrugëve nuk shënohen thonjëzat, ndërsa në tekstet e shkresave, siç u cek, po.

Tash del çështja që dy shembujt që i mora në trajtim në artikullin tim, në cilën trajtë-formë del e lejueshme të përdoren në faqe gazetash e shkresash, sipas mënyrës së parë apo sipas të dytës?

Pra, a do të shkruajmë rruga "Lenin" apo "Rruga e Leninit", përkatësisht: rruga "Skënderbej" apo "Rruga e Skënderbeut"?

Trajtat e tjera, nga shembujt e mësipërm, vetvetiu kuptohen që janë jo vetëm të diskutueshme, por edhe të paqëndrueshme.

S'do mend se për të zbardhur rastin tonë konkret, lidhur me barasvlerësit në shqipe të dy shembujt që shënuam në ballë do të na ndihmojë vetë barasvlerësi i gjuhës serbokroate: Lenjinova (ulica) ose Skenderbegova (ulica).

Shikuar nga ana formale me sytë e një përkthyesi "bukvalist" (fjalëpërfjalshëm): *Lenjinova (ulica)* ose *Skenderbegova (ulica)* normalisht do të përkthehej (*rruga*) e *Leninit* ose (*rruga*) e *Skënderbeut*, pasi që mbiemri, përkatësisht emri si mbiemër i emëruar **Lenjinova** ose **Skënderbegova** që ka kuptim përkatësie (serb. *pripadnost*) në shqipe përkthehet në rasën gjinore, por duke u bazuar në natyrën e gjuhës shqipe (sipas rregullave të sipërcekura) del se barasvlerësi me të drejtë dhe i vetmi i togfjalëshit **Lenjinova ulica** apo (*Ulica*) *Lenjinova* në shqipe del: **rruga "Lenin"** apo **Skenderbegova ulica** apo (*Ulica*) *Skenderbegova*, **rruga "Skënderbeu"** e jo "Rruga e Leninit" apo "*Rruga e Skënderbeut*" pasi që këtu nuk kemi të bëjmë me kuptimin simbolik të rrugës revolucionare të Leninit (rrugës leniniste të fryrë ideologjikisht), madje as me rrugën luftarake kombëtare të Skënderbeut që në serbishte ky koncept shprehet me sinonimin tjetër **Lenjinov put** apo **Put Lenjina** ose **Skenderbegov put** ose **Put Skenderbega**, por kemi të bëjmë me emërtimin e rrugës (*ulica*) si emër të përgjithshëm të emnuar (nderuar) me emrin "**Lenin**" ose "**Skënderbeg**", për qëllime a motivime të caktuara politike, ideologjike etj.

Sidoqoftë, nga ndikimi i formës shkrimore të gjuhës serbokroate s'ka mundur të jetë imun as ndonjë redaktor e hartues teksti, siç janë rastet jo të pakta si p.sh. në gazetën "*Rilindja*":

Rruga e Mostarit (12.XII.1993), *Rruga e "Proleterit"*(21.VIII.1983), *Rruga e Splitit* (23. II. 1984), *rruga e Sremit* (8. VIII. 1983 dhe 24.X.1983) si dhe rasti i adresës në revistën "*Gjuha shqipe*" nr. 2/83.

Në mbështetje të kësaj që u shtrua më sipër del se duhen të korrigjohen e të interpretohen drejt të gjithë shembujt e dhënë në "*Fjalorin shqip-serbokroatish*" të IA, Prishtinë 1981, f. 837, si barasvlerës për emërtimet e caktuara në gjuhën serbokroate. Pra:

jo rruga e Shkupit (Skopska ulica) po rruga "Shkupi", jo rruga e Goleshit (Goleška ulica) po rruga "Goleshi", rruga e herojve të popullit (ulica narodnih heroja) po rruga "Heronjtë e Popullit", jo rruga Ballkani (Balkanska ulica) po rruga "Ballkan", jo rruga e Skënderbeut, po rruga "Shënderbeu"ose "Skënderbej" etj.

Në këtë kontekst, lypsen sqaruar rastet kur kemi të bëjmë me ndonjë emërtim (praktik) popullor, kur emërtimi i tillë në kontekst tregon drejtimin ku shpie rruga e caktuar, kështu b.f. në Kaçanik apo Elez-Han si emërtim "gjeografik" mund të jetë i qëndrueshëm emërtimi "Rruga e Shkupit", d.m.th. rruga që shpie (çon) në Shkup si kundërvënie me "*Rruga e Ferizajt*", në Tiranë "*Rruga e Kavajës*", në Prizren: *Rruga e Kukësit*, ose në Kukës: "*Rruga e Prizrenit*"

etj., emërtime këto (popullore) faktikisht në përdorim e sipër dhe si të tilla janë funksionale, por me sa di shkrimisht askund nuk dalin të sqaruara: si do të shkruhen me thonjëza a pa to, me ahkronjë të vogël a të madhe fjala e parë! Madje, kur përdoret stili italic i shkronjave?! Kurku ndërhyt shkronja e madhe në emërtime togfjalësha të bashkuar ose të lirë e kur jo? Rastet e tilla duhet të jenë të lejueshme, por si të shënohen adresa zyrtare, familjare, siç përdoren në jetën e përditshme apo jo?!

Po përsëris, me sa di, çështjet e tilla nuk janë të sqaruara në asnjërin nga dokumentat zyrtarë normativë në gjuhën tonë. Ma merr mendja që rastet e tilla duhen konstatuar dhe zgjidhur. Pra, mendimi im, kur është fjala p.sh. për ndonjë rrugë brenda qytetit të Prishtinës të emërtuar b.f. me emrin e Shkupit, Beogradit, Parisit e ku ta di, atëherë sipas rregullit duhet të shënohet rruga "Shkupi", rruga "Beogradi", rruga "Parisi" e jo ndryshe, pra jo *rruga e Shkupit*, rr. *e Beogradit*, edhe pse në serbokroatisht del: *Skopska (ulica)*, *Beogradska (ulica)*.

Mbetet çështje e hapur për gjuhën tonë, jo vetëm problemi i shquarsisë të emrit si emërtim rruge: rruga "*Lenin*" apo rruga "Lenini"), ose rruga "*Skënderbej*" ose rruga "*Skënderbeu*", përkatësisht rruga *Beograd* apo *Beogradi* (si emra gjeografikë), por edhe drejtshkrimi i emrave e mbiemrave të huaj personalë mbetet çështje e hapur si të shënohen në gjuhën shqipe, madje te ne, si të shënohen sidomos emrat e kombeve e të kombësive, përveç atyre të shqiptarëve atyre ndërkombëtarë. Pastaj si të bëhet shkrimi i emërtimeve të rrugëve në tekstet shqipe të adresave si jashtë e sidomos atyre brenda truallit të shqipes, të shkruhen emërtimet sipas ortografisë origjinale ose sipas shqiptimit të përafërt përkatës në alfabetin tonë, madje dallimi me shkronjat italiane mund t'i zëvendësojë thonjëzat, apo jo?! etj.

Gjithsesi edhe këto çështje lypset trajtuar e sqaruar nga gjuhëtarët tanë kompetentë të Qendrës, apo jo?!

Prishtinë, 23.II.1984

2) TUBIMI I PUNËTORËVE, KËSHILLI I PUNËTORËVE E JO TUBIMI PUNËTOR, KËSHILLI PUNËTOR

(Artikull i botuar në revistën "Gjuha shqipe", Prishtinë, nr. 2/84)

Në shkrimet tona, sidomos në kohë të fundit, vihet re dukuria e zëvendësimit të termave togfjalësha: *tubimi i punëtorëve, këshilli i punëtorëve* me trajtat po ashtu me togfjalësh, po me mbiemër sintetik: *tubimi punëtor, këshilli punëtor*.

Një dukuri e tillë që mund të ketë shtrat lindje në stilin bisedor apo është lancim i dikujt jashtë vatrës së krijimit dhe përdorimit zyrtar të përditshëm të termave të tillë, gjithnjë e më shumë po fiton zgjerim përdorimi edhe në mjetet tona të informimit, duke e vënë në dyshim apo duke e nxjerrë jashtë trajtën drejtshkrimore: *tubimi i punëtorëve, përkatësisht këshilli i punëtorëve*.

Sa për ilustrim po sjell disa shembuj që i shënova vetëm brenda një muaji në gazetën "Rilindja", kryesisht në faqet ku bëhet publikimi i shpalljeve dhe konkurseve të organizave të punës së bashkuar

1) *Tubimi punëtor në Dobrasellë - Prishtinë (26.XII.1993 f. 3); Tubimi punëtor i Shtëpisë së Kulturës "B. Kidriq" të Vitisë (24. XII.1993, f. 23); Tubimi punëtor i OBPB "Barnatoret" të Podujevës (19.I.1984, f. 19); Tubimi punëtor i OP për termofikim "Ngrohtorja e qytetit", të Gjakovës (23.I.1984 f. 19), Tubimi punëtor i Konviktit të Rinisë" I. L. Ribar" - Prizren (23.I.1994, f. 15).*

2) *Këshilli punëtor i OP "Vinex" - Viti (26.XII.1993, f. 3), Këshilli punëtor i OTHPB "Taftison"- Gjilan (26.XII.1983 (dy raste), f. 19), Këshilli punëtor i OTHPB "Elektroinstaluesi"-Pejë (19.I.1984, f. 19), Këshilli punëtor i OBPB "Universal" -Prishtinë (26.I.1984, f. 18), Këshilli punëtor i OTHPB të revistave - Prishtinë (26.I.1984, f. 18), Këshilli punëtor i OTHPB "klinika interne" e FM të Prishtinës (28.I.1984, f. 23), Këshilli punëtor i Shtëpisë së Shëndetit të Lipjanit, 28.I.1994, f. 23).*

Siç po shihet edhe nga shembujt e mësipërm një dukuri e tillë është shtrirë te ne vargevi madje edhe vazhdon me intensitet të shtuar (Shih edhe në gazetën "Rilindja", 14. II.1984, f. 1, 5 dhe 19) duke u paraqitur si trajtë mbizotëruese në krahasim me trajtat **tubimi i punëtorëve**, përkatësisht **këshilli i punëtorëve**, të cilat (trajtat kontestuese) vazhdojnë të përdoren edhe në dokumentat përkatës zyrtarë, po që ndeshen edhe në mjete të tjera informative si:

Në gazetën "Shkëndija" nr. 3/84, f. 6, në revistën "Jeta e re" nr. 2/84, f. 387, në gazetën "Rilindja" (18.II.1984, f. 20, në rubrikën "Juristi ju përgjigjet", e në ndonjë rast tjetër, prandaj është e udhës të tërhiqet vërejtja lidhur me këtë dhe si rrjedhojë del e nevojshme që kjo temë të trajtohet si një çështje problemore gjuhësore.

Ç'është e vërteta, vërejtja jonë ka të bëjë me përdorimin e mbiemrit *punëtor* në vend të emrit shumës të rasës gjinore "**i punëtorëve**", si gjymtyrë e dytë e fjalëve: **tubim, këshill** në togfjalësh dhe parimisht një transformim i tillë është i mundshëm në gjuhën tonë si p.sh. klasa punëtore, aristokracia punëtore shërbyesit punëtorë etj, kur emri i rasës së zhdrejtë kalon në mbiemër të panyjshëm cilësues të ndërmjetuar.

Mirëpo duhet pasur parasysh faktin se zëvendësimi i emrit shumës i rasës gjinore si në rastin konkret **i punëtorëve** me mbiemrin në njëjës **punëtor** nuk është i lejueshëm për arsye se "emri në gjinore (...) shpreh përkatësi (...), ndërsa mbiemrat përkatës më -OR/E shprehin një tipar cilësor e jo marrëdhënie përkatësie (prandaj ata nuk mund (*nuk duhet*) të përdoren në vend të emrave)" (Shih: Gjuha letrare për të gjithë, Tiranë 1976, f. 215), prandaj edhe në rastin tonë në shqyrtim me të drejtë shprehim rezervë lidhur me një zëvendësim të tillë.

Lidhur me togfjalëshin: *klasa punëtore, lëvizje punëtore, kontrolli punëtor, aristokracia punëtore* ("pjesa e borgjezuar e klasës punëtore") etj. do konstatuar se asnjëri nga këta shembuj nuk shpreh ndonjë organ "të pushtetit", por tregojnë një veprim që ka të bëjë me punëtorët, është i përbërë nga punëtorët apo ka lidhje kuptimi të ndërmjetuar me ta, ndërkaq trajtat **tubimi punëtor** dhe **këshilli punëtor** nuk kanë të njëjtën fushë kuptimore apo të ngjashme me shembujt e mësipërm, pasi që këtu është fjala për aspektin e organeve të *pushtetit vetëqeverisës të punëtorëve a të punonjësve*, prandaj del e nevojshme të ceket përcaktori "**i punëtorëve**", sepse nuk mjafton vetëm cilësia përcaktuese e ndërmjetuar "punëtor".

Meqenëse këta dy terma janë specifike për sistemin politik e shoqëror të vetëqeverisjes (vetadministrimit) të ne, është e nevojshme dhe fare e natyrshme që të konsultohen barasvlerësit adekuatë në gjuhën e kombeve dhe të kombësive që përdoren në Jugosllavi, sepse në këtë kontekst u farkëtuan në gjuhën shqipe të ne edhe termat a trajtat në fjalë: **tubimi i punëtorëve (punonjësve) dhe këshilli i punëtorëve.**

Kuptimi i termit serbokroatisht: *zbor radnih ljudi*, sllovenisht . *zbor delovnih ljudi*, maq. *sobir na rabotnite luge* dhe shq. *tubimi i punëtorëve* (Shih: Enciklopedija upravljanja, Beograd 1980, f. 925.), sipas LPB (1976) është përcaktuar si një formë e vetëqeverisjes në organizatat e punës së bashkuar dhe si njëri nga aspektet e deklaramit personal të punonjësve lidhur me vendosjen për të drejtat e tyre të patjetërsueshme" (Shih: "Pravni leksikon" Beograd 1979, f. 1683.), por që në shembujt e nxjerrë nga shkrimet tona konsiderohet si organ a si aspekt qeverisës, nuk ka arsye të përkthehet me togfjalëshin *tubimi punëtor*, por **tubimi i punëtorëve a tubimi i punonjësve.** (Shih edhe te "Komentar zakona o udruženom radu", Beograd 1980, f. 1224.)

Sa është pavend përkthimi me mbiemër në vend të emrit në gjinore, shihet edhe nga këta dy shembuj:

1. serb. *zbor birača - mbledhja a tubimi i zgjedhësve* dhe
2. *zbor gradjana - tubimi i qytetarëve.*

Pra, për konceptet e tilla nuk mund të thuhet në shqipe *tubimi zgjedhës!* apo *tubimi qytetar!* A *tubimi punonjës* sepse del me kuptim krejt tjetër ose s'ka kuptimi fare, andaj pa kurrfarë rezerve duhet të përdoret analogjikisht termi: **tubimi i punëtorëve a tubimi i punonjësve** ose **tubimi i njërëve punues**, siç është në *Fjalorin terminologjik juridk serbokroatisht -shqip*, Prishtinë 1979, f. 179, prandaj s'ka arsye të dalë trajta: *tubimi punëtor*.

Edhe termi: serb. *radnički savet*, sllov. *delovski savet*, maq. *rabotnički savet* dhe shqip: *këshilli i punëtorëve*, (Shih: Leksikon samoupravljanja, f. 866.) sipas LPB-së është përkufizuar si "organi më i lartë qeverisës i obliguar i të gjitha formave të organizatës së punës së bashkuar dhe i organizatës së përbërë të punës së bashkuar", (Shih: *Pravni leksikon*, f. 888 dhe *Komentar ZUR-a* f. 837.) që del si rezultat a shprehje e aplikimit të parimit socialist "*pushteti i punëtorëve*" a "*fabrikat e punëtorëve*", në gjuhën shqipe nuk ka kurrfarë arsyeje të modifikohet në togfjalëshin: *këshilli punëtor*.

Një konstatim i tillë mbështetet dhe nxirret nga kuptimi leksikor i fjalës "këshill/këshilli" në shqipen e sotme letrare dhe për të qenë më e kapshme lënda që po e trajtojmë, më poshtë po i jap disa shembuj të nxjerrë nga kuptimi leksikor i kësaj fjale, sipas FGJSSH-së f. 827, duke e përshtatur paksa me realitetin tonë gjuhësor të ne, sigurisht duke i shënuar krahas edhe barasvlerësit e gjuhës serbokroate:

a) si organe të larta të pushtetit:

1. Këshilli popullor - Narodni odbor - si organ i përgjithshëm i pushtetit shtetëror – popullor;

2. Këshilli i Shtetit - Državni savet,

Këshilli i Ministrave - Ministarski savet,

Këshilli i Mbrojtjes Popullore - Savet narodne odbrane

Këshilli i punëtorëve (i OBPB-së) - Radnički savet (OOUR-a),

Pleqësia e shkollës (universitetit, e bashkësisë punonjëse) - Savet škole (universiteta, radne zajednice).

b) si organe kolegjiale, profesionale a drejtuese:

1. Këshilli i profesorëve - Profesorsko veće;

2. Këshilli i arsimtarëve - Nastavničko veće;

3. Këshilli punëdrejtues - Poslovodni odbor etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm **këshilli i punëtorëve** (radnički savet) bën pjesë në kuadër të organeve "**të larta të pushtetit**". Në gjuhën serbokroate, zakonisht vetëm për emërtimin e organeve të "pushtetit shtetëror" përdoret fjala **savet**, ndërsa për kuptimet e tjera përdoren zakonisht termat: *odbor, veće a kolegijum*.

Edhe sa i përket traditës së shkrimit togfjalëshat "*tubimi i punëtorëve, këshilli i punëtorëve*" kanë stazh më të gjatë përdorimi si terma teknikë të fushës vetëqeverisëse. Si terma në trajtë të tillë janë kodifikuar në aktet më të larta ligjore e normative. Kështu i ndeshim të shënuar edhe në fjalorët përkatës normativë (Shih edhe te: "*Terma dhe shprehje të tjera nga LPB-ja (projekt)*", Prishtinë 1977, *Fjalori terminologjik juridik shqip - serbokroatisht*, Prishtinë 1979, *Enciklopedija samoupravljanja*, Beograd 1980, *Fjalori shqip - serbokroatisht*, IA, 1981 etj.), prandaj për ndryshimin e trajtave të tyre duhet të qëndrojnë arsye tejet të forta gjuhësore e jashtëgjuhësore.

Me sa u tha më lartë mund të thuhet se më të drejta dalin trajtat **Forumi i intelektualëve** sesa **Forumi intelektual**, **Forumi i të rinjve** sesa **Forumi rinor** etj., dhe gjithsesi **Këshilli i punëtorëve**, **Tubimi i punëtorëve** sesa **këshilli**

punëtor, tubimi punëtor , emërtime këto mjaft frekuentuese në realitetin tonë aktual shoqëror e politik.

(Prishtinë, 28.II.1984)

3) SHPREHJA "I PAZHLLUAR SA DUHET" SI SHKARJE SEMANTIKE

(Artikull i botuar në gazetën "Bujku", Prishtinë, 29.VI.85)

Kësaj here në shqyrtim del një rast specifik që ka të bëjë me një ndikim të gjuhës serbokroate në gjuhën tonë si rrjedhojë e përkthimit të fjalëpërfjalshëm. Është fjala rreth barasvlerësisë së mbiemrave të prejardhur të gjuhës shqipe me parashtesën *pa-* ballaballas mbiemrave të gjuhës serbokroate me parashtesën *ne-* të tipit: **i (e, të) pazhvilluar**, përkatësisht **nerazvijen/a/o**.

Më poshtë po jap tre shembuj në tri raste në gjuhën serbokroate me barasvlerësit përkatës në gjuhën shqipe, ashtu siç dalin në raste të caktuara në realitetin tonë gjuhësor:

1. *razvijeno područje* - rajon i zhvilluar;
nerazvijeno područje - rajon i pazhvilluar;
dovoljno nerazvijeno područje - *rajon i pazhvilluar sa duhet(!)*;
2. *iskorišćena sredstva* - mjete të shfrytëzuara;
neiskorišćena sredstva - mjete të pashfrytëzuara;
dovoljno nekorišćena sredstva - *mjete të pashfrytëzuara sa duhet(!)*;
3. *proučena pitanja* - çështje të studiuara;
neproučena pitanja - çështje të pastudiuara;
dovljno neproučena pitanja - *çështje të pastudiuara sa duhet(!)*.

Siç po shihet nga barasvlerësia e shembujve të mësipërm duke u vazhduar përkthimi i fjalëpërfjalëshëm, pasi që dy rastet e para qëndrojnë, në rastet e treta, pa vetëdije, është bërë shkarje semantike. Themi "shkarje semantike", sepse shikuar veç e veç të gjithë barasvlerësit e togfjalëshit të caktuar qëndrojnë ballaballas njëri tjetrit në gjuhët përkatëse, por sa i përket kuptimit të tërësishëm ndryshon raporti.

Mbase logjikisht mund të thuhet "rajon i zhvilluar sa duhet (dovoljno razvijeno područje), por nuk bën të thuhet "rajon i pazhvilluar sa duhet", sepse shprehja "sa duhet", si shprehje ndajfoljore përcaktore semantikisht nuk mund të përcaktojë një fjalë (mbiemrin prejfoljor) që tregon mohimin e një fjale

tjetër, siç janë rastet e mësipërme, sepse shprehja në fjalë ruan në vetvete gjithsesi kuptimin e foljes dua (duhet /me dashtë/): "dëshiroj të kem diçka" (FGJSSH f. 380) ose të kem (me pasë) aq sa është e domosdoshme a sa është e nevojshme, përkatësisht me shprehjen "sa duhet" apo "aq sa duhet" në gjuhën tonë kuptohet diçka që na nevojitet "në masën a shkallën e duhur, pa teprime e zvogëlime; aq sa është e nevojshme apo aq sa kërkohet" (FGJSSH f. 384) dhe vetvetiu kuptohet se kjo shprehje s'ka se si të qëndrojë si përcaktor pas mbiemrave si më sipër: "*i pazhvilluar*", "*të pashfrytëzuara*", "*e pastudiuara*", sepse moszhvillimi, mosshfrytëzimi (i mjeteve) apo mosstudimi as që i duhen kujt, as "kaq" as "aq" as fare, apo jo?!

Mirëpo në gjuhën serbokroate në kontekste të caktuara (madje edhe parapëlqehet) parashtesa e mohimit ne-, e cila i shtohet pikërisht ndajfoljes dovoljno, si p. sh.:

-nedovoljno razvijeno područje - rajon i zhvilluar jo sa duhet ose rajon jo mjaft i zhvilluar;

- nedovoljno iskorišćena sredstva - mjete jo të shfrytëzuara sa duhet ose mjete jomjaft të shfrytëzuara;

- nedovoljno proučena pitanja -çështje jo të studiuara sa duhet ose çështje jo mjaft të studiuara.

U tha më sipër, siç doli edhe nga shembujt e mësipërm, se si barasvlerës i ndajfoljes **dovoljno** të serbokroarishtes, pos shprehjes "**(aq) sa duhet**" del edhe ndajfolja "**mjaft** (mjaftueshëm), por fjala **mjaft** del si barasvlerës edhe për ndajfoljen **dosta** të serbokroatishes, për të cilën shprehja "**sa duhet**" nuk mund të përdoret. Prandaj edhe këtë fakt është mirë ta kemi parasysh, si p.sh.:

- dosta nerazvijeno područje - rajon mjaft i pazhvilluar ose mjaft rajon i pazhvilluar(!) etj.

Është i njohur fakti se një nocion mund të shprehet në disa mënyra, prandaj edhe rastet e mësipërme mund të kenë ndonjë variant tjetër, por patjetër duhet pasur kujdes që mos të cenohet kriteri semantik i kontekstit në gjuhën tonë.

Nga kjo që u tha më sipër del se ndajfolja **dovoljno** e serbokroarishtes në gjuhën shqipe veç fjalës **mjaft** ka si barasvlerës shprehjen "**(aq) sa duhet**", prandaj është e udhës që një fakt i tillë të shënohet edhe në fjalorët përkatës. Gjithashtu edhe për mbiemrat e tipit "**nerazvijen/a/o**" të serbokroatishes në

shqipe duhet te shënohet edhe shprehja barasvlerëse e tipit "**jo i zhvilluar**", krahas barasvlerësit të tipit: **i pazhvilluar**" etj.

Besoj se një fakt i tillë gjithsesi do të ndikonte që shkarjet (pa dashje) semantike të tipit "*i pazhvilluar sa duhet*" (*dovoljno nerazvijen*) mos të përsëriten, siç po ngjet jo rrallë ndër ne, jo vetëm në stilin bosedor, por edhe në paraqitje publike, në referate e në mjete të informimit edhe në ndonjë punim shkencor, siç është rasti në revistën "*Gjuha shqipe*"(nr. 2/84 f. 51).

4) RRETH KRISTALIZIMIT TË KUPTIMIT

TË FJALËS NISMË/NISMA

(Artikull i botuar në gazetën "Shkëndija", Prishtinë, nr. 6/85)

Me fjalën *iniciativë iniciativa* (me origjinë latine: initium - fillim, nisje), e cila si ndërkombëtarizëm është përhapur në gjuhë të ndryshme, në FGJSH 1954 jepet ky përkufizim: "*shtysa e parë, hapi i parë në një punë*" dhe "*cilësia e atij që është i hedhur dhe guximtar, kur i hyn një pune*" (Aty f. 1981.) dhe për këtë është shënuar përgjegjësja **nismë nisma**, e cila do t'i konkurrojë si sinonim këtij ndërkombëtarizmi dhe çka është me rëndësi të dihet dhe të theksohet sot për sot që me këtë fjalë (nisma), sipas FGJSSH, u zëvendësua pothuajse plotësisht kuptimi i parë i fjalës **iniciativë**, siç u cek më sipër, pasi që tash për fjalën **nismë** jepet ky përkufizim: "*punë që merr përsipër i pari dhe me vullnetin e me dëshirën e vet një punonjës a një kolektiv për të bërë ose për të organizuar diçka, zakonisht të re e që kërkon përpjekje*". (Aty f. 1267.) dhe për këtë është shënuar fjala **iniciativë**, si sinonim apo si përgjegjëse reference, e cila sipas këtij fjalori ruan kuptimin e dytë nga FGJSH (1954) që tashti është riformuluar kështu: "*aftësi për të parë i pari e në mënyrë të pavarur në punë e në jetë, për të filluar një punë a për të vetëvepruar, për t'i dhënë shtysën e parë diçkaje ose për të nxitur të tjerët të ndërmarrin një punë*". (Aty f. 722.) dhe për këtë shënohet barasvlerësi përgjegjës **vetëveprim** "*diçka që bëhet me vetë nismën e dikujt*". (Po aty f. 2148.)

E kemi të njohur faktin se me kuptimin e fjalës *iniciativë* Naum Veçilharxhi përdori fjalën *e nisërë*, ndërsa në gjuhën e sotme, siç u tha, përdoret trajta **nismë** (nis+më), e cila si të themi, bashkëjeton me trajtën *iniciativë*.

Ç'është e vërteta, fjala **nismë**, sipas FGJSSH-së, mund të ketë edhe ndonjë nuancë kuptimësie që u përgjigjet fjalëve *zanafillë*, *fillim* apo *pikënisje*, (Aty f. 1267.) por një sinonimi e tillë nuk është e fortë dhe, sipas këtij burimi, as që duhet favorizuar, pasi që te fjalët përkatëse nuk shënohet fare trajta **nismë** si një barasvlerës i mundshëm, prandaj tërë përqëndrimi i kuptimit të fjalës **nismë** mbetet si barasvlerës i një pjese të fjalës **iniciativë**, e jo i fjalëve: *zanafillë*, *fillim*, *nisë*, *pikënisje*, apo jo?

Sa është identik përkufizimi i fjalës **inicitivë** me përkufizimin e fjalës **nismë** që jepet në gjuhën tonë po e ilustroj me këta dy shembuj që i solla nga gjuha frënge dhe ajo serbokroate, p.sh. në frëngjishte: *initiative*: "*action de*

celui qui propose ou qui fait le premier quelque chose" (aksioni i atij që propozon ose bën diçka i pari) (Shih: *Nouveau petit Larousse* f. 544) dhe në serbokroatishte: *inicijativa*: (sipas fjalorëve përkatës) : "*Prvi poticaj (potrtreh, pobuca, predlog, pokretanje) za otpočivanje nekog posla, početni korak u nekom poslu; preduzetnost*" (shtytësi/nxjtësi, nismësi / i parë për fillimin e një pune, hapi i parë në një punë; nismëri).

Pra edhe nga përkufizimet që u cekën më sipër mund të konstatohet se fjala **iniciativë** mund të këmbehet a të "përkthehet", me të drejtë, me barasvlerësin **nismë** të gjuhës sonë dhe një zëvendësim i tillë është i parapëlqyeshëm sipas kontekstit të caktuar.

Konstatojmë me kënaqësi se një sinonimi e tillë është kuptuar drejt edhe te ne dhe po gjen zbatim, por ka raste jo të rralla kur fjala **nismë** po përdoret në vend të fjalëve **fillim, nisje, nisë** etj., edhe pse siç e pamë, ajo (fjala nismë) ka sinonimi të mirëfilltë vetëm me fjalën **iniciativë**, jo me fjalë të tjera.

Nisur nga ky konstatim na dalin jo të drejta nga aspekti semantik të gjitha rastet e shënuara më poshtë që u nxorrën nga mjetet tona të shtypit të përditshëm a periodik, p.sh.:

1. "*në nismën tonë për këtë vit akademik...*" (*Bota e re* 13-14/84 f.2) "*në nismë të studimeve*" (*Zëri i rinisë* nr. 43/84 f.31), "*nismë e mirë*" (*BAT* nr. 8/84 f.2) etj. që është fjala për fillimin e punëve të caktuara e jo për iniciativë.

2. Nga gazeta "*Rilindja*" sa për ilustrim po i jap vetëm këto raste: "*Objekti në nismë...*" (datë, 28.08.1984 f.10), "*në nismë të spektaklit*" (dt.30.07.84 f.2), "*nismë e mbarë e hendbollistëve*" (dt. 12.10.1984) "*garat kanë nismë të parapëlqyeshme*" (dt. 21.08.1984 f.18) etj.

Mendoj se në të gjitha rastet nga shembujt e mësipërm fjala **nismë** duhet të zëvendësohet me fjalët përkatësisht: **fillim, nisje, nisë, zanafillë, pikënisje** etj. dhe se një lëshim i tillë duket fare qartë po të zëvendësohej fjala **nismë** me **iniciativë**, me të cilën siç e pamë, normalisht mund të këmbehet vetëm fjala **nismë**, e cila, madje si burimore, del edhe më e parapëlqyeshme.

Së këndejmi, për t'iu shmangur lëshimeve eventuale lidhur me këtë do të ishte e këshillueshme që sa herë të përdorim fjalën **nismë** le të na shkojë mendja në çast të fjalës **iniciativë**, e nëse kuptimi me të përputhet relativisht, atëherë me siguri konteksti do të dalë i qëlluar, përndryshe duhet kërkuar zgjidhje tjetër, jo nismë.

Gjithsesi mbetet çështje stili e shije përdorimi i njërës po tjetrës fjalë sinonimike *nismë* apo *inisiativë*, por duhet ta kemi të qartë faktin ose prirjen e gjallë të gjuhës sonë lidhur me sforcimin e kuptimit të fjalës **nismë** në krahasim me fjalën *iniciativë*, e cila gjithashtu nuk përjashtohet nga fondi aktiv i leksikut të gjuhës sonë, por secila trajtë merr nuancimin e veçantë kuptimor të caktuar që del nga konteksti, sipas përkufizimeve që u ilustruan me shembujt përkatës të sipërshënuar.

Në përmbyllje po shtoj edhe faktin mbi nevojën e përdorimit apo jo të foljes *inicoj/inicohet*, e cila është refleks i fjalës *iniciativë*, përkatësisht i trajtës *iniziare* (*iniciare* - me *inicie*) të italishtes ose *inicirati* të serbokroatishtes.

Në të vërtetë, për trajtën *inicirati* Klaiqi në serbokroatisht jep këto përgjegjëse shpjeguese: *pokrenuti, započeti, dati pobudu* etj. (RSR f. 390.), prandaj edhe në shqipe për foljen **inicoj** mund të përdorim përgjegjëset përkatëse: *nis, filloj, nxit*, krahas: *hap, cyt, shtyt* etj. apo ndoshta edhe foljen *nism/nismet a nismoj/nismohet (me nismue)*, që një përftim i tillë është i mundshëm dhe del fare natyrshëm, përdorim ky që varet nga vetë forcimi i kuptimit a i përdorimit të fjalës **nismë nisma**.

5) BANORËT E FERIZAJT APO BANORËT E FERIZAJIT?

Në një artikull të botuar në gazetën "Rilindja", më 25.X.1986, f. 15, veç tjerash tërhiqet vërejtje, siç thuhet aty "të përdorimit të gabueshëm" të shprehjes "*banorët e Ferizajt*", shprehje kjo që sipas autorit duhet të shënohet "*banorët e Ferizajit*" d.m.th. sipas tij emri i qytetit duhet shquhet duke e marrë nyjën shquese **-i-(!)**.

Në mënyrë që lexuesit si dhe autori të mos mbesin me bindje të gabuar, pa hyrë në hollësi, tërheq vëmendjen se kërkesa e tillë nuk del fort e bazuar. Andaj rreth kësaj çështjeje po i rikujtoj dy fakte, të cilat nuk shkojnë në favor të gjykimit të autorit, siç u cek më sipër, por janë fakte që dëshmojnë të kundërtën.

Së pari, nga konsultimi i burimeve të caktuara normative leksikografike, siç janë: "*Fjalorit drejtshkrimor i gjuhës shqipe* (1974, f. 739), "*Fjalorit shqip-serbokroarisht, IA., Prishtinë* (1981) si dhe të "*Fjalorit të shqipes së sotme*, Tiranë (1984), del se fjala Ferizaj, si term (emërtim) gjeografik, është shënuar me shquarsi përfaqësuese të "ngurtësuar", pra pa nyjën shquese -i. Ky rast nuk është i vetmuar në burimet në fjalë, aty janë afro 70, përkatësisht 80 shembuj të tillë, prandaj s'di sa mund të cilësohet "gabim" shprehja "*banorët e Ferizajt*"?! Përkundrazi, sipas burimeve në fjalë, shprehja "*banorët e Ferizajit*" do të konsiderohej si shkelje e normës letrare. Pra, për këtë "lëshim" pa të drejtë fajësohet "shtypi, radio e televizioni" ynë, siç shprehet autori, apo jo/!

Së dyti, me sa më kujtohet pikërisht kjo çështje është trajtuar në revistën "*Gjuha jonë*", ku mbrohet qëndrimi që emrat gjeografikë si dhe mbiemrat personalë më -aj dhe -ej, tipi: Bicaaj, Ferizaj, Musaraj, Çabej etj. kanë shquarësi zero, nëse mund të thuhet kështu, d.m.th. pa nyjën shquese -I, prandaj duhet të shkruhet sipas normës: "veprat e Musarajt", "veprat e Çabejt", banorët e Ferizajt e jo "veprat e Musarajit", "veprat e Çabejit"; "*banorët e Farizajit*" etj., ngase theksi i fjalës sipas shqiptimit letrar nuk bie mbi zanoren e fundit, por te ajo e parafundit.

Sigurisht edhe kjo çështje mund të diskutohet, mirëpo për të dhënë gjykim të prerë mohues krahas mbështetjes së fortë sipas argumentave pohues të sipërcekur duhet pasur edhe kompetencë.

(Prishtinë, 1.XI.1986)

6) AKTROJ (AKTRIM) APO AKTOROJ (AKTORIM)
(Artikull i botuar në gazetën "*Rilindja*", Prishtinë, 20.XII.1986)

Rreth fjalës aktroj (aktrim) të përftuar ndër ne është bërë fjalë edhe më përpara, madje një "neologjizëm" i tillë është cilësuar si një "kalk i dobët" për fjalën glumiti (glumljenje, gluma) të serbokroatishtes, apo si një fjalë "e formuar gabim në gjuhën tonë (...) nga disa njerëz që nuk e njohin mirë gramatikën dhe strukturën fjalëformuese të shqipes" (Shih: S.I. "Shtrembërime gjatë formimit të fjalëve të reja", artikull i botuar në gazetën "Rilindja", më 23.II.1985, f. 15).

Megjithë vlerësimin e mësipërm, ç'është e vërteta, kjo fjalë vazhdon të përdoret po ashtu, siç e vëren edhe autori në fjalë, "dendur si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar". Mjafton të cek vetëm këto burime sa për ilustrim, ku fjala aktroj (aktrim) është përdorur në konstrukte të caktuara të të shprehurit, si p.sh. në gaz. "Rilindja", më 19.I.1986, f. 12; 12.IV.1986; "Jeta e re", nr. 3/86, f. 380; "Fjala", nr. 18 - 19/86, f. 17; "Zëri i rinisë", 1.VIII.1986, f. 19 etj., duke bërë kështu, si të themi, jetë të pavarur në fondin aktiv të leksikut tonë, edhe pse në vetvete gjithnjë ruan qartë barasvlerësinë me konceptin e fjalës **glumiti (glumljenje, gluma)** të serbokroatishtes, madje një barasvlerësi të tillë e favorizon, përkatësisht e "ushqen" edhe vetë prania e kësaj fjale në Fjalorin shqip - serbokroastisht, IA, Prishtinë 1981, f. 19, burim normativ ky, i cili është në përdorim të përditshëm te ne.

Duke i dhënë të drejtë, në njërin anë, qoftë edhe pjesërisht autorit rreth "shtrembërimit" të fjalës në shqyrtim, sidomos në aspektin e fjalëformimit dhe njëherazi duke pasur respekt ndaj autorëve që e favorizojnë përdorimin e kësaj fjale në anën tjetër (duke përfshirë edhe autoritetin e fjalorit në fjalë) e shoh të nevojshme dhe me interes të them diçka, së pari rreth mënyrës së përfutimit të kësaj fjale duke pasur për bazë rrethanat, përkatësisht si faktorët e jashtëm ashtu edhe ata të brendshmit që kanë ndikuar në "lindjen" e gjallimit të një trajte të tillë dhe së dyti, do të bëj fjalë rreth barasvlerësisë ekzistuese sinonimike që ka "neologjizmi" në fjalë në gjuhën tonë në raport me barasvlerësit e caktuar të gjuhës serbokroate dhe të ndonjë gjuhe tjetër.

Siç u tha më sipër, është i pakontestueshëm fakti se fjala **aktroj** (aktrim) është krijuar si kalkëzim për fjalën **glumiti** (glumljenje, gluma) të serbokroatishtes. Pra, faktori i jashtëm ishte faktori motivues, ndërkaq "kalkëzimi" është bërë me mjete të shqipes. Ç'është e vërteta, për nga struktura fjalëformuese ky përfutim mund të shpjegohet në dy mënyra:

e para, duke u marrë si temë prodhuese fjala **akt** (lat. actus), plus prapashtesa -RO/j e gjuhës shqipe, siç e konsideron autori në artikullin e sipërcekur dhe

e dyta, nga fjala **aktor** (lat. actor) plus prapashtesa -O/j e shqipes, siç na imponohet kur kemi parasysh ndikimin konkret të fjalës **glumac**, përkatësisht të foljes **glumiti** të serbokroarishtes që në shqipe ka barasvlerësin **aktor**, përkatësisht reflektimin e foljes **aktroj** (**me aktrua**), qëndrueshmëria e sëcilës goditet në njëfarë dore, por edhe nuk qortohet aq në këtë trajtesë.

Nëse pranohet ndërtimi sipas mënyrës së parë, atëherë sipas rregullave për formimin e foljeve në fuqi të gjuhës sonë, pas temës **akt-** përkatësisht para prapashtesës -RO/j vihet një -Ë- mbështetëse, sikurse te shembujt lajmëroj (lajm), lavdëroj (lavd), ligjëroj (ligj) etj. (Shih edhe GJLSHGJ f. 228), prandaj kjo trajtë foljore duhet ndërtuar e drejtshkruar kështu: **aktëroj** (**me aktërua - aktërim**).

Nëse pranohet mënyra tjetër e ndërtimit (përfitim), pra nga emri aktor, atëherë temës aktor i shtohet prapashtesa foljore -O/j dhe trajta foljore del **aktorj** (**me aktorua - aktorim**).

Pra, siç po shihet, sipas rregullave a modeleve fjalëformuese në fuqi të gjuhës sonë janë të qëndrueshme të dyja trajtat **aktëroj** dhe **aktorj**, kurse trajta **aktroj** jo. Mënyra tjetër se mos kemi të bëjmë me huazim të ashtuquajtur hibrid mbi bazë të trajtës foljore të ndonjë gjuhe tjetër ku huazohet tema e zëvendësohet automatikisht prapashtesa e huaj -ARE (zakonisht) me prapashtesën e shqipes -O/j duhet përjashtuar pa mëdyshje, pasi mbi bazë të temës akt-, me sa pamë, nuk del e formuar asnjë trajtë foljore në asnjërën gjuhë që konsultuam, madje, as në ato neolatine. Prandaj këtë fakt gjithsesi duhet pasur parasysh "adhuruesit" e fjalës a të trajtës *aktroj* në shqyrtim.

Mirëpo rreth parapëlqimit të trajtës së caktuar përveç modeleve të caktuara duhen pasur parasysh edhe kriteret që dalin nga aspekti logjiko-semantik e që në rastin konkret paraqiten mjaft vështirësi të kësaj natyre. Në të vërtetë, shtrohet pyetja nga aspekti semantik, cila nga këto dy trajta: *aktëroj* a *aktorj* duhet të jetë më e drejtë, kurse sa i përket trajtës *aktroj*, u pa më sipër se ajo nuk ka mbështetje në shqipen e sotme letrare as nga aspekti formal fjalëformues, edhe pse shikuar nga ish dialekti i gegnishtes, ku Ë-ja nuk del

aq e shqiptueshme, sidomos në rastet kur –N e -R këmbehen, siç është rasti Shqip'ri/Shqipni, andaj lidhur me këtë lypset një arsyetim i veçantë.

Pasiqë fjala *aktrorj* (*me aktrve*) ka dalë si barasvlerës për fjalën glumiti të serbokroarishtes, siç u tha më sipër dhe për këtë nuk ka fije dyshimi, atëherë kjo fjalë i takon fushës kuptimore që ka të bëjë me punën e drejtpërdrejtë të aktorit, të personit a artistit "*që luan një rol në shfaqjet teatrale ose në filma kinematografikë*" (FGJSSH f. 20) dhe kuptimisht është më e lidhur me këtë fjalë, d.m.th. emrin **aktor**, sesa me fjalën **akt**, me të cilën kuptohet një "*pjesë e një vepre dramatike ose e një shfaqjeje teatrale, që përbëhet nga disa skena dhe që përfshin një veprimtari të plotë*" (FGJSSH f. 19) e që në serbokroatishjte ka për barasvlerës fjalën **čin**, me të cilën kuptohet "*svaki od glavnih delova dramskog komada*" (secila nga pjesët kryesore të një vepre dramatike) (RSHKJ 6 f. 879).

Prandaj sipas këtij kriteri më drejt del trajta **aktororj** (serb. glumiti) sesa ajo **aktërooj** që lidhet me fjalë *akt* -(serb. *čin*).

Mirëpo është me interes të ceket lidhur me këtë se në gjuhën tonë pikërisht nga emrat si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë (profesionit) nuk praktikohet aqfort krijimi i foljeve, edhe pse nuk përjashtohen. Sipas lëndës së konsultuar për këtë qëllim, të përfshirë në FGJSSH, vetëm nga emri *krushk* mund të thuhet se ka dalë folja *krushkoj*, mbase edhe nga *dhëndër - dhëndëroj*, *reshper reshperoj* e ndonjë tjetër, kurse shembujt e tjerë na dalin nga ndonjë emër me cilësi të fjalës ndërkombëtare si p.sh. pilot pilotoj, refer referoj, arbitër arbitroj, atashe atashoj, rekrut rekrutoj, nëse si temë fjalëformuese cilësohet emri i caktuar si më sipër, emra këta që edhe në gjuhë të tjera kryejnë një funksion të tillë. P.sh. nga emri pilot serb. pilotirati, angl. (to) pilot, fr. piloter, it pilotare, sp. pilotar dhe në shqipe pilotoj. Kështu që në gjuhën tonë folja **pilotoj** mund të jetë e ndikuar nga trajtat përkatëse të ndonjëris nga gjuhët e huaja më të zhvilluara, gjë që nuk mund të thuhet për foljen *aktrorj* a *aktororj*, përkatësisht glumiti të serbokroarishtes. Krahaso serbokroatisht. *glumiti*, angl *to act a role*, rus. *igrat rolj* na scene, fr. jeuer, représenter; it. recitare, rappresentare; sp. representar.

Megjithatë po të shikohet ky fakt nga modeli fjalëformues i gjuhës sonë mund të thuhet pa mëdyshje se këto folje janë të prejardhura mbi bazë të temave emërore, siç u cekën më sipër, pra ekziston, megjithatë model i pranueshëm fjalëformues.

Megjithë vështirësitë që dalin, në krahasim me trajtat e tjera trajta **aktor** del pra më e qëndrueshme. Sidoqoftë, në këtë kontekst me të drejtë shtrohet pyetja: Si u shpif, pra trajta aktroj (aktrim) ndër ne?

Me gjasë, krijuesi i kësaj trajte që në fillim, për konceptin në fjalë, kishte fjalën **aktor** (serb. **glumac**) dhe për **glumiti** të serbokroatishtes e është kalkëzuar ose është *foljezuar* emri **aktor** në **aktor**, mirëpo pasi që për shkaqe fonetike-fonologjike theksi i fjalës shpërngulet në formantin -O-prapashtesor me këtë rast -O-ja e temës prodhuese rrëgjohet, përkatësisht zhduket, sidomos në të folmet e gegnishtes, atëherë bëhet i mundshëm reflektimi i trajtës **aktroj**, mbase si ushtar usht(a)roj **ushtroj**, edhe pse këtë rast (të fundit) del edhe emri *ushtë usht(ë)+roj ushtroj (me ushtrue)*. Shikuar nga ky këndvështrim trajta aktroj aktrim nuk del aq fort e qortueshme.

Gjithsesi procesin e zhdukjes së zanores së tillë e ka ndihmuar fakti se në gjuhë të tjera -O-ja e formantit -OR, del e zhdukshme në emërtimin e gjinisë femërore të profesionit në fjalë. Krahaso: angl. actor - actress, fr. acteur - actrice, rus. akter aktrisa, it. attore - attrice etj.

Edhe pse H. Bariqi në Fjalorin e tij për glumica (aktore) të serbokroatishtes e shënon aktoreshë, ashtu është edhe në FGJSH 1954, ndër ne është dëgjuar (përdorur) më tepër trajta aktreshë, ndikim asociacionor i shqiptimit dhe shkrimit të gjuhëve të huaja që u cekën pak më sipër, kurse në normën e shqipes letrare del i kristalizuar ky emërtim në të dyja gjinitë: aktor - aktore. Duke parapëlqyer kështu në gjuhën tonë mënyrën vetjake për emërtimin e emrit të gjininë femërore mbi bazë të trajtës së mashkullores, d.m.th. duke i shtuar fjalës aktor- prapashtesën femërorëzuese -E: **aktore**.

Sipas Fjalorit të Aleksiqit (RSZI, Beograd 1978, f. 26) nga trajta frënge **akteur** në serbokroatisht është reflektuar fjala ndërkombëtare **akter** (ashtu si edhe në rusishte). Siç mund të shihet në gjuhën frënge formanti i gjuhës latine -OR, është reflektuar në formantin -UER, pra **akteur** e që në shqipe përfarësisht shqiptohet **aktër**. Këtë fakt po e cek me qëllim që nga kjo pozitë mund të ketë dalë e përfutur në gjuhën tonë pothuaj normalisht trajta **aktroj**, sikurse dalin trajta foljore anase **afroj** nga afër, ose përfutimi i foljes **arbitroj** nga *arbitër* etj., por ky supozim nuk duket se është aq relevant.

Gjithsesi për një shpifje të tillë të trajtës **aktroj** del supozimi i qartë se do të kenë pasur "hise" edhe faktorët psiko-linguistikë, qoftë si shtytës të jashtëm, qoftë si shtytës të brendshëm gjuhësorë.

Pa marrë parasysh që trajta **aktroj**, mbase, për veshin e dikujt ndër ne duket tashmë e përvetësuar si fjalë e "faktit të kryer", mendoj se një praktikë e tillë e përdorimit të saj duhet të shikohet me rezervë apo ndoshta edhe të

ndërpritet plotësisht, mbase edhe për hir të mungesës së motovimit morfologjik dhe semantik, apo jo? Lidhur me këtë, megjithatë më duket se më mirë është trajta e tillë të sillet në trajtën **aktor aktorj**, ngase pikërisht trajta aktorj (aktorim) nga pikëpamja e fjalëndërtimit dhe e motivimit, edhe pse jo plotësisht, ka më shumë përparësi konkurruese për përhapje në mbarë truallin e gjuhës sonë letrare në krahasim me trajtën *aktroj aktrim* që ka mbetur hëpërhë si një lokalizëm i mbyllur. Sigurisht, shikuar nga një prizëm i veçantë, jetësimin e trajtës së tillë **aktorj (aktorim)** mund ta ndihmojë edhe vetë koncepti i temës motivuese fjalëformuese aktor- në kuadër të fushës sinonimike në raport me fjalë të tjera të kësaj natyre që kanë të bëjnë me emërtimin e njerëzve sipas profesionit në gjuhën tone..

Rreth gjetjes së barasvlerësisë së foljes *glumiti* të serbokroatishtes në gjuhën tonë me të vërtetë, shihet një zbrastësi. Barasvlerësit e shënuar në fjalorët përkatës te ne nuk janë të mjaftueshëm, madje në raste të caktuara lypset edhe ndonjë sqarim a plotësim rreth favorizimit të trajtës **aktorj (aktor-)**, apo jo?

Sido që të jetë, po shtojmë se në *Fjalorin serbokroatisht shqip* (1986) për foljen *glumiti* ndeshim këta barasvlerës: "*luaj teatër, shfaq, fig. luaj komedi, shtirem, shtihem, bëj sikur*" (Aty f. 199). Në bazë të konsultimit të FGJSSH (1980) për konceptin në fjalë në gjuhën tonë përveç barasvlerësit: "**luaj**" (nën pikën 3 f. 726), **shfaq** (f. 1837 po nën 3. del edhe folja **interpretoj** "*luaj një rol në një dramë ...*" (f. 726 nën 3.), fjalë kjo që për këtë koncept nuk është e përfshirë në burimet e tjera, madje as në *Fjalorin shqip-serbokroatisht* (1981), në të cilin, siç u cek në fillim të kësaj trajtese, për konceptin në fjalë është regjistruar trajta **aktroj** (Aty f. 19.) dhe së andejmi del edhe në *Fjalorin drejtshkrimor* 2011, trajtë kjo, të cilën ne e diskutuam në këtë por nuk e quajtëm aq të qortueshme, apo jo?!

Në fund, tërheq vëmendjen, pra, se te ne për konceptin **glumiti** të serbokroatishtes krahas barasvlerësve të tjerë mund të aktivizohet edhe trajta **interpretoj** e nëse ndihet nevoja, madje në raste të caktuara mund të vijë në ndihmë edhe trajta **aktorj** (aktorim), e cila del paksa më e mbështetur ndaj trajtës *aktroj (aktrim)*, për hir të temës së qartë motivuese fjalëformuese që ka, por sidoqoftë, standardologët tanë duhet ta bëjnë zgjidhjen më të mire edhe të kësaj teme, edhe pse me sa pamë edhe trajtën aktroj, aktrim struktura fjalëformuese e shqipe nuk e qorton.

(Prishtinë, 10.XII.1986)

7) NISMË E SHKËLQYER QË LYP KURORËZIM

(Rreth *Fjalorit shqip-latinisht* të Engjëll Sedajt, hartuar sipas
Fjalorit latinisht –shqip të F. Bardhit, botuar si shtojcë
e Fjalorit të Frang Bradhit)

(Resension, i botuar në gazetën "Fjala", Prishtinë, më 15.IV.1987)

Është për çdo admirim ribotimi i veprave të traditës sonë leksikore, siç është edhe ribotimi (me fotokopjim) i Fjalorit të Frang Bardhit (Dictionarium latino - epiroticum / Romë 1635) që e botoi NGBG "Rilindja", Prishtinë 1983 dhe për këtë meritë të veçantë pos botuesit ka edhe Dr. Engjëll Sedaj, i cili jo vetëm pse bëri përgatitjen e materialit dhe transliterimin, përkatësisht transkriptimin e teksteve përcjellëse duke i përkthyer a përshtatur ato nga origjinali, por edhe pse shkroi një punim mjaft përmbledhës që i paraprin Fjalorit, i cili u vlerësua, për mendimin tim, me të drejtë, si "një studim i mirëfilltë shkencor", por ai (Sejdaj) ka meritë të veçantë, ngase i shkrepiti të hartojë një "njësi të re leksikografike": **Fjalorin shqip-latinisht sipas Fjalorit të Frang Bardhit**, me qëllim që të na bëjë sa më të lehtë komunikimin me veprën e parë të mirëfilltë të leksikografisë sonë dhe kështu në mënyrë masive mund të shijohet nektari i thesarit leksikor të gjuhës sonë i para katër –pesë shekujsh e i ruajtur në atë Fjalor. Dhe, ç'është e vërteta, E. Sedaj, arriti të na japë një vepër të tillë, e cila u botua si shtojcë e Fjalorit të F. Bardhit në të njëjtin libër.

Kjo punë e E. Sedajt u përshëndet dhe u vlerësua pozitivisht në shtypin tonë, në gazetën "Rilindja" (më 4.II.1984, f. 5 dhe të datës 17.III.1984 (intervistë), f. 12, në revistën "Zëri i rinisë" nr. 16/84 si dhe në revistën "Gjuha shqipe" nr. 1/84 dhe kështu kjo "njësi e re leksikografike", siç e quan autori apo "punë me përkushtim" (Sh. Galica) ose si një "pjesë e vlefshme" (Q. Murati) mori epitete që duhet t'i ketë apo do t'i ketë me siguri pas "disa" përmirësimesh që duhet t'i bëhen. Kështu po shprehem pasi që, për mendimin tim, sipas tekstit të prezantuar, autori nuk ka arritur t'i plotësojë tërësisht asnjërën nga pikësynimet që ia parashtron vetes në shënim-fusnotën që e jep në fillim të Fjalorit në fjalë, sepse:

1) nuk e ka përfshirë tërë lëndën leksikore të Fjalorit të F. Bardhit (as latinisht as shqip),

2) transkriptimi nuk është i plotë e besnik as në variantin e F. Bardhit as në variantin e gjuhës së sotme letrare shqipe, dhe

3) kur kemi parasysh edhe disa lëshime të tjera jo aq të lehta, del se E. Sedaj materialit nuk i ka bërë as korrekturën e fundit.

Së këndejmi, ai patjetër duhet ta rimarrë në dorë, ta korrigjojë, madje edhe ta ripunojë këtë **fjalor** (shtojcë) dhe lidhur me këtë duhet t'i ketë parasysh edhe këto vërejtje qëllimmira që po i bëhen.

a) Mbasi që lënda patjetër duhet të ripunohet autori do të bëjë mirë që ta ndryshojë metodën e punës duke u mbështetur në kritere të asaj metodologjie, e cila do t'i sjellë rezultate më të mira. Pra, duhet ta hartojë a ta ndërtojë *Fjalorin shqip-latinisht* nga lënda leksikore e Fjalorit të F. Bardhit, ashtu siç është e regjistruar aty, natyrisht të transkriptuar. Mendoj se për një punë të tillë ka nevojë gjuhësia jonë e jo siç është bërë aty. Gjithsesi gjatë ndërtimit (mbarshtrimit) është mirë të shënohen a të përcaktohen pjesët e ligjëratës apo njësitë leksiko-gramatikore si: emër, mbiemër, folje, ndajfolje, togefjalësh, shprehje etj. dhe kështu të na bëhet më e kapshme, më funksionale dhe më komunikuese lënda e Fjalorit në fjalë.

Sa i përket merendimit a renditjes së lëndës në kolona mendoj se duhet bërë kështu:

1- në kolonën e parë të shënohen të transkriptuara fjalët e F. Bardhit (në kllapa të transiletuara);

2- në kolonën e dytë të shënohen ekuivalencat latine dhe

3- vetëm në shtyllën e tretë, të fundit, të shënohet trajta në gjuhën e sotme letrare e pastaj ndonjë ilustrim në trajtat dialektore, ndonjë përmirësim apo ndonjë sqarim rasti etj.

Dhamë propozimin, sipas pikave të mësipërme, ngase mendojmë se metoda, siç është vepruar në tekstin në fjalë, nuk na duket punë aq e sukseshme, ngase aty janë përzier trajtat, jo vetëm kategorikisht, por edhe (drejt)shkrimisht, gjë që për këtë shkak mund të na shkojë mendja se autori nuk e respekton apo nuk e njej drejtshkrimin e shqipes së sotme letrare.

b) Gjithashtu gjatë ripunimit duhet t'i lexojë apo t'i transkribojë më me vëmendje fjalët nga teksti i F. Bardhit, sepse materiali i vjelë që na prezantohet sa i përket vetë leximit, është me plot lajthitje të rënda jo vetëm si gabime shtypi, por edhe të tjera.

Më poshtë po i paraqit vetëm këto nëntë raste (shembuj) prej kah del se leximi a transkriptimi nuk është bërë si duhet:

Nga Fjalori i F. Bardhit	Teksti latinisht	Nga Fjalori i E, Sedajt	Varianti i mundshëm në letrarishten e sotme
1. akshiani dritës)	aurora	akshami (i dritës)	ag/shi/ani (ag, (i agsholi)
2. sholli	planta	bimë (shkolli)	sholla (a shputa

i kambës		i këmbës)	e këmbës)
3. krefëza (...)	muscipula	kafez	grehëza (ngrehca, kurtha)
4. shëgun (o cohë)	panus	shëgun	zhëgun-i
5. kërpesh	capuistrum	çepresh	kërpesh (kapistall)
6. shkÿjlet	puglia	zhilet	shqye/let(!) (pinjall)
7. me bam fÿg	plicare	bëj fiq, palos fiq	bëj fugë (me bë fugë)
8. shkiut	parma	skut	shqyt (mburojë)
9. njerijpagÿgj	tyranus	i pagÿg (tiran)	tiran, njeri pa gÿyq,

Kështu nga vetë materiali na imponohen gjëra me interes që duhen rishikuar, mbarështruar e sqaruar nga autori, patjetër, apo jo?!

c) Veç leximit të gabuar, në mbarë tekstin në fjalë, bëhen gabime edhe lidhur me trajtat adekuate,. përkatësisht nuk shënohen trajtat sipas drejtshkrimit apo trajtës së pranuar në gjuhën letrare. Ja disa shembuj:

1	2	3	4
1. atëni	paternus	atëri	atësi
2. barktë (barktë ku jet foshnja)	venter	amëz	an-i
3. ai gji fort dëshiron gratë	melierosus	granues	gruar
4. plot me ranë	sabulosus	rëror	ranor
5. jeta e shintenet	vita sanetorum	jeta e shenjtarëve	jeta e shenjrtërve, jeta e shenjtorëve
6. posi ullij	olecaeus	ullias	ullinjor, posi ullinj
7. me pasun het	sitire	eqtohem	etem, kam etje,

8. me u avitunë	propinquare	ofrohem	(me pasë etje) avitem (me u avitë)
9. me u afruem	proximare	ofroj	afroj (me u afrue)
10. i përmkatnuem etj.	sons	mëkatëror	mëkatar

S'do mend, lajthitjet e tilla nuk janë të natyrës së lehtë, toleruese, apo jo?!

ç) Gabime ortografike (përzier me ato të shtypit) në tekst ka me dhjetëra e dhjetëra, prandaj edhe për këtë shkak duhet të rimerret në dorë e të korrigjohet teksti. Lëshimet e shkarjet e tilla hetohen fare lehtë nga çdo lexues, prandaj as që e shoh të arsyeshme të bëj fjalë rreth tyre.

Ç` është e vërteta, pos vërejtjeve që u dhanë më sipër ia vlen të përmendet një dukuri e mirë që gjithsesi kërkon vlerësim. Autori disa fjalë togfjalësha të F. Bradhit i kthen në gjuhën e sotme dhe kështu ai krijon disa fjalë neologjizma, si p.sh.:

peshkatore, këshilltore, pëllumbëtore; mbamendje, delake, mbretërisht, maturisht, dërrasoj etj.

që ndonjëra prej tyre mund të qëndrojnë, sepse edhe ka prirje përgjithësimi në fjalësin e gjuhës sonë letrare. Gjithsesi mendoj se me rastin e ribotimit autori do ta rishqyrtojë veprën në fjalë, sepse kështu nuk i shërben as për së afërmi qëllimit të botuesit e as të përgatitësit, megjithëse vetëm "*Parathënia*" dhe teksti origjinal i Fjalorit të Bardhit do të mjaftonin sa për të arsyetuar botimin, por teksti i përmirësuar dhe i ndërtuar sipas kërkesës së kritereve metodologjike shkencore e praktike, sipas nismës së qëlluar të prof. E. Sedajt, do t'ia shtonin vlerën edhe autorit edhe librit në fjalë.

Së këndejmi, E. Sedaj ka fuqi dhe dijeni t'i bëjë vetë përmirësimet, madje edhe përplotësimet e nevojshme, si b.f pse F. Bardhi për fjalën latine *iliria* në shqipe jep barsvlerësin *shkieni*, për hir të shumicës ortodokse, apo kishte ndonjë shkak tjetër?! Mund të shtrohen edhe disa pyetje të tjera dhe sidoqoftë autori, mund të na japë përgjigje, bashkë me përmirësimin e përplotësimin që duhet t'ia bëjë veprës, ngase një punë të tillë borxh ia ka vetvetes, na e ka borxh edhe ne lexuesve (dashamirës e adhurues edhe të veprës së tij) dhe sigurisht ia ka borxh edhe shkencës, sepse ai tanimë ka renome të padiskutueshme dhe gëzon respekt të merituar si një "latinisht i

shquar, profesor fakulteti, autor i punimeve të shumta dhe person reprezentues në kuadër të aktivitete të ndryshme shkencore, profesionale dhe eseistike nga letërsia antike greko-romake dhe nga letërsia krahasimtare" (gazeta "Rilindja", 17.III. 1984, f. 12), prandaj një lëshim i rastit që mund të jetë i motivuar nga zënia e tepërt me punë, apo do të ketë ndonjë arsye tjetër, jo vetm që nuk do ta shkurajojë, por do t'i shtojë forcën për punë të mëtejshme, madje do ta ketë mirësinë që ta përmirësojë e ta çojë më tej vetë këtë nismë të shkëlqyer duke e kurorëzuar, ashtu siç i ka hije punës së mirë e si mostër mund t'i shërbejnë pikërisht veprat e tij të sukseshme.

Në fund po përsëris se për këtë çështje është mirë ta ndryshojë metodën, siç u cek më sipër dhe njëherazi është mirë të bashkëpunojë edhe me kuadro të tjerë, si filologë, ortologë, dialektologë e të tjerë që sigurisht nuk na mungojnë, në mënyrë që vepra në fjalë të dalë siç lypset: e studiuar dhe e komentuar shkencërisht, sipas kërkesës së kohës, përndryshe kështu si është mbase mund të ndikojë edhe negativisht.

8) TRAJTA VUARJE SI LAJTHITJE FJALËFORMUESE

(Artikull i botuar në gazetën "Bujku", Prishtinë, 21.V.'92)

Në mjetet tona të informimit masiv po përsëritet herë pas herë një lajthitje fjalëformuese ose një trajtë e paqëndrueshme që mund të konsiderohet në njëfarë mënyre si hipertoskizëm i shpifur, e cila ka të bëjë

me formimin e emrit të veprimit nga folja **vë** (vura vënë, me vu). Sa për ilustrim po sjell disa shembuj:

"(...) *vuarja e dryrëve shkollave të mesme të Kosovës*" (gazeta "Shkëndija" nr. 34, gusht 1991, f. 10), (...) "*kundërvuarje*" (e fakteve) ("Fjala, 19.II.1992 f. 8), (...) "*vurja e formave*" (Shkëndija, 4.III.1992 f. 9), (...) "*mbi vuarjen në veprim*" (gazeta "Dielli", 4.III.1992 f. 2), (...) "*është vurë në procedurë*" (revista "Zëri", 16.V. 1992 f. 12), (...) "*vuarja e firmave në shkrepse, blokë e lapsa*" ("Kosovarja", 9. IV.1992, f. 35 dhe "Fjala", 13.V.1992, f. 12), (...) "*vurja e mbiemrit*" (gazeta "Bujku", 15.V.1992 f. 13), (...) "*vuarja në lëvizje të thënies*" ("Bujku, 27.VI.1993 f. 4) etj.

Edhe pse lidhur me këtë do të mjaftonte një vërejtje shoqërore që në vend të trajtave **vuarje**, **vurje** duhet përdorur trajta e normëzuar **vënie**, ngase ashtu është sanksionuar në normën e shqipes së sotme letrare, (Shih: *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe* f. 88 dhe FGJSSH f. 3157.) megjithatë mendoj se del e nevojshme të rikujtohen dhe të sqarohen nja katër fakte, sepse një lajthitje e tillë u ka shpëtuar e po u shpëton jo vetëm lektorëve e redaktorëve, por edhe autorëve që janë penda intelektuale jo të panjohur te ne:

E para, ekziston rregulli fjalëformues në gjuhën tonë letrare që emrat e veprimit me prapashtesën -JE formohen mbi temën e pjesores dhe të atyre foljeve "që dalin në pjesore më -NË", (Shih: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, f. 219.) siç është edhe folja **vë vënë**, prandaj jo *vuarje*, *vurje*, po **vënie**. Ç'është e drejta, prapashtesa -JE këtu del paksa e modifikuar në -IE (I:J(e)), për të mënjeluar kështu shqiptimin e dy shkronjave n+j si "një tingull i vetëm **nj**". (Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, f. 87, 88.)

E dyta, trajta **vurje**, **vuarje** nuk mund të përliqjet edhe në qoftë e përfutur nën ndikimin e ndonjë analogjie a si asociacion i trajtës së aoristit **vura**, sepse aoristi si temë fjalëformuese, sidomos për këtë nëntip foljesh, në formimin e prejppjesorëve nuk mund të ketë as ndikim plotësues.

E treta, nuk mund të jetë i pranishëm as ndikimi i pjesores së mundshme të gegërishtes vum/ë (Shih: Fjalori i Konstantin Kristoforidhit f. 375.), përkatësisht emri i veprimit **vumje**, për arsye se trajta vumje në këtë formë nuk di sesa do të ketë pasur shtrirje në fondin aktiv të gjuhës sonë, e cila pa u toskëzuar do të mund të konkurronte konkretisht si koncept, por përdorimi në rastin e caktuar e aq më tepër rotacizimi i saj do të dilte fare i panevojshëm, pasi që kemi të bëjmë për të njëjtin nocion, të cilin tashti e shpreh plotësisht trajta **vënie**. Ndërkaq është e vërtetë se në të folme të caktuara të gegërishtes mund të haset edhe trajta vnoj (vnue, vënie a vndue (te E. Koliqi), mbase me etimon nga *vendue* (me vendue, vendoj vendos), siç e hasim edhe në një

shkrim (dokument) të viti 1944 të botuar në "Zëri, më 25.IV.1992, f. 44 e 45, por as nga kjo trajtë përfftimi nuk mund të përlligjen trajtat: **vrje vuarje**.

E katërta, zhvillim të ngjashëm sikurse folja *vë vënë vënie*, d.m.th. nga pjesorja më -NË fundore (pa rotacizim) e kanë edhe dy folje të tjera vokalike me mbaresë zero: **zë zënë zënie** dhe **nxë nxënë nxënie** si dhe nja katër folje të parregullta: *them thënë thënie, lë lënë lënie, bie rënë rënie* dhe *jap dhënë dhënie*, andaj edhe nga kjo anë trajta vuarje nuk ka kurrfarë ndikimi, apo jo?

Gjithsesi trajtat *vuarje vrje* në vend të asaj të drejtës **vënie** janë lajthitje fjalëformuese, ose lajthitje të shpifura, të cilat assesi s'duhën përsëritur.

Në fund, për t'u mënjeluar lajthitjet si kjo është e nevojshme që autoritet tona gjuhësore të hartojnë një doracak të ri të tipit siç është hartuar doracaku për rregullat e drejtshkrimit të shqipes përkatësisht *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, ku do të përfshiheshin (përmbledheshin e sistemoheshin) rregullat drejt-fjalëformuese e formëzuese të gjuhës sonë letrare në njërën anë dhe në anën tjetër lajthitjet.

(Prishtinë, 13. V.1992)

9) JO TRUPA PO ORGANIZMA (POLITIKË, SHTETËRORË)

(Artikull i botuar në gazetën "Bujku", Prishtinë, 30.VIII.'94)

Në stilin administrativo - publicistik, te ne, si duket më tepër nën ndikimin e gjuhës serbokroate sesa si zhvillim i brendshëm, ka raste që fjalë-termi **trup trupa** të përdoret pa nevojë edhe për asi koncepti që nuk e njeh shqipja e sotme letrare, si p.sh.:

1) "(...) përgjegjësit e resorëve dhe të trupave të tjerë" (revista "Zëri" dt. 23.XI. 1991 f.12);

2) "Si parti kemi nevojë për trupa analitikë që do të na ndihmonin në mënyrë profesionale" (gazeta "Bujku" dt. 27. IX. 1994 f.5.);

3) "*Qeveria ka vepruar me lejen kryetarit të Republikës dhe të trupave politikë të Kosovës*" (gazeta "Bujku" dt. 15. VIII. 1994 f.3.) etj.

Nga konteksti prej nga u nxorën shembujt mund të dalë më qartë, por edhe kështu mund të shihet se fjala është për një njësi të tillë semantike, e cila ka të bëjë me emërtimin e një organi politik a shtetëror, nocion ky që në shqipen e sotme letrare mbulohet me fjalë-termin **organizëm**. Sipas FGJSSH-së, nën 2., me fjalën **organizëm** kuptohet "*një organ politik, shtetëror a shoqëror i parë në tërësinë e pjesëve përbërëse*". (Aty f. 1308.). Edhe në gjuhën serbokroate për ndërkombëtarizmën "*organizam*" jepet pothuajse përkufizim i ngjashëm : "*(...) ustanova s odredjenom namenom, funkcijom u javnom, društvenom i političkom životu*" d.m.th. "institucion me destinim e funksion të caktuar në jetën shoqërore, politike e publike". (Shih: RSHKJ 4 f. 183.) Mirëpo në gjuhën serbokroate për të njëjtin nocion e më gjerë del më i favorizuar fjalë-termi sinonimin **telo/tela** sesa fjala **organizam / organizmi**. (Shih: RSHKJ 6 f.175.)

Fjala **telo** e serbishtes në gjuhën shqipe (hiq konceptin në shqyrtim dhe pjesërisht edhe të ndonjë tjetri) ka barasvlerësi të qëndrueshme e të plotë me fjalën **trup**. Kështu që, te ne, duke u lidhur, si me thënë, organikisht (spontanisht) të dyja këto fjalë, përkatësisht duke i vajtur pas fjalës serbe nën motivimin e konceptit të tillë, fjala shqipe pësoi zgjerim kuptimi, siç e dëshmojnë edhe shembujt që u dhanë për ilustrim në këtë artikull. Lidhur me këtë nuk është e parëndësishme të dihet edhe fakti tjetër se në procesin e zhvillimit të gjuhës sonë edhe vetë fjala **trup**, sipas FGJSSH-së, nën 6., ka pësuar zhvillim të ngjashëm kuptimor (figurativisht sikurse fjala **telo** e serbishtes (edhe pse kuptohet se jo njësoj për të gjitha hijesat kuptimore). Kështuqë me fjalë - termin **trup**, sipas pikës së sipërcekur, kuptohet "*një grup njerëzish që kanë punë të njëjtë a detyrë të përbashkët dhe që përbëjnë një kolektiv, një administratë, një institucion etj.*"(Aty f. 2033.), si p.sh.: trupi diplomatik (serb. dipomatsko telo), trupi gjykues (serb. sudsko vece (telo), trupi mësimor (serb. nastavno vece (telo) etj. Së këtejmi në serbishte del edhe njëjësi **političko telo**, shumësi **politička tela**; nj. **džavno telo**, sh. **državna tela** etj., forma këto që në shqipen letrare nuk dalin me përbërësin **trup** të togfjalëshit, por me përbërësin **organizëm**: njëjësi **organizëm politik** shumësi: **organizma politikë**, **organizëm shtetëror** shumësi: **organizma shtetërorë**.

Ku qëndron pra dallimi dhe si mund të mbahet mend më lehtë ky dallim?

Për njohësit dhe përdoruesit e shqipes së sotme letrare, të cilët edhe e kanë të ravigjësuar në sistemin e tyre ligjërëimor, një dallimi tillë është i lehtë, por edhe për ne që e mësojmë dhe e zbatojmë normën letrare nuk do të jetë i vështirë. Pra, nuk do të jetë vështirë, nëse vështrohen me kujdes përkufizimet që u dhanë për të dy fjalë-termat në shqyrtim: **trup/organizëm**, ku dallimi duket qartë. Po ritheksojmë se me termin **trup** kuptohet "një grup njerëzish" pak a shumë pa nuanca politike (shtetërore) dhe se me një koncept të tillë veprohet në mënyrë të kufizuar deri te një kolektiv, një institucion etj., ndërsa me fjalë-termin **organizëm**, në radhë të parë, del hijesa politike (shtetërore) jo e një grupi njerëzish, por të një organi (politik, ekonomik, qeveritar etj.), koncept ky që vepron në suazat e një shteti a të organeve të tij. Me fjalë të tjera, me termin **trup** kuptohet "*një grup njerëzish*", ndërsa me organizëm emërtohet një "*organ shtetëror*", gjithsesi me rreze më të gjerë veprimi se të një grupi njerëzish.

Prandaj sipas kësaj dihotimie: "**grup njerëzish**"/"**organ shtetëror**", siç u cek më sipër, në përputhje me normën e shqipes letrare në fuqi, te shembujt ilustrues e të ngjashëm, siç u dhanë në fillim të këtij artikulli, fjala **trup** duhet të zëvendësohet me fjalën **organizëm**.

Kështu pra:

1) jo "përgjegjësit e resorëve dhe të trupave të tjerë", po "**përgjegjësit e resoreve dhe të organizmave të tjerë**";

2) jo "Si parti kemi nevojë për trupa analitikë që do të na ndihmonin në mënyrë profesionale", po "**Si parti kemi nevojë për organizma analitikë që do të na ndihmonin në mënyrë profesionale**";

3) jo "Qeveria ka vepruar me lejen e kryetarit të Republikës dhe të trupave politikë të Kosovës", po "**Qeveria ka vepruar me lejen e kryetarit të Republikës dhe të organizmave politikë të Kosovës**".

Lidhur me temën që u trajtua këtu po ritheksoj faktin se kjo dukuri nuk është vënë re nga askush, madje as nga hartuesit e deritashëm të fjalorëve përkatës dygjuhësh shqip - serbokroatisht e anasjelltas, prandaj edhe nga disa autorë, lektorë e punonjës të tjerë nuk është hetuar ky dallim.

Sidoqoftë, besoj se tash e tutje, pasi që u bë e qartë, nuk do të ketë këmbëngulje në përdorimin e fjalë-termit **trup** për nocionin në shqyrtim, për arsytet që u dhanë më sipër. Është me rëndësi që kjo shkarje, e lehtë në dukje, e normës letrare sa më me lehtësi të përballohet d.m.th. të korrigjohet pa kurrfarë ngurrimi.

Hetimi e korrigjimi i rasteve të shpifura si kjo, mbase të vogla për syrin e dikuj, nuk janë pa peshë për mbarëvajtjen e gjuhës sonë të njësuar standarde

kombëtare. Fundja, procesi i harmonizimit të terminologjisë në raportin Prishtinë - Tiranë si një çështje e ditës gjithnjë aktuale kërkon trajtim e përgatitje më të plotë e të organizuar mire nga kuadrat tanë.

(Prishtinë, 18.VII.1994)

10) JO PËRFOLET PO RITREGOHET RRËFESA POPULLORE

(Vërejtje e botuar në gazetën "Bujku", 20.VIII.1994)

Kam vërejtur se jo rrallë në shtypin tonë po përsëritet një shkarje e vrazhdë semantike lidhur me përdorimin pa vend të foljes përflas (me përfolë). Kështu ndodhi edhe në gazetën "Bujku" të datës 18.VII.1994, f. 6, ku për rrëfesarat (anekdotat) e vjela nga "goja e popullit" të cilat aty po dalin të parafrazuara thuhet: "*i përfoli* Anton Çetta".

Siç del nga konteksti, në të vërtetë, i nderuari A. Çetta, nuk "i përfol" ato, d.m.th. nuk i përgojon, nuk i përqesh as nuk i shpif, siç e ka kuptimin leksikor (sinonimik) folja *përflas* (*me përfolë*) në shqipen letrare (serb. ogovara ogovarati), por ato profesor Çetta i *ritregon*, i *parafrazon ose i thotë me fjalë të veta* (serb. *prepričava prepriča(va)ti*), madje duke i përpunuar e ndrequr paksa ato po i bën më të arrira.

Gjithsesi një shkarje e tillë duhet korrigjuar. Për këtë temë më gjerësisht është bërë fjalë në një artikull tjetër, por pasi që ende nuk është botuar, po mjaftohem vetëm me kaq, sa për të tërhequr vërejtjen që mos të ndodhin gafe të tilla.

11) RASTE TË NGATËRRIMIT TË HISTORIZMËS NJËSIT ME FJALË-TERMIN NJËSI (USHTARAKE) TË NE

Artikull i botuar në revistën "Koha", Prishtinë më 13.IX.'95)

Fjala **njësit** u përftua në gjuhën tonë aty kah fundi i vitit 1941 dhe fillimi i vitit 1942 si emërtim i grupeve të vogla ushtarake (ilegale) të lëvizjes nacional-çlirimtare "*të përbëra nga 5-10 vetësh*", të cilat, siç thuhet në

"Fjalorin enciklopedik shqiptar" (1985), u organizuan nga komitetet qarkore të PKSH-së", me qëllim për të kryer aksione të caktuara luftarake kundër pushtuesit fashist. "Njësitët guerile" - thuhet aty - "nuk ndërprejnë veprimtarinë e tyre edhe pas formimit të çetave partizane dhe krijimit të Ushtrisë NÇSH". (FESH f. 768.) Pas çlirimit, siç dihet, pushoi nevoja për organizimin e grup-forcave të tilla, prandaj edhe përdorimi i fjalë-termi **njësit** fillon të pasivizohet, mirëpo ai nuk do të shuhet, qoftë në shenjë kujtimi për "*njësitët partizane*", qoftë për arsye të tjera. Në FGJSSH (1954) kjo fjalë sqarohet kështu: "*skuadër e vogël prej 10-15 vetash në luftën partizane*, (Aty f. 356.) duke i dhënë fjalës paksa ngjyrim specifikimi. Në FGJSSH (1980) dhe në FSHS (1984) fjala *njësit*, së pari, (nën 1.) shënohet si historizëm "*grup i vogël partizanësh ose ilegalësh gjatë Luftës NÇ*", por nën 2. shënohet edhe me kuptimin "*formacion i vogël ushtarak*", (Aty f. 812.) kuptim ky i përgjithësuar, por pa iu hequr epiteti "*i vogël*".

Nga pikëpamja e qëndrueshmërisë fjalëformuese trajta njësit/njësite del paksa e diskutueshme, ngase paraqitet si rast i veçantë, pa model. Sipas rregullit (pasi që shqipja nuk ka prapashtesë zvogëluese -(I)T) në bazë të sistemit fjalëformues të shqipes letrare, nëse do të duhej patjetër të njëfjalëzohej togfjalëshi "njësi e vogël", mbi fjalë-temën motivuese njësi-mund të vinte prapashtesa zvogëluese -TH, **njësith** (siç u përftua fjala partith për "parti e vogël" në gazetën "Bujku" më 8. VII. 1995 f. 5), përkatësisht edhe më mirë prapashtesa -ZË, **njësizë** (ngase përshtat me gjininë gramatikore të emër-temës njësi-). Trajta njësit/njësite del e shpjegueshme si shumës i singularizuar: nga shumësi njësi njësitë / njësit(ë) njësite d.m.th., me zhvendosje theksi dhe me ndryshim semantik: njësite njësit/ njësit njësite, në mos pastë pasur dorë aty ndonjë ndikim kontaminimi me ndonjë fjalë tjetër, për çka ia vlen të hulumtohet. Formalisht asociacione mbase mund të kenë zgjuar, por s' di sa, edhe fjalët *komit*, *bandit* etj., d.m.th. *njësit* me -IT fundore(!).

Sidoqoftë, në këtë formë fjalë-termi **njësit** me konceptin: "*grup i vogël ilegalësh*" a "*grup i vogël partizanësh*", pati përdorim aktiv vetëm gjatë luftës nacional-çlirimtare dhe pastaj kaloi në historizëm, d.m.th. në fjalë që "*tashmë ka dalë nga përdorimi i gjallë*", siç thuhet në FGJSSH f. 687. Mirëpo me kuptim të përgjithshëm në ligjërime, për arsye të caktuara sinonimike, del e lejueshme të përdoret edhe për konceptin "*formacion i vogël ushtarak*", siç u cek më sipër, por pa cilësinë e termit të mirëfilltë në kuadër të strukturës së organizimit të brendshëm kiearkik të ushtrisë kombëtare.

Lidhur me këtë për të pasur ide sa më të qartë rreth thelbit të temës që po trajtohet këtu, më poshtë po shënoj njësitë organizuese që dalin nga organizimi i brendshëm i ushtrisë shqiptare, ashtu edhe të asaj jugosllave, si gjatë luftës nacional-çlirimtare (të përbashkët), ashtu edhe më vonë, duke filluar nga njësia bazë, ajo më e vogla, e deri të njësia më e madhe. Organizimi i tillë i brendshëm, pa hyrë në hollësi a specifika të veçanta, duket kështu:

skvadër/odeljenje, togë/vod, kompani/çeta, batalion/ bataljon, regiment/ puk, brigadë /brigada, divizion/divizija, truparmatë /korpus, armatë /armija.

Në përdorim del edhe ndonjë term tjetër si p.sh. aradhë/odred, formacion/formacija, repart ose nënrepart, madje edhe njësi/jedinica etj., por çdo armatë mund të ketë edhe emërtime të veçanta (kombëtare a shtetërore).

Nga sa u tha më sipër del se fjalë-termi **njësit**, si njësi e vogël "prej 5-10 vetash", del i rezervuar, si dje si sot, vetëm për konceptin që në ushtrinë e rregullt përkon me njësinë më të vogël organizuese, d. m. th. me fjalë-termin **skvadër** (serb. odeljenje) e jo edhe për koncepte të tjera, të cilat janë njësi ushtarake po jo njësite ushtarake. Ç`është e vërteta, kjo dëshmohet edhe me faktin se me fjalë-termin **njësi** (serb. jedinica) në fushën e terminologjisë ushtarake, pa përcaktuesin: "e vogël" a "e madhe", kuptohet; "formacioni ushtarak që përbëhet nga disa reparte (brigada, batalione) të një arme ose të armëve të ndryshme dhe që kryen detyra të caktuara luftarake" (FGJSSH f. 812). Fjala "armë" në kontekstin e mësipërm në serbishte ka barasvlerësin "rod vojske".

Pikërisht këtu qëndron ngatërrimi i historizmës **njësit** me fjalë-termin **njësi** (ushtarake), që po diskutohet këtu. Një lajthitje të tillë, patëm rast ta ndeshim jo pak herë në shtypin tonë, por së voni vihet re edhe në shkrimet e disa historianëve tanë të njohur dhe jo pa emër të mirë.

Sa për ilustrim po i cek disa raste që i nxora nga gazeta "Bujku", si p. sh.: më 20.VI.'92, f. 9; 6. VIII. 1994, f. 6; 8.II. 1995, f. 9; 15, IV. 1995, f.12, 18. IV.1995, f. 18, te "Lufta e Drenicës", f. 60, 61 etj., etj., ku shihet qartë një lajthitje e tillë.

Për një ngatërrësë të tillë a zgjerim kuptimi të fjalës njësit, mund të ketë ndikuar edhe edhe fakti se në fjalorët përkatës shqip - gjuhë e huaj, fjala **njësit** pothuajse në shumicën e rasteve, del e njëjtësuar sa i përket barasvlerësisë me fjalën **njësi** apo me ndonjë fjalë tjetër në kuadër të formacioneve të caktuara ushtarake, pa u shpjeguar fakti se fjala e tillë tashmë ka cilësinë e historizmës.

Kështu si barasvlerës sinonim të fjalës *njësi* ashtu edhe të fjalës *njësit*, në gjuhë të huaja ndeshim barasvlerësit si vijon: it. unit(o), fr. unité. angl. unit (detachment), gjerm. Abteilung dhe në serbishte: odred (aradhë). /Shih: *Fjalori shqip-serbokroatisht* (1981, f. 649.)

U tërhiqet vërejtje, në radhë të parë autorëve të nderuar që të korigjohen si dhe të tjerëve, siç janë lektorët e redaktorët e botimeve të caktuara, që mos të bijnë pre e dukurisë së tillë. Gjithsesi, për arsyet që u thanë më sipër, fjala *njësit/njësite* nuk duhet të favorizohet për aso nënfushash semantike të cilat mbulohen mirëfilli me fjalë-terma të tjerë tashmë të qëndrueshëm, siç ishte edhe fjalë-termi: **njësi ushtarake**.

12) SLLAVIZMA "TROJKA" TË MOS PËRDORET PA KRITER

Artikull i botuar në gazetën "Fjala jonë", Prishtinë, mars 1995)

Fjala "trojka", me origjinë ruse, që ka për etimon numrin tre, si fjalë ndërkombëtare në gjuhë të ndryshme, si gjermanisht, serbokroatisht, etj. si dhe në shqipe (si ekzotikë karakteristike ruse) del e regjistruar vetëm për nocionin: *"lloj karroce pa rrota (...) a sajë për tre kuaj"* (Shih: edhe te FGJSSH, f. 2028), mirëpo kjo fjalë që e ka poliseminë mjaft të zhvilluar në gjuhët sllave, si rusisht, serbisht etj., në ato gjuhë del edhe me kuptimin "*grup*

njerëzish prej tre vetash", të cilët i lidh interesi, detyra dhe puna e përbashkët"(Shih *RSHKJ* 6 f. 302 dhe *Fjalori rusisht - shqip*, Moskë 1954, f. 527.) Po në kuadër të këtij kuptimi, por në nuancë disi më të ngushtë e ndeshim edhe në gjuhën shqipe sipas stilit figurativ, libror, keqësues me përkufizimin "*grup njerëzish prej tre vetash që janë në krye të një vendi dhe drejtojnë pa përfillur mendimin e masave punonjëse e në kundërshtim me interesat e këtyre masave*". (Shih: FGJSSH, f. 2028.) Pikërisht lidhur me këtë koncept të fjalës **trojka** (e cila nuk është ndërkombëtarizëm edhe pse nuk është pa prirje të tillë) në shqipe del e nevojshme të sqarohen këto çështje:

e para, sa del e qëndrueshme forma e tillë me konotacion negativ në raportin: përkufizim / nocioni real në gjendjen e sotme të gjuhës, kur konceptet për "vendin" si dhe "interesat e masave punonjëse" janë relativizuar shumë,

e dyta, kjo fjalë a ka mundësi të përdoret në rrethana të caktuara, edhe me konotacion pozitiv dhe

e treta, a ka arsye që fjala e tillë e huaj të përdoret në stilin asnjans të gjuhës sonë, kur fushën përkatëse semantike e mbulon tërësisht fjalë e brumit të shqipes: **treshë treshja**?

Pas përgjigjeve në këto tri pyetje sigurisht çështja e shtruar do të jetë më e qartësuar, gjë që është edhe qëllimi i kësaj trajtесе.

1. Sipas një rregulli të përgjithshëm që ka të bëjë me normën pragmatike, stilistikisht çdo fjalë (si njësi semantike) në situata e rrethana të caktuara ka mundësi të përdoret qoftë me konotacion negativ, qoftë me konotacion pozitiv, prandaj shikuar nga kjo pikëpamje qëndrueshmëria e fjalës "**trojka**" në shqipe me kuptimin negativ keqësues as që ka nevojë të diskutohet, mirëpo sa i përket raportit: përkufizim / nocioni që sfidon, dalin çështje të hapura. Në gjendjen e sotme të realitetit politik vështirë e kemi për të gjetur një vend-shtet, ku sundon treshi i tillë që stilistikisht mund të quhej "trojkë", ngase ai nuk i përfillka "interesat e masave punonjëse"(!) ose që sundon a "qeveris në mënyrë autokrate", siç e thotë në fjalorin e tij M. Ndreca. (Shih: *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë* 1986 f. 711.)

Në realitetin tone gjuhësor nocioni i tillë sigurisht del më i gjerë dhe më specifik. Është mirë që kjo gjerësi dhe ky specifikim është kuptuar si duhet në mënyrë praktike. Këtë po e ilustruj me një shembull tipik, stilistikisht të qëlluar dhe të arsyeshëm, që e nxorra nga shtypi ynë, ku me të drejtë koncepti

i formuluar vetëm për treshe të rangut të lartë, siç u cek më sipër, ka zbritur edhe në nivele të tjera më të ulëta duke u specifikuar vetëm për botën sllave. Kështu p.sh. në gazetën "Bujku" (25.VI.1994, f. 1) është theksuar se si pjesëtarë të "trojkës", siç theksohet aty "më të urryer e më antishqiptare" përveç prefektit Simoviq, kriminelit Arkan, bën pjesë edhe Zh. Igiq. Sigurisht kjo "trojkë" edhe pse nuk i takon rangut më të lartë, e meriton, apo jo, këtë epitet të urryer në shqipe, kur kemi parasysh momentin emocional kur është shkruar, mund të merret me mend edhe sot.

Pse ka dalë leksema e tillë me konotacion negativ, patjetër do të ketë pasur arsye, ashtu siç mund të ketë edhe sot shtytës të mjaftueshëm për kultivimin e mëtejshëm të saj po për këso qëllimesh. Në këtë drejtim nuk është pa interes të sqarohet që për një konotacion të tillë keqësues sa ka pasur dhe ka ndikim asociacionisht kuptimi figurativ i fjalës kalë (kafshë), përkatësisht i togfjalëshit "kalë karroce", me të cilat në shqipen e sotme letrare emërtohet një "njeri i trashë, i pasjellshëm, mizor (...) çnjerëzor", përkatësisht "një njeri, i cili shikon vetëm një drejtim (...) që zbaton vetëm atë që i thonë". (FGJSSH f. 1922, 764.) Sido që të jetë, në stilin politik të tendosur "epitetet" e mësipërme të përgjegjësve "kalë" a "kalë karroce" përshtatin me "trojkën", përkatësisht me "tre kuaj që tërheqin karrocën pa rrota..."(!). Gjithsesi në kontekst të stilit të tillë kësaj fjale mund t'i përtërihet jeta e përdorimit.

2. Përveç konotacionit negativ, siç u tha më sipër, në shqipe, po për arsye stilistike, ka mundësi që **trojka** të përdoret edhe me konotacion pozitiv. Jo pse dikujt, siç thuhet, kjo "i fle a i shkon për zemër", po pse ashtu kushtet mund ta diktojnë. Fjala vjen, nëse në rrethana të caktuara mund të paraqitet ndonjë "treshe" qoftë nga pala ruse a ajo serbe a përgjithësisht nga bota sllavofolëse, me mision që ka a mund të ketë qëndrime konstruktive me peshë në dobi të zgjidhjes së çështjes sonë, atëherë jo vetëm "sa për politikë", por në shenjë mirësjelljeje e nderimi, s'ka arsye të mos quhet ajo me epitetin "trojkë e paqes" a ku ta di, pasi që ata në gjuhën e vet këtë fjalë mund ta kenë për zemër. Me një fjalë, siç mund të përdoret b.f. *triumvirati* latin, *trio* italiane, *Dreiherschaft-i* gjerman, *trashja* shqiptare ... pse të mos përdoret edhe *trojka* sllave (ruse, serbe, bullgare, boshnjake etj.), madje në stilin politiko - diplomatik kjo fjalë është në depërtim e sipër.

3. Me fjalë të tjera, fjala **trojka**, pra e rezervuar stilistikisht kryesisht për botën sllavofolëse, në situata të caktuara mund të përdoret edhe nga të tjerët, pra edhe nga shqipfolësit, qoftë me konotacion negativ, qoftë me atë

pozitiv, por kur është fjala te stili asnjans, përdorimi i fjalës së tillë mund të paraqesë shkelje të normës letrare, për arsye se për konceptin asnjans shqipja e ka fjalën e brumit të vet: **treshje treshja**, me të cilën kuptohet "grupi i përbërë nga tre njerëz", (Shih FGJSSH f.2023.) grup ky që mund të jetë i organizuar qoftë në shërbim pushteti, qoftë në punë të tjera si në komisione, delegacione, celula, ekipe etj., me destinim për të kryer kështu detyra me interes të përbashkët, funksion ky që për konceptin e caktuar e kryen edhe fjala "trojka" në gjuhët përkatëse sllave. Këtë fakt po e theksoj në mënyrë të veçantë, sepse pikërisht në këtë segment ka paqartësi dhe si pasojë bëhen lajthitje. Një lajthitje të tillë patëm rast ta vërejmë në gjuhën tonë të informacionit, si p.sh. në emisionet e lajmeve të TVSH-së më 11. XI. 1994, 16.10 (RT), rast ky kur me fjalën "trojkë" u quajt "treshja evropiane", e përbërë nga Gjermania, Franca dhe Greqia (Shih: Bujku, 26. IX. 1994, f.2)(!).

Duke e pasur parasysh ndërgjegjësimin rreth individualitetit të gjuhës shqipe e në përputhje me kërkesën nga kodeksi i agjensive të njohura informative, të cilat i karakterizon paanshmëria në dhënien e informatave si dhe në kontekst të detyrimit që ka të bëjë me emetimin (leximin) e informatave të tilla të zhveshura nga çdo lloji emocioni, ta quash "trojkë", treshen e tillë e të ngjashme (qoftë jashtë botës sllave qoftë brenda saj) në stilin asnjans në gjuhën tonë, duke e pasur barasvlerësin kuptimplotë **treshje treshja** në gjuhën tone, nuk më duket punë e qëlluar mire, sidomos aktualisht te ne! Them kështu me plot gojë ngase me një veprim të tillë mund të zgjohen asociacione të dyshimta te shqipfolësit e së këtejmi edhe te pjesëtarët e **treshes** së caktuar të agjencisë përkatëse. Andaj për arsyet që u cekën më sipër, mund t'i bie hije jo fort e bardhë edhe vetë institucionit prej nga lancohet një gjë e tillë. Gjithsesi barasvlerësi që shpreh kontekstin në shqyrtim në shqipe më mirë është të përkthehet me fjalën **treshje treshja** se sa më fjalën e huaj **trojkë trojka**.

Sidoqoftë drejtuesit e TVSH-së nuk është keq ta shtojnë kujdesin ndaj gjuhës në mënyrë që fjalët e huaja siç është edhe sllavizma **trojka** të mos përdoren pa kriter.

13) PRIRJE E VËREJTSHME NË DIFERENCIMIN SEMANTIK TË PREJFOLJORËVE PËRBËRËS TË "TRESHIT EMËROR SINONIMIK"

(variant punimi)

Që në fillim të punim-kumtesës "Çështje rreth emërtimit të proceseve tekniko-teknologjike me foljet më -O- (-ZO-)" të botuar në "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", nr. 12/87, Prishtinë, 1987, kalimthi është prekur çështja e të ashtuquajturit "treshe sinonimike", d.m.th. të emrave prejfoljorë të veprimit të përfutur nga fjalë-tema e njëjtë motivuese, të tipit shkruaj: **shkrim/shkruarje/të shkruarit; çmoj: çmim/çmuarje/të çmuarit**, për të cilin, duke pasur parasysh shfaqjen e tyre në realitetin tonë gjuhësor, prirjen e vërejtshme në diferencimin semantik apo më mirë luftën konkurrenente të sinonimeve në fjalë si dhe

qëndrimin që jepet në burimet tona teorike normative lidhur me favorizimin vetëm të emrave më -IM, kundrejt atyre më -JE dhe prejfoljorëve asnjans, si ide e re me njëfarë rezerve shtrohet pyetja: "mos vallë, treshja e tillë sinonimike do të konsiderohet në gjuhën tonë, jo vetëm si një begati që jep mundësi për të shprehur ngjyresa të ndryshme sinonimike për të njëjtin koncept, apo përbërësit e kësaj treshje do të mund të konsiderohen si fjalë-terma të veçantë që shërbejnë për të shprehur koncepte të ndryshme semantike, varësisht nga konteksti apo vetë diskursi që shprehet", ngase është e vërejtshme prirja që:

a) emrat më -IM të tipit: shkrim, çmim prirën të shprehin rezultatin e veprimit të foljes përkatëse;

b) emrat më -JE të tipit: shkruarje, çmuarje specifikohen të shprehin veprimin si proces (në vazhdim) dhe

c) emrat asnjans të tipit: të shkruarit, të çmuarit anojnë të shprehin konceptin e përgjithshëm të abstraksionit si proces?

Meqenëse aty përmasat e një kumtese nuk lejonin përthellim më të madh në pikëpamje të vështrimit më të gjerë, në këtë trajtesë paksa më hollësisht do të trajtohet kjo temë, me qëllim që të arrihen këto tri pikësnyime:

së pari, të ilustrohen dhe të verifikohen konstatimet e idetë e thëna aty;

së dyti, të shtrohet për vlerësim e argumentim arsyeshmëria e kundërvënieve të vërejtshme me prirje diferencimi sipas nënfushave të cekura semantike dhe

së treti, si është më së miri të vepohet tash dhe çfarë qëndrimi duhet mbajtur rreth kësaj dukurie me interes për gjuhën tonë standarde tash e në të ardhmen.

Siç dihet norma jonë letrare e njeh si të përligjur rregullën fjalëformuese se nga foljet më -OJ, -EJ (pjesërisht) dhe të një grupi të vogël më -UAJ, emrat e veprimit dalin me prapashtesën -IM, ndërsa prapashtesa -JE "bashkohet me të gjitha ato tema foljesh me të cilat nuk bashkohet prapashtesa -IM" (Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976 f. 219). Gjithashtu konstatohet se përkundër faktit se "formimet më -IM dhe -JE në gjuhën e sotme shqipe e kanë ngushtuar kategorinë e emrave foljorë asnjans të tipit të punuarit, të ardhurit" (LGJSSH f. 68.) sa që u ka dhënë atyre "karakter arkaik" a "karakter mbeturinor (reliktor) të theksuar", (Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Tiranë 1976 f. 64 dhe 109.) megjithatë ka raste që emërzimet

e tilla të pjesoreve vazhdojnë të përdoren në numër të pakufizuar, qoftë si terma, qoftë si fjalë të përgjithshme me të cilat shprehet procesi i caktuar.

Sidoqoftë, përkundër rregullave a konstatimeve të mësipërme, parimisht të pranueshme dhe të pakontestueshme, në realitetin tonë gjuhësor del i përfutur i ashtuquajtur term "treshe sinonimike", që do të thotë se në kontekste të caktuara shfaqen të trija këto forma emërore. Ja disa shembuj, ku krahas emrave më -IM dhe atyre asnjans dalin edhe emrat e veprimit më -JE:

1. shkruarje (rishkruarje, përshkruarje): "Rilindja", 20. II. 1986, f. 4; 15. III. 96, f.6; 19. III. 1986 f. 7; "Jehona" nr. 2/86 f. 35; "Bujku":16. I 1992, f. 11; 21. X. 192 f. 4; "Koha", 14. VI. 1995 f. 50; "Sistemi operues" i S. S. etj.

2. zgjuarje: "Rilindja": 22. VI. 1986, f.13; "Shëndeti" 4/86, f. 9; "Zëri i rinisë", 17. II. 1990 f.21; "Alternativa" II 2/90, f. 30; "Bujku", 20. V.1994, f. 7.

3. lëshuarje: "Rilindja", 22. III. 1986, f. 13; 20. VII. 86, f. 10; 28. II. 1990 f. 12; 13. III 1990, f. 8; "Fjala", 15. IV. 92, f. 7; "Koha" 23. III. 1994, f.9; "Bujku", 14.VII.93, f. 4 (3 herë); 2. II. 92, f. 4; 12.III. 92, f. 2; 22. XI. 93, f. 2; 5. VIII. 94 f. 5; "Koha", 23. III. 94, f.9. "Fjala jonë", qershor 1995 f.26.

4. dërguarje: "Rilindja", 22. VI. 86, f. 17;

5. mësuarje: "Rilindja", 2. II. 87, f. 5; 11. IV. 1992, f. 7; "Fjala jonë", maj 1995, f. 16.

6. vluarje: "Seminari ...", nr. 11/86, f. 23; "Zëri", 18. I. 1992, f. 29.

7. rrëzuarje: "Shkëndija" nr. 8 shkurt 1991, f. 11; "Forumi", 31. I. 94, f. 22; "Bujku", 13. VII. 91, f. 4; "Zëri" 3. X. 1992, f.8; 14. XII. 91, f. 15.

8. mëshuarje: "Zëri", 3. X. 1992, f. 8.

9. dëbuarje: "Bujku", 18. II. 1992, f. 9.

10. ftuarje: "Zëri", 28. III. 1992, f. 10;

11. shpuarje: Fjalori shqip-anglisht (Duro-Hysa), f.423.

12. shfryerje: "Zëri", 28. V. 1994, f. 39.

13. paguarje: "TVB", 27. XI. 1992.

14. çmuarje: Fjalor i termave të tregtisë së jashtme, Tiranë (1989), f.103.

Nga shembuj e mësipërm, të cilët sigurisht nuk mund të jenë të vetëm, besoj se vërtetohet fakti se nuk kemi të bëjmë me raste të vetmuara, por kemi të bëjmë me një dukuri të gjallë, e cila, dorën në zemër, nuk duket se del në përmasa të gjera, por nuk është edhe pa anim përgjithësimi. Edhe pse te ne

dukuria e tillë mund të ketë elemente spontaniteti për shkak të formës së pjesores mbi bazë të toskërishtes (tash letrarishtes), ajo në të vërtetë si mënyrë fjalëformuese në gjuhën tonë ka ekzistuar edhe më përpara. Lidhur me këtë prof. A. Xhuvani konstatonte se "nga pjesorja e foljeve më -oj, më -ej (e me -ij) janë formuar në toskënishtet qysh në kohë të Rilindjes e mbasandaj edhe në kohët e reja emra abstraktë me prapashtesën -JE: p.sh. perënduarje - perëndim, mburuarje - mbrojtje, gatuarje etj." (Shih: *Studime gjuhësore*, Prishtinë 1968 f. 328.)

Po theksoj lidhur me këtë se ndonjë trajtë e tillë e emrit prejpjesor e përfutur mbi këtë bazë si p. sh. **hutarje, shtruarje, zgjuarje**, ndeshet si shembull përfaqësues në punimin e mirënjohur të bashkautorëve Xhuvani-Çabej "*Prapashtesat e gjuhës shqipe*". (Shih: A. Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980 f. 506.)

Me fjalë të tjera, çështja e ekzistimit të treshes sinonimike, siç u quajt këtu, nuk vihet në dyshim, ngase vërtet i ndeshim në gjuhën tonë rastet **më -IM**, ato **më -JE** si dhe formimet me **prejpjesorët e nyjshëm të gjinisë asnjane**, të cilat thuhet se në të kaluarën kishin përdorim më aktiv sesa kanë sot, por, sipas studimeve më të reja, aktiviteti i tyre edhe sot nuk ka pushuar, madje shënon rritje.

Natyrisht kur është fjala tek të shprehurit e konceptit të njëjtë neutral, atëherë në ndjenjën gjuhësore do të përzgjedhet vetëm njëra trajtë, ajo që shqipfolësit i duket më e drejtë, por sipas normës fjalëformuese, përzgjedhja del e zgjidhur kështu: "Prej foljeve më -OJ emrat prejfoljorë të veprimit formohen me prapashtesën -IM e jo më -JE, prandaj përdorimi i emrave *helmuarje (helmoj), hutarje (hutoj), shpuarje (shpoj), shtruarje (shtroj), zgjuarje (zgjoj)*, në vend *helmim, hutim, shpim, shtrim, zgjim* nuk janë në pajtim me normën letrare". (Shih: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976 f. 219.)

Mirëpo, ç'është e vërteta, rregull-kontatimi i mësipërm paksa bëhet i diskutueshëm, madje edhe jo aq i qëndrueshëm edhe nga vetë fakti i regjistrimit të trajtave paralele **çmim/çmuarje, shqim/shquarje** dhe **shtrim/shtruarje** në FGJSSH (1980), pra, nga foljet: **çmoj, shquaj, shtroj**, por edhe trajtat e formave të tipit: **të çmuarit, të shkruarit** që dalin në kontekste të caktuara.

Diçka rreth vlerësimit të arsyeshmërisë së bashkekzistencës së këtyre tri formave sinonimike se a do të konsiderohet ndonjëra prej tyre si shkelje e

normës apo del si një nevojë që lypset favorizuar dhe në çfarë rrethanash paksa do të behet fjalë në vazhdim.

Sigurisht nevoja është ai faktori i domosdoshëm që përcakton dhe kushtëzon përdorimin apo jo edhe të dy apo të tri formave sinonimike në shqyrtim, gjë që varet si nga shtytës të brendshëm ashtu edhe nga ata të jashtëm gjuhësorë. Për të qenë edhe më e kapshme tema që po trajtohet këtu e shoh të arsyeshme që më poshtë të shënoj nja dy shembuj të gjuhës sonë në ballafaqim me barasvlerësit përkatës të gjuhës serbokroate:

1. Nga folja çmoj (me çmue) - ceniti, oceniti:

a) *çmim* / - cena /shprehet: rezultati i veprimit a vlera financiare e një malli/;

b) *çmuarje* / - cenjenje, ocena, ocenjivanje - /shprehet: veprimi si proces a vlerësimi i veprimit të caktuar/;

c) *të çmuarit* - procenjivanje, cenjenje, ocenjivanje - /shprehet: koncepti i temës lëndës) si abstraksion, vlerësim i përgjithshëm, mjeshtria e të çmuarit/.

2. Nga folja shkruaj (me shkru) - pisati, napisati:

a) *shkrim* - rukopis, spis: - /shprehet: rezultati i veprimit të të shkruarit/;

b) *shkruarje* - pisanje: - /shprehet: procesi i të shkruarit/;

c) *të shkruarit* - pisanje, pismenost:- /shprehet: koncepti i përgjithshëm i procesit të veprimit/.

Në *Fjalorin shqip - serbokroatisht* (1981) i ndeshim të shënuara të tria trajtat nga shembulli i parë, ndërsa për shembullin e dytë del e shënuar vetëm trajta **shkrim**, ndërkaq në FGJSSH (1980) nuk e ndeshim të shënuar trajtën **të çmuarit** nga shembulli i parë dhe trajtën **shkruarje** të shembullit të dytë.

Sidoqoftë, pa përjashtuar mundësinë e përdorimit të ndonjë trajte tjetër sinonime, me marrë përgjithësisht barasvlerësit e shënuar më sipër dalin të qëndrueshëm, qoftë në përfaqje të brendshme sinonimike, qoftë në krahasim me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja, edhe pse kuptimi i vërtetë i çdo fjale merr jetë e arsyetohet bindshëm vetëm kur të jepet brenda sekuencës së caktuar në kuadër të tekstit a korpusit përkatës në suazat e sistemit të vet ligjërimor. Barasvlerësit e gjuhës serbokroate u cekën këtu me qëllim sa për të hyrë më lehtë në temën që duam ta spikasim, sepse trajtat e gjuhës shqipe mund të kenë rrugën e vet autoktone të zhvillimit dhe të jetës, gjë që nuk është

kusht i domosdoshëm të përkojnë në numër a sasi me trajtat a mënyrat fjalëformuese të gjuhëve të tjera. Sidoqoftë, një nevojë e tillë del e shprehur më ndjeshëm në raport me gjuhët në kontakt, sidomos në të ashtuquajturën "gjuhë të përktimit", ku bëjnë pjesë edhe proceset tekniko-teknologjike e ekonomike të karakterit universal.

Nuk është fakt i panjohur përgjithësisht se zhvillimi tekniko-teknologjik shtron nevojën dhe bën trysni në zhvillimin e çdo gjuhe ashtu si dhe në gjuhën tonë, qoftë duke u dhënë fjalëve ekzistuese kuptime të reja (polisemike), qoftë duke shtruar nevojën e krijimit të fjalëve të reja ose duke huazuar e përvetësuar fjalë e konstrukte të huaja.

U tha më sipër se sipas rregullit nga foljet më -OJ, -EJ (pjesërisht) dhe të një grupi të vogël më -UAJ emrat e veprimit janë formuar e formohen me prapashtesën -IM, ndërsa "prapashtesa -JE bashkohet me të gjitha ato tema foljesh, me të cilat nuk bashkohet prapashtesa -IM" (GJLSHGJ f. 218 – 219.), rregull kjo fort e kapshme dhe e qëndrueshme, edhe pse në raportin -IM / -JE dalin përjashtime, siç është edhe kjo analizë jona, të cilat ka nevojë të sqarohen.

Në gjendjen e sotme në gjuhën shqipe prapashtesa femërore -JE ndonëse "nga pikëpamja e lidhjeve fjalëformuese paraqitet më e shtrirë nga ajo -IM", kjo e fundit ndeshet në numër më të madh, "është më prodhimtare", ngase "pothuaj nga çdo folje më -OJ formohet një emër prejfoljor i veprimit me prapashtesën -IM" (Shih: *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* II, Tiranë 1976, f. 109).

Mirëpo edhe pse foljet më -OJ janë klasa më aktive dhe prodhimtare në kuadër të sistemit foljor të shqipes, ndërsa foljet me bashkërtingëllore fundore dhe të tjera mbi të cilat formohen emrat e veprimit më -JE, ndeshen në numër më të vogël, madje disa prej tyre dalin në numër farë të kufizuar, nga pikëpamja e motivimit emrat më -JE janë më të kapshëm dhe më lehtë të shpjegueshëm. Këtë motivim asociacionisht e ndihmon edhe përfitimi i emrit të vepruesit, i cili del i ndërtuar mbi të njëjtën temë fjalëformuese siç del edhe emri i veprimit më -JE.

Për ta pasur më të qartë këtë raport po shërbehem me pasqyrën e mëposhtme duke paraqitur nga një shembull për çdo grup a nëngrup të foljeve, të ndarë në tri rubrika:

1. trajtën përfaqësuese të foljes, në kllapa futa edhe paskajoren e mirëfilltë me qëllim që të shihet më qartë pjesorja përkatëse temëfjalëformuese,

2. trajtën e emrit të veprimit dhe
3. trajtën e emrit të vepruesit.

Pasqyra e raportit fjalëformues të emrave të veprimit dhe atyre të vepruesit në shqipe:

Trajta përfaqësuese e foljes 1	Emri i veprimit 2	Emri i vepruesit 3
a) mësoj (me mësue):	mësim	mësues;
shkruaj (me shkruar)	shkrim	shkruar;
shpërblej (me shpërblje)	shpërblim	shpërbljes.
b) mbroj (me mbrojtje)	mbrojtje	mbrojtës;
ruaj (me ruajtje)	ruajtje	ruajtës;
vërej (me vërejtje)	vërejtje	vërejtës;
blej (me ble/rë)	blerje	blerës;
mbrej (me mbrehje)	mbrehje	mbrehës;
shkrij (me shkri/rë)	shkrim	shkrimtar;
arrij (me arritje)	arritje	arritës;
buj (me bujtje)	bujtje	bujtës;
bëj (me bë/rë)	bërje	bërës;
fryj (me fry/rë)	fryrje	fryrës;
laj (me la/rë)	larje	larës;
mbaj (me mbajtje)	mbajtje	mbajtës;
ziej (me zie/r)	zierje	zierës;
kryej (me krye/r)	kryerje	kryerës
vë (me (vu) vënë)	vënie	vënës;
(me vu/më)	vumje!)	
nxë (me nxënë)	nxënie	nxënës;
ngre (me ngritje)	ngitje	ngritës;
mat (me matje)	matje	matës;
marr (me marrje)	marrje	marrës;
stolis (me stolisje)	stolisje	stolisës;
pajis (me pajisje)	pajisje	pajisës;
hekuros (me hekurosje)	hekurosje	hekurosës;
radhit (me radhitje)	radhitje	radhitës.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm emrat më -IM formohen nga rrënja e trajtës foljore që disa e quajnë trajtë të së tashmës së njëjësit të dëftores, përkatësisht të kuptuar kështu "në ndjenjën gjuhësore si temë e përgjithshme e foljes" (Xhuvani, Çabej), ndërsa disa të tjerë e shpjegojnë se ka dalë nga "participi i shqipes nëpër një zhvillim të brendshëm të gjuhës" (Xhuvani, Ajeti). Sidoqoftë, prapashtesa -IM i është shtuar trajtës foljore pa prapashtesë-mbaresën përkatëse qoftë të dëftores: O/j, -E/j, -UA/j, qoftë të pjesores: -UE(-UEM)/-UAR, -YE(-YEM)/-YER, temë fjalëformuese kjo që del e motivuar vetëm tërthorazi e jo drejtpërdrejt, siç del b.f. emri i vepruesit nga trajta e shkurtër e pjesores mbi bazë të ish - gegërishtes letrare si p.sh. mësues, shkrues, shpërblyes, d.m.th. pjesore + prapashtesa -S, pra jo nga trajta e zgjeruar: mësuem(ë)/S, shkruem(ë)/S, shpërblyem(ë)/S (!).

Në anën tjetër emrat më -JE pothuajse dalin të motivuar nga pjesorja e foljes përkatëse, qoftë mbi bazë të ish - gegërishtes letrare të foljet me tëmë në bashkëtingëllore, qoftë mbi bazë të toskërishtes letrare, përkatësisht të shqipes së sotme letrare, mbi bazë të foljeve me tëmë në zanore a togzanor. Të vihet re se tek grupi foljeve b) në të gjitha rastet emri i veprimit dhe ai i vepruesit kanë mbështetje mbi temën e njëjtë fjalëformuese: pjesoren e foljes përkatëse.

Pra në formën e pjesores së shqipes së sotme letrare kanë mbështetje edhe emrat që po diskutohen këtu, të cilët u përfatuan krahas atyre më -IM të tipit: shkruarje/shkrim, çmuarje/çmim.

Sipas arsyes formale emrat më -JE kanë model që asociacionisht del jo vetëm i mundshëm të shtrihet edhe te foljet e grupit a), por edhe i lejueshëm, mirëpo sa i përket anës semantike ia vlen të diskutohen, ngase për të njëjtin koncept gjuhësisht vërtet s'ka arsye fare të favorizohen. Me fjalë të tjera, emrat paralelë më -JE krahas atyre më -IM semantikisht mund të jenë të lejueshëm vetëm atëherë nëse emri më -IM u lë atyre nënfushë të lirë (kuti të zbrazët) veprimi. Por meqenëse me emrat më -IM emërtohen a mund të emërtohen dy koncepte themelore:

1. nocioni i "veprimit si proces" dhe
2. koncepti i "rezultatit të veprimit",

atëherë emri i tillë poqese del i specifikuar më tepër a kryesisht vetëm për konceptin e dytë lë shteg për manipulim, ngase paksa e zbeh kuptimin e parë. Dhe vërtet, në shumicën e rasteve që u sollën në këtë punim emri më -IM dilte i specifikuar për kuptimin e dytë themelor, por edhe për kuptime të tjera polisemike qoftë edhe me kuptim figurativ e më pak për kuptimin e parë themelor. Kështi, në *Fjalorin e shqipes së sotme* (1984): emri **shkrim** është i

regjistruar edhe për tri kuptime të tjera polisemike, emri **çmim** për katër, ai **lëshim** për dy, **shkëlqim** për 4 etj.

Prandaj në këtë heterogjeni, si me thënë, ka gjetur vend a shkas, gjë që mund të gjejë edhe në të ardhshmen, për t'iu futur pranë për konceptin e parë pikërisht barasvlerësi sinonimik asociativisht më i afërti e ai është: **emri i veprimit më -JE**.

Gjithsesi kjo dukuri lypset analizuar gjithanshmërisht nga studiuesit madje edhe në përqsaje me emrat e nyjshëm prejfoljorë asnjansë sinonimikë, me të cilët, sidomos emrat më -JE kanë sinonimi edhe më të përfaqësuar, madje shpesh edhe ndërkëmbehen, dukuri kjo që vërehet, qoftë në gjuhën e shkrimit, qoftë në gjuhën e folur.

Ndonëse mbase del i drejt në parim gjykimi se formimet më -IM dhe -JE në gjuhën e sotme shqipe e kanë "ngushtuar kategorinë e emrave foljorë asnjansë të tipit të punuarit, të ardhurit etj.", kategori kjo "që vjen vazhdimisht duke u ngushtuar" sa që "u ka dhënë atyre karakter arkaik", siç thuhet në gramatikën tonë normative (Shih: *Fonetika dhe gramatika ...II*, f. 109), megjithatë emrat prejfoljorë asnjansë vazhdojnë të përdoren, madje jo vetëm ata "të vjetrit", të cilët janë ngulitur, qoftë me cilësinë e termit, qoftë me kuptim të përgjithshëm, por përftohen edhe "të rinj".

Me fjalë të tjera, ndonëse emrat e tillë të gjinisë asnjansë nuk përdoren si më përpara, siç e tha, për emërtimin e një veprimi a të një rezultati të veprimit, pasi që tash për koncepte të tilla dalin të aktivizuar dhe të favorizuar emrat përkatës të veprimit më -IM e -JE, qoftë secila trajtë veç e veç mbi tema të ndryshme foljore, qoftë edhe mbi temë-folje të njëjtë fjalëformuese, megjithatë ai vazhdon të përdoret, ngase, siç pranohet edhe në gramatikën tonë normative, emri prejfoljor asnjansë në disa raste e ka "më të theksuar kuptimin e procesit" dhe për ndonjë a tjetër arsye "është i pazëvendësueshëm", (Shih: *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Tiranë 1976, f. 109.*) siç janë p.sh. rastet, kur emri i tillë ka marrë tiparin e termit në fushën e caktuar të shkencës a të kulturës si p. sh. **të ardhurat** (në ekonomi), **të menduarit** (në logjikë) etj., të cilat dalin të shënuara në të gjitha burimet përkatëse normative. Mirëpo është fakt i pamohueshëm se në burimet e tilla vihet re një pakësim do ta quaja të tepruar të numrit të emrave të tillë asnjansë, edhe pse në jetën e përditshme ndeshen më me shumicë, sidomos prejmbiemërorët e prejpjesorët.

Sidoqoftë, forma e prejfoljorit të gjinisë asnjansë nuk del e shuar për të gjitha konceptet që i nevojiten gjuhës sonë, sidomos asnjansësi zë vend të

pakundërshtueshëm në nënfushën e abstraksionit mendor për të emërtuar kuptimin e procesit si temë (koncept i përgjithësueshëm), e cila ngërthen në vetvete edhe elemente të nocionit të veprimit edhe nuanca të tjera. Është e vërtetë se nga çdo folje të të dy grupeve të sipërcekura mund të formohet emri përkatës i nyjshëm asnjans dhe se për këtë del si fjalë-koncept i kuptueshëm nga secili shqipfolës i të gjitha shtresave të ndryshme shoqërore, ngase modeli i tillë fjalëformues qëndron i ravijëzuar thellë në kohëhapësirë kaheerë e tash në sistemin e përgjithshëm ligjërimor të shqipes globale.

Pra kur kemi parasysh këtë fakt s' di sa mund të cilësohet prejfoljori i tillë si një "fosil" i shkelur kohe? Mbase duhet rishikuar më mirë mundësinë që edhe emërtimet e tilla të (ri)aktivizohen sa herë që e lyp nevoja krahas barasvlerësve të tjerë sinonimikë?

Prejfoljorët e gjinisë asnjansë i karakterizon përparësia sepse mund të përdoren paralelisht, siç u cek më sipër, pa shkaktuar kundërvënje të ndjeshme edhe ndaj emrave mashkullorë më -IM edhe ndaj atyre femërorë më -JE, pra për të gjitha grupet e foljeve pa përjashtim.

Në përputhje me rastet që konsultuan, ku u gjet i përdorur edhe emri i diskutueshëm më -JE (është fjala për ndërtimet mbi bazë të foljeve më -OJ, -JE e -UAJ) po i rikonstruktoj dy shembuj analogë:

1. Në një reportazh, b.f. ku raportohet për garat me ski nga një skijimtare, titulli mund të jetë: "**Të lëshuarit** me ski", ndërsa brenda tekstit mund të figurojë fjalia: "**Lëshimi** i parë dhe i dytë kaluan normalisht, por gjatë **lëshuarjes** së tretë ngjau diçka e papritur!".

2. Po kështu veprohet b. f. në ndonjë rast tjetër me temë tjetër, p. sh: "**Të shkruarit** e reportazheve kërkon mjeshtëri. Gjatë **shkruarjes** duhet pasur kujdes, ngase së bashku me **shkrimin** vlerësohet edhe autori edhe organi ku do të botohet".

Raste analoge si këto aspak nuk janë befasi në realitetin tonë gjuhësor.

S'do mend se vetë diskursi brenda sistemit ligjërimor, natyra e tij, është kriteri më i mirë që e pranon ose jo formën a njësinë e caktuar gjuhësore, por sipas përvojës mund të thuhet se pragmatikisht emri asnjans prejpjesor ka mundësi të dalë nga secila folje e gjuhës sonë, prandaj një mundësi e tillë ia vlen të shfrytëzohet. Angazhimi i trajtave më -JE si dhe i prejfoljorëve asnjans aspak nuk zbehin aftësinë e emrave më -IM, të cilët mund të

shërbejnë si tema të qarta fjalëformuese për formimin e një tufë emrash, mbiemrash e ndajfoljesh, madje edhe foljesh si p. sh. lëshimtar lëshimtare, lëshimtore, lëshimësi, lëshimor lëshimore, lëshimurina; lëshimor/e, lëshimësor/e; lëshimthi, lëshimisht; etj.

3. Nga sa u tha më sipër besoj se bashkëjetesa e treshit sinonimik jo vetëm se del e mundshme të shfrytëzohet për të shprehur ngjyresa të ndryshme stilistike, por nga zberthimi i elementeve përbërëse të këtij "treshi", ka mundësi që secili komponent të përfillet si fjalë-njësi e pavarur me prirje diferencimi për nënfusha të caktuara semantike. Kjo aq më shumë ka rëndësi të njihet e të kuptohet drejt, sepse është rrezik të ndodhin keqkuptime. P. sh. ndodh të përjashtohet arbitrarisht nga përdorimi gjoja si relikto prejfoljori i nyjshëm asnjans ose të përjashtohet përjetësisht paralelja (femërore) më -JE ndaj formantit -IM edhe në ato raste kur shihet qartë se nuk prish punë, ngase konteksti e arsyeton etj.

Gjithsesi thjeshtëzimet e tilla pa kriter mund t'i sjellim dëm fondit të përgjithshëm të fjalësisë të gjuhës sonë letrare dhe njëherazi mund ta gjymtojnë një mundësi të natyrshme e me vlerë për pasurimin e gjuhës sonë standarde tash e në të ardhshmen.

Sidoqofte, për arsyet e mësipërme "treshi foljor sinonimik" mund të cilësohet si një begati që na dhurohet, por, ç'është e vërteta, fati i tij varet edhe nga qëndrimi dhe vlerësimi që marrin ndaj kësaj dukurie ekspertët tanë të gjuhës sonë letrare. Unë mendoj se kjo mundësi duhet të ndiqet me vëmendje të shtuar nga standardologët tanë, duke i lënë të lira të konkurrojnë të tria trajtat, në mënyrë që secila sosh ta kërkojë vendin e vet në hapësirë dhe kohë, varësisht nga konteksti që shprehet a që do të duhej të shprehej.

Çdo gjuhë të zhvilluar e karakterizon një shumësi relative formash e leksemash, të cilat të përpunuara e të formëzuara në modele fjalëformuese i japin entitetin asaj gjuhe. Pra edhe gjuha jonë është duke e ndjekur po atë rrugë. Është krejt normale që së pari duhet të shfrytëzohet pasuria e brendshme e trashëguar e gjuhës, së këtejmi, nga nevoja do të farkëtohen fjalë të reja në bazë të modeleve prodhuese dhe pastaj, gjithashtu nga nevoja, edhe do të huazohen fjalë të huaja, por vetëm ato të domosdoshmet. Njohja e modeleve fjalëformuese vetjake të shqipes nga të gjitha shtresat shoqërore del e nevojshme, sidomos në aktualisht, por aq më tepër në të ardhshmen, kur pritet të rriten nevojat për të shprehur edhe më shumë koncepte e nuanca edhe më të holla kuptimore e stilistike që deri më tash nuk dilnin aq të ndjeshme. Çdo formë e çdo koncepti do të jetë mjet i mirëseardhur që do t'i hyjë në punë për

pasurimin e gjuhës sonë standarde në të ardhshmen, në këtë kuadër do të futeshën edhe përbërësit e të ashtuquajturit "tresh sinonimik".

Në fund pa kundërshtuar konstatimet e dhëna në mjetet tona normative lidhur me nënfushat semantike që mbulojnë emrat më -IM, emrat më -JE si dhe emrat asnjans prejfoljorë të nyjshëm, të cilat në pika të caktuara edhe mund e duhet të përplotësohen e modifikohen. Në këtë plan, patjetër duhen njohur nënfushat semantike që mbuloohen nga treshi sinoniumi, ngase:

a) me emrat më -IM të tipit: *shkrim, çmim, shkëlqim* shprehet koncepti i rezultatit të veprimit;

b) me emrat më -JE të tipit: *shkruarje, çmuarje, shkëlqyerje* shprehet veprimi si koncept i veçueshëm dhe

c) me emrat asnjans prejfoljorë të tipit *të shkruarit, të çmuarit, të shkëlqyerit* etj. shprehet procesi i veprimit si koncept i përgjithësueshëm.

Në këtë kontekst duhet pasur kujdes që për të njëjtin koncept mos të ngatërrohen formimet më -JE me ato më -IM si dhe format më -JE dhe *emrat asnjans* mos të njëjtësohen në çdo rast, kur ka mundësi të diferencojnë nënfushat semantike.

Përfundim

Në këtë trajtesë pa i ra ndesh rregullës decidive dhe parimisht të drejtë e të qëndrueshme se prapashtesa -IM del si ndajshitesë e specializuar për formimin e emrave nga foljet më -OJ, më -EJ (pjesërisht) dhe të një grupi të vogël më -UAJ, vërtetohet se në realitetin tonë gjuhësor shfaqet i ashtuquajturi "tresh foljor sinonimik", ku përkrah emrit më -IM shfaqet edhe prejpjesori me prapashtesën -JE si dhe prejpjesori i nyjshëm i gjinisë asnjansë. Kjo dukuri karakterizohet me bashkëjetesën e të tre emrave prejfoljorë, të tipit:

-çmim / çmuarje / të çmuarit;

-shkëlqim / shkëlqyerje / të shkëlqyerit;

-shkrim / shkruarje / të shkruarit.

Siç po shihet trajtat e "treshit"ose e "treshes" në fjalë mbështeten përkatësisht në foljen e njëjtë temëfjalëformuese: **çmoj, shkëlqej, shkruaj.**

Gjatë analizës u arrit përfundimi se nga zbërthimi i komponenteve të kësaj treshe sinonimike vërehet, pos karakterit sinonimik stilistik, prirja e diferencimit semantik të tyre, kështuqë:

- me emrat më -IM shprehet rezultati i veprimit;

- më emrat më -JE shprehet veprimi (koncepti i veçueshëm);

me emrat asnjans shprehet veprimi si proces abstrakt (koncepti i përgjithsueshëm).

Njëherazi tërhiqet vërejtje se nëse emri më -IM ruan kuptimin e veprimit si kuptim themelor e jo rezultatin, atëherë në raste të tilla përjashtohet trajta më -JE. Gjithashtu shprehet mendimi se kur është fjala për të shprehur veprimin me prirje të karakterit të përgjithsueshëm, atëherë s'ka arsye të mënjanohet prejpesori i nyjshëm asnjans duke u zëvendësuar domosdo me emrin përkatës me prapashtesim, qoftë me trajtën më -JE, qoftë me atë më -IM, por kur është fjala tek të shprehurit e konceptit abstrakt të shkallës më të lartë gjithsesi asnjans del i domosdoshëm. .

Po të shfrytëzohen me kriter konstatimet e mësipërme, "treshja" e tillë sinonimike nuk do të jetojë vetëm si një mundësi e karakterit stilistik por do të përfillet edhe si një mënyrë që shkon në dobi të pasurimit të mëtejshëm të leksikut të gjuhës sonë, në kuadër të sistemit të përgjithshëm emëror të shqipes standarde.

Prishtinë, më 17. VI. 1995

14) EDHE NJËHERË RRETH LAJTHITJES KONTEKSTORE "DERI ATËHERË MIRUPAFSHIM!"

Rreth lajthitjes kontekstore "*deri atëherë mirupafshim!*" si një ndërtim a "*formulë stereotipe në kundërshtim me veçoritë semantike të gjuhës sonë*" a si një konstrukt që "*s'ka fare kuptimi logjik*" është bërë fjalë te ne që në vitet e '70-a. Që atëherë qe konstatuar se shprehja e tillë është përftuar si shpifje e panevojshme nën ndikimin e drejtpërdrejt të shprehjes "*do tada dovidjenja!*" të serbokroatishtes dhe lidhur me këtë qe shprehur mendimi se në vend të pasthirmës së tillë "mirupafshim!" për kontekstin në fjalë në shqipe si trajtë më e drejtë do të dilte fjala përrshëndetëse: "**mirëmbeç, mirëmbeçi**". (Shih: T. Këlmendi te *Çështje të normës letrare*, Prishtinë 1980 f.186 dhe Dr. I Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes III*, Prishtinë 1985, f. 85.)

Kritika që iu ishte drejtuar atëherë "disa gazetarëve e spikerëve të Radiotelevizionit të Prishtinës", të cilët e përdornin shprehjen e tillë "pas përfundimit të çdo emisioni" të radios a të televizionit, pati efektin e vet pozitiv, por si duket nuk mundi të shrrënjoste plotësisht një dukuri të tillë të pamirë, pasi që ajo ushqej nga ndikimi i gjuhës kontaktuese serbe, por mbase edhe të ndonjë gjuhe tjetër.

Kjo që po them nuk dëshmohe vetëm me faktin se në kohë të vona, jo vetëm në emisionet "shqipe" të Radios dhe TV të Prishtinës, ku mjerisht, sidomos sot pas dëbimit të kuadrit shqiptar, vërtet mungojnë gazetarët e redaktorët cilësorë, u rikthye shprehja e tillë, por po dëgjohet gjithnjë e më

shpesh edhe në lajmet "shqip" të "Radio -Jugosllavisë" dhe të "TV-Beogradit", siç ndodhi edhe më 25. X. 1995, ora, 17.30. Jo vetëm kaq, por aq më keq një shprehje të tillë patëm rastin ta dëgjojmë 2-3 herë, muajin e fundit, edhe në fund të lajmeve (të para) të emetuara me satelit nga TVSH-ja (edhe më 25. XI. 1995, ora 20.25), madje edhe në emisione të tjera, siç ndodhi edhe në emisionin për fëmijë "PAF" të datës 20. X. 1995, ora 19.25, të emisionit për të rinj "Fillad", më 26. XII.1995, ora 19.45 etj. Ngjashëm me këtë është e vërejtshme edhe shprehja analoge "deri atëherë mirudëgjofshim!" (serb. "to tada do slušanje") që mjaft shpesh po emetohet nëpërmjet emisioneve të stacioneve të sipërcekura, por edhe nga emisionet shqipe të radio BBC-së nga Londra (ku pothuajse disa folësve u është bërë ves), si p.sh. më 30. X. 1995, ora 15.45, më 27. XII. 1995, ora 7. 58 etj. Atyre nuk po u mbesin prapa as disa kolegë në radio "Zëri i Amerikës" nga Uashingtoni, më 29. X. 1995, ora 15.15 , më 24. XII. 1995, ora 18.24 etj., por edhe nga Radio-Tirana, si p. sh. më 4. X. 1995, ora 16.30; më 30. XI. 1995, ora 16.30; 22. XII. 1995, ora 20. 50 etj.

S`do mend, se edhe për shprehjen "*deri atëherë mirudëgjofshim!*" ose "*deri atëherë mirutakofshim!*" që mund të kemi rast t`i dëgjojmë të emituara nga radio-stacionet e caktuara, vlejnë të njëjtat vërejtje e vlerësime, siç janë thënë e do të thuhën për formulën stereotipe "*deri atëherë mirupafshim!*" edhe në vazhdim të këtij artikulli.

Rreth kësaj dukurie këto ditë ka reaguuar edhe gjuhëtari Q. Murati, i cili veç tjerash thekson se "*kjo shprehje që nuk ka as kokë as bisht ... nga masmediat shqiptare në Kosovë e në Maqedoni, ka shkuar... e është bartur tash së fundi edhe në masmediat shqipe të Tiranës. Folësit... që e përdorin këtë shprehje drastike dhe të neveritshme njëkohësisht, nuk e kanë të qartë aspak se "mirupafshin deri atëherë" shpreh në të vërtetë një kuptim të kundërt me atë që duan ta thonë ata...*". (Shih te revista "Koha" (Prishtinë), datë 30. XII. 1995 f. 13.)

Nga sa po shihet shprehja e tillë "*pa kuptim logjik*" siç e thotë prof. I Ajeti a si "*shprehje drastike dhe e neveritëse... pa kokë e bisht*" si e shpreh Q. Murati apo si një "*lajthitje kontekstore*", siç po quhet në këtë artikull, ka marrë përmasa të tilla saqë meriton të ridiskutohet, përkatësisht të jepën paksa edhe vlerësime me të thella e bindëse rreth çështjes se a duhet të harret nga kopshti i gjuhës sonë letrare kjo bimë e egër e shpifur, apo duhet pranuar me dhunë si një pirrë në kopshtin tonë letrar, pasi që s'po mund ta largojmë dot?

Pra, me qëllim që mos të mbesin dilema lidhur me pyetjet e shtruara, mendoj se duhen sqarohen këto dy çështje:

e para, a ka kontaminim konceptesh në një shprehje të tillë dhe
e dyta, cila do të jetë zgjidhja më e mirë në shqipe, lidhur me konceptet
në trajtim?

1

Te sekuenca përmbyllëse, b. f. "Shikues (dëgjues) të nderuar, para se të ndahemi, po ju njoftojmë se emisionin tjetër mund ta ndiqni nesër (... pas gjashtë orësh, pas dreke, pas dy dite, ... etj.) në të njëjtën orë, deri atëherë (nga realizuesit e këtij programi, edicioni) *mirupafshim!* (*mirudëgjofshim!*)", sidomos në formulimin e fundit: *deri atëherë mirupafshim!* ose *deri atëherë mirudëgjofshim!* ka mundësi të nënkuptohen dy mesazhe: e para ashtu siç shprehet me fjalët "*deri atëherë*" ka të bëjë me kohën (intervalin) deri sa do të shfaqet (emetohet) sërish a vazhdimi i emisionit të përfunduar dhe e dyta, nuk shprehet me fjalë, por nënkuptohet, se ka të bëjë me kohën (terminin) e saktë, kur do të emetohet sërish emisioni tjetër, natyrisht me përmbajtje të re, d.m.th. atëherë kur mund të shihemi a të dëgjohemi "për të mirë", ashtu siç e dëshiron lexuesi i mesazhit.

Që të dyja këto koncepte në shqipe me shprehjen "deri atëherë mirupafshim!" përkatësisht "deri atëherë mirudëgjofshim!", në gjendjen e sotme, assesi nuk mund të përthekohen me mend, ngase "deri atëherë mirupafshim!" do të thotë "(mir)upafshim" në intervalin kohor deri në shfaqjen e emisionit, siç u cek më sipër, ndërsa në kontekst logjikisht duhej të kuptohej koncepti i dytë, d.m.th. takimi në emision në terminin (afatin) e caktuar, përndryshe s'ka sesi të shihet a të dëgjohet kur nuk shfaqet (emetohet) emisioni, qoftë në radio, qoftë në televizion!

Sido që të jetë, para se të japim mendimin tonë se si është më së miri të zgjidhet kjo çështje për ta kuptuar më mirë shkakun e një dukurie të tillë del e nevojshme të konsultojmë paksa skemën se si shprehet a mund të shprehet ky koncept në disa gjuhë të zhvilluara, nga të cilat sigurisht do të jetë e ndikuar edhe serbishtja, ashtu siç po ndikohet sot shqipja, përkatësisht disa nga gazetarët e caktuar që punojnë në radio-tv-stacionet përkatëse:

angl.	till then (...)	good bye, bye-bye!
gjerm.	bis dehin (...)	auf Wiedersehen!
fr.	jusqu` alors (...)	au revoir!
it.	fino allora (...)	arrivederci!

serb. do tada do vidjenja!
shq. deri atëherë(!) (...) ngjatjeta! mirëmbeçi!/ *mirupafshim??*

Dihet se çdo gjuhë ka natyrën e saj dhe se sinonimet përkatëse mund t'i specifikojë për koncepte të caktuara, por në bazë të fjalorëve që konsultuam, barasvlerësia e mësipërme në trajtën e caktuar për secilën nga gjuhët del e shënuar si e qëndrueshme, prandaj një fakt i tillë mund të ketë efektin e vet asociacionisht tek shqippërkthyesit e caktuar për shkak të zgjidhjeve të ngutshme që imponohen në rrethana të caktuara, siç është përkthimi simultant, natyra e shpejtë e përgatitjeve të lajmeve etj.

Sipas gjasës ligjëruesit e gjuhëve të huaja të zhvilluara me fjalën e tillë përshendetëse, si më sipër, shprehin nocion sigurisht më të gjerë sesa që shprehet me fjalë-pasthirmën e shqipes "mirupafshim!", e cila "përdoret për të përshëndetur dikë kur ndahemi prej tij për një kohë jo të gjatë", (Shih; FGJSSH, f. 1117.) vetëm kaq, prandaj mbase përshëndetjet e tilla në ato gjuhë edhe mund të kenë logjikë që mund të shprehen edhe bashkë me shprehjen përkatëse barasvlerëse që në shqipe u përkthye me "deri atëherë", apo jo?

Ç'është e vërteta, në shqipe me shprehjen "deri atëherë" kuptohet "caku kohor kur kryhet një veprim", por edhe "koha sa zgjat ai veprim etj." (Shih: FGJSSH f. 68 dhe 314.), gjë që konceptin e sipërcekur në gjuhën tonë me të drejtë e bën të kontestueshëm, ngase treguesit e tillë e përjashtojnë njëri tjetrin logjikisht.

2

Duke e pranuar si të drejtë mendimin e prof. Tafil Këlmendi, që "*për sa u përket urimeve, mallkimeve dhe përshëndetjeve, shqipja s'ka përse të kërkojë ndihmë nga gjuhë të tjera, bile jo vetëm nga serbokroatishtja, por as nga anglishtja, frëngjishtja etj.*" (Shih: *Çështje të normës letrare*, Prishtinë 1980, f. 146.), po shtoj se në shqipe të dyja konceptet e implikuara në shprehjen e mësipërme, e para që lidhet me kohën "*deri atëherë*" d.m.th. intervalin deri ne emetimin e emisionit dhe e dyta, që ka të bëjë pikërisht me kohën e caktuar, kur do të bëhet emetimi, janë të zgjidhshme a mund të zgjidhen fare lehtë:

a) Koncepti i parë që lidhet me kohën "deri atëherë", mund të shoqërohet me një fjalë tjetër urimi si p. sh. "*Deri atëherë, gjithë të mirat! (kalofshi bukur!, plotësim dëshirash! gëzofshit shëndet!, lavdi paçit, paqja qoftë me ju!* etj.) ose në daçim pak më zyrtarisht: deri atëherë *mirëmbeçi a tumirmbeçi!*, (ose: deri atëherë: *përhëndetje!, lamtumirë! "gëzuar!" "me fat!", "përzemërsi!", "shëndet"* etj.), por edhe "deri atëherë: "**ngjatjeta!**" (tungjatjeta a jungjatjeta) etj.

b) Koncepti i dytë, që lidhet me kohën (terminin) e takimit mund të shprehet "**atëherë mirupafshim!**" d.m.th. gjithsesi pa treguesin "deri", ose edhe më mirë vetëm: "**mirupafshim!**", "*mirupjekshim!*" a "**mirutakofshim!**" që nënkuptohet se shprehim dëshirën "me u pa (me u dëgjue, me u takue) për të mirë!" në atë kohë, për kur asociacionisht kërkon koha e tillë ose na është bërë me dije.

Është interesant se në stilin bisedor të ne, është zgjidhur çështja e përshëndetjes për të dyja konceptet e më sipërme: me një **tung!** ose **tungjat!**, që i referohet përshëndetjes së mirëfilltë tipike karakteristike të shqipes "**tungjatjeta!**", e cila, siç thuhet në FGJSSH 1954 është: "*përhëndetja e zakonshme e Shqiptarit*, kur piqet me miq e të njohur, në çdo orë të ditës e të natës", por që tashti në gjuhën e sotme, siç del nga FJSSH f. 2040, është shtrirë edhe në rastet "*kur duam ta bëjmë bisedën të thjeshtë e të ngrohtë ose kur duam të qesendisim*", por që në shembullin tonë përdoret edhe me rastin e ndarjes së përkohshme, por paksa me një ndryshim (shkurtim) forme, siç janë trajtat: *tung!*, *tungjat!*, por sidomos "**ngjatjeta!**".

S'do mend se trajta **tungjatjeta!** në variantet *tung!*, *tungjat!* *jungjatjeta* e **ngjatjeta!** Mund të përdoren në çdo situatë, por trajta e fundit "**ngjatjeta!**" më duket më e parapëlqyeshme, nga sishoqet e veta, sepse ndeshet e shënuar si barasvlerës i suksesshëm ndaj përshëndetjeve të gjuhëve të huaja si p.sh.: *angl. hall, hello; gjerm. Heil!, Guten Tag!; fr. salut!, hola!; it. salute!, salve!, ciao!, adio!* etj, por ajo me pak sforcim do të mund të përdoret edhe për konceptet e cekura të barasvlerësve të sipërcekur, krahas trajtës *mirupafshim!*, madje të përdoret më me pa druajtje se sinonimi lamtumirë! a "gëzuar!". Kështu pra mund të dalë: "*deri atëherë ngjatjeta!*" ose "*atëherë ngjatjeta!*" (mirupafshim) ose vetëm **ngjatjeta!** (**shikues, dëgjues të nderuar!**)

Me fjalë të tjera, mendoj se trajta "**ngjatjeta!**" duhet të sforcohet krahas trajtës *tungjatjeta!*, në mos më tepër, ngase si duket ka disa përparësi praktike

jo vetëm ndaj trajtave tung!, tungjat!, siç u tha më sipër, por edhe ndaj trajtës tungjatjeta! (jungjatjeta!).

Ja përse:

së pari, i ka në përbërje të dy elementet kryesore përbërëse të kompozitës (fjalisë përngjitëse "ngjatë" + "jeta") të desemantizuara a të shkruara në semantikë të re si pasthirmë a fjalë përshëndetse specifike me domethënie e simbolikë të thellë;

së dyti, si trajtë e tillë del e shënuar në FGJSSH, f. 1260 dhe se nga ajo del e zhvilluar folja **ngjatjetoj** e së këtejmi po mbi këtë bazë nënkuptohen edhe derivatet e caktuara prejfoljore (ngjatjetim, ngjatjetues, ngjatjetor ngjatjetësi ngjatjetesë, të ngjatjetuarit etj.);

së treti, është më e thjeshtë në shqiptim dhe se nuk humb fare as nga kuptimi fillestar as nga kuptimi aktual, përkundrazi me mënjanimin treguesve të përemrit nistor (njëjës e shumës): tu- (t`u) a ju- nga përbërja e saj më lehtë përgjithsohet;

së katërti, përshëndetja e tillë mbetet tipike shqiptare dhe si e tillë në situata të caktuara del me përparësi konkrete përgjithësuese edhe ndaj sinonimeve të tjera përshëndetëse si: ditën e mirë, natën e mirë, lamtumirë, tumirëmeç, mirupafshim, etj. me të cilat bashkëjeton dhe aspak nuk rrezikon përdorimin e tyre në stile të caktuara;

së pesti, me sforcimin e trajtës së tillë do të dalin të panevojshme trajtat si tung!, tungjat! jungjat(jeta), të cilat nuk janë pa gjurmë në ligjërimet tona, edhe pse nuk dalin të shënuara në FGJSSH dhe

së gjashti, **ngjatjeta!** (si përshëndetje) *mund të përdoret në çdo fillim takimi (paraqitjeje), gjatë bashkëbisedimit, ashtu si edhe në çdo rast largimi, ndarjeje.*

Sidoqoftë, nëse autori gjithsesi e ndjen të nevojshme të përdor shprehjen "*deri atëherë*" mund t'ia shtojë pra për konceptin në trajtim edhe fjalën përshëndetëse **ngjatjeta!** "*deri atëherë, ngjatjeta!*", por jo "*deri atëherë mirupafshim!*", sepse nuk kemi se si të shihemi as të dëgjohemi, pasi që mesazhdhënësi është b.f. në Londër, në Vashington, në Tiranë etj., ndërsa dëgjuesit a shikuesit, të cilëve u dedikohet mesazhi ndodhen anëmbanë botës, në vende të ndryshme, kështu që as fizikisht s`mund të kenë kurrfarë kontakti, për t`u parë a për t`u dëgjuar me njëritjetrin "*deri atëherë!*".

Po e shtoj edhe këtë, madje edhe në rastet kur është e lejueshme trajta **mirupafshim** nga konteksti ajo nëse duam ta kursejmë atë nga përdorimi i tepërt a ku ta di, për shkaqe stilistike, mund ta zëvendësojmë fare mirë me sinonimin "**ngjatjeta!**".

Si përfundim, vërtet, nëse aktivizohet trajta "**ngjatjeta**" për konceptet për të cilat u përmend këtu, jo vetëm se do të përjashtohen vetvetiu si të panevojshme trajtat si: tung, tungj e jungj!, jungjat e tungjat etj., por njëherazi do t'i hiqet trysnia ndaj fjalës "mirupafshim!" për t'u përdorur edhe për asi koncepti që lidhet me shprehjen "deri atëherë".

Me një sforcim të tillë fjala "**ngjatjeta**" (tungjatjeta) mund të bashkëshoqërohet me fjalë të tjera përshëndetëse, por edhe do të na ndihmonte që të flakim jashtë më lehtë e më me sukses trajtat si "merhaba!" "ejvallah!" e të tjera të kësaj natyre, por edhe ato të "modës" të gjuhëve evropiane, siç janë: baj-baj!, adio!, çao! etj.

Gjithsesi trajta "**ngjatjeta!**" (tungjatjeta) duhet të zërë vendin e merituar në fjalorët tanë normativë, jo vetëm si përshëndetje tipike shqiptare "kur të takohemi" në çdo kohë, por edhe "kur ndahemi me dikë" *në çdo kohë*, aq më tepër kjo fjalë përshëndetëse duhet të përdoret jo vetëm në stilin bisedor, por të ketë favorizim edhe në standard.

Pra, nga sa u tha më lartë, del se te shprehja përmbyllëse "deri atëherë mirupafshim!" (mirudëgjofshim!) për konceptin që u trajtua këtu, fundorja "mirupafshim!" s' ka nevojë të marrë përgjithësim a zgjerim kuptimi, si të thuash "me dhunë", kur në vend të saj kemi mjaft fjalë të tjera përshëndetëse më të pranueshme e ndër to, siç u përpoqëm të paraqisim më përpara, mund të përdoret farë natyrshëm edhe fjala "**ngjatjeta!**".

(Prishtinë, 30.X.1995)

15) TRAJTA "NISJATIVË" SI KONTAMINIM DËSH TAK I SINONIMEVE NISMË / INICIATIVË

Në një artikull të botuar në gazetën "Shkëndija" nr. 6/85 f.18 me titull "Rreth kristalizimit të kuptimit të fjalës nismë/nisma", tërhiqej vërejtja që fjala **nismë** duhet të përdoret edhe te ne ashtu, siç del e favorizuar në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980)¹, si zëvendësim a sinonim i ndërkombëtarizmes **iniciativë**, sidomos për konceptin: *"punë që e merr përsipër i pari dhe me vullnetin e me dëshirën e vet një punonjës a një kolektiv për të bërë ose për të organizuar diçka, zakonisht të re e që kërkon përpjekje.* (Aty f.1267.) Gjithashtu tërhiqej vërejtja se fjala **nismë** duke qenë e angazhuar si zëvendësim i konceptit të fjalës iniciativë, siç u cek më sipër, ajo normalisht në mënyrë graduale e zbeh barasvlerësinë me sinonimet e saja, siç janë fjalët: *fillim, nisje, zanafillë, pikënisje, fillesë, fill...* etj. dhe së këtejmi përdorimi i fjalës **nismë** në vend të fjalës **fillim** ose të ndonjë sinonimi tjetër konsiderohet përdorim jashtë norme a në kundërshtim me prirjen e tillë, siç janë b.f. shembujt:

"në nismë të vitit akademik ...", "në nismë të spektaklit...", "në nismë të garave..." etj.

Madje, siç thuhet aty, *"për t'iu shmangur lëshimeve të tilla eventuale lidhur me këtë do të ishte e këshillueshme që sa herë duam të përdorim fjalën nismë le të na shkojë mendja te fjalat iniciativë e nëse ajo përputhet relativisht, atëherë me siguri konteksti do të dalë i qëlluar, për ndryshe duhet kërkuar zgjidhje tjetër"*, d.m.th., duhen përdorur barasvlerës të tjerë. Shtrohet pyetja sa është respektuar këshilla a prirja e tillë për të lehtësuar sadopak përvetësimin e normës sonë letrare në këtë pikë? Përgjigjja përgjithësisht del pozitive, me ndonjë rezervë. E themi me ndonjë rezervë, sepse, ç'është e vërteta, edhe tash, pas kaq vitesh, mund të konstatojmë jo pa keqardhje, se

¹ Në tekstin e mëtejme në shumicën e rasteve ky Fjalor shënohet me shkurtesën: FGJSSH.

ende lidhur me këtë ka paqartësi tek disa intelektualë të ne. Ende ndër shkrime të disa pendave tona që nuk janë pa emër të respektuar, të cilët mund të jenë veprimtarë të fushave të ndryshme të kulturës si: gazetarë, shkrimtarë, publicistë, shkencëtarë, akademikë etj., ndeshim rastet si b. f.:

...në nismë të shkrimit..., në nismë (të veprës) ... ("Bujku" 30.I.95 f.10); "në nismë të programit" ("RTV 10.X.95); "shëndeti iu rrezikohet që në nismë" ("Bujku" 10.IV.1995 f.1); "foli për nismën e këngës" ("Zëri" 27.V,95 f.40); "në nismë meçi është i humbur" ... "që nga nisma e invadimit italian ..." ("Zëri" 10. VI. 1995, f. 10 dhe 28), "frëngjishtja në nismë (si shtyllë.. sipas gjedhës së latinishtes)" (Etni... f. 31); "Te kacafytjet e mëdha ... gjatë 1000 vjetëve ... është nisma e këngëve kreshnike" ("Bujku", 9. IX. 1995 f. 7) etj. etj.

Siç u tha pak më përpara të gjitha këto raste sigurisht më mirë do të qëndronin dhe do të përputheshin me normën, poqese fjala **nismë** të zëvendësohej me ndonjë barasvlerës tjetër, siç është fjala vjen: **fillim**, **zanafillë**, **pikënisje** a ndonjë tjetër.

Ç'është e vërteta, në FGJSSH trajta *nismë* është e shënuar përkatësisht nën 2.dhe 3., edhe me kuptimin e sinonimeve: *zanafillë*, *fillim* dhe *pikënisje*, por aty del si trajtë e pafavorizuar. S`do mend, siç u tha më sipër, që gjithsesi kësaj fjale i jepet përparësi për të shprehur konceptin që ndërlidhet vetëm me sinoniminë e fjalës së huaj iniciativë. Po e përsëris se vetëm fjala **nismë** mirëfilli, sipas FGJSSH-së, e zëvendëson ose mund të ndër-këmbehet me ndër-kombëtarizmen a fjalën e huaj **iniciativë**.

Kjo dukuri qe vërejtur më herët nga A. Xhuvani, i cili thotë se fjala "nismë" që "në kohë të vjetra asht përdorë, po me atë kuptim të fjalës iniciativë"².

Por kjo që u tha deri këtu, edhe pse nuk është e parëndësishme dhe me interes të dihet e të njihet botërisht, nuk është qëllimi i vetëm dhe kryesor që dëshirojmë të tërheqim vërejtjen në këtë artikull. Këtu objekt trajtimi del diçka edhe më specifike. Pikërisht duam ta vëmë në analizë trajtën **nisjativë**, trajtë kjo e cila ndërtimisht e semantikisht del e lidhur me dy fjalët e sipërcekura sinonimike: **nismë** dhe **iniciativë**. Trajta **nisjativë**, si duket del si një shfaqje kontaminimi, si një mishmash a përzierje spontane e të dyja trajtë-fjalëve sinonime të sipërcekura: **nismë** e **iniciativë**, fenomen ky që meriton analizë paksa më të thelluar.

² Shih: A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980 f. 140

Së ktejmi, para se të shohim a ta zbërthejmë më në hollësi këtë kontaminim, siç po quhet kushtëzimisht këtu, po japim pasqyrën se si del e shënuar në disa gjuhë ndërkombëtarizma: **iniciativë**, e cila, siç u tha, në shqipe ka si barasvlerës të mirëfilltë sinonimik vetëm trajtën **nismë**. Ndërkombëtarizma e tillë rrjedh nga latinishtja mesjetare **iniciativa** (lexo: iniciativa) (nga *initum*) dhe të vihet re sesi është reflektuar si emër dhe si folje në këto 5-6 gjuhë (edhe në shqipe):

<i>angl.</i>	<i>(to) initate</i>	<i>iniciativa;</i>
<i>fr</i>	<i>initier</i>	<i>initiation;</i>
<i>it.</i>	<i>iniziare</i>	<i>iniziativa;</i>
<i>srb.</i>	<i>inicirati</i>	<i>inicijativa</i>
<i>sp.</i>	<i>iniciar</i>	<i>iniciativa</i>

dhe *shqip*: *inicoj (me inicue) iniciativë (nismë)*

Ç'është e vërteta, siç po shihet trajta **nisjativë**, nuk përputhet me asnjërën nga trajtat e gjuhëve të huaja dhe as me atë të gjuhës shqipe, gjë që mund të shihet qartë. Këtu bie në sy gjymtyra e dytë përbërese (nëse mund të quhet kështu): *nis -jativë* ose *nis -iativë*. Si duket nga *nis(më)* (me *nisë*) a *nis(ë)* + *iniciativë* rezultoi: *nis + jativë* ose **nis + iativë = nisjativë** ose **nisiativë**. Kjo është aryeja që këtu u quajt kjo trajtë *kontaminim dështak*, patëm të drejtë apo jo le të vlerësohet.

Sidoqoftë, me rastin e sajimit të trajtës **nisjativë** është bërë zhdukja e I-së nistore e fjalës *iniciativë* (i)*niciativë* (fenomen ky jo i panjohur në gjuhën shqipe) dhe njëherazi bashkëtingëllorja -c- është shndërruar në -s-: *ni(c/s)(j)iativë : nisjativë*, mbase sipas fjalë-foljes **nis (me nisë)** të shqipes ose sipas shqiptimit në frëngjishte.

Dihet se kontaminimi është një proces psiko-linguistik që mund të shfaqet në rrethana të caktuara dhe në rrethe të caktuara, por nuk di arsyen pse pikërisht ky fenomen i përfutur spontanisht të shfaqet ose të ketë prani pothuajse vetëdijësisht në mesin e gazetarëve, publicistëve dhe të intelektualëve përgjithësisht e tashti edhe te ne, me njëfarë gjallërie përdorimi. Kjo na duket pak e çuditshme apo për mendimin tim shpreh diçka jo të këndshme. Them kështu, sepse kjo trajtë kontaminuese **nisjativë**, e cila ndoshta mund të jetë përfutur, që në etapat e para të gazetarisë shqiptare të Periudhës së Pavarësisë e më përpara, andaj është krejt e panevioletshme të rishfaqet në kohën tone. Për çudi pra, veç burimeve të tjera tani e ndeshim jo rrallë në mjetet tona të informacionit edhe sot, si p. sh.

te revista "Zëri", më 29. III. 1985, f. 39 e 41; 27. V. 1995 f.6; 17. VI. 1995 f. 31; të gazeta "Bujku", më 5. III. 1995 f. 7; 26. VI. 1995 f. 11 etj.

Kam bindjen se edhe autorët edhe redaktorët pas kësaj vërejtjeje, si të themi, paralajmëruese shoqërore, nuk do të lejojnë më të përdoret ashtu spontanisht, jondërgjegjshëm, trajta "nisjativë" a "nisiativë" në vend të trajtave të normëzuara: **nismë a iniciativë**, ngase kjo trajtë sot duket si një kontaminim fare i panevojshëm. Andaj e quajta *kontaminim deshtak* sepse gjuhësisht nuk kemi nevojë për një sajësë të tillë dhe njëherësh duhet ditur se edhe nëse plasohet assesi nuk mund t'i qëndrojë konkurrencës kundrejt trajtës së favorizuar të brumit vendës **nismë** si dhe ndërkombëtarizmës së njohur **iniciativë**, trajta këto që mund të përdoren si sinonime ose edhe si fjalë me kuptime paksa të ndryshme semantike, varësisht nga stili a konteksti që shprehet pa lënë pretekst për ndonjëfarë kontaminimi, sepse nuk mbetet asnjë hapësirë a nuacë semantike e pambuluar semantikisht.

Përfundim

Në fund po ricek nismën e cytur që në artikullin e sipërcituar që sikur favorizohet emri **nismë** kundrejt sinonimit **iniciativë**, po ashtu mund të jetë e lejueshme të nxitet e të përkrahet edhe dalja e foljes mbi këtë bazë, kështu që krahas foljes inicoj (krahaso: it. iniziare, fr. initier, angl. (to)iniciate, srbkr. inicirati ose pokrenuti) të përftohet dhe të përdoret në shqipe trajta foljore: nism a nismoj. Pra krahas sinonimeve togfjalësha si p.sh. "*filloj (nis, nxis, cyt, hap, shtyt etj.) nismën (iniciativën) për një punë*", do të mund të përdorej b.f. trajta nism a nismoj si p. sh.: "**nismoj (nism) një punë, një veprim ...**" etj. Si mbështetje për këtë, si hallkë ndërlidhjeje e vargut të strukturës fjalëformuese të modelit, shërben emri i vepruesit nismës, i cili, sipas FGJSSH-së del më i favorizuar nga trajtat: nismëtar dhe iniciator. (Shih aty f. 1267.)

Ndërkaq, përdorimi me kriter i fjalës **nismë** kryekëput për konceptin që lidhet me nocionin e fjalës **iniciativë** gjithsesi nuk do t'i linte shteg hapur shfaqjes së kontaminimit të panevojshëm **nisjativë** që u diskutua këtu. Dhe në këtë mënyrë do të shmangëte ngatërresën kuptimore me sinonimet nga prejardhja: *nisë, nisje, pikënisje* si dhe të tjera si: *fillim, zanafillë* etj.

Prishtinë, më 8. VII. 1995

16) RRETH FORMËZIMIT TË FJALË-TERMIT E PAME / E PAMJA

(Trajtesë e botuar në gazetën "Fjala jonë", shkurt 1995)

Në traditën pozitive që brez pas brezi përcillet si thesar me vlerë në kulturën shpirtërore të popullit tonë bën pjesë edhe institucioni i vizitës që i bëhet familjes së të ndjerit pas varrosjes së tij. Në të vërtetë, pasi të kryhet ceremonia e varrimit familja e të ndjerit, në mënyrë të organizuar familja e tij: **hap "të pame"**: bën pritje-përcjelljen e vizituesve, të cilët sipas zakonisht vijne për kryeshëndoshë. Lidhur me nocionin e sapovënë në pah këtu, për çudi, në burimet tona normative të gjuhës së sotme letrare, nuk e kemi të regjistruar emërtimin përkatës që ne e nënvizuam dhe e vumë nën thonjëza

Ç'është e drejta në FGJSSH lidhur me dukurinë e zënë në gojë është shënuar termi periferik "*kryeshëndoshë*", me ilustrimin: "vajti (shkoi) për kryeshëndoshë", me sqarimin; "shkoi për të ngushëlluar dikë" (Aty f.897.), i cili as për së afërmi si term nuk mund të shprehë procesin e pritje-përcjelljes rreth vizitës për ngushëllim, nocion ky i njohur në gjuhën e popullit, te ne, të cilin më së miri e shpreh fjala **e pame e pamja të pamet** (Shih: "*Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore*", Prishtinë 1983, f. 359, edhe tek gazeta "Bujku" dt. 31.XI.1991 f. 2), e cila, siç u tha pak përpara tërthorazi nuk është regjistruar në asnjërin nga fjalorët përkatës normativë të gjuhës sonë.

Rreth dukurisë së pritje-përcjelljes së vizituesve për kryeshëndoshë ia vlen të bëhet analizë e thukët etnografike, gjë që duhet ta bëjnë kuadrot kompetentë, ndërsa unë do të mjaftohem vetëm me të nxjerrët në shesh për diskutim dy çështje terminologjike lidhur me këtë dukuri, që po shtroj në formë pyetjesh:

e para, sa i kalon caqet e një adeti a të një zakoni të rëndomtë një dukuri e tillë për t'u cilësuar si institucion? dhe

e dyta, sa i përgjigjet nocionit në fjalë formëzimi i fjalës "**e pame**" si term etnografik?

Përgjigjen në këto dy çështje do të përpiqem ta jap në vazhdim të kësaj trajtесе.

1. "E pamja" si institucion

Po të vështrohet më në hollësi *dukuria e "të pames"* shihet qartë se nuk kemi të bëjmë me një adet a një zakon të rëndomtë, por kemi të bëjmë me ***një institucion*** jo të parëndësishëm shoqëror a me një "mënyrë sjelljeje që është rregulluar sipas ligjeve a zakoneve të vendosura brez pas brezi". (FGJSSH f. 724.)

Për të dëshmuar këtë konstatim më poshtë do të përmend disa të dhëna, të cilat pak a shumë japin skicë-konstruktin e nocionit në fjalë, siç janë:

1) Organizimi i pritje-përcjelljes nga ana e familjes së të ndjerit, veprim ky që vetvetiu kuptohet si një detyrë shoqërore familjare e domosdoshme a si një akt moral i detyrimshëm. Lidhur me këtë pothuajse spontanisht i dalin në ndihmë farefisi i ngushtë, fqinjët, miqësia, shokë të të ndjerit, shokë të punës etj.

2) Caktimi i lokalit të përshtatshëm për sendërtimin e një akti të tillë, zakonisht caktohet shtëpia e të ndjerit ose e ndonjë të afërmi të tij, gjithsesi sa më afër vendbanimit të të ndjerit, përkatësisht të mbajtësit të **së pames**.

3) Vendi i **të pames** (shtëpia e të ndjerit), shenjohe. Në vend të caktuar shënohet shigjeta me sqarimin "**e pamja**". Zakonisht para derës së vendpëritjes në kohën tonë vendoset një peshqir në karrige. Në derën e shtëpisë ngjitet shpallja e kumtit. Varësisht nga natyra dhe përmasa e rastit vendoset flamuri në gjysmë shtize. Gjithnjë dikush nga pritësit qëndron si vrojtues dhe kujdeset për të orientuar vizituesit si dhe për të sinjalizuar pritësit për të dalë në pritje (selamllëk).

4) Përveç njerëzve të shtëpisë të afërt nga gjaku (si nga lidhja atnore dhe nga ajo amnore) e lyp rendi që në pritje përballë vizituesve (zakonisht caktohet këndi i veçantë i lokalit) të jetë i pranishëm ndonjë plak a njeri me autoritet nga familja e gjerë, nga fqinjët, lagja (katundi), shok i ngushtë i familjes (i të ndjerit), shenjëzim ky, të cilit edhe do t'i drejtohet kryeshëndosha. Gjithashtu lidhur me këtë caktohen persona të tjerë të përshtatshëm për të kryer të gjitha detyrat a shërbimet e caktuara. Organizimi i tillë bëhet si te burrat ashtu edhe te gratë.

5) Vizituesit pak para se të arrijnë në vendtakim, d.m.th. në cakun për kryeshënoshë rendohen sipas moshës dhe përsëndeten me grupin e pritësve të cilët sipas rregullit i presin në këmbë me dorë në zemër. Në vendtakim pas përsëndetjeve të para ata ndërohen me nga një cigare (tash po hiqet nga përdorimi), lëng, çaj a kafe, sipas mundësisë së pritësit e në anën tjetër vizituesit, para se të largohen (ose në tabllën e gotës lënë nga një pako cigare ose shumë simbolike të hollash, varësisht nga mundësitë që kanë për të ndihmuar kështu **të pamen**, përkatësisht familjen e të ndjerit. Tash edhe kjo

dukuri nuk po praktikohet ose po refuzohet nga vetë familja e të ndjerit. Gjithashtu edhe me rastin e largimit vizituesit nderohen nga grupi i pritësve të cilët gjithnjë qëndrojnë në anën e djathtë të tyre në selamllëk.

6) "**E pamja**" ka kohën e caktuar, minimumi ishte 7-10 ditë (pa orar të caktuar ditor, por tash vende-vende minimumi zgjat 3-5 ditë, por mund të zgjasë një muaj e në raste të caktuara 40 ditë e më tepër, varësisht nga rasti e mundësitë e pritësve.

7) Vende-vende kur **e pamja** është në vllug ushqimin për pritësit e vizituesit e largët e të rastit e përgatisin fqinjët me radhe, varësisht nga mundësitë që kanë. Gjithsesi familjes së të ndjerit i ofrohet ndihmë nga fqinjët, miqtë e shokët, qoftë materialisht, qoftë me forca pune.

8) Vlen të përmendet edhe kjo e dhënë më interes kombëtar se mënyra e **të pames** nuk ndryshon sa i përket konfesionit, madje edhe formulat e kryeshëndoshës janë të përbashkëta, pos të ndonjë rasti periferik (më ngjyrë fetare) të pa peshë.

9) Po e përmend edhe këtë se kur e ndjera është femër, e pamja bëhet edhe në shtëpinë e burrit edhe në shtëpinë e vajzërisë, madje të dyja palët i shkëmbejnë vizitat, por sidomos në kohën tonë për personat e shpërngulur me detyrë, si b.f. në qytete, ditët e para të të pames zakonisht organizohen në vendlindje, ndërsa pjesa tjetër të shpija e tij në qytet.

10) Aktualisht, sidomos për persona të caktuar që kanë jetuar e vepruar në diaporë dhe se një pjesë të familjes e kanë ende atje, pasi po kryhet e pamja në "vatan", po hapet e pame e re edhe atje në diasporë, madje me sa po vërejmë, e pamja e tillë po kryhet me pritje përcjellje për lakmi e respekt, me u mbajtë mend, si në aspektin njerëzor, ashtu edhe në atë kombëtar.

11) Sa u tha tregon që kjo dukuri (si institucion) është futur aq thellë në psikologjinë e individit të shoqërisë tek ne që ilustruhet me faktin se kur thuhet b.f. "Po shkoj në të pame" vetvetiu kuptohet se vizituesi i bën vizitë familjes së të ndjerit, në radhë të parë për të larë borxhin moral ndaj institucionit, **ndaj të pames**, d.m.th. ndaj rrethit shoqëror, ndaj ligjit të vendit që e ndjen ai në vete si detyrim e pastaj shkon për të nderuar kujtimin e të ndjerit dhe njëhezi poashtu për të nderuar të gjallët e farefisin që la ai pas. Pra motivi i parë i një shumice njerëzish ishte dhe është ai i karakterit institucional, apo jo?

Këto ishin vetëm disa të dhëna që ravijëzojnë, sadokudo, siç thashë, skicë-konstruktin e nocionit në shqyrtim, mirëpo kurorezimi i të gjitha vlerave, është lënda që konstruktin i jep muskuj, shëndet, jetë, bukuri e shpirt, është pikërisht komunikimi masiv, fjalët e mira me plot kulturë, edukatë,

mësim e urti që fliten e këmbehen në mes të vizituesve dhe pritësve, të cilat gjithsesi nuk mbyllen në suazat e ngushëllimit, por kalojnë në tema serioze e porosi. Në këto raste e kontakte vëllai e njëh më mirë vëllanë, miku mikun, fqinji fqinjin, me një fjalë njeriu më mirë e njëh njeriun e vet në kuadër të shoqërisë dhe kombit që i përket. Po përmend rastin e vizitave për kryeshëndoshë që u bëheshin familjeve të dëshmorëve e martirëve të kombit, kohë më parë anë e mbanë Kosovës e më gjerë, gjë që pati jehonë e reagim jo vetëm tek ne, por më gjerë edhe në botën e jashtme.

S'do mend se emërtimi i një nocioni të tillë del mëse i domosdoshëm në gjuhën e sotme letrare (standarde).

2. Formëzimi i fjalës "*e pame*" si term etnografik

Fjala **e pame** (e pamja, të pame/t) edhe pse nuk është përfshirë në FGJSSH, ajo qysh herët qëndron e pranishme në gjuhën e popullit. E ndeshim në Fjalorin e K. Kristoforidhit si dhe në atë të "Bashkimit", madje me polisemi heterogjene, mirëpo edhe me nuancën kuptimore që mund të formulohet kështu: **vizitoj dikë për...**", koncept ky i cili u ruajt dhe i kristalizua në gojën e popullit (së paku në Kosovë në pjesën dërrmuese) vetëm për nocionin që po diskutohet këtu. Kuptimet e tjera që kishte kjo fjalë, sipas FGJSSH, kryesisht kaluan tek emri prejppjesor sintetik i paparanyjzuar: **pamje** e te ndonjë sinonim tjetër. Kështu pra fatmirësisht fjala **e pame** si rezervë e brendshme, e ruajtur, e përpunuar dhe e filtruar në gojën e popullit u gatua pikërisht e fuqizuar vetëm për nocionin *pritje - përcjellje për kryeshëndoshë në trajtën analitike të paranyjzuar*.

Mbase edhe për arsye të mos përfshirjes së fjalës **e pame** në FGJSSH dhe në burime të tjera e ndoshta edhe për shkak të mosnjohjes a të mospërfilljes së kuptimit leksikor të fjalës **e pame**, që është gjithsesi më e përhapura, nga individë të caktuar te ne, në gjuhën e shkrimit ndeshen edhe trajta të tjera si p. sh.: **të pamurit(!)** (Shih: "e hapëm të pamurit dhe po na vijnë njerëz për ngushëllim", Zëri. dt. 9.XI. 1991 f. 15), **të pamët (!)** (Shih: "para shtëpisë ku mbahej të pamët", gazeta "Bujku", 17. VIII.1991), gjithashtu edhe mund të dëgjohen edhe trajtat: **pamje (!)** ("U bë pamje e madhe") Ndërkaq në të folme dëgjohet edhe trajta **E pane**, e cila vjen e trashëguar nga e folmja kosovare sinonim popullor, por në krahasim me trajtën **e pame**, del më pak e favorizuar. Dëgjohet edhe trajta **të parët** (toskëzim që pandehet të jetë trajtë e letrarishtes, por gjithsesi trajta **e pame** e **pamja** del me konkurrencë të fituar. I quajta "trajta" se të gjitha këto forma

fjalësh që konkurrojnë për të njëjtin koncept lidhen me temën e njëjtë prodhuese, pjesoren e foljes së parregullt shoh (parë, geg.(pa **me pa**, (**me pamë**), por nga pikëpamja drejt-fjalëformuese e formëzuese gjithsesi parapëlqehet trajta **e pame** (e parotacizuar), jo vetëm pse ka përhapje më të gjerë, por edhe për arsye se të gjitha trajtat e tjera po të parapëlqeheshin do të ndeshnin në homonimi nga zbërthimi i polisemisë, sepse ato trajta dalin të zëna për koncepte të tjera. P.sh. trajtat: të pamët (të pamit) të pamurit (të pamunit) dhe tosk. të parët (të parit), kryesisht përdoren për konceptin e shqisës së të parit; fjala **pamje** (është e favorizuar në FGJSSH për 7 kuptime), përdoret edhe për konceptet që kanë të bëjnë me dukjen, pamjen e jashtme, kurse fjala **të parët**, përdoret për konceptin etnografik "vajtja e nuses për herë të parë te prindërit e vet pas martesës" (FGJSSH f. 1369). Kjo trajtë (e rotacizuar) është në homonimi edhe me nocionin e "të parëve" (gjyshërve, parisë etj.), prandaj pajtohem sipas popullores *që për ditët kur vajza vjen në gjini* të përdoret trajta **të panët**, ndërsa *për ditët, tri, shtatë a më shumë kur priten ngushëllime në familjen e të ndjerit* të përdoret termi **e pame e pamja të pamet**. (Shih: A. Zymberi, Fjalorthi ... f. 195.) Po edhe M. Elezit në Fjalorin e tij për fjalën **e pame e pamja etnogr.**, jep këtë përkufizim:

Ditët e caktuara, tri, shtatë ose më shumë për të pritur ngushëllime për rast vdekjeje, bashkë me ritet përkatëse; ngushëllim në familjen e të ndjerit; tëpame, kryeshëndoshë, kryeshëndoshje, përdhimbje. (Aty f. 1051,.1467.)

Gjithsesi standardologët tanë duhet ta kenë të qartë se fjala **e pame, e pamja**, si trajtë e vetme e lirë mbetet e angazhuar për të shprehur vetëm nocionin në shqyrtim, andaj lypset favorizuar kjo fjalë për këtë nocion, për këtë destinim.

Së këndejmi, lidhur me këtë vlen të sqarohen edhe dy çështje:

e para, sa i shtrohet dukurisë së rotacizmit trajta e pame dhe

e dyta, sa ndikon prirja e pasivizimit të emrave të nyjshëm (a asnjans) në këtë trajtë?

Sidoqoftë, edhe pse as nga njëra as nga tjetra dukuri e sapocekur nuk pëson trajta **e pame**, megjithatë ka nevojë të thuhet ose të njihen edhe këto dy arsye:

Së pari, fjala **e pame** nuk i shtrohet rotacizmit, ngase si fjalë ka fituar autonomi leksikore në këtë trajtë dhe se po nga kjo arsye si dhe për shkak të dukurisë së homonimisë, siç u cek më sipër, edhe në FGJSSH, emri i veprimit si dhe emri i vepruesit nga folja e parregullt shoh (pashë, parë geg. (me) pa,

pamë) si temë prodhuese nuk e ka pjesoren e gjuhës së sotme letrare **parë-**, por pikërisht trajtën e zgjeruar të pjesores së gegërishtes **pamë- (me pamë)**. Krahaso: pamje, pamës (largpamës), prandaj trajtat e toskëzuara *të parët, parje*, (hibridja) *të pamurit* për konceptin në shqyrtim, jo vetëm se dalin të panevojshme, po edhe mund të quhen të qortueshme, të gabuara.

Së dyti, fjala e nyjshme **e pame** gjithashtu nuk pëson as nga prirja e pasivizimit të emrave të nyjshëm (a asnjës), sepse kjo si fjalë e nyjshme e gjinisë femërore gramatikore që me kohë ka fituar fizionomi të qartë leksikore (semantike) dhe njëherësh për arsye se trashëgimisht në mënyrë autentike mbulon konceptin që shpreh nocioni i caktuar. Madje, në të vërtetë, kjo fjalë, **e pame e pamja** mbulon kuptimin e asaj dukurie, e cila është gjalluese në viset edhe ku është krijuar, pikërisht aty ku është gatuar e formëzuar dhe ku ka përdorim gjallues edhe sot si institucion, apo jo?

Përfundim

Nga sa u tha më sipër del se trajta **e pame** për konceptin në shqyrtim ka përparësi të padiskutueshme ndaj trajtave të tjera si dhe ndaj shprehjeve perifrastike dhe se këtë përparësi lypset favorizuar e respektuar institucionalisht edhe gjuhësisht. Madje duhet pranuar e kuptuar këtë fjalë-term të gatuar si një dhuratë që gjuha e popullit nga rezerva e vet, ia jep për shërbim të përhershëm gjuhës së shkrimit. Gjithsesi emri **e pame** për nocionin që shpreh edhe si term profesional duhet të ketë vendin e merituar edhe në fushën e etnografisë.

Ma merr mendja se një term i tillë bashkë me nocionin e institucionit që shpreh që është kurorë mirësie për kujtimin për të ndjerin, i cili shndërrohet në dashuri shoqërore kombëtare, sidomos për shqiptarët, të cilët në të pame në të kaluarën kanë pasur mundësi me e shprehë identitetin e vet kombëtar, ngase pushtetet mjerisht ishin të huaja edhe në këtë mënyrë ruajtën atributet më të bukura njerëzore e kombëtare. Shikuar nga kjo pikëpamje ka bazë reale që kjo fjalë-term të inkuadrohet jo vetëm në fjalorin normëzues të shqipes, por edhe në fjalorët enciklopedikë të kulturës së përgjithshme shpirtërore të popujve, jo si një ekzotizëm i rastit, por si një fakt i gjallë i pamohueshëm a si një institucion unik *sui generis*, i krijuar në rrethana të caktuara shoqërore-historike specifike të shqiptarët, kur vërtet kryente një institucion real shoqëror e kombëtar. Por për t'u arritur kjo nevojitet vetëm prezentimi me kompetencë i shkencëtarëve, para auditorëve të kulturës botërore (UNESKO), ku ka vend të merituar apo ku nuk duhet të jetë pa hise as populli ynë, jo

vetëm me këngë labe, me lojë kapuçash, me këngë kreshnike, por edhe me besë e burri (kanun vendi), por edhe me institucione të tjera, siç është edhe **e pamja**, kurorë lavdie në kohë-hapësirën përkatëse, për të ndjerin, për familjen dhe për shoqërinë e kombin.

Po përsëris vlera e deritashme dhe e sotme e **të pames** si institucion *sui generis etnik shqiptar* kërkon angazhimimin e *pendës dhe të mendjes së shkencëtarëve tanë*.

17) RRETH PËRDORIMIT TË FJALËS ZOT NË GJUHËN SHQIPE

Hyrje

Me ndryshimin e sistemit shoqëror-politik që ndodhi në dhjetëvjetëshat e fundit në shoqërinë shqiptare, ndër të tjera, u riaktualizua në njëfarë dorë, për pika të veçanta, edhe çështja e përdorimit të fjalës **zot**, qoftë nga pikëpamja e përdorimit të saj si fjalë hyjnore, qoftë si fjalë e përgjithshme: si emërtim i njeriut sipas rangimit shoqëror ose si fjalë nderimi a përuljeje. Për të hequr çdo dilemë, të cilat ekzistonin edhe më përpara si çështje të hapura, në drejtim të qartësisimit dhe trajtimit me të plotë të temës në fjalë, e pamë të nevojshme të përfshijmë në analizë në mënyrë të veçantë këto tri çështje që i formuluar, kështu, në formë pyetjesh:

e para, si qëndron përhapja vertikale dhe horizontale e përdorimit të fjalës **zot** në gjuhën tonë përgjithësisht?

e dyta, si qëndron raporti i kësaj lekseme si fjalë hyjnore, kundrejt barasvlerësve sinonimikë në përdorim e sipër në gjuhën tone? dhe

e treta, si qëndron raporti aktual semantik i fjalës **zot**, në përdorim të përgjithshëm, ndaj trajtave derivate: *zoti* (njëjësi i shquar) + emri përkatës dhe *zotëri* e *zotni*?

1) Përhapja vertikale dhe horizontale e fjalës **Zot**

Fjala **zot**, me nocionin e tij themelor që nënkupton një "qenie të ndërgjegjshme njerëzore a sinjerëzore, të aftë, të adhuruar, prepotente a paksa më të fuqishme se qeniet e tjera ", me sa dihet, bënte pjesë në fondin aktiv autokton të shqipes që në zanafillë. Studiuesit e shpiejnë me origjinë aq të vjetër saqë përpiqen ta shpjegojnë me reflekse të fjalëve të gjuhës indoevropiane, duke i rikonstruktuar trajtat si *g'iotō a < *guia-tas, përkatësisht si: ind. e vj. a'yayati, pers. e vj. yazatan, yazdan, ir. iazatanan, gr. a'yiamaj, a'yus, por edhe me trajtat helene zeus, lat. deus (jovis) etj. deri të koincidenat si rastësi edhe me trajtën: Zabaot (Savaot, Jahve) të hebraishtes etj. Si mbështetje për krahasime të tilla shërbejnë pikërisht reflekset e mundshme ndërkëmbyese të nistoreve: Z-, D- (Dh, T(H)), J- (GJ-) që janë prezente te fjalët përkatëse të gjuhëve të caktuara, pra edhe përtej familjes indoevropiane. Lidhur me shpjegimin e trajtës "**zeus**" me anë të shqipes **zot** nuk bënë përpjekje vetëm rilindësit tanë mendjendritur, por edhe të tjerë. Të kujtojmë këtë rast p.sh. G.F. Wiliams-in, i cili konstatonte se "në gjuhën shqipe" është e qartë, ndër të tjera "domethënia Zeus, Zaa, Zee Zoot" që del

sipas tij "shumë e drejtë"^{3[1]} Një sugjerim të tillë e ndeshim edhe në një shkrim të Sh. Gjeçovit.

Sido që të jetë, kjo fjalë aktive e shqipes **zot** që ndeshet që në dokumentet e para të shkrimit shqip me nënfushë të përcaktuar semantike, sigurisht dëshmon se do të ketë qenë e formëzuar dhe e përdorur si e tillë shumë e shumë kohë më përpara. Supozohet se kjo fjalë që në krye të herës do të ketë pasur edhe elemente të kuptimit abstrakt totemik a mistik, por që ndërkohë gjithnjë e më shumë do t'i atribuohet edhe personit konkret, d.m.th. emërtimit të njeriut, apo forcës së tij sunduese e vepruese, po njëherazi edhe forcës së përfytyruar hyjnore të imagjinuar. Kështu, që në periudhën e shkrimit shqip, kjo fjalë del si emërtim i njeriut të ranguar, paksa të dalluar nga të tjerët për ndonjë arsye a tjetër, por që afrohet edhe me koncepte hyjnore të mbinatyrshme. Kështu në Fjalorin e F. Bardhit (1635)^{4[2]} fjala **zot** qëndron si barasvlerës i fjalës **dominus** të latinishtes, d.m.th. me kuptimin: (njeri) sundues, sundimtar; pronar, posedues i një pasurie a të një të drejte dalluese në raport ndaj të tjerëve, por del edhe me konotacion të fjalës hyjnore, përshtatur sipas kushteve të perceptimit të besimit fetar të asaj kohe.

Sigurisht ndërkohë, në vazhdë e sipër, fjala **zot** gradualisht, gjithnjë e më tepër, do të marrë konotacion të ri semantik, sidomos pas përqafimit të fesë kristiane të një pjese të madhe ose edhe masive të shoqërisë shqipfolëse. Ndërkaq, që tashti, me fjalën **zot** gjithnjë e më qartë fillon të formëzohet koncepti rreth emërtimit të një qenieje të vetme hyjnore, në përputhje me predikimin e ri që bëhej sipas kodit të fesë monoteiste, por pa u shkëputur nga konceptet e tjera që, tashmë, ishin të ravijëzuara thellë në strukturën e ligjërimit shqip. Ndërkaq në literaturën kishtare gjithnjë e më tepër e ndeshim si barasvlerës të termit **Dio / Zot**, përkatësisht **deus noster / Zotynë** a **Ynëzot**, ashtu siç e ndeshim në shkrimet e vjetra si te Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi etj., por edhe tek të tjerë, madje edhe në shkrimet e shkrimtarëve "të vjetër" të konfesionit muslimanë. Megjithatë fjala **zot** vazhdon të përdoret, jo si fjalë e specifikuar vetëm për një koncept, por për disa, madje edhe me elemente edhe të kuptimit abstrakt pagan, por edhe të kuptimit konkret (të njeriut). Po me këtë konotacion të pjesërishëm si emër abstrakt e konkret si dhe me elemente të fjalës hyjnore, fjala **zot** gjeti prani edhe në Fjalorin e M. Boçarit (1809), siç konstaton prof. E. Çabej.^{5[3]}

3[1] Shih edhe te gazeta *Bujku*, 24.IX.1995, f.13.

4[2] Frang Bardhi, *Fjalor latinisht-shqip* 1635, Rindja, Prishtinë 1983.

5[3] Dr. Egerem Çabej, *Studime gjuhësore* VII, Prishtinë 1985, f.271.

Edhe në burimet e mëvonshme leksikografike fjala **zot** del e shënuar edhe si fjalë hyjnore, por edhe si emër i përgjithshëm në emërtimin e njeriut sipas rangimit. Kjo dëshmohet edhe nga lënda e regjistruar në Fjalorin e H. Bariqit (1950)^{6[4]} dhe në atë të S. Dobroshit (1953)^{7[5]} etj, ku fjala **zot** përdoret si fjalë hyjnore, por edhe si sinonim pranë trajtës **zotni**.

Në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954)^{8[6]} për fjalën **zot**, jepet ky përkufizim: 1. titull që i jepet një burri për ta nderuar; 2. i zoti, pronari; 3. perëndia; secila nga hyjnitë pagane.

Në këtë burim mbi bazë të fjalës **zot**, jepen këto fjalë të prejardhura, të cilat ndeshen në përdorim e sipër edhe sot si: folje: *zot/em, zotëroj, zotnoj, zotoj*; emra: *zotëri, zotni, i zoti..., zotrote; zotërim, zotnim, zotim e zotësi*; mbiemër: *i zoti* dhe ndajfolje: *zotnisht*.^{9[7]}

Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) fjala **zot**, në krahasim me Fjalorin e gjuhës shqipe (1954) del e plotësuar me sqarime të caktuara dhe me ndonjë ndryshim formulimi dhe me zëra a nënzëra të rij, të veçantë. Po lidhur me këtë burim janë dy çështje që zgjojnë interes:

E para, është bërë punë e mire që këtu trajta **Zot**, shënohet në zë të veçantë si fjalë hyjnore dhe veçmas si fjalë e përgjithshme, madje në këtë burim, mbi bazë të fjalë-temës prodhuese nga rrënjori *zot-* si fjalë-trajtë e re shënohet mbiemri prejfoljor: *zotërues* (që del edhe me kuptim si emër vepruesi).

E dyta, vlen të theksohet një fakt tjetër që lë shteg hapur për diskutim. Është fjala për përfshirjen vetëm të trajtave të rotacizuara për shkak të përzgjedhjes së dialektit të toskërishtës si dialekt bazë që u mor për njëzimin e gjuhës së sotme letrare (në vitet '70), prandaj në këtë burim nuk dalin të shënuara fare fjalët: *zotni, zotnoj, zotnim e zotnisht*, ndonëse konceptet e trajtave të tilla që dilnin të përcaktuara në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954), siç do të argumentohet më poshtë, nuk dalin plotësisht të zëvendësuara tekstualisht me trajtat përkatëse të rotacizuara. Pra, ky fakt del si çështje e dikutueshme, jo pse është vepruar ashtu rreth bazës së përzgjedhur, por sepse, e kam fjalën vetëm për rastin në shqyrtim, mbesin jashtë përfshirjes në normë koncepte që ishin të pranishme përpara njëzimit, të cilat shpreheshin kryesisht me trajtat e parotacizuara.

^{6[4]} Henrik Bariq, Reçnik srpskoga ili hrvatskoga i albanskog vezika, Zagreb 1950.

^{7[5]} Fjaluer serbokroatisht –shqip, Mustafa Bakia, Prishtinë 1953.

^{8[6]} Fjalor i gjuhës shqipe (grup autorësh), Tiranë 1954, rib. Prishtinë 1976, f. 637.

^{9[7]} Po aty f. 638.

Sidoqoftë, para se ta shohim më për së afërmi se për cilat koncepte është fjala, në vazhdim do të japim ndonjë konsideratë lidhur me përdorimin e fjalës **zot** si fjalë hyjnore a si term fetar.

2) Raporti i fjalës **Zot** me trajtat sinonimike të stilit hyjnor

Siç u cek paksa në fillim të kësaj trajtесе, del i drejtë mendimi i prof. E. Çabejt, se "*në gjuhën shqipe fjala zot, duke ruajtur kuptimin profan të kryehershëm, nëpërmjet të gjuhës fetare. arriti të shënojë hyjinë*",¹⁰[8] mendim ky që bie pakëz ndesh me konstatimin e Ahmet Qeriqit, i cili thekson se emri **Zot** "*relativizohet në përdorim të një atributi të thjeshtësuar*", ngase, siç shprehet ky "*krahas **Zot** në kuptim hyjnor futen në përdorim edhe formulimet si **zot shtëpie**, ashtu edhe zëvendësimi **zotëri** e të tjerë*"¹¹[9]. Pra këtu mospërputhja qëndron lidhur me kronologjinë e perceptimit të koncepteve dhe të përdorimit të fjalëve, gjë që kërkon sqarim, pasi të dyja konceptet mund të arsyetohen varësisht nga këndvështrimi teo-filozofik i trajtimit të çështjes rreth formëzimit të tyre në kohëhapësirë.

Siç dihet, në cilësinë e emrit hyjnor, për të njëjtin koncept, përveç emrit **Zot** në shqipe kanë hyrë në përdorim të gjerë edhe fjalët barasvlerëse sinonimike: **Hyj** dhe **Perëndi**, madje edhe transferi **Allah**. Me qëllim që të saktësohet më mirë koncepti hyjnor i fjalës **zot** do të japim ndonjë konsideratë edhe për të tria fjalët e sapopërmendura barasvlerëse sinonimike të fjalë-termimit **Zot**.

a) Edhe fjala **Hyj**, e cila shpjegohet si singularizim i shumësit **hyje** që vjen nga njëjësi *hyll* (yll), konsiderohet si fjalë e vjetër autoktone e gjuhës sonë. Fjala *hyll yll* pandehet se është zhvilluar nga një trajtë më e hershme **huil*”, trajtë e vetme kjo, siç e thekson prof. E Çabej, e cila ka gjetur vend si refleks shqiptar i rrënjës indoevropiane **suel*”¹²[10] Në anën tjetër sipas A. Qeriqit, po trajta **HYLL** është ajo e cila zgjon asociacione (sidomos nga përbërja e bashkëtingëlloreve) me trajtën **JHVH**, përkatësisht **ELLOH** të hebraishtes dhe **All - Llah** të arabishtes, fjalë-terma këta të natyrës hyjnore që lidhen kryekëput me emërtimin e "*krijuesit të vetëm të botrave*", ashtu siç

¹⁰[8] (Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë 1986 f. 213).

¹¹[9] Shih A. Qeriqi, *Prania e emrave hyjnor ndër shqiptarë*, artikulli i botuar në gazetën "Bujku" më 16. I. 1995 f. 10.

¹²[10] Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore IX*, Prishtinë 1989 f. 242.

ndeshet koncepti i mbuluar me fjalën HYJ (Hyje Hyll), në burime të caktuara, deri edhe në përdorim të përditshëm në gjuhën tonë, edhe pse siç del nga interpretimi i A. Qeriqit, për konceptin e tillë "*ndërkohë sikur kishte filluar përdorimi gjithnjë e më i shpeshtë i fjalës Zot, Zotynë e Ynëzot*".^{13[11]}

Vlen të theksohet gjithashtu se në shqipe mbi bazë të emrit **Hyll (Hyj)** doli emërtimi **hyjni**, i cili, sipas prof. E. Çabejt "*pas gjase është një sajim i Bogdanit*", emërtim ky, me të cilin në gjuhën e sotme shprehen zakonisht "*perënditë pagane*", por edhe ndonjë koncept tjetër i attributeve hynore të *Krijuesit të vetëm po edhe vetë Krijuesi*. Nuk është larg mendsh se fjala **hyll** (hyje Hyj) si fjalë hyjnore përshtatet me konceptin fetar politeist siasteror (asteroid) që kishin iliro-dardano-shqiptarët para përqafimit të kristianizmit, prandaj një fjalë e tillë do ta ketë të ruajtur vazhdimësinë, edhe pse tashti paksa të transformuar, duke iu përshtatur konceptit hyjnor sipas botëkuptimit e predikimit fetar të ri monoteist, duke qëndruar në raste si barasvlerës sinonimik për termat hyjnorë: **Zot, Perëndi** e **Allah**.

b) Edhe pse ka përpjekje që edhe fjala **Perëndi** të shpjgohet si fjalë me origjinë të vjetër shqipe, duke e lidhur atë me fjalën "perëndim" si dukuri, përkatësisht kompozitën peren+DI si "zot iliro-trak" etj., sipas prof. E. Çabejt duhet përjashtuar mundësinë e tillë dhese duhet përkrahur "rrugën e zhvillimit të saj" si fjalë hyjnore nga "etimologjia latine imperant+i", siç e pandehnin "Boppi e Meyeri" dhe "të heqim dorë nga krahasimi indoevropian me emrin sll. "Perunj", lit. "perkunas", ind. vj. Parja'ya gr. "keraunos"^{14[12]} Për këtë gjykim Prof. Çabej ka parasysh faktin se autorët e vjetër të Veriut fjalën **perëndi** e përdornin me kuptimin "sundues, sundimtar" dhe e barasvlerësonin me fjalën **imperator** të latinishtes. Në vazhdë të kësaj, mjafton të sjellim këtu konstatimin e shënuar në Fjalorin e Konstantin Kristoforidhit, ku për fjalën **Perëndi** gr. o Theos (Zot) sqarohet se "*kjo fjalë (është fjala për trajtën Perëndi si fjalë hyjnore - N.V.) e ka marrë këtë kuptim në kohët e vona, d.m.th. pas Krishtit, prej Kristianëve, të cilët e besojshin Krishtin mbret të qiellit e të tokës, pra prej kuptimit mbret u muar kuptimi Zot*" dhe përfundon shënimi me konstatimin mjaft kategorik, por të guzimshëm, se "*Gegët kurr nuk e përdorin fjalën Perëndi për Zot, po thonë Zot*".^{15[13]}

Lidhur me këtë ne shprehim rezervë, ngase për që njëhej e njihet fjala **perëndi** edhe nga gegët, gjë që bie paksa ndesh me konstatimin e mësipërm,

^{13[11]} A.Qeriqi, art. I cit, f. 10.

^{14[12]} Dr. E Çabej, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë 1986, f. 213-214.

^{15[13]} Shih:K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht* (1904), rib. Prishtinë 1977 f. 256.

po sjellim faktin se në Fjalorin e "Bashkimit" (1908) del e shënuar fjala "**Perenni**" (Perëndi) pikërisht për fjalën Dio (Zot) të italishtes 16[14].

Po e rikujtojmë faktin e njohur për studiuesit se edhe trajta **mbret** ashtu si edhe ajo **perëndi**, pra si trajtë e mëvonshme, janë të lidhura etimologjikisht me trajtën *imperator* të latinishtes, mirëpo që me kohë këto dy trajta fjalësh dalin të përpunuara brenda sistemit të gjuhës shqipe dhe që të dyja konsiderohen si fjalë të fondit aktiv të shqipes që nga periudhat e hershme të gjuhës sonë.

Për mua ishte një befasi jo e pakëndshme, kur një reagues me pseudonimin *Ilir* lidhur me këtë trajtesë të botuar te *zembrashqiptare*, pikërisht për fjalën **perëndi**, sjell këtë plotësim sisqarim:

Fjala Perendi është fjalë shqipe e vjeter, dhe argumentohet kështu: Në dialektin dibran- kuksian thuhet Prenia (Perendia), qe rrjedh nga fjala pren (prind), Prenia ka kuptimin Prendia (prindja prindët n.v.), d.m.th Ai qe te Krijoi, është fjalë me se e perdorshme ne Diber-Mat-Kukës, si psh: t'bekoft Prenaja, ose t'vraft Prenaja! Rrenja e fjales eshte prendmth prind, nga ku del Prindëria qe mbase per lehtesim gjuhesor behet Perëndia.

Së këndejmi e falenderojmë z. Ilir që na solli këtë etimologji popullore, edhe pse bie ndesh me sqarimet e mësipërme, por sidoqoftë edhe Prof E. Çabej, me të drejtë, shpjegonte se rruga e kalimit të fjalëve **zot** dhe **perëndi** si fjalë hyjnore është e njëjtë, ngase që të dyja nga kuptimi profan abstrakt kanë kaluar në kuptimin konkret dhe së këtejmi në kuptimin hyjnor dhese për një kalim të tillë kanë ndikuar konceptet e caktuara, përkatësisht, siç e thotë ai "*për mungesë dëshmish të moçme*"... "*nga përdorimet e sotme vetëm mund të nxjerrim që kuptimi bazë është "zot" dhe kuptimi "perëndi" u përftua nën diktimin e gr. kyrios e të latinishtes dominus gjatë periodës së krishterë të gjuhës shqipe: dukëmeqenë që të dyja gjuhët klasike ndikuan shqipen e vjetër në terminologjinë kishtarë jo vetëm me anë të huazimeve, po edhe në këtë, që fjalët e vjetra muarnë tek kjo kuptime të reja... Pra këtu kemi të bëjmë me përdorim fetar të një fjalë që në burim qe fjalë profane...*" dhe përfundon me konstatimin përgjithsues se "*thesari i fjalëve fetare ka ndikuar mjaft nga njëra gjuhë indoevropiane në tjetrën*" 17[15]

16[14] *Fjalori i "Bashkimit"* (1908), rib. Rilindja, Prishtinë 1978. f. 332.

17[15] Shih dr E. Çabej, *Studime gjuhësore IV*, Prishtinë 1977 f. 44-45.

c) Nën tryshninë e kulturës orientale e të tjera dhe sidomos pas pranimit të fesë islame nga një pjesë jo e vogël, gjithnjë në rritje e shqiptarëve, si fjalë hyjnore krahas *Hyj*, *Zot* e *Perëndi* hyri në përdorim edhe fjala hyjnore **Allah** (e cila etimologjikisht krahasohet me aramishten *Elah* dhe hebraishtes Elohim), por në arabishte si term fetar kuptimisht fitoi konotacion të ri të veçantë. Po nënvizojmë që fjala **Allah**, ndaj sinonimeve të tjera të sipërpërmendura në gjuhën tonë është e vetmja që nuk vjen si fjalë profane ose si transformim i një emri konkret etj., por vjen drejtpërdrejt si një huazim transfer me konceptin e fjalë-termi hyjnor. Në gjuhën arabe kjo fjalë **ALL-LLAH** do të ketë pasur të njëjtën ecuri përpunimi si fjalët e mësipërme të shqipes, të cilat që në stadin e tretë u bënë hyjnore për masën e gjerë, siç u cek më sipër për fjalë-termat: **Zot**, **Hyj** e **Perëndi**. Nga disa burime të caktuara mësojmë se fjala **Ilah** (I adhuruari), përkatësisht **Allah** (e përbërë nga Al + Lah, d.m.th. nga El nyja përveçuese e shquarsisë + emri hyjnor Ilah), përdorej si emërtim hyjnie a kryezoti edhe para profetit Muhamed (570 - 632), d.m.th. themeluesit ose vazhduesit legjitim më të denjë të fesë islame, siç dëshmohet edhe në burime të caktuara enciklopedike. Kjo fjalë, siç thuhet në *Enciklopedinë e vogël të Prosvetës*.18[16]përdorej nga "poetë" të kohës edhe më përpara, përkatësisht ndeshej edhe në "mbishkrime" a shkrime të caktuara. Dihet se edhe tashti jomuslimanët arabë e kanë fjalën all-llah për koncept hyjnor në fjalësin e tyre aktiv. Siç dihet feja islame ka për mbështetje librin e shenjtë **Kur`anin**, në të cilin, veç tjerash jepen interpretime e njohuri origjinale a të dhëna të dorës së pare edhe për disa "elemente të religjioneve të tjera të Lindjes së Afërme" (monoteiste),19[17]dhe pikërisht këtu ka mbështetje dhe merr konotacion të ri përforcues fjala **Allah**. Kështu quhet tani, si me thënë, jo një kryezot, por "*krijuesi i vetëm i të gjitha botrave*", të cilin e karakterizon **njëshmëria absolute**, prandaj kjo fjalë-term u perhap, pa dyshim si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë, me konotacion hyjnor, pothuajse në të gjitha gjuhët e zhvilluara e të përpunuara të botës, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe.

Sidoqoftë, kur kemi parasysh faktin që del nga mësimi fetar fundamental se besimi në radhë të parë duhet të jetë akt i ndërgjegjshëm i shpirtit të njeriut a i vullnetit të botës së tij të brendshme, i cili duhet kuptuar si mishërim i gjuhës së zemrës dhe i gjuhës së mendjes (grykimit), gjuhë këto (edhe pse të pashprehura me fjalë) i kupton plotësisht vetëm "I gjithdijshmi

18[16] *Mala enciklopedija Prosveta I*, Beograd,1978 f. 36,

19[17] Po aty f. 730.

Allah” - *Krijuesi i të gjitha botrave*, pra edhe i botës së brendshme të çdo individi. Dihet se është fjala për Krijuesin, i cili në shqipe emërtohej me fjalë-termat përkatës: **Zot**, **Hyj**, përkatësisht **Perëndi**, andaj s'ka se si të mos jetë i shprehur po me gjuhën e mendjes dhe të zemrës në gjuhën shqipe nga besimtarët islamë, edhe koncepti i fjalës **Allah**, pa përjashtuar nuancimet e caktuara stilistike si rrjedhojë e ndikimeve përkatëse administrative e të tjera, që sipas natyrës së gjuhës përkatëse, mund të shprehen edhe me fjalë të tjera.

Nga sa u tha më sipër mund të nxirret si përfundim se për besimtarin shqiptar, si dhe për të tjerë, me rëndësi është vetë koncepti i besimit të ravijëzuar vullnetarisht thellë në ndërgjegje, së pari në gjuhën e zemrës e në gjuhën e mendjes, pa mohuar edhe të shprehurit me gojë a shqiptimin me fjalë, që kurorëzohet me të thënë të fjalë-termit përkatës në lutje ose në kontekste të tjera. Ç’është e drejta, në të gjitha gjuhët koncepti i "Krijuesit" (Zotit, Hyjit, Perëndisë, Allahut) shprehet me emra të ndryshëm. Madje edhe në **Kur’an** nocioni i Perëndisë shprehet me shumë attribute-emrash hyjnorë (përmenden 99 sish), por që nënkuptohet se të gjitha këto attribute i referohen vetëm Atij, të Gjithëpushtetshmit - Allahut. Në gjuhën turke b.f. për barasvlerësin Zot, serb. Bog (Gospod) jepen këta barasvlerës: *Tanri, Allah, Çalap. Ogan, Rab, Ilah* 20[18]), ngjashëm ndodh edhe në gjuhë të tjera.

Sido që të jetë, për fetarin universalist nuk është me rëndësi cila fjalë thuhet (shqiptohet), sa është me rëndësi koncepti që ndjen dhe e shpreh me shpirt ai. Edhe për shqiptarin besimtar, pra, vlen po kjo premisë, megjithatë gjithsesi ka rëndësi që fjala e tillë të jetë, në radhë të pare, ajo më e kuptueshmja, e origjinës shqipe ose e përvetësuar si e tillë, e cila, për të shprehur konceptin në fjalë, duhet me qenë e vetëmjaftueshme fetarisht, gjuhësisht dhe kombëtarisht.

Nuk është vendi as rendi që prej nesh të predikohet ndonjëfarë ekumenizmi ndërfitar monoteist, pasi që te populli ynë toleranca e tillë ndërfitare, historikisht e aktualisht, del ekzistuese dhe fort e qëndrueshme, e shoh të arsyeshme të përmend faktin, siç kuptohet në menyrë eksplicite, se shqiptarët e të dy, tri a katër konfesioneve 21[19], përveç gjuhës së përbashkët i lidh edhe besimi fetar i përqëndruar në një Hyj, përkatësisht në një Zot, një

20[18] *Srpsko-turski rečnik* (nga K. Agushi), Ankara 1980, f. 213.

21[19] Sqarim: ka dijetarë që, duke pasur parasysh librat e shenjtë Ungjillin (Biblën) e Kuranin, mendojnë se te shqiptarët janë të përhapura dy fe: kristiane e islame, disa të tjerë këmbëngulin në tri: ortodkse, katolike e islame, ndërsa dikush tjetër në katër(!): ortodkse, katolike, islame dhe bektashiane(!).

Perëndi, që pjesa më e madhe e shqiptarëve të konfesionit islam e shqipton edhe si *Allah*.

Edhe pse b.f. që nga "*Formula e pagëzimit*" e kemi të njohur tekstin: "Në emën të Atit, të Birit dhe të Shpirtit Shenjtë", ku binë në sy tri elemente përbërëse që tek individët mund të asociacionojnë gjurmë politeizmi, mirëpo sipas interpretimeve kompetente fetare kristiane aty nuk është fjala për ndonjëfarë politeizmi për **tre zota**, por fjala është për **Një Zot** a një **Zotynë**, gjë që del e shpjeguar kështu edhe në dokumentet e vjetra të materialit fetar të gjuhës sonë. Është indikative të theksohet këtu se si kjo "treshe" shpjegohet në veprën e L. Matrëngës (1592). Aty thuhet se: **Ati** është **Zot**, **Biri** është **Zot**, **Shpirt Shenjti** është **Zot**, por nuk është fjala për tre zota, por kemi të bëjmë me një "**YNËZOT**", dhe për t'u kuptuar më mire ky nocion jepet shembulli se edhe ne kemi "një të vetëm shpirt", por me "tri fuqi" që janë: "kujtimi (kujtesa historike), vlemë-i (vullneti) e ljosmo (intelekti a ndërgjegja)".^{22[20]}

Sigurisht kur kemi parasysh zhvillimin dhe përpunimin e gjuhës sonë interpretimi në gjuhën e sotme dhe në të ardhmen mund të dalë më i qartë dhe më i plotë se barasvlerësit që u dhanë prej nesh në kllapa. Mund të formëzohen terma edhe më të specifikuar dhe stilistikisht më të niveluar, por për ne është me rëndësi fakti se koncepti mbështetet gjithnjë te e njëjta fuqi mbinatyrore, e cila në shqipe emërtohet: **Zot**, **Hyj**, **Perëndi**, por edhe **Allah**.

Nga sa u tha më sipër, po ritheksoj faktin se pavarësisht se si quhet "Krijuesi i botrave", të gjithë besimtarët monoteistë shqipfolës **Atij** i lutën, i përulen, e respektojnë sipas riteve e mënyrave të ndryshme, por ai është i **Njëjti**, prandaj kurrfarë arsyeje nuk ka që besimtarët të sharrojnë në fanatizma të tepruar dhe të krijojnë përçarje në mes të tyre për shkak të ndonjë interpretimi përkeqas të politizuar të ndonjë termi a riti përkatës. Bindja në mënyrë evolutive, pa përjashtuar organizim e disiplinim, ravijëzon më së miri.

Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980)^{23[21]}, siç u tha, është vepruar drejt, ku krahas fjalës **zot** me kuptim të përgjithshëm është shënuar homonimi **Zot** si fjalë hyjnore, madje në skedë të veçantë paraprise, mirëpo lidhur me formulimin e dhënë atij përkufizimi mund t'i bëhen vërejtje serioze,

^{22[20]} Shih L. Matrënga, "*E mbësuarë e Krështëne*" (1592), përgatitur nga F. Sulejmani), Prishtinë

1979, f. 263.

^{23[21]} Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 2246.

ngase ai formulim nuk është hartuar nga pozita neutrale, siç do të duhej, por teksti është dhënë nga pozita e qëndrimit ateist. Në *Fjalorin e shqipes së sotme* (2002)^{24[22]} është bërë njëfarë përmirësimi, po edhe ky del i pamjaftueshëm. Prandaj në burimet e ardhshme normëzuese, siç është paraqitur në revistën *Drita e jetës*^{25[23]}, propozojmë që teksti i korrigjuar duhet ta ketë këtë përmbajtje:

ZOT-I 1. m. v.nj. *Sipas përfytyrimeve fetare (monoteiste) qenia e vetme më e lartë e mbinatyrshe, e cila ka krijuar botën, qëndron mbi të dhe drejton gjithçka. Perëndi Hyj, Allah.*
2. sh. A-T) Sipas përfytyrimeve fetare mistike pagane (politeiste) çdo hyjni e cila besohet se sundonte një pjesë të botës e të natyrës.

Pra siç po shihet nën 1. fjala **Zot-i** (sipas së cilës po kështu për këtë koncept duhet të shënohen edhe sinonimet: **Hyj, Perëndi e Allah**), ka shquarsi njëjësi, po nuk ka shumës dhe përherë përdoret si emër i përveçëm dhe si i tillë shënohet në çdo rast me shkronjë të madhe nistore, ndërsa nën 2. fjala **zot-i** e bën shumësin më –A-t: **zotat** apo **zotËt** dhe zakonisht shkruhet me shkronjë të vogël (ashtu si edhe **hyj** e **perëndi**, sa herë që koncepti i **hyjnisë** përdoret si emër i përgjithshëm.

3) Fjala Zot në raport me trajtën zoti, zotëri e zotni

Pasi pamë shtrirjen vertikale dhe horizontale të fjalës **zot** ashtu edhe formëzimin e saj si fjalë hyjnore, më saktë, si emërtim për "*Krijuesin e vetëm të botrave*" etj., duke dhënë edhe propozimin se si duhet zgjidhur çështja në burimet tona normëzuese, po kalojmë në pikën e tretë të temës në shqyrtim që ka të bëjë me raportin e fjalës **zot** kundrejt trajtave **zoti** (formalisht vetëm *njëjësi i shquar*), **zotëri** dhe **zotni** me kuptim të përgjithshëm, të cilat, pothuajse i kanë të përcaktuara a të specifikuar nënfushat semantike të përdorimit.

Sipas FGJSSH-së^{26[24]} në stilin libror ishte i "lejueshëm" përdorimi i trajtë-emrit **zoti** vetëm "*për t'iu drejtuar në mënyrë zyrtare a me nderim "burrave"* që ishin "*shtetas të një vendi josocialist e që nuk ishin komunistë*", por që tashti, pas ndryshimit të sistemit shoqëror-politik në Shqipëri, sipas

^{24[22]} Shih *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë 2002 f.1519.

^{25[23]} *Drita e jetës*, Gjilan 1995, f.23.

^{26[24]} *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980 f. 2248.

Fjalorit të shqipes së sotme (2002) si të themi, u rehabilitua plotësisht shprehja: **zoti + emri përkatës**, që normalisht të “**përdoret për t’iu drejtuar në mënyrë zyrtare e me nderim burrave**”^{27[25]}, d.m.th si vendës dhe të huaj, pa marrë parasysh sistemin shtetëror e shoqëror të tyre, pra edhe në ato raste kur për këtë funksion ishte i rekomandueshëm përdorimi i fjalës së shtanguar **shoku**, fjalë karakteristike kjo “*mirësjelljeje*” e rezervuar vetëm për anëtarët e udhëheqësit e caktuar të partisë socialiste (komuniste) si të vendit ashtu edhe të vendeve të jashtme.

Siç dihet, fjala **shoku** në rendin socialist ishte favorizuar të përdorej në vend të fjalës “**zotni** (përkatësisht *zoti*), e cila, sipas prof. A. Kostallarit”^{28[26]}, konsiderohej e tejkaluar, “jashtë mode”, për t’u përdorur përpara një emri a titulli të njeriut, qoftë për të shprehur nderim në marrëdhënie zyrtare e pune, qoftë për të shprehur nderimin ndaj të panjohurve. Po kjo ide e zëvendësimit të fjalës “zotni” përkatësisht “zoti me “*shoku*”, që ishte sanksionuar në *Fjalorin e gjuhës letrare shqipe*, del e sanksionuar edhe në *Fjalorin e shqipes së sotme* (1984) ku për fjalën e shtanguar **shoku**, thuhet se është “*fjalë që e përdorim përpara emrit të plotë ose vetëm përpara emrit a mbiemrit të udhëheqësve të Partisë e të shtetit ose të pjesëtarëve të tjerë të kolektivave punonjës, të cilëve u drejtohem me nderim*”.^{29[27]}

Pra, siç u tha më sipër, për këto koncepte nga të cilat ishte eliminuar fjala “zotni”, përkatësisht pjesërisht “zoti”, duke u zëvendësuar me fjalën shoku, tashti u rehabilitua në tërësi pikërisht trajta **zoti**, kurse trajta **zotni** ende mbeti e pa përfshirë në atë “amnisti”(!). Ç’është e vërteta fjala shoku, sipas *Fjalorit të shqipes së sotme* (2002),^{30[28]} si një “*fjalë që e përdorim me nderim përpara një emri të përveçëm ose një emëri të përgjithshëm sipas funksionit*” - mbetet në përdorim, por, siç po shihet, me formulim të ri.

Edhe trajtë-emri **zotëri** përdoret zakonisht si emër i veçantë me të cilin tregohet njeriu sipas rangut shoqëror, po në radhë të parë ai mbulon konceptin e njeriut si *posedues (pronar) i pasurisë*, pastaj *njeriun sipas postit a pozitës shoqërore zyrtare kiearkike që zë etj*, dhe së fundi edhe sipas *sjelljes e qëndrimit bujar që mban a mund të ketë akcili person*. Madje në FGJSH

^{27[25]} *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë 2002 f.1519.

^{28[26]} Shih artikulli i prof. A. Kostallarit “*Pse duhet zëvendësuar fjala zotni*” i botuar te “*Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*” I, Tiranë 1973 f.96.

^{29[27]} *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë 1984 f. 1169.

^{30[28]} Shih *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 2002, f. 1268.

(2006) te zëri **Zot-i** si term fetar del e anashkaluar pika 2., po shënohet shumësi **zotat**, çka e bën çështjen edhe më të paqartë, ndërkaq tek zëri **zot -ërinj** dhe **zotëri-a -injtë** mbizotëron koncepti i pronarit, i punëdhënësit, i zotëruesit, **padronit** me pushtet sunduesi etj. (Aty f. 1236) dhe kështu trajta **zotëri** me kuptim respekti bie edhe më nën hije ndaj trajtës **zoti** + dhe lë njëfarë shteku për rikthimin e trajtës **zotni**, apo jo?!). Së këtejmi, siç u përmend më sipër në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954), por edhe në *Fjalorin shqip-serbokroatisht* (1981)^{31[29]} si dhe në ndonjë burim tjetër krahas trajtës **zotëri**, e cila gjithsesi mbetet trajtë e favorizuar, edhe në ato burime, del e shënuar edhe trajta **zotni**, e cila pasi dilte siç del ende mjaft e përdorur aktualisht si në ligjërimin e përditshëm, jo vetëm te gegërishtfolësit, por edhe nga vazhduesit e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, në ato burime del e *lejueshme* me u përdorë për koncepte të veçanta. Ajo përdorej siç përdoret edhe sot së pari si zëvendësim i trajtës së ngurtëzuar **zoti** + *emër i caktuar*, por edhe në vend a si zëvendësim i trajtës **zotëri**, për ndonjë koncept që u cekën më sipër, mirëpo, siç u **sinjalizua** më përpara, fjala *zotni* përdoret edhe për koncepte të tjera që nuk duket se janë mbuluar mjaftueshëm me dy trajtat e sipërcekura, madje as me trajtën **zot-i** përgjithësisht. Siqoqoftë, rreth raportit të këtyre tri fjalëve *zoti*, *zotëri-a* dhe *zotni-a* ose **zotni zotniu** mbesin çështje të hapura.

Së këtejmi, çfarë del e hapur dhe a ka arsye të shtrohet një çështje e tillë për diskutim, mbetet të sqarohet apo jo? Janë dy fakte që e arsyetojnë të vënit në pah si çështje të hapur këtë temë:

e para, keqkuptimi i reflektuar në raportin: **zoti njeri / Zot Zoti, si hyjni e vetme** dhe

e dyta, barasvlerësia jo e plotë semantike në raportin: **zotëri / zotni**.
Tashti fill po i trajtojmë sadopak më në hollësi këto dy çështje.

Së pari, pra, kemi të bëjmë me faktin për një shqetësim tashmë të shprehur botërisht, pa nevojë fare, nga individë të caktuar (jo gjuhëtarë) se mos, vallë, përdorimi i fjalës së ngurosur **zoti** para një titulli a të një emri a mbiemri të njeriut, qoftë për të respektuar rangimin e tij zyrtar shoqëror, qoftë si shprehje nderimi a nënshtrimi, prekka për keq etikën e besimit monoteist, më saktësisht atë islam, ngase "emni i Zotit" si emër hyjnor kurrsesi nuk duron t'i bëhet shok "as njeriu as gjindi", në çfarëdo pozite qoftë ai!? Me fjalë

^{31[29]} *Fjalor serbokroatisht-shqip* (grup autorësh), Instituti Albanologjik, Prishtinë 1981, i cili konsiderohet normativ.

të tjera, duke e marrë përpara emrin "zoti"+ *emri përkatës* (njeri), qoftë konkret qoftë abstrak, si b.f. *zoti N.N. ose zoti ministër*, sipas mendjes së dikujt, gjoja u përçmuaka vetë emri i Zotit (Allahut), prandaj rekomandohet që në vend të trajtës së ngurosur **zoti**... të përdoret trajta **zotëri!**? Mbase harrojnë zotërinjtë e tillë *patëkeq* se pikërisht treguesi infiksor **-ër** te trajta **zot/ër/i** është element i numrit të shumësit të emrit zot, andaj fjala *zotëri* si singularizim i trajtës **zotrat**, sipas asaj logjike formale, mund të asociacionojë edhe më përkeqësisht për t'i sjellë në mendje elementet e politeizmit(!), që më shumë mund të lëndojnë etikën e besimit fanatikisht të pastër në një **Zot**, apo jo, sesa vetë trajta e njëjësit të ngurosur, e cila në rastin konkret kontestues është identifikuar pavetëdijshëm dhe pa të drejtë me fjalën **Allah**.

Pra kemi të bëjmë, vërtet, me një lajthitje a mospërputhje semantike në situata të caktuara të fjalës **Zot** me **Allah** që për dikë ka shkaktuar shqetësim siparanojik(!). Sa për të përforcuar të vërtetën që kemi të bëjmë me një shqetësim, pra, fare pa mbulesë, i cili mjerisht nuk mbeti pa jehonë, po ua rikujtojmë lexuesve disa shprehje të njohura të gjuhës sonë, ku fjala **zot** (si fjalë e vjetër e gjuhës sonë), s'mund të zëvendësohet assesi me fjalë-termin (relativisht të ri) **Allah**, por as me sinonime të tjera, madje as me vetë fjalën **Zot**, në kuptim të *krijuesit të botrave*, ngase nuk ka kurrfarë lidhje as ndërlidhjeje kuptimore me të, madje insistimet e njëjësimit (identifikimit) të emrit të përgjithshëm të ngurosur **zoti** me një emër të përveçëm **Allah** (=ZOT), siç është edhe shembulli b.f. *zoti N.N. ose zoti ministër* me *allah*, (*perëndi, hylli*) *N. N. ose allah (perëndi, hylli) minister(!)*, do të dilte jo vetëm qesharak por edhe denigrues për çështjen dhe për vetë tentuesit e përdorimit të tillë.

Po i kujtojmë edhe dy fakte të tjera, ku një zëvendësim i tillë i fjalës *zot* me *Allah* s'mund të bëhet dot:

- a) Shpia ka **zot**, U bë **zot** i vetvetës. Vetë **zot** vetë shkop etj.
- b) Kush është **zoti** i shtatë qiejve? – **All-llahu**; Kush është *zot* i *Arshit të madh* - përgjigjja është: **All-llahu**.^{32[30]}

Shembulli i pare a) është nxjerrë nga burimet tona normative, ndërsa shembulli i dytë b) nga *përktimi i materialit kuranor*, ku fjala **zot** është përdorur normalisht për një fushë të caktuar pushteti, d.m.th. me kuptim jogjithpërfshirës. Pra, është fjala për attribute që i takojnë vetëm Allahut (Zotit a Krijuesit ose Sunduesit të botrave).

^{32[30]} Shih: Zindan, *Njëshmëria e krijuesit*, Prishtinë, 2000, f. 255, .

Sidoqoftë, më sa u tha, për asnjë arsye s' duhet stepur rreth përdorimit të trajtës së ngurosur **zoti + emri përkatës**, siç është rasti: **zoti N.N.** ose **zoti ministër** etj., sepse për konceptin në fjalë është e vetmja trajtë e normëzuar në shqipe. Prandaj sipas mendimit tonë përdorimi i trajtës **zotëri** në vend të trajtës **zoti** në raste të tilla, bile më tepër se ajo **zotni**, bie ndesh me vetë normën në fuqi, ngase siç del nga përkufizimi përkatës në fjalorët tanë përshtues normativë, trajta *zotëri minister!* në vend *zoti ministër* mund të quhet shkelje e normës, ngase asnjë respektues i denjë i normës në fuqi nuk shprehet ashtu, prandaj s'ka nevojë të përdoret as nga ndonjë fanatik i patëkeq gegërishtfolës. Po ritheksoj faktin se ngatërresa në mes të trajtës së ngurosur **zoti** dhe të fjalës hyjnore **Zot** del e fryrë pa kurrfarë arsyeje, prandaj duhet cilësuar si fakt i paqenë (kuazihipertosekëzim!).

Lidhur me këtë po i ritheksoj këto tri çështje që shërbejnë si përforsim i sqarimit tonë:

e para, kemi të bëjmë me dy fjalë kuptimisht e gramatikisht të veçanta që u takojnë dy nënfushave a kategorive të ndryshme semantike;

e dyta, fjala hyjnore **Zot -i** (= **Allah-u**) shënohet përherë me shkronjë të madhe, është emër i përveçëm, ka shquarësi dhe ka pavarësi në përdorim, ndërsa trajta **zoti** (njëjësi i shquar) përherë gjendet e varur a e mbyllur brenda shprehjes së caktuar, duke hyrë kështu në një grup a kategori të veçantë emrash nderimi, siç janë b.f. emrat në trajtë të ngurosur: *baci (baca), bali, efa (efendi), imzot, atë, baba* etj. + *emri përkatës* dhe

e treta, fundi i fundit në asnjë kontekst fjalisor e semantik këto dy koncepte, me sa dihet, nuk mund të kenë takim për të formuar kështu ndonjëfarë homonimie as të lehtë as të vrazhdë! Në të vërtetë në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegnishtes si barasvlerës i trajtës *zoti N.N.* ose *zoti ministër*, përdorej trajta *zotni N.N.* ose *zotni ministër*, por që aktualisht trajta *zoti* del me konkurrencë të fituar, të preferuar, apo jo?! Por gjithsesi tashmë është jo e qortueshme përdorimi **zotni** N.N. bile më mirë se *zotëri* N.N., jo vetëm për *gegën e tillë* dhe përgjithësisht që s'i qaska trajtë-shprehjen *zoti N.N.!*

Prandaj, nga sa u tha, nuk qëndron asnjë arsye (as brenda- as jashtëgjuhësore) për ta bërë zëvendësimin e trajtës **zoti** me trajtën **zotëri**, po të dyja të përdoren sipas specifikimit që tashmë e kanë të ravijëzuar në letrarishten e sotme, ndërsa trajta *zotni ministër*, mund të qëndrojë, pse jo, nën hije të trajtës *zoti ministër*, por edhe të dalë si pa e qortueshme në rrethe përdorimi, apo jo?!

Së dyti, është cekur më sipër, por do të vërtetohet edhe më poshtë, se kuptimi i emrave **zotni** dhe **zotëri** nuk ishte identik, d.m.th. kishte dallime në mes tyre edhe në ish-shqipen letrare para kodimit të normës (të viteve '70), siç u cek paksa më sipër, prandaj lidhur me barasvlerësinë jo të plotë të trajtave **zotëri / zotni** del e nevojshme të jepen sqarime të duhura.

Është e vërtetë se me rastin e mënjanimin nga norma të trajtë-emrit **zotni**, të gjitha nënfushat semantike të saj nuk dalin të mbuluara kënaqshëm me trajtën **zotëri**, prandaj në këtë kontekst çështja del paksa konfuze. Kur është fjala për koncepte të pambuluara me trajtën **zotëri** e derivatet që dalin mbi këtë bazë, diskutimi i çështjes, jo vetëm që nuk duhet të cilësohet si një kthim prapa a "çelje punë pa nevojë" rreth njëzimit të gjuhës sonë letrare, por duhet të konsiderohet si një ndihmesë për përplotësimin e standardit me elemente të reja. Të jemi më të qartë. Është e vërtetë se me fjalën **zotni** dhe derivatet e saj, e cila dilte si trajtë e favorizuar në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954) si dhe në *Fjalorin shqip - serbokroatisht*, Prishtinë 1981, mbulohehin a mbulohen më shumë koncepte se sa mbulohen tashti vetëm me fjalën **zotëri** dhe derivatet e saj. Konkretisht me fjalën **zotnoj** kuptohej vetëm pjesërisht edhe koncepti i fjalës **zotëroj** (posedoj), për çka këtu nuk insistohet të bëhet farë diskutimi, por kur me atë trajtë kuptohej diçka më tepër, atëherë çështja domosdo kërkon sqarim. Me fjalën **zotni** mbulohej së pari, siç u tha, kryekëput kuptimi i trajtës **zoti**, d.m.th. përdorimi para "**titullit që i jepet një burri për ta nderuar**", por së dyti edhe koncepti "*i pari i shtëpisë*", *zoti i shtëpisë* ose *zotshpi-a*³³[31] dhe së treti, vetia bujare a njerëzore e njeriut të caktuar etj.

Ç'është e vërteta, cilësia që u cek në pikën e tretë përmendet paksa edhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) për fjalën **zotëri**, por, si me thënë, përmendet në margjinë, nën hije të koncepteve të tjera dhe jo e plotë, koncept ky që te fjala **zotni** zinte vendin e parë dhe dilte më e plotë. Edhe këtu, te jemi edhe më të qartë. Në *Fjalorin shqip - serbokroatisht* (1981)³⁴[32], por edhe në ndonjë burim tjetër trajtat **zotëri zotëroj** kanë barasvlerësi me fjalën **gospodar gospodariti** (posedovati) të serbokroatishtes (it. padroneggiare, rus. gospodovatj), gjë që është barasvlerësi e drejtë, ndërsa trajtat: **zotni zotnoj** kanë barasvlerësi me trajtat **gospodin gospodovati** të

33[31] Shih dhe M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006, f. 1633.

34[32] Shih *Fjalori shqip -serbokroatisht*, Prishtinë 1981, f.1040

serbishtes (it. *signoreggiare*,^{35[33]}rus. *barstvovatj*),^{36[34]}të cilat, sipas përkufizimit, nuk mbulohen me trajtën *zotëroj, zotëri*. Te koncepti i dytë **gospodovati**, siç e shënon S. Dobrosi (1952), kemi të bëjmë me barasvlersin "**me zotnue, me jetue si zotni**"^{37[35]}, përkatësisht me konceptin të një njeriu "**burrë zotni**", serbisht **gospodin, pravi gospodin, prefinjen čovek**".^{38[36]} Pra pikërisht koncepti zotnoj, **jetoj (me jetue) si zotni**,: jetoj zotnisht (bujarisht) a me zotnillëk etj. nuk del i mbuluar qartë ose fare me foljen zëvendësuese të letrarishtes së sotme **zotëroj**.

Prandaj, nuk na duket aspak me vend, dukuria e ikjes nga trajta **zot + emri përkatës** që mjerisht është e vërejtshme te ne në mjaft paraqitje publike e shkrime të autorëve tanë, sidomos gegërishtfolës, të cilët e respektojnë, si me thënë, verbërisht (më tepër se vetë toskërishtfolësit) trajtën *zotëri!*, në vend të trajtës **zotni**, të cilën si duket qartë e kanë të gjallë e aktive ende në sistemin e vet ligjërimor, por, për hir të respektimit zyrtar të normës (për mendimin tim të keqkuptuar), po e zëvendësojnë automatikisht me trajtën **zotëri**. Prandaj rastet e tilla me të drejtë shtrojnë nevojën e rehabilitimit të trajtës *zotnoj*, ngase shtohet dyshim i ligjshëm se me mënjanimin i trajtës geqe, mos vallë, është shkaktuar varfërimi i gjuhës letrare kombëtare marrë në tërësi për këtë pikë, apo jo!?

Pra, për mendimi tonë s' ka kurrfarë arsyeje që në raste të tilla të mos bashkëjetojnë trajtat e foljeve më -NO- krahas atyre më -RO-, kur ato tregojnë koncepte të ndryshme semantike, madje edhe në qofshin të farkëtuara e të motivuara nga tema e njëjtë fjalëformuese.^{39[37]} Në situata të tilla zgjidhja me polisemi të dhunshme është fare e panevojshme dhe mund të cilësohet si veprim i dëmshëm gjuhësor.

Kjo çështje që sapo u prek këtu po të trajtohet më në hollësi do të na hapte edhe hulli të reja me interes, por që nuk është synimi ynë i trajtesës sonë këtë rast. Megjithatë, edhe kjo, sa u tha, besoj se mjafton sa për të rikujtuar këtë dukuri, e cila gjithsesi paraqitet si çështje e hapur. Sa për ilustrim po cek një shembull, ndonëse të formuluar arbitrarisht, ku janë të pranishme të tria trajtat në shqyrtim:

"Zoti profesor është zotëri i nderuar. Babai i tij ishte një burrë-

^{35[33]} Shih: *Vocabolario irtaliano – croato o serbo*, Zagreb 1980, f. 600, 822.

^{36[34]} Shih: Standardni rečnik rusko-srpskohrvatski, Obod, Cetinje 1979, f.40,13.

^{37[35]} S. Dobrosi, vepra e cit. f.56.

^{38[36]} *Fjalori shqip-serbokroatisht* Prishtinë 1981 f. 1041.

^{39[37]} Lidhur me këtë shih më gjerësisht në veprën *Foljet më –o në gjuhën shqipe* (N. V.), Prishtinë 2002, f. 123 etj.

zotni që si të tillë e njihte dhe e nderonte bota".

Zëvendësimi i njërës trajtë me tjetrën, sipas mendimit tonë, do të lëndonte autenticitetin e tipizimit. Më e logjikshme dhe më e arsyeshme na duket që gegërishtfolësit ta përdorin në konkurrencë lojale trajtën **zotni**, ndaj trajtës së normëzuar **zoti**, sidomos në raste tipizimi etj. sesa ta përdorin trajtën **zotëri**, e cila, siç dihet, del e rezervuar për koncepte të tjera dhe vetë toskërishtfolësit nuk e përdorin në vend të treguesit *zoti*, apo jo?

Në përmbyllje, krejt kjo që u shtrua dhe u trajtua në tri pjesët e kësaj trajtëse, mund të përmbliidhet fare shkurtazi në këto tri pika:

E para, fjala **zot-i**, si fjalë autoktone e shqipës, pati dhe ka përdorim mjaft të ngjeshur e të gjerë në mbarë gjuhën tonë edhe në ditët e sotme përdoret, qoftë si emër konkret, qoft si emër kuptimi, por edhe si emër-term hyjnor. Si emër hyjnor, përkatësisht si term fetar fjala **Zot** ka sinonimi me fjalë-termat: *Hyj*, *Perëndi* dhe *Allah*, por nuk është identik në të gjitha rastet e përdorimit me ta.. Fjala **Zot-i**, si term hyjnor veçan është regjistruar me të drejtë në fjalorët normativë përshkrues të gjuhës sonë letrare, mirëpo përkufizimi i kuptimit leksikor i fjalës së tillë duhet rishikuar, përkatësisht duhet korrigjuar e përplotësuar nga pozita neutrale, siç u prozua edhe në këtë trajtësë.

E dyta, me kuptim të përgjithshëm në kuadër të fjalës *zot* del trajta e ngurosur **zoti** (njëjës i shquar), e cila përdoret në shprehje të veçanta përpara një emri, mbiemri a titulli të njeriut, me qëllim nderimi, përuljeje, qoftë në raporte zyrtare, qoftë në raport të rangimit shoqëror etj. dhe në mjaft raste po tentohet pa të drejtë, për arsye subjektive, pa mbulesë, me u zëvendësue me trajtën **zotëri (!)**.

E treta, nga raporti **zotëri / zotni** del se trajta **zotëri** me derivatet e saj si trajtë e normëzuar i ka të specifikuar nënfushat semantike të përdorimit që dallojnë paksa nga nënfushat që mbulonte fjala **zotni**, me derivatet përkatëse të saj. Prandaj propozohet që jo vetëm për "tipizime" të caktuara, por edhe për koncepte të pambuluara kënaqshëm me trajta të tjera, trajtës **zotni** institucionalisht t'i lejohet e drejta për konkurrencë të lire, lojale.

Përfundim

Pas ndryshimeve që ndodhën, 10 - vjetshat e fundit, në sistemin shoqëror e politik të shoqërisë shqiptare, sërish u riaktualizua çështja e përdorimit të fjalës **Zot**, prandaj edhe ne e rrahëm këtë problem, duke u përqëndruan në këto tri pika themelore:

E para, rreth shtrirjes vertikale e horizontale të fjalës **zot** në gjuhën shqipe, ku u vërtetua se fjala *zot*, si fjalë autoktone, del e përhapur në kohëhapësirë nëpër shekuj më kuptim abstrakt dhe me kuptim konkret.

E dyta, rreth raportit të fjalë-termi hyjnor **Zot** me sinonimet përkatëse *Hyj*, *Perëndi* dhe *Allah* si emra të përveçëm dhe u vërtetua se me përqaftimin e kristianizmit, përveç kuptimeve hyjnore që kishin në jetën pagane përveç fjalës **Zot**, edhe **Hyj** e **Perëndi** fituan konotacion të ri, duke marrë elemente specifikimi për të shprehur konceptin biblik të *Krijuesit të vetëm të botrave*, ndërsa po për të njëjtin koncept u pranua si huazim transfer që me përhapjen e islamizmit ndër shqipfolës edhe fjalë-termi **Allah**.

Meqenëse për arsye të ndryshme në fjalorët shpjegues të shqipes përcaktimi i kuptimësisë monoteiste të fjalës **Zot** nuk del e dalluar kënaqshëm nga kuptimësia pagane, si përplotësim u propozua teksti si vijon:

ZOT-I 1. m. v.nj. *Sipas përfytyrimeve fetare (monoteiste) qenia e vetme më e lartë e mbinatyrshme, e cila ka krijuar botën, qëndron mbi të dhe drejton gjithçka. Perëndi, Hyj, Allah.*

2. sh. -A/T) *Sipas përfytyrimeve fetare mistike pagane (politeiste) çdo hyjni e cila besohet se sundonte një pjesë të botës e të natyrës.*

E treta, rreth raportit kuptimor të fjalës **zot** si fjalë-emër i përgjithshëm në raport me derivatet: **zoti**, **zotëri** e **zotni**, ku doli përfundimi se në gjuhën shqipe me kuptim konkret njeriu, veç fjalës **zotëri**-a, del në përdorim edhe trajta e *ngurosur zoti* + *emër përkatës*, e cila padrejtësisht tentohet të zëvendësohet me trajtën **zotëri**, gjoja për t'i ikur homonimisë së vrazhdë me emrin e përveçëm hyjnor **Zot-i**. Në trajtesë u sqarua bindshëm se një shqetësim i tillë, del fort i pa bazë, ngase një përdorim i tillë nuk pengohet formalisht e thelbësisht nga vetë struktura e sistemit të gjuhës sonë letrare.

Fundja, nëse del e nevojshme që trajta **zoti** + **emri përkatës** të rishikohet për ndonjë arsye tipizuese etj. atëherë, mund të konkurrojë po për atë koncept edhe edhe fjala **zotni** + **emri përkatës**, e cila në ish - shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes kryente po të njëjtin funksion dhe assesi nuk ka nevojë të zëvendësohet me trajtën **zotëri**, e cila del e specifikuar për koncepte të tjera.

18) RRETH KONTAMINIMIT HOMONIMIK TË FJALËS EMËN OSE EMËR1 ME FJALË-TERMIN KURANOR EMËR2 (EL ÄMR*) NË GJUHËN SHQIPE**

Hyrje

Kontaminimin homonimik ose përzierjen e koncepteve të këtyre dy fjalë-termave, nga titulli i kësaj trajtесе që ne i dalluam për qartësim me numra: emër1/emër2, të cilët kanë konstrukt shkrimor e shqiptimor të njëjtë ose të përafërt e kam vërejtur më parë në një artikull të botuar në gazetën *Bujku*, të datës 16.IX.1985, f. 13, ku artikullshkruesi dëshmonte me vend se në të folmet tona popullore (Kosovë) paska vënë re trajtën emër në shprehjen "*Me emër të Zotit ka me u ba mirë*", të cilën, jo pa të drejtë, e cilëson si "shprehje të shtanguar", por pa u thelluar në kontaminim homonimik të saj,

shqiste paksa në *silajthitje*, ngase i dukej që trajta e tillë emër si me qenë toskëzim i trajtës emën të gegnishtes, e bërë nën ndikimin e letrarishtes së sotme(!). Në të vërtetë, aty kemi të bëjmë me diçka tjetër e jo me toskëzim të trajtës emën, e cila zakonisht edhe në të folmet e trevave tona si në mbarë Gegninë përdorej dhe përdoret në ligjërim të lire e parotacizuar. Nuk dime sa patëm të drejtë që shqitjen e autorit e quajtëm: *paksa silajthitje*, kur kemi parasaysh faktin se kjo përzierje, që dikush edhe sot nuk e dallon dot, potencialisht del shumë e ngatërruar në gjuhën e të gjitha trevave të gjuhës shqipe, ku mbase shumica nuk e vret mendjen t’i dallojë, edhe pse janë dëgjuar e dëgjohen edhe shprehjet e rregullta, të cilat, qëndronin në përdorim normal në ish shqipen letrare mbi bazë të gegnishtes. Sidoqoftë, tash fill po japim një shembull të paqortueshëm me nocionin emën (emër1!) ndaj emër2 në dy versione, sipas normës së situatës të dialektit përkatës:

(1) Sipas ish-shqipes letrare mbi bazë të gegnishtes:

a) **Me emnin** e Zotit po e filloj këtë punë (*nënkuptohet realizimi me shqiptim paraprak të shprehjes me këtë emër: Zot, (Perëndi, Allah);*

ndaj

b) **Me emër të Zotit** do ta kryej këtë punë (*sipas urdhër-detyrimit të nënkuptuar si ndihmë hyjnore e fatit të mëparëcaktuar!*).

(2) Sipas letrarishtes së sotme mbi bazë toskërisht:

a) **Me emrin e Zotit** po e filloj këtë punë (*nënkuptohet realizimi me shqiptim paraprak të shprehjes me këtë emër Zot (Perëndi, Allah).*

ndaj

b) **Me emër të Zotit** do ta kryej këtë punë (*sipas urdhër-detyrimit të nënkuptuar si ndihmë hyjnore e fatit të mëparëcaktuar!*).

Të vërehen trajtat: **me emën** ndaj **me emër** në versionin e parë (1), ku nuk shfaqet kontamini, ndërkaq në versionin e dytë(2) shfaqet kjo kontamini e shprehur me homonim, dukuri kjo e krijuar në toskërishte kohësisht që me rastin e huazimit, por e sforcuar edhe më tepër me rastin e formëzimit të *shqipes letrare kombëtare* mbi bazë të atij dialekti. Andaj për të qenë më e kuptueshme kjo problematikë, e pamë të arsyeshme që në këtë trajtesë t’i qartësojmë këto katër çështje:

e para, si e ndeshim shtrirjen dhe shqiptimin e këtyre dy fjalëtermave *emën ose emër1, në një rën anë dhe emër2* në gjuhën tonë, në anën tjetër, sipas trevave e burimeve përkatëse?

e dyta, cilat janë nënfushat semantike që mbulojnë ose mbulonin tradicionalisht këto dy fjalë, njëra e burimit vendës: *emën* krahas *emër1*, tjetra fjalë e huazuar *emër2*?

e treta, si qëndrojnë dallimet dhe përkimet formale shkrimore e ato kuptimore të këtyre fjalë-termave: **emën** ose *emër1 /emër2*, sidomos në letrarishten e sotme? dhe

e katërta, çfarë duhet ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj problematike?

Pra në vijim do të përpiqemi të japim sadokudo përgjigjet për çështjet e saposhtuara.

I. SHQIPTIMI DHE PËRHAPJA E KËTYRE DY-TRI FJALËTERMAVE

Ç'është e vërteta, në ligjërimet tona të zakonshme (gege) dhe përgjithësisht jo vetëm shprehja e vërejtur nga autori, por edhe të tjera të ngjashme nuk janë të rralla, si:

"Zoti ka ba emër ashtu...", "Me emër të Zotit kemi me fitue", "Do të zbardhet kjo punë, me emër të Zotit", "Me emër të Perëndisë kemi me ia dalë", "Emri i Zotit është hak, është i drejtë", "Emri i Tij patjetër ashtu qysh asht shkruar do të shkojë në vend! Me emër të Zotit kemi me u kthye mbarë!" etj.

S'do mend se trajta **emër** në këto shprehje nuk ka të bëjë fare me toskizëm, madje as me trajtën **emën** të gegnishtes, por siç del e shënuar në titullin e kësaj trajtese kemi të bëjmë me një fjalë-term të huazuar nga arabo-turqishtja, kuptimi i së cilës në radhë të parë i takon fushës së terminologjisë kuranore, andaj si e tillë del e nevojshme të sqarohet nga ekspertë njohës të asaj problematike. Por mbasi në realitetin tone gjuhësor, siç do të shohim, kjo fjalë kalon edhe në përdorim të rëndomtë, pa hy në analiza të thella rreth kësaj fjale në kuadër të terminologjisë fetare ontologjike në përgjithësi dhe të asaj islame në veçanti, vështruar nga këndvështrimi i shqipes, ne e pamë të mbëhishme që me aq sa dimë dhe aq sa kemi mundësi, qoftë edhe guximtarisht, të sqarojmë ose të shprehim mendimin tonë rreth shfaqjes së kësaj kontaminie homonimike në gjuhën tone, ndërmjet fjalës anase shqipe **emër (emën)**, qoftë si term gramatikor-gjuhësor etj., me termin kuranor **emër**, qoftë shtrirjen e kësaj fjale për hijesa të tjera nocionore si në gjuhë të tjera edhe në gjuhën shqipe.

Po fillojmë me një konstatim të përgjithshëm që mbase ia vlen të njihet. Theksojmë faktin që fjala e tillë **emër**, dëgjohet e shqiptuar te ne edhe si **emer** e cila nuk vjen vetëm si ndikim i ndonjë gjuhe të huaj në kontakt, por edhe nga arsyeja se në viset tona (gege), ë-ja tradicionalisht nuk artikullohet ose nuk ka shqiptim të përputhshëm si në letrarishten e sotme, mirëpo meqë në gjuhën e shkrimit, mbizotëron trajta **emër**, ne e shënuam kështu.

Sido që të jetë ajo nuk është toskizëm, por kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur kontaminim kuptimor ndërmjet këtyre dy fjalë-termave edhe më parë në të dy dialektet **emën** ose **emër1** ndaj **emër2**, por kjo përzierje sidomos në toskërishte del më e dalluar dhe së andejmi ky kontaminim është ngjizur në letrarishten e sotme zyrtare, prejse kjo e njeh të normëzuar vetëm fjalë-trajtën autoktone **emër1**, e cila siç e pamë në rastin që po trajtohet këtu del si homoformë e plotë ose gjithësi e ngatërruar me atë të huazuarën **emër2** (*emer*, ***el-emrun**).

Te shembulli i parë që e dhamë në fillim, nën (1) te pikat: a) dhe b) në gegnishte, siç e pamë, nuk ka homoformë, ndërsa te shembulli i dytë (2), te pikat a) dhe b) në toskërisht ose në letrarishten e sotme, po. Pra, sot për sot, vetëm në letrarishtes e sotme paraqitet një homonimi e tillë problemore.

Tash besojmë se çdo lexues e ka të qartë problemin e të shfaqurit të kësaj homonimie vetëm në versionin toskërisht, por kjo nuk do të thotë se del i qartë krejt problemi rreth raportit të nënfushave semantike ndërdialektore që mbulojnë këto dy fjalë: **emën/emër** ose **emër1/emër2**, qoftë bashkë si homonimi, qoftë veç e veç, si në letrarishten e mëparshme me bazë gegërishte, qoftë sidomos në letrarishten e sotme me bazë toskërishte.

II) RRETH FUSHËS KUPTIMORE QË MBULOJNË TRADICIONALISHT DY FJALË-TERMAT NË SHQYRTIM

Për t'u kuptuar edhe më mirë objekti i trajtimit të këtij punimi, së pari do të rikujtojmë, mbështetur në burimet normëzuese, përkufizimin e kuptimit të fjalëtermit **emër1 (emën)** e cilësuar si fjalë anase dhe së dyti, do të konstatojmë fushën semantike që mbulon fjala e huazuar ndërkombëtare **emër2 (emer *emr ose el -emrun)** e cilësuar si term kuranor, po edhe me shqitjen ose përdorimin e saj si fjalë e rëndomtë në stilin përkatës administrativ.

a) Rreth fjalës **emër1** (ose **emën**) si fjalë autoktone e shqipes

Nga FGJSSH 1980 si dhe përgjithësisht në burime të tjera normëzuese të shqipes standarde sipas zërit përkatës *fjala emër1* (geg. **emën**) bashkë me disa shprehje plotësuese, edhe ndonjë rast me kuptim të figurshëm, si rrjedhojë e saj, sqarohet në mbi 5 kuptime polisemantike, duke filluar: *si fjalë*:

emër - që i vihet çdo njeriu posa të lindë, që e shoqëron gjatë tërë jetës si shenjë identiteti, pastaj

*emër - quhet çdo **nofkë** – si fjalë e ngjitur, për të kaluar kështu si lemë emërtuese a si njësi leksiko – gramatikore, të cilës në gramatikë kryesisht i jepet ky përkufizim:*

emër - *pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që shënon një qenie a një send dhe që eptohet (sipas gjinisë, numrit, rasës).*

Ndërkaq sipas funksionit ose realieve që shprehen me këtë njësi semantiko-gramatikore kuptohet:

emër -fjalë ose grup fjalësh me të cilat quhet (emërtohet) një njeri, një kafshë, një send, një vend, por edhe një dukuri etj. për ta veçuar ose për ta dalluar atë nga një tjetër a nga të tjerat...

Madje si shprehje plotësuese me fjalën **emër** jepen shembujt ilustrues, si:

emër - *një njeri i dëgjuar; autor i një vepre, pastaj: (emër me...) nam, famë,*

por edhe:

flas në emër të... Trego emër për emër kush erdhi? E njoh vetëm me emër, për nga emri, (me) emërmbiemër etj.

Por siç do të shohim, në kontekste të ndryshme me fjalën **emër1** (geg, **emën**) si njësi leksiko-gramatikore, sidomos sipas rrjedhojave fjalëformuese që përftohen, mbi këtë bazë, dalin edhe kuptime të tjera polisemantike, por, mesa hetuam, me to nuk shprehet ndonjë proces a dukuri jashtë sferës së kuptimit të ngushtë të fjalës emën (emër1), por në raste mund të përftohen ose të përzihen asociacione kontaminuese në krahasim me fjalëtermin e huazuar homoform **emër2**, siç do ta shohim më poshtë.

b) Rreth fushës kuptimore të fjalëterminit kuranor emër2 (*el-emrun)

Fjalë- termi **emër** ose **emer** (arab. **äm*r, *el-amrun*), siç shpjegohet në tekstin e Kur'anit në shqipe është:

një ndër termat: "ndoshta më kryesori, më i përgjithshmi" i Kur'anit, ku flitet për "natyrën hyjnore" të përmbajtjes së tij dhe njëherësh, siç ceket aty, me këtë fjalë-term: "çdo send, ipso facto, është **"*äm"** (**emër2**) a nënkuptohet vetvetiu si i tillë.

Me fjalë të tjera:

kjo fjalë- ide (hyjnore) si një dukuri (e shprehur në Kuran) nënkuptohet si simbol a si një siligj që ngërthen në vetvete të gjitha *faktet ekzistuese të botës organike dhe inorganike*, të cilat, sipas këtij **libri të shenjtë** (fjalë e Zotit) integrohen në një sistem"...

të cilin, mbase sipas terminologjisë së sotme dialektike (ontologjike), është më mirë ta quajmë: **"rend"** a **"strukturë sistemesh"**, apo jo?!

Sidoqoftë,

në këtë "sistem" a "rend", bën pjesë edhe vetë "shpallja e ämr-it" ose të një pjese të tij që quhet **vahj-i**, d.m.th. shpallje e fjalë-ideve të Zotit, që del e realizuar nëpërmjet të të frymëzuarit (inspirimit), e deklamuar nga goja e Profetit (Muhammed), siç është teksti i Kur'an-it në arabishte, gjuha e të cilit, shikuar sipas pikëpamjes së përgjithshme (në vetvete si gjuhë perëndie): "është e përsosur, e qartë dhe e plotkuptueshme, e pajisur me saktësi e koncizitet të plotë (dhe si e tillë), si unikat "nuk ka model imitues" etj. (Shih: Kur'an-i, Prishtinë 1985 f. 15 – 16.)

Dhe së këtejmi, meqë:

"Kurani vlerësohet si një libër i jashtëzakonshëm me karakter universal me përmbajtje ekonomiko-sociale, juridike, apologjetike, letrar-artistike etj. etj....,

atëherë dhe fjala **emër** (emer *emr) duhet vlerësuar si e tillë, si fjalë e karakterit hyjnor, të cilën dikush e quan edhe **fat i mëparëcaktuar i individit!**, që ne e shënuam me pikëçuditje, ngase një mendim i tillë mund të arsyetohet ndoshta vetëm në parim (si sistem, si rend), por jo në hollësi, sepse, siç komentohet mendjesisht, çdo njeri duhet të përpiqet që vetë ta shkruajë fatin e rrugës së vet të shpëtimit, duke u mbështetur në dhantitë që ia ka dhënë i Lumi Zot, siç janë: **arsyeja (aftësia e të gjykuarit), vullneti, ndërgjegjja dhe kujtesa historike**, të cilat është i autorizuar t'i shfrytëzojë e t'i përsosë si mëkëmbës i Zotit që është në tokë, por njëherazi ka përgjegjësi që këto dhanti t'i përdorë me invencion, me vetëdije të lartë në rrugën e së mires, të drejtës, në rrugën e shpëtimit, pra sipas **emrit** (urdhërit) të **Krijuesit e jo sipas të paudhit** etj.... Së këtejmi për ta kuptuar dhe përkthyer (ose plotësuar) nocionin e fjalë-termit **emër2** lypset përpjekje e niveleve më të

larta të mendjes njerëzore, ngase **fjala e Zotit** në procesin e të kuptuarit i tejkalon aftësitë e njeriut të rëndomtë, madje as në arabishte ose aramishte *nuk mund të kuptohen disa koncepte në mënyrë natyrore (!)* fjalë-idetë e *Krijuesit të Universit*, andaj librat e shenjtë: **Kurani** e **Bibla** (përkatësisht, Teurati a Tora, Zeburi a Psalmet e Davidit, Ungjilli a Dhjata e re - të pëmbledhura në Bibël) si shpallje hyjnore (revelata) imponojnë interpretim kompetent profesional nga dijetarët e profileve të caktuara, ngase në çdo pikëpamje çdo shprehje a *shenjë-ide* e Zotit dhe tërë teksti (b.f. në Kuran), siç thuhet, zë majat më të larta të çdo stili funksional, andaj edhe kushtëzon interpretim me përgjegjësi të jashtëzakonshme autoritative nga ulemaja (dijetarët e specializuar). Andaj po ky vlerësim vlen edhe sa i përket gjuhës dhe ideve letraro-estetike të shprehura në këtë *Kryelibër*, sepse bazuar sipas burimeve përkatëse teorike dihet se çdo vepër (gjuhësore) e sidomos:

*“Vepra poetike duke qenë manifestim i ndjenjave më të larta njerëzore... e cila porosinë e poetit (autorit) e shpreh nëpërmjet vargjeve (gjuhës poetike), ku përmban një varg figurash stilistike, siç janë: metafora, metonimia, rima, krahasimi, simboli, hiperbola e të tjera, lë vend për përjetime e interpretime të ndryshme ndenjore e kuptimore varësisht nga aftësia e konsumuesit (lexuesit e interpretuesit), andaj edhe vepra e Kur’anit (me vargje të përkryera duhet të përjetohet me “fi se bili lah”, me mend, me zemër e me shpirt), sepse kjo vepër që përshkohet me besnikëri e bukuri të paarritshme estetike nga çdo njeri-poet, si e tillë në rastin kur u shpall i linte në hije të gjitha ose ua kalonte në çdo pikëpamje të gjitha **maul-lakateve** të atëhershme (poezi më të përsosura arabe të kohës) madje, siç vërtetësohet nga kritika përkatëse, mbetet e tillë edhe ndaj krijimeve të mëvonshme deri në ditët e sotme, në atë gjuhë e përgjithësisht, apo jo?!*

Sidoqoftë, sipas konstatimeve që lexuam nga të tjerët (nga interneti) në kontekst të kësaj tërësie gjithpërfshirëse, edhe përmbajtja e fjalës **emër²**, sipas Kuranit paraqitet si një rast *“me specifikë të veçantë”* si perceptim i një *siobligimi moral e intelektual ose një siligj i nënshtrimit të besimtarit ndaj Zotit*, por edhe *si zotim i mëkëmbësit njeri në këtë botë me autorizim nga Zoti*, për me i krye punët e detyrimet e veta **të emëruara** (të mëparëcaktuara), të cilit, njeriut, ç’është e vërteta, siç nënkuptohet nga kjo shpallje *“nuk i është dërguar prej së larti” vetëm si një **vahj-i** (shpallje) ose vetëm si një **emër (*äm̄r)** apo si **urdhër zbatimimi**, por, siç thuhet, njeriut i vjen edhe si botë gjalluese subjektive në vetvete si *shpirt krijues inventiv*, pra si një *“shpirt nga**

ämri", d.m.th. gjallim kreativ po nga ai zbatimim (*ruh min al-ämri*). Madje lidhur me këta dy terma "**el-ruhu**"(shpirti) dhe "**el-amr**" (urdhër ose porosi hyjnore e mëparcaktuar si ligj udhëzimi moralizues), studiuesi Dr. M. Mahmud thotë se "këto dy shprehje: **el-ruhu** dhe **el-amru**, si sinonime janë shenja (simbole), domethëniet e vërteta të tyre i di vetëm All-llahu, i Gjithdijshmi (Shih. Dr. M. Mahmud, *Dialog me mikun ateist*, Prishtinë 1990 f.77). Edhe Rifat Shahinović (sipas përkthimi të Nexhat Ibrahimit), në punimin *Ruhi dhe nefsi në Kur'an*, veç tjerash konstaton se "*ruh në Kuran përmendet në shumë kuptime, edhe si shpallje, sepse me të arrihet jeta e zemrës dhe e shpirtit...* Kështu pra, sipas tij me **Emrin e Zotit (vahjin)** u gjend edhe shpirti (*ruh*)... Po lidhur me këtë (rreth fjalës *el-emru*) në *Takvim* (1997, f. 68) lexuam komentin rreth ajetit: **El -Emru bil mar'uf ven nehju anil munker...** etj., ku thuhet:

*Është interesant të përmendim se në ajetet e cituara ka aluzione të qarta, lidhur me rolin e pushtetit në misionin e udhëzimit kah e mira. Në të gjitha ajetet në të cilat flitet për këtë mision, janë përdorur shprehjet **emër dhe nejh**, që në gjuhën tonë do të thotë **urdhër dhe ndalim**. Është fare e qartë se kjo ka të bëjë me pushtetin, sepse vetëm pushteti mund të japë **urdhëra** dhe të bëjë **ndalime**. (Po aty f. 70.)*

Ndërkaq Muhammed Ikbali në punimin: "*Ego-ja e njeriut*" (sipas shqipërimin të Avni Aliut, të botuar në gazetën "Hëna e re" të Shkupit, të datës 3.IV.1996, f. 19, shpjegon se fjala "**Emr**", e cila në shqipe aty shpjegohet me barasvlerësin **qeverisje, urdhëresë**, bashkë me fjalën "**Halk**" që aty shpjegohet me barasvlerësin **krijim**, shprehin dy mënyrat në të cilat "**zbulohet aktiviteti kreativ i Zotit në ne**" dhe se fjalë-termi ***Emr** si koncept hyjnor "**funksionon si njësi e ego-s**". Me fjalë të tjera, konceptet **Halk** (krijimi) si dhe **Emr** (qeverisja) i takojnë sistemit të njëjtë. Po ashtu, po në këtë vazhde komentuesi Orhan Bislimaj në *Takvim* (2007), jep këtë shpjegim mjaft përcaktues, që pikërisht jep sadopak ndihmesë përgjigjeje lidhur me temën tonë:

*Fjala **emër**, është fjalë e gjuhës arabe. Ajo ka disa kuptime, ndërsa në frazën: **Allahu ka bërë emër** ose **Allahu e ka shkruar, vjen me dëmethënie e "urdhërit"**. Kjo do të thotë **Allahu ka urdhëruar**.*

Dhe më tej shpjegon:

Mirëpo kjo frazë lejohet të përdoret vetëm për vepra të mira dhe në raste gëzimi dhe jo për vepra të këqija dhe në raste fatkeqësie. Allahu nuk urdhëron b.f. njeriun të vetvaret ose të ngasë veturën pa kontroll...etj. (Aty f. 174.)

Ne duke mos kontestuar përpjekjet për gjetjen e sinonimit të tërë frazës ose edhe të barasvlerësit përkatës sa më adekuat të fjalëtermit **emër2** (*el emrun) po theksojmë se edhe në librin *Komentimi i përsosur i Kur'anit* nga Shirazi, përkthyer shqip nga Vullnet Merja (Tiranë, 2011) fjala *emrun* përkthehet *urdhër*, përkatësisht varësisht nga konteksti: *urdhër që pritet të shfaqet!*

Sidoqë të jetë, në shqipe, sipas këtyre burimeve përkatëse profesionale, fjalë-termi "**emër**", "***el-emr**" është përkthyer me barasvlerësit: **rend**, **udhëzim**, **qeverisje**, **strukturë sistemesh** etj., por edhe thjesht si **sistem**, **urdhër**, **urdhërim**, andaj kur kemi parasysh kompleksin semantik që mbulon një fjalë-term i tillë, siç u cek edhe pak më sipër, nuk përjashtohen edhe sinonime të tjera që mund të ofrohen, qoftë në kontekste të caktuara që mund të përdoren edhe sotpërsot, qoftë në të ardhmen, varësisht nga përthellimi i të kuptuarit të nocionit të temës si e vërtetë e të qenmes (ekzistueses) si dhe varësisht nga zhvillimi dhe përpunimi i vetë gjuhës e i shoqërisë shqipfolëse, ose varësisht nga ngritja intelektualisht e bashkësisë shqipfolëse, që mund të "*zbulohen*" ndërkohë fjalë-terma të rij. Kështu, *me emër të Zotit*, apo jo, mund të imponohet ndoshta ndonjë barasvlerës edhe më adekuat për nocionin përkatës të karakterit hyjnor.

Sidoqoftë, fjalë-termi kuranor "**emër**"(**emer**), si fjalë ndërkombëtare, është e përhapur në gjuhë të ndryshme të botës, qoftë si huazim transfer ose si përkthim kalkëzues nocioni. Së andejmi, mesa u tha, është vështirë që për koncept të tillë t'i gjendet një barasvlerës i vetëm në sferën hyjnore në cilëndo gjuhë (njerëzore) e sidomos në gjuhën tone, në përpunim e sipër, por, megjithatë më fort nën ndikimin e stilit me ngjyrim administrativ shtetëror, si në gjuhë të tjera edhe në gjuhën tonë, siç do të shohim, mbizotëron përgjegjësi:

urdhër, **urdhër-porosi**, **urdhëresë**, **urdhërim**, **përudhëzim**, **përcaktim fati**, **leje veprimi eprorie nga i Gjithdëshmi dhe i Gjithëfuqishmi**, e të ngjashme.

III) DALLIMI DHE PËRKIMI SEMANTIK NË SHQIPE I FJALË-TERMAVE NË SHQYRTIM

Siç po shihet nga përkufizimet e mësipërme **emën a emër1 /emër2** kemi të bëjmë, jo me fjalë të karakterit sinonimik ose me kuptimësi të

përafërta, por, që nga zanafilla në shqipe, kemi të bëjmë me një homonimi formale me dallim kuptimor të një niveli të caktuar, më fort largues se afrues, ngase e para, trajta **emër1 (emën)**, si njësi leksiko-gramatikore a si fjalë e përgjithshme autoktone e shqipes, qoftë si term në gramatikë, qoftë si fjalë e rëndomtë emërtuese, ose me kuptim të figurshëm, nuk mbulon as pjesërisht kuptimin jo vetëm të termit kuranor me kuptim të gjerë si **urdhër-porosi, a qeverisje hyjnore** me detyrim moral të karakterit fetar ose në fushën filozofike (ontologjike), por as kuptimësinë e një procesi pune a të detyrave të punës **si term administrativ** siç del në të vërtetë, **emër2**, si fjalë e reflektuar aktualisht edhe në aktualitetin tonë gjuhësor.

Së këtëjmi, e shohim të nevojshme ta përforcojmë idenë tone me nja tri arsye si çështje, të cilat do të na i bëjnë më të qarta si dallimet e përkimet, qoftë edhe kontaminimin ose përzierjen kuptimore në përdorim konkret të fjalë-termit **emër2** (arab. *ämr, *el-emrun) të huazuar, në krahasim me fjalëtemrin e shqipes **emën** ose **emër1**, në përdorim të gjerë si kategori leksiko-gramatikore e semantike që emërton diçka tjetër e jo diçka që jep urdhëra të karakterit hyjnor ose që shpreh ndonjë dukuri a proces administrativ e shtetëror. Andaj për ta pasur çështjen më të qartë, do të përpiqemi që në këtë trajtesë me i bë më të qarta po këto tri çështje:

e para, si është reflektuar kuptimi i zakonshëm praktik i fjalëtermit **emër2 (*amr)**, rëndomë në gjuhë të tjera dhe në shqipe?

e dyta, në cilat burime dhe kryesisht në cilën trajtë e ndeshim të regjistruar ose me cilin barasvlerës e ndeshim të mbuluar konceptin e fjalëtermit **emër2** në gjuhën tone? dhe

e treta, trajta në shqyrtim, **emër2**, duke qenë e ngjashme ose e afërme për nga forma e shqiptimi me fjalën autoktone të shqipes **emër1** si mund të dallohen semantikisht, sidomos pas anashkalimit të trajtës gege **emën emnoj emnim** nga FGJSSH 1980, d.m.th. nga norma e sotme zyrtare e gjuhës sonë letrare?

a) Cili është reflektimi i zakonshëm i fjalëtermit emër2 (*el emr) në disa gjuhë të huaja si term administrativ dhe ndikim-përftimi i tij në shqipe

Si është reflektuar dhe reflektohet ky term, **emër2**, në gjuhë të ndryshme këtu nuk e kemi objekt trajtimi, por megjithatë, siç na dikton tema, ne konsultuam domosdo disa nga ato gjuhë, me cilat ka lidhshmëri ndërndikuese gjuha jonë. Kështu nga kjo arritëm në kostatimin që, jo vetëm

në trajtën shkrimore, por edhe atë shqiptimore fjalëtermi **emër2** (***emrun**) në gjuhët përkatëse del paksa me ndryshime të vogla, varësisht nga transkriptimi i sistemeve të ndryshme alfabetike, dhe varësisht nga natyra shqiptimore e gjuhës përkatëse, por me përcaktim kuptimor të ngjashëm, gjithsesi më të thjeshtëzuar, në krahasim me atë që u përpoqëm ta konceptonim ne si term kuranor. Sidoqoftë, pa kaluar te shembujt konkretë nga gjuhët që konsultuam, që do t'i japim fill pasi të cekim faktin se po mbi bazë ose nën ndikim të fjalëtermi kuranor *emër* (**ämr*) kanë dalë mjaft emra vetjakë si dhe mbiemra (patronime familjesh) ndër arabë si dhe te popuj të tjerë të botën islame. Po mbi këtë bazë janë edhe disa ndërkombëtarizma të mirëfilltë si:

emername; emir, emirat, admiral, emir-al-mumenin, emir-al-umara etj.

Madje, theksojmë të vërtetën se në fjalorë emrash (vetjakë) të gjuhës sonë, janë shënuar me dhjeta emra mbi këtë bazë në të dyja gjinitë, si:

Amir, Amërllah, Almir, Almer, Almero; Emir, Emire, Emri, Emrije Emrush, Emrushe, Emron, Emrit, Emrin, Emran, Emërllah, Emirshah etj.

Sido që të jetë, termi **emër** në terminologjinë kuranore që parësisht kishte të bënte me **strukturë sistemesh, qeverisje, rend, sistem, urdhërim** etj, ndërkohë, me sa kuptuam, në turqishten osmane kishte kaluar si term në administratën shtetërore dhe si rrjedhojë përdoret edhe sot. Së andejmi, edhe në gjuhën shqipe si në gjuhë të tjera në kontakt, si *serbisht, kroatishte* dhe *boshnjakishte* fjala me konceptin **emër2** del e specifikuar e gjalluese kryesisht për barasvlerësin:

urdhër, urdhërim, gjithsesi me ngjyrim komandimi - në kuadër të sistemit *administrativ (shtetëror, siç e pamë pak më sipër* edhe nga komenti i z. Orhan Bislimaj.

Po japim disa shembuj ashtu siç i ndeshëm në burimet përkatëse nga gjuhët e sipërcekura, por krahas barasvlerësve të tillë po shënojmë gjegjësin e përkthyer në shqipe prej nesh. Kështu, në turqishten e re b.f. trajtat: **emir** (emër) ka kuptimin *urdhër, emirname (yazili buyruk) - urdhëresë (urdhër me shkrim)*. Po ashtu në boshnjakishte: **emer (zapovijed/urdhëresë), emer allah (božja volja /vullneti i Zotit/)**. (Shih: A.Škiljan, *Turcizmi u srpskohrvatskom - hrvatskosprskom jeziku*, Sarajevo 1985, f.267. Në serbisht, sipas *RSHKJ 1* e ndeshim **emer** – turc. **zapovest (urdhër komande)**,

naredba (*urdhëresë*) dhe **odredba** (*dispozitë*), **emername** – **pismena zapovest** (*urdhër-komande me shkrim*). Në kroatishte **emer** - **zapovijed** (*urdhëresë*). (Shih: B.Klaić, *Veliki riječnik stranih riječi*, Zagreb 1968 f.352).

Së këndejmi edhe në shqipe, siç do ta argumentojmë në pikën vijuese trajta "**emër2**", del e përdorur kryesisht me kuptim të njëjtë ose të ngjashëm si tek gjuhët e cekura më sipër, qoftë si huazim transfer, qoftë edhe i përkthyer.

b) Trajta e fjalëtermit emër2 dhe barasvlerësit në shqipe sipas burimeve përkatëse

Pra, si në gjuhë të tjera edhe në shqipe, siç u cek, pak më sipër, fjalëtermi **emër2 (emer)** ka gjetur barasvlerësi më të përafërt, pikërisht me fjalën: **urdhën** me derivate. Këtë fakt po e dokumentojmë, si më poshtë:

1. Nga Fjalori i "Bashkimit"

Në Fjalorin e "Bashkimit" (1908) shkrimisht dallohen qartë kuptimet e fjalëve në shqyrtim, ashtu siç i shënuam ne, veç e veç. Kështu si barasvlerës për fjalën e shqipes: **emën1** në italishte jepet përgjegjësi: **nome**, ndërkaq për trajtën e huazuar nga turqishtja. **emër 2** jepet sinonim shqip **urdhën** dhe barasvlerësi italisht **comando** e **ordine** dhe për **emername** jepet po ashtu në shqip **urdhën** italisht **decreto**. (Shih Fjalori i "Bashkimit" Prishtinë 1978 f.102.)

Po te ky fjalor, në zërin përkatës shënohet prejfoljori **urdhënim** (urdhën/urdhënoj), për të cilin në italishte jepen barasvlerësit: **comandamento** e **precetto**, fjalë këto, sidomos e para del paksa më e specifikuar se të tjerat për të shprehur "*urdhërat*" *fetarë*, të cilët më fort kuptohen si ligje moralizuese ose si *detyrim moral*, ashtu siç e pamë dilte edhe përkufizimi i termit kuranor **emër (*emrun)**, sigurisht jashtë sferës obliguese të stilit administrativ shtetëror, apo jo?!

Së këtejmi për me qenë edhe më të qartë, duke u kapur pas fjalës **ordine**, përkatësisht **orde** (urdhër, rend) të latinishtes mund të themi se edhe në gjuhë të tjera rëndomë barasvlerësit përkatës që i përgjigjen këtij koncepti janë:

it. ordin/amento (comandamento), fr. ordre, gjerm. Ordnung (Behfehl), angl. order etj.

Jo vetëm sa për kërshëri, por edhe për arsye të tjera po e cek faktin se në Fjalorin e F. Bardhit (1635) pos barasvlerësisë: **ordo - urdhën**, del edhe trajta **urdhënim**, fjalë kjo, e cila del e ngarkuar për disa barasvlerës të gjuhës latine, siç janë: *imperatum, mandatum, praeceptum, regula, scitum* dhe *decreto*. (Shih: F.Bardhi, Fjalor latinisht-shqip (1635), Prishtinë 1983, f. 380.)

Këtë fakt po e theksojmë me qëllim për të sugjeruar mundësinë e favorizimit si koncept barasvlerësie për **emër2 emërim** trajtën **decreto** si ndëkombëtarizëm (stili administativ) dhe vendësen **urdhënim (urdhërim)** në kuadër të barasvlerësisë përkatëse në shqipen e sotme në stilt të rëndomtë, trajtë kjo që mund të integrohet për ndonjërin nga konceptet semantike që mund të dalë nga zberthimi i fjalë-termit **emër2** (*emer) që po trajtohet këtu, si fjalë e huazuar por ndërkohë thellësisht e përvetësuar.

2. Nga Komisia Letrare Shqipe në Shkodër

Në **Lajme 1** të Komisionit Letrare Shqipe në Shkodër më 1917, si term për gjyqe e administratë si barasvlerës të termit **emër** të turqishtes në shqipe u shënuan dy trajta: **urdhën** dhe **urdhënim**. (Shih T.Osmani, *Shekulli i KLSH* në Shkodër, Tiranë, 2016. f. 227)

3. Nga Mevludat në gjuhën shqipe

Në 20 mevludat që konsultuam (Shih: *Mevludet në gjuhën shqipe*, “Camaj-Pipaj”, Shkodër 2002) ndeshim jo pak shembuj ku dëshmohet përdorimi i fjalës **emën** ose **emën1**, por edhe **emër2**, madje mbi këtë bazë mësojmë sadopak edhe për shtrirjen e fjalëtermit **emër2** ndaj **emën** ose **emër1** në dialekte e të folme të caktuara të shqipes. Mirëpo, ndërsa në shkrimet e përkthyesve ose të mavlud-hartuesve gegë këto dy fjalë konceptualisht dallohen lehtë, kryesisht kjo kuptohet nga trajta shkrimore **emën/emër**, në shkrimet toskërisht për shkak të homonimisë (homofomës shkrimore e shqiptimore) konceptet **emër1/emër2** mund të dallohen vetëm nga ana kontekstore.

Këtë dukuri po e ilustruam konkretisht me ndonjë shembull.

Shembuj nga mevludat në gjuhën shqipe

a. Teksti gegnisht, ku dallimi del qartë nga forma shkrimore:

a) me trajtën **emën:**

Zotynë përmendi 28 **emna** pejgamerësh - **Emni** i tina (duhet) me u përmendë... Me **emën** t'Madhit tash po filloj... E shkrova **emnin** tem me **emnin** tand. **Emnin** Emin vet populli ia ngjiti etj.,

b) me trajtën **emër2**

Xhebrailit bani **emër** ai Dhylxhelal, Me **emër** të Zotit bahet gjithçka. Me **emër** të Zotit... Pruni **emer**, Jashtë **emrit** të Muhametit mos me dale. Zoti pa ba **emër** s'bin as një fije bar. **Emri** i Zotit refreni vjen... Banu gati bani **emër** Zoti hak.Me **emrin** e Zotit prap u përcoll. Filloj rrugën me **emrin** e të madhit Zot, **Emrin** e Zotit në vend çoje i tha, Perëndia **emër** ashtu kishte ba. Për një çast gjithçka bahet me **emrin** e Perendis ... etj.

Sa më sipër, si konstatim i përgjithshëm del (po përsërisim) se nga autorët gegë dallohen shumë lehtë kuptimet sipas trajtave: **emni i Zotit** ndaj **emri i Zotit**.

Këtu sa për kërshëri, po cekim faktin se numerikisht Hafiz Islam Çelebiu si dhe Hafiz Ali Ulqinaku, e kanë përdorur këtë fjalë-shprehje (emri i Zotit) mëse 10 herë. Madje te H. Ali Ulqinaku, ndeshëm dhe emrin në trajtën: **Zat**, pastaj **biemër** (mbase për mbiemër!) si dhe shumësin **emeret(?)**.

b. Teksti toskërisht, ku dallimi del vetëm nga ana kontekstore:

a) Me trajtën **emër1:**

Bismilahi me **emrin** tat, Dëgjova një **emër** Muhammed, Mori **emër** Muhamed, Pranë **emrit** të Zotit u shkrua **emri** i Pejgamberit. Me **emër** të Ra(h)manit...Allah **emri** i Zotit sefte të kujtohet. **Emrin** e Zotit kujtoni më parë, Ah sa mire or vëlla **Emrin** e Zotit kur e thua ...etj.

b) Me trajtën **emër2:**

E bëri **emër** Allahu; Gjer erth **emri** i Zotit; U krye **emri** i Zotit;
Me emër të Hakut.
Emër bëri Zoti për ty këtë herë...etj.

c. Shembuj jo të qartë kontaminues ose me kuptim alternativ:

Ndeshëm ndonjë shembull, ku logjikisht trajta përkatëse e fjalës **emën** ose **emër1 /emër2** mund të interpretohet alternativisht, p.sh.:

Me emën !? (*me emër*)/ të Tij vdes e ngjallet çdo gja. Kujtoje dhe kuptoje **emrin**!(?) e të madhit Zot?! . Lexo *me emrin* e Zotit (!?) /Lexo *në emër* të Zotit(!?).

Është interesant se te rastet kur teksti është adaptuar në normëzimin aktual (në standardin e sotëm) trajtat **emër1(emën) e emër2** ngjan të ngatërrohen më tepër se në origjinal, andaj edhe kontaminimi semantik nuk mungon, edhe pse një përzierje të tillë (lapsuse) ndeshim edhe në ndonjë nga fjalorët gegnisht të botuar para FGJSH 1954.

4. Nga “Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare”

Nga libri "*Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*", Prishtinë 1978, po i veçoj këto dy raste:

- 1) Dogërllekun jam tue ndiekë/ *N'emër të Zotit s`ka me të gjetë* (Aty f. 171) dhe
- 2) Mos m`u bafsh asqerit konak/ *Kam emrin me jav marrë grat...* (Aty f. 71).

Po në këtë burim në faqen 349, për këtë fjalë me prejardhje të huaj jepet sqarimi: *emër* - "*urdhër, vullneti i perëndisë (emri i zotit)*."

5. Nga Fjalori i H. Bariqit

Prof. Henrik Bariqi si barasvlerës të fjalës **naredba**, veç fjalës **urdhën, urdhënesë**, nën *2.adm.* shënon edhe trajtat: **embër dhe embrëname**, por prek edhe nocionin hyjnor (**emër2**): **obnarodovati naredbu –me përpallë (shpallë), me dhanë embër, narediti – me ba embër, me dhanë urdhën (Aty f. 507)**, me të cilën faktohet se fjala **emër2** kishte shtrirje e njihej gjithandej dhe nuk shënohej përherë njësoj në të dy profilet semantike (edhe si term administrativ, edhe si term kuranor: revelatë (përpallje shpallje).

Kështu mund të themi se në këtë burim kuptimi **emër2** del më i plotë se në çdo burim tjetër.

6. Nga revista Takvim (1997)

Edhe në doracakun "Takvim" (Prishtinë 1997), kjo fjalë kuranore në shqipe del e shënuar në trajtën emër dhe sqarohet me barasvlerësin urdhër. (Shih aty f. 70 e 84.)

7. Nga Fjalori i M. Elezit

Në Fjalorin e Mehmet Elezit del **emër** (ar. turc.) **urdhër, porosi**, ku ndeshim edhe shprehjen: *Me emër të Zotit vjen sot.*

Siç po shihet në të gjitha këto burime kryesisht del trajta **emër2**, por, siç u tha zëvendësohet me trajtat barasvlerëse **urdhër, urdhëresë**, por përdoren edhe trajta të tjera sinonimike, si: *porosi, leje, vullnet, udhëzim*, e ndonjë tjetër.

c) Në cilat burime normative të shqipes së sotme shihen reflekse kontaminimi të fjalëtermave në shqyrtim emër1 dhe emër2

Edhe pse, siç e pamë në Fjalorin e Bashkimit si dhe në atë H. Bariqit, si dhe në shumicën e rasteve në Mevluda etj., koncepti i fjalëtermit **emën**, që ne po e shënojmë edhe **emër1** me atë të stilit hyjnor ose administrativ që ne po e shënojmë **emër2**, dallohej qartë, mirëpo, me sa pamë si b.f. edhe në Fjalorin e Sokol Dobroshit e burime të tjera me trajtën **emën emnim** ngërthehej edhe nocioni i dekretimit **emër2(!)**.

Mirëpo, ç'është e vërteta, pasaktësitë e tilla nga faktet që u sollën më sipër, nuk mund të mohojnë ekzistimin e fjalës **emër** me kuptimin **emer2** si sinonim i fjalës **urdhën urdhënoj urdhënim** ose **dekret, dekretoj, dekretim**, qoftë nga gjuha e shkruar, qoftë nga ligjërimi popullor. Madje nuk mund të mohohet dot, as e vërteta që një dukuri e tillë nuk është sqaruar si e tillë pas LDB-së në asnjërin nga burimet tona teorike normëzuese. Megjithatë, me sa pamë, në FGJSH 1954, reflekton drita e arsyes, sepse aty dallohen paksa konceptet, respektohen në të shkruar të dyja nocionet. Në fakt, aty fjala **emër** sipas kuptimit **emër2** nuk del e shënuar fare si fjalë më vete, por aty, del e shënuar folja **emëroj**, vetëm për konceptin **emëroj2**, të cilës i mungon fjala temëprodhues **emër** me konceptin **emër2**. Madje po aty ndeshim, prejfoljorët: **emërim, të emëruarit**, të cilët nuk dihet cilës folje i takojnë: **emëroj1** apo **emëroj2**, edhe pse në fakt më shumë kanë të bëjnë me kuptimin **emëroj2**, ngase aty del e shënuar **emnoj**, në trajtën gege me përkufizim - sqarimin:

mos e emno, *mos e zë në gojë me emër*,

çka nënkupton se kjo trajtë **emnoj** është formim prejëmëror nga trajta **emën** dhe njëherazi nënkuptohen edhe prejfoljorët mbi atë bazë: **emnim, të**

emnuemit që i takojnë pra konceptit **emër1**. Në të vërtetë si sinonim i trajtës emnoj nën 2. aty del trajta **emëroj**, e cila, edhe pse si formim i rregullt nga tema prodhuese **emër**, siç u cek, si sinonim kuptimor për përkufizimin që i jepet trajtës **emnoj**, ku, si e tillë, del e panevojshme fare, ngase, në fakt nuk qëndron si sinonim zëvendësimi dhe kështu një prani e tillë aty, krijon ngatërresë kontaminie, me pasoja, por kjo më mire do të kuptohet, pase sqarimit të konceptit të trajtës:

emnoj me emnue emnim /i emnuari, të emnuarit?/

që do ta bëjmë pas sqarimit ndërmjetës të mëposhtëm, sqarim ky që si fakt është i nevojshëm që nga dikush nga intelektualët tanë të njihet e nga dikush tjetër vetëm të rikujtohet.

Në të vërtetë, atëbotë, pas LDB-së, rrethanat shoqërore-politike në Shqipëri, ishin të tilla, kur edhe në hartimin e fjalorit normativ edhe pse hartues ishin 4 gegë dhe vetëm një toskë (E Çabej) duhej vepruar sipas *direktivave* të ravijëzuara që më parë (1952), kështu që **me emrin e ...** (Partisë dhe të Pushtetit), **Fjalori i gjuhës shqipe (1954)** duhej hartuar dhe përfunduar domodo mbi bazë të dialektit toskërisht, fakt që tregon edhe ky citat i nxjerrë nga *Parathënia* e këtij burimi:

Fjalori, ... është punuar në bazë të toskërishtes: përkufizimet janë shkruar toskërisht e janë vënë zakonisht në fjalët e në trajtat toskërishte.

Por megjithatë e quajmë shumë me mend rastin aty kur përkundër faktit siç u tha më sipër se politikisht e institucionalisht në mënyrë arbitrare norma e bazës së mëparshme ishte shfuqizuar dhe tashti mbizotëronte baza e re toskërishte, aty del e shënuar në zëri të veçantë, siç e pamë, folja gege **emnoj**, ngase hartuesit mendjendritur, përkundër *urdhër-vendimit* administrativ të nënkuptuar (direktivës partiako-shtetërore) për anashkalimin e gegnishtes, ata në mënyrë dinake (siç e thotë prof. A. Pipa) sadopak u përpoqën me i riejtë në standard disa trajta të gegnishtes, për koncepte të pambuluara me mjete të toskërishtes, pasuri kjo e pakompenzueshme, dhe ja si arsyetoheshin:

Format e gegërishtes, për të mos e ngarkuar shumë vëllimin janë dhënë vetëm në rastet kur ka ndonjë ndryshim kuptimi a për fjalët më kryesore, për të tjerat jo.

Dhe pikërisht për “**ndryshim kuptimi**” ose për **mosmbulesë koncepti** hartuesit e fjalorit edhe pse mbi bazë toskërishte i lanë të paprekura disa trajta të gegërishtes si **emnoj** e ndonjë tjetër, pra për ato koncepte që edhe sot, as trajta **emëroj1** as ajo **emëroj2**, siç do të argumentohet në këtë punim, **nuk i mbulojnë dot**. Në të vërtetë, mbi bazë të foljes **emnoj**, sipas fjalëformimit

gegë aty dalin edhe fjalët: *emnesë*, *emnore* dhe *emnues*, kurse mbi bazë të konceptit të trajtës *emër1* (toskërisht) dalin: (listë...) *emërore* dhe *emërtim* (mbështetur nënkuptueshëm nga folja *emërtoj*, e cila mungon).

Pra lëshimi i parë ose kontamini i parë në fjalorin shpjegues normativ ka ndodhur vetëm paksa në FGJSH 1954, kur trajta emër nuk është shënuar në dy zëra të ndarë, siç po e propozojmë dhe po e praktikojmë ne në këtë punim: **emën** ose **emër1** veçmas nga **emër2**, ku:

zëri i parë: emën ose **emër1** – do të përfshinte: a) **emnoj me emnue emnim**; b) **emërtoj (me emërtue) emërtim, emërzoj (me emërzue), emërzim etj. etj.** me përkufizimet përkatëse dhe

zëri i dytë: emër2 – 1. fet. Me emër të Zotit dhe 2. adm. (Me emër të pushtetit) emër emëroj emërim, gjithsesi të liruar nga koncepti i fjalës **emën** ose **emër1** dhe prejfoljorëve të prejardhur mbi atë bazë.

Nuk dimë është diskutuar, apo jo, ky problem kontaminues nga hartuesit, por është shumë pozitiv fakti që ata (hartuesit e fjalorit FGJSH 1954) e dëshmuar të vërtetën se me trajtën e toskërishtes **emëroj1, emërim** nuk mbulohej nocioni që shprehej me trajtën e gegnishtes **emnoj me emnue emnim**, prandaj edhe lejuan trajtën gege, sepse pa të mbetej e zbrazët kutia semantike për këtë pikë të standardit të emëruar (rekomanduar), ngase konceptet e tilla nuk mbulohehin dot me mjetet e toskërishtes.

Mirëpo, në vend që fjalë-trajtat e tilla si folja **emnoj**, me çerdhet e veta fjalëformuese të sforcohej dhe të pasurohej edhe më tej njëzimi i standardit të gjuhës shqipe me trajtat e tilla pa dëmtuar përparësinë e bazës së toskërishtes, hartuesit e FGJSSH 1980 (shumica emra të rij) me në krye prof. A. Kostallarin, pa i plotësuar konceptet e tilla, të foljeve më **-NOj** si, *trimnoj, burrnoj, zotnoj, pleqnoj* etj, pra edhe **emnoj**, mbase pa i ditur rrjedhojat, vajtën më tej në *thjeshtësimin partizançe* të trajtave gege dhe kështu, siç po duket tashmë dritë me diell, shkaktuan varfërimin e standardit të shqipes globale, duke e ntrashur e ngjizur pa dyshim edhe kontaminimin që kemi në shqyrtim. Me një veprim të tillë të nxituar ata varfëruan normën letrare, jo pse toskëzuan trajtat paralele *emnore* në **emërore** (rasë) si dhe *emnues* në **emërues** (term në matematikë) nga FGJSH. po pse e hoqën trajtën **emnoj**, të cilës faktikisht, për atë koncept, nuk i gjetën zëvendësim fare, ngase folja **emëroj**, pasi ishte e zënë për koncept tjetër dhe foljet e tjera sinonimike s'mund ta mbushnin atë zbraztësi, andaj koncepti i foljes **emnoj** (me çerdhën përkatëse të natyrshme fjalëformuese) mbeti kuti e zbrazët. Në të vërtetë, nga

fondi i fjalëve në FGJSH 1954 mbi bazë **emën** e lanë të paprekur vetëm trajtën *emnesë*, të cilës i shtuan edhe emnin *emnak*.

Sigurisht homonimia (homoforme) e fjalës **emër2** (**amrun*) me fjalën shqipe **emër1** që u krijua ose u ngjiz keqas edhe më tepër sidomos në shqipen letrare të njësuar pas viteve '72), kur u lanë jashtë norme trajta të parotacizuara gege: **emën emnoj (me emnue), emnim**. Kështu, u la pa u mbuluar koncepti si rasti që po shqyrtohet këtu, por u shkaktua edhe bllokadë fjalëformuese mbi atë bazë, gjë që rrjedhohet e tilla sot janë gjithnjë e më të vërejtshme.

IV. ÇFARË DUHET NDËRMARRË PËR ZGJIDHJEN E KËSAJ ÇËSHTJEJE?

Në mënyrë që opinion i gjerë, ashtu si edhe studiuesit ta kenë më të qartë këtë problematikë ne e shohim të arsyeshme të ndërmerren këto veprime:

e para, të bëhet rishikimi dhe përplotësimi i detajuar i përkufizimit të koncepteve të fjalë-termave në shqyrtim;

e dyta, të bëhet domosdo rishikimi dhe harmonizimi i barasvlerësisë si brenda gjuhën sonë ashtu edhe në krahasim me gjuhë të huaja dhe

e treta, të formulohet konstatimi përmbyllës me theks dallimet e koncepteve dhe mbulimi i tyre sipas specifikimit të trajtave në shqyrtim.

1. Rishikimi dhe përplotësimi i detajuar i përkufizimit të koncepteve të fjalë-termave në shqyrtim

E shohim të arsyeshme, lexues i nderuar, tash fill që edhe më saktësisht të shpjegojmë kontaminimin ose dëmin e shkaktuar nga mosrespektimi i zgjidhjes së dhënë paksa në FGJSH 1954, duke përkufizuar:

së pari, konceptin e fjalës **emnoj** krahas **emëroj1** (në dy versione) dhe së dyti, konceptin e fjalës **emëroj2** (në dy fusha semantike).

A) Konceptet e fjalës emnoj dhe emëroj1

Pra, cilat koncepte nuk i mbulonte dhe nuk i mbulon as sot trajta **emëroj1** për shkak të homonimisë me trajtën **emëroj2**, të cilat i mbulonte dhe i mbulon për mrafekulli trajta **emnoj emnim**.

1) Disa shembuj, konceptet e të cilëve shprehen me trajtën emnoj:

- a) Emër (*emën*) -fjalë me të cilën **emnohet** fëmija i posalindur,
emnohet nofka,
emnohet mbiemri.
emnohen kandidatët.
- b) Me këtë trajtë emnohen shprehjet, si:
- emnimin me gojë e kemi kryer tash ju vendosni radhitjen në listen emërore,
 - me emnue cili do të jetë ulur kryevendi (te oxhaku(!)),
 - \- e emnova (e përmenda) për të mirë
 - e emnoj – e thërras (e quaj) me emër,
 - emnoji tre të parët,
 - emnoji dy të fundit që referuan,
 - emnoji emër për emër,
 - mos e emno po më trego me gisht, me sy ose me shtrëngim dore, cili është me atë emër që duam ta njohim;
- c) sot emnohet, (pagëzohet!), d.m.th. sot i vihet emri, sot po vendoset emri i tij.
- ç) Janë *emnue (nominuar)* tre kandidatë, por nuk dihet cili do ta marrë *emërimin*. *Emërimi vjen pas numrimit të votave dhe pasi zyrtari ta lëshojë (zyrtarizojë) shkresën e emërimit (mbi emërimin)* etj.

Pra me trajtën **emëroj1, emërim etj.** nuk mund të mbulohen konceptet: **emnoj, pika 1) a. b. c. ç**, përkatësisht trajtat **emnohet, u emnue, emno, mos e emno etj.**, madje as koncepti i fjalës së huazuar **nominoj (nominim)** (*me emnue, emnim*).

Së këndejmi, kërkohet që në standardin e rishtë të gjuhës shqipe të inkorporohet kjo zgjidhje, pra me elemente të trajtës geqe: **emnoj, me u emnue, emnim** në vend ose në sinonimi me fjalën e huazuar: **nominoj, me u nominue, nominim**. Dhe kështu standardi të pasurohet, duke i rikthyer në vendin që u takon këto trajta të gegnishtes.

Këtë po theksojmë në mënyrë të veçante, ngase kjo zbraztësi ekzistuese nuk del e hetuar (e mbuluar) pothuaj në asnjërin nga fjalorët dygjuhësh si dhe

ata normativë përshkrues të botuar kohët e fundit, madje as në *Fjalorin themelor...* të Pavli Qeskut (Tiranë 2012), edhe pse aty janë futur (legalizuar) mjaft prurje barasvlerëse të gegnishtes.

2) Disa shembuj, konceptet e të cilëve shprehen me trajtën emëroj1

Fjala me konceptin **emër1 (emëroj)**, në letrarishten e sotme përdoret:

1. për këto koncepte:

a) listë emërore,

b) emërembiemër

c) fig., emër i njohur,

ç) fitoi emër të mire;

d) mund të ndër këmben joqortueshëm, sipas normës së situatës: **emën** ose **emër1**, edhe në shprehjet e ngurosura që ndeshëm në mevluda, si: *Njëherë me zemër emnin (emrin!) e Zotit me thanë / Rrxon gjynah sa dushku i malit shumë me kanë etj.*

2. Përdoret si bazë fjalëformuese për foljet me –O – të zgjeruar, më –TO dhe më –ZO:

a) emërtoj, emërtim (vënie emri gjësendeve etj.);

b) emërzoj, emërzim (formëzim emri nga një mbiemër etj.).

Vërejtje.- Edhe pse edhe trajta e njëjtë mbi bazë **emën** (gegnisht) mund të kryejë të njëjtin funksion për të gjitha konceptet e shprehura si më sipër me *emër1*, siç ngjan në të folmen e përditshme ndër gegërishtfolës, ne mendojmë se për rastet e tilla, sidomos *emërtoj emërzoj* etj., gjithsesi s'ka arsye mos të respektohet norma e letrarishtes së sotme, apo jo?!

B) Koncepti i fjalë-termimit emër2

Koncepti i fjalës **emër2**, shtrihet në dy fusha: a) si term kuranor dhe b) si term i stilit administrativ shtetëror, andaj sqarimin tonë po e japim në dy pika:

1) Emër emëroj2 si fjalë-term kuranor (*el emrun)

Edhe pse rreth kuptimit të fjalë-termimit **emër** (***al-emrun**) si term kuranor hasëm në pyllnajë konceptesh, ngase ajo fushë kuptimore nuk dilte e përkufizuar qartë, si duket kështu ndoshta ndodh edhe në gjuhën origjinale, sidoqoftë, ne për konceptin **emëri (i Zotit)-term kuranor** - veçnam disa barasvlërës:

përpallje, shpallje hyjnore, rend, qeverisje, strukturë sistemesh, sistem, udhëzim hyjnor, paracaktim, udhërrëfimi, rregulli, fat i mëparëcaktuar, porosi, urdhërim etj.,
që sadokudo u përpoqëm të sqarojmë më sipër.

2) Emër emëroj2 në stilin administrativ

Ndërkaq, si fjalëterm kryesisht në stilin administrativ (shtetëror) koncepti **emër2 emëroj emërim** mund të përkufizohet:

a) si veprim i autoritetit pushtetor si: urdhërdhënës përmbarues, koncept ky, i cili varësisht nga konteksti mund të mbulohet me disa barasvlërës sinonimikë, si: **caktoj (përcaktoj), vendos për..., rregulloj me...jap urdhër, urdhëroj, dekretoj etj.**

b) *Ja disa shembuj konkretë:*

- emërimi ose caktimi në vendin e punës;
- emërimi i një nëpunësi.
- emëroj- i jap nëpunësi një tjetri,
- emëroj - e ngarkoj me një punë zyrtare;
- emërohem – marr një nëpunësi ose autorizohem të emëroj dikënd në...
- emëroj- i jap detyrë nëpunësie dikujt,
- e emëruan drejtor (mësues, llogaritar etj.
- me emërim (urdhër zyrtar (dekret) është vendosur rasti i punësimit të

tij

- emëroj dikënd në një punë a në një detyrë zyrtare; kund. çemëroj
- emërohem për të kryer punë a detyra të caktuara

c) **emërim** - quhet *shkresa zyrtare (vendimi, dekreti, urdhëri zyrtar) që njofton dhe vërteton se dikush:*

mori emërimin (vendimin me shkrim) për atë *vend pune, iu dorëzua dekreti (emërimi) për atë pozitë.*

Jo vetëm te profili i konceptit nën 1, **emër2 si term kuranor**, ku ndër të tjera konsatojmë që si barasvlërës i atij koncepti në shqipe dilte edhe emri *përpallje (shpallje hyjnore)* që jo vetëm ky po asnjë shembull tjetër nuk kishte

të bënte fare me konceptin **emën ose emër1**, siç e pamë në analizën e pakmësipërme, por, siç po shihet, as barasvlerësit e profilimit të konceptit nën2, **emër2 në stilin administrativ, pikat a), b) c)**, siç janë shembujt barasvlerës sinonimikë: **urdhëroj, jap urdhër, emëroj** etj., përkatësisht, **bëj emërimin, lëshoj vendimin (emrimin) dekretin, urdhëresën, përmbartimin** etj. nuk ka të bëjë fare me konceptin *emën ose emër1*, po kemi të bëjmë me një veprim, me një proces, kryesisht në punë administrative (shtetërore).

Së këtejmi del se dallimi i kontaminimit në raportin **emën ose emër1**, ndaj **emër2** i shkaktuar dhe zhvilluar pa kontroll fare, tashti është shumë lehtë për ta kuptuar dhe për ta zgjidhur në gjuhën e shkruar, sidomos pas këtij konstatimi dhe kthjellimi që u përpoqëm ta japim me këtë sqarim. Dhe si përpjekje e parë e zgjidhjes le të shërbejë nisma që po japim në vijim.

2. Rishikimi dhe harmonizimi i barasvlerësisë në gjuhën tonë dhe në krahasim me gjuhë të huaja i domosdoshëm

Në mënyrë që kërkesa e fundit të jetë edhe më e qartë dhe më funksionale, më poshtë po përpiqemi të përgjigjemi në këto dy pyetje:

a) ku shënohen barasvlerësit e nocionit **emën emnoj me emnue emnim**, dhe

b) ku shënohen barasvlerësit e fushës semantike të konceptit **emër2: emëroj emërim**.

Të vihet re fakti se shembujt nga pyetja ose pika a): **emnoj, emnim**, sipas letrarishtes së sotme i takojnë fushës semantike **emëroj1**, trajtë kjo, e cila faktikisht pa lënë gjë keq nuk shënohet fare edhe prej nesh, sepse, siç është konstatuar disa herë më parë, atë trajtë nuk e lejon t'i konkurrojë trajtës së gegnishtes vetë formë-koncepti i nocionit nga pika b), **emër2, emëroj emërim**, e cila, siç do të shohim tash fill, te shembujt më poshtë në gjuhë të ndryshme ka prani të mirëdukshme.

Shembuj në disa gjuhë

Të shohim pra në:

1. turqisht:

- a) emën ose emër1: ad- **adlandirmak** (*emnoj*); **isimfili** (*emërfolje* ose *paskajore*);
- b) emër2: **emir** (*urdhër*), emirname (*dekret, urdhëresë*), **emir vemek** (*jap urdhër*); **atamak atanmak** (*emëroj emërohem*).

2) anglisht:

- a) **nominare** (*emnoj*) **nomination** (*emnim, parashtrimi i emnit* (Mann));
- b) to **appoint** (*emroj*), **appointment** (*emrim*), **by order of...** (*me urdhër(emër)të...*); **to obtain an appointment in a school** (*marr emrimin në një shkollë*).

3. frengjisht

- a) **nommer, ordiner** (*emnoj*) **nomination** (*emnim*) ;
- b) **assignation, order** (*urdhër*), **affecter, desinjer** (*emëroj*), **comandament, ordination** (*emërim*).

4) italisht:

- a) **nominare** (*emnoj*) **denomazione** (*emnim*); **don il noma** (*me emnue*)
- b) **determinare** (*emëroj*) **determinazione** (*emërim*). **decreto, ordinanza** (*emërim*)

5) serbisht:

- a) **imenovati** (*emnoj, me emnue*), **imenovanje** (*emnim*); **kazivati ime** (*me tregue emrin*), **novoditi po imenu** (*emnoji emër për emër*).
- b) **postavljati** (*emëroj*) **postavljanje** (*emërim*); **-namesti u neku sluzhbu** (*caktimi (emrimi) në ndonjë shërbim*);
-izabrati radi vrshenja kakve duzhnosti (*të emëruarit (emërimi) për të kryerë ndonjë detyrë*).
- uzdici u neki položaj (*të emëruarit (emërimi) në ndonjë pozitë më të lartë, avancim pozite*).
- c) **Postavljanje na random mestu prevodioca** – *Emërimi në vendin e punës përkthyes*.

Si rrjedhojë, pas kësaj vërejtjeje del e nevojshme të bëhen përmirësime (plotësime), së pari, siç u tha, në fjalorët tanë përshkruar normativë, pastaj

në të gjithë fjalorët dygjuhësh, por gjithsesi këto duhet bërë menjëherë sipas realitetit gjuhësor, por është mire me pasë edhe bekimin e institucioneve kompetente, apo jo?.

3) Konstatim përmyllës me theks dallimet e koncepteve dhe specifikimi i trajtave në shqyrtim sipas fushave semantike

Nga nëntitulli i mëparshëm u pa qartë edhe specifikimi i trajtave të caktuara sipas nënfushave semantike, kështu:

Së pari, trajta **emnoj me emnue, emnim** sipas pikës **nën A):1), a),b),c),ç).**, si dhe nën pikën a) sipas gjuhëve përkatëse, d.m.th., trajta: **emnoj me emnue, emnim** përdoret në nënfushat e tilla semantike, koncepte këto që nuk dalin jashtë të të cekurit të emrit të përgjithshëm si njësi gramatikore, ndërkaq trajta **emëroj1**, ka fushë të lirë përdorimi vetëm sipas pikës **nën A): 1.,a),b),c),ç),d)** që nuk prekin fare nënfushat e sipërcekura të trajtës **emnoj**. e cila në ish shqipes letrare mbi bazë të gegnishtes i mbulonte plotësisht edhe po këto nocione.

Së dyti, koncepti i fjalës **emër2**: 1) si term kuranor dhe 2) si term i stilit administrativ shtetëror, gjeti shtrirje po në këto dy fusha semantike, të cilat assesi nuk preken nga nocionet e trajtave **emnoj ose emëroj1**, sepse ato kishin të bënin vetëm me përmendje emni a emëri, por jo me koncepte veprimi. siç është emërtimi i proceseve që mbulojnë sinonimet e trajtës **emëroj2 emërim**, siç janë: *dekretimi, detyrimi, rregullimi, urdhërimi, (për)caktimi, porosia* etj., që duhen zbatuar lidhur me punët e detyrat e caktuara etj. Theksojmë se për këtë fushë semantike del e specifikuar me u përdorë, pra, vetëm trajta **emëroj, emërim**, sipas nocioneve **nën B) 1. dhe 2. a), b), c).** ashtu siç është përkufizuar në nëntitullin më sipër, si dhe te shembujt **nën b).** sipas gjuhëve përkatëse.

Si përfundim për rastet e pikës së parë të normëzuara me trajtën **emër1, nën A): 1.1),a),b),c),ç),d)**, edhe pse mund të zëvendësohen pa lënë gjë keq me trajtën e gegnishtes **emnoj**, nuk kërkohet rikthimi ose përdorimi paralel i trajtave geqe me pestigj norme, por kërkohet me imponim detyrimi që t'i kthehet prestigji i normëzimit trajtës geqe (**emën**) **emnoj me emnue emnim** për konceptet **nën A) 1. a), b), c) ç)**, sepse kuptimisht janë të pambuluara nocionet e tilla, qoftë për shkak të sinonimisë jo të plotë ofruese, qoftë për mungesë të mjeteve adekuate të letrarishtes së sotme, ngase trajta **emëroj2**,

kuptimisht e formalisht pamundëson që trajta *emëroj1* të zëvendësojë nocionet e trajtës **emnoj**.

S`do mend se fjalë-termi kuranor **emer2** (***amr**) duhet të njihet më në hollësi sa është e mundur, të kristalizohet më mirë përdorimi i tij në kuadër të kuptimit leksikor që mbulon në gjuhën tonë dhe të shënohet veçan, qoftë në fjalorët përkatës normativë e të tjerë, qoftë në fjalorin profesional të terminologjisë fetare në përgjithësi dhe të terminologjisë islame (kuranore) në veçanti dhe së këtejmi në fjalorin përkatës të ndërkombëtarizmave të gjuhës shqipe gjithsesi, por pse jo edhe në fjalorin përshkrues normativ. Nuk dime arsyen pse ky term (kuranor) nuk është përfshirë as në fjalorin e akademik E.Murtezait. (Shih: Prof. dr. Ekrem Murtezazai, *Fjalor i feve*, Rilindja, Prishtinë 2000.)

Së këtejmi del e domosdoshme që ky fakt, dallimi i fjalëtermave në shqyrtim, të respektohet gjithsesi në realitetin tonë si në gjuhën e folur, si në gjuhën e shkruar, po ashtu të sendërtohet edhe në burimet normëzuese të shqipes standarde.

Përfundim

Kështu, pra, pa marrë parasysh se në gjuhë të ndryshme, mund të ketë zgjerime ose ngushtime fushash kuptimore, në shqipe për fjalë-trajtat në shqyrtim patjetër duhet respektuar kriteri që u praktikua në këtë punim:

1) Nocioni që ka të bëjë ekskluzivisht me fjalën **emën ose emër1**, si fjalë autoktone assesi nuk duhet ngatërruar me nocionin **emër2**, qoftë si term kuranor: arab. ***el emrun (emri i Zotit)**, , qoftë si term i stilit adm.: turq. ***emër**” (**emri i pushtetit**) prej nga në shqip: **jap emër (jap urdhër): emëroj, emërim**, ngase këto fjalë njëra autoktone tjetra e huazuar kanë origjinë të ndryshme ashtu edhe mbulojnë fusha kuptimore krejtësisht të ndryshme.

Krahaso:

1. emnoj (me emnue) - quaj (me quajtë), përmend (me përmendë) etj. një emër (emën);

2. emëroj (me emërue) – urdhëroj (me urdhërue), caktoj (me caktue) një punë, një detyrë etj.

2) Kontaminimi në raport **emën emër1** ndaj **emër2**, i shkaktuar nga homonimia e trajtave, *emër1+emër2!*, sidomos në toskërishte e së andejmi edhe në letrarishten e sotme zyrtare, edhe pse paraqitet mjaft e ngulitur, mund

të zbutet ose edhe mund të zgjidhet plotësisht ky kontaminim me rikthimin në standard të trajtave gege: **emnoj me emnue emnim**, dhe me një veprim të tillë do të lehtësoheshin e qartësoheshin edhe jo pak çështje të tjera në raportin shqipe e sotme letrare/prurje të domosdoshme nga dialekti gegnisht.

Meqë kjo temë **Rreth kontaminimit të homonimik të fjalës emër1 me fjalëtermin kuranor emër2**, e cila ka të bëjë me një çështje mjaft të mprehtë, por paksa si të fshehtë, me sa dimë, nuk është trajtuar në hollësi dhe gjerësi më parë, nga studiusit tanë, andaj puna jonë mund të quhet pioniere, pra mund të mos jetë e plotë, andaj kërkon ndoshta përplotësim a qasje të re, por i mëshoj me zë të lartë që problemi si ky, nuk mund të fshihet më nën arsyetimin se gjoja nuk duhet përpushur në hinin e zjarrit të shuar, prej nga doli drita e njëzimit të standardit të shqipes edhe pse mbi bazë të një dialekti, ngase në atë hi mund të ndeshen ende gaca të pashuara që është drojë se mund ta djegin atë godinë standardi gjuhësor me aq mund ndërtuar etj. Përkundarzi, ne nuk shohim gaca të mbuluara ose të pashuara, po ndeshim vlera kombëtare gjuhësore tejet të çmuara, mjerisht të anashkaluara, atëbotë nga nxitimi i punëve që atë godinë, ta bënin të banueshme gjuhësisht sa më shpejt, edhe pse ishte jo vetëm ende e pasuatuara, por edhe e pa armuar fort që nga themeli. Këtu flasim për vlera, të cilat e sforcjnë edhe sot atë godinë, pra, që nga bazamenti e deri maje kulmi, siç janë b.f. *integrimi i paskajores së mirëfilltë në standardin e sotëm, çështja e pjesores së shkurtër si trajtë përfaqësuese, foljet me –AV, raporti specifikues i foljeve paralele –NO /RO* etj, tipi: *pleqnoj pleqni* (institucion juridik) ndaj *pleqëroj, pleqëri* (kryesisht moshë) dhe të tjera, ashtu si edhe raporti **emnoj/emëroj** i trajtuar këtu që kanë të bëjnë me raportin: *shqipe e sotme letrare mbi bazë toskërishte/ish-shqipe letrare mbi bazë gegërishte*, e cila në destinacion më të ngushtë ka të bëjë me temën: **prurje nga gegnishtja** si përpunim e sforcim të standardit të sotëm – drejt një norme më të natyrshme të gjuhës shqipe.

Kështuqë me integrimin e tyre standardi i gjuhës sonë, pra pa i luajtur themelet e sotme fare do të jetë shumë më i sforcuar jo vetëm për banuesit eventualë, por do të ishte më i rehatshëm e komod për të gjithë shqipot, si standard i pranueshëm ndërgegjësisht, i përqafoshëm politikisht dhe më i integrueshëm kombëtarisht, pra norma e rishtë do të jetë shumë më kombëtare, shumë më shkencore, shumë më e arrirë dhe më e fortë në mënyrë që më me sukses t’u bëjë ballë si sfidave të brendshme, ashtu edhe atyre të jashtme në këtë epokë vorbullie të globalizmit gjuhësor botëror.

Sidoqoftë, edhe pse jemi përpjekur që këtë paraqitje ta bëjmë sa më me kompetencë e performance shkencore, në mënyrë që kompetentët në

instutucionet tona, jo vetëm ta marrin në dijeni, por edhe ta konstatojnë e vlersojnë dhe kështu ta legalizojnë zgjidhjen, apo jo?!

Gjithsesi në të ardhmen në fjalorët tanë përshkrues normativë dhe përgjithësisht për t'u qartësuar ky kontaminim këto dy fjalë homonimike **emër1** dhe **emër2** duhet shënuar veç e veç. Madje edhe folja prejëmërore e trajtës gege: **emnoj me emnue emnim** (nga emën), që del e specifikuar për mbulimin e disa koncepteve, për të cilat trajta paralele *emëroj1* nuk përdoret për arsye homonimie me foljen emëroj2, domosdo lypset shënuar në vendin e duhur me përkufizimin që e meriton.

Andaj shikuar nga ky aspekt mesazhi nga ky punim nuk del i jashtëzakonshëm, sepse tema rreth prurjes së elementeve gege në standard tashmë është çështje e hapur dhe kërkesa si kjo besojmë se do të jenë të mirëpritura.

Prishtinë, (1996, rish. 2015)

19) RRETH SHPREHJES TRIVARIANTËSHE TË BISMELES NË GJUHËN SHQIPE

Hyrje

Në termonologjinë islame shprehja ose *fjalìa-formulë*: “**Bismil-lahirr-Rrahmanirr –Rrahim**” siç e quan akademik E. Murtezai në *fjalorin e tij* (Shih Prof. dr. Ekrem Murtezai, *Fjalor fetar, Rilindja, Prishtinë 2000, f. 64.*), në arabishte është emëruar në një fjalë: **el besmele** (“**basmla**”), *formulë kjo e plotë që ndodhet në fillim të çdo sureje të Kuranit, pos të 9-s. Në të vërtetë tërë kjo fjali-formulë ose kjo besmele, përveç që parashoqëron çdo kaptinë Kurani, ajo sipas Ash-Shafiisë është një thirrje e brendshme që, besimtari duhet t’i drejtohet Zotit, duke e shqiptuar me zë ose jo, para ose sapa të nis çdo punë të mirë, a veprim pak a shumë me rëndësi që fillon me njet dhe shpresë në ndihmën e Perëndisë, dhe, siç thuhet, shqiptuesi i divotshëm i kësaj formule e zvoglon forcën e djallit të mallkuar te vetja e tij shumë, e bën të vogël sa një mizë, por, po shtojmë ne, duhet të ketë kujdes që ajo mizë, mos ta bezditsë ose mos ta shqetësojë, jo vetëm në atë punë të filluar, por edhe në punë e veprimtari të tjera apo jo?!*

Sidoqoftë, ne objekt trajtimi nuk do ta kemi përthelimin rreth vlerës përmbajtësore të formulës në fjalë, por do të japim disa konstatime se si kjo formulë është reflektuar dhe po përdoret, sidomos në gjuhën tone të shkruar.

Që në fillim po cekim se në fjalorin e Shkiljanit kjo fjalë shënohet *Bismela* ose *bismele*, e cila në arabisht e transkriptuar del ***“basmla”** të gjitha a- janë me dy pika sipër (*e). Edhe në turqishte del *besmele*, kështu e ndeshim edhe në disa burime të tjera. Prof. E. Murtezai e shënon **bismela**, si në boshnjakisht, formë kjo që në shqipe nënkupton trajtën e pashquar **bismelë**, Ndërkaq në gjuhën tonë të folur dhe të shkruar ky koncept si një fjalë emër e gjinisë femërore shquarsisht ka mundësi me u reflektue tre trajtash:

- 1) **bismelë-a bismelat**
- 2) **besmel/e-ja bismelet dhe**
- 3) **bismele bismeleja bismeletë.**

Ne i japim përparësi trajtës së dytë, të mesit dhe duke respektuar nistoren **b/is-**, ose më mirë fjalemrin *emën* në arabishte *is-ism ismi*, shumësi *esma*”, ose *ismaul eazam* (emri më i madh). Kështu, pra në punimin tonë u përcaktuam

për trajtën në njëjtesin e pashquar: **Bismele**, përkatësisht **Bismelja**, në trajtën e shquar dhe shumë: **Bismele Bismelet**.

Së këndejmi sipas gjuhës dhënëse (kuranore) *Bismelja*, shekuj me radhë ishte e pranishme edhe në gjuhën tone, sigurisht e mishëruar bashkë me kontaktin, përkatësisht me normat përkatëse, d.m.th. që me përqaftimin e fesë islame. Për mos me zgjatë, e ndeshim të përdorur në gjuhën e folur domosdo në çdo lutje namazi etj., si dhe në gjuhën e shkruar që në *ilmihalat e parë shqip* e libra të tjerë të fesë islame, por ne në këtë trajtesë do të përqëndrohemi vetëm në tekstet shqip të Kur'anit në gjuhën shqipe, përkthyer në këta dhjetëvjetshat e fundit të shek. XXI

Siç mund të shihet nga origjinali *Bismelja*: **Bismil-lahirr/ rrahmanirr - rrahim**, përbëhet prej dy pjesësh:

1. **bismil-lahirr** (*Bismil-lah*) ose *përmendja e emrit të Allahut Lah* dhe

2. ***rrahmanirr - rrahim*** (*Err-Rahman dhe Err-Rrahim*), që janë. dy emra, cilësi këto me të cilat Ai (All-llah-u) ka dashur që besimtarët e vet ta identifikojnë: **I Gjithmëshirshmi e Mëshirploti**.

Kështu ne në këtë artikull do të bëjmë fjalë fare shkurtimisht: së pari, për pjesën e parë, si reflektohet në shqipe dhe së dyti, do të përmendim paksa edhe ndonjë të veçantë të pjesës së dytë, rreth përkthimit në shqipe.

1. Konstatime rreth pjesës së parë

Pjesa e parë e **Bismeles**, përgjithësisht, por edhe nga përkthyesit e Kur'anit në shqip del trivariantëshe:

- 1) **Bismil-Lah -i ...;**
- 2) **Me emrin e Allahut... dhe**
- 3) **Në emër të All-llahut ...,**

por edhe me zëvendësim të emrit **Allah** me sinonimet barasvlerëse **Zot** ose **Perëndi**.

Edhe pse fetarisht dhe sipas të drejtës universale, asnjëri variant nuk mund të jetë i qortueshëm, megjithatë gjuhësisht mund të trajtohet përshkallëzimi i qëndrueshmërisë, qoftë duke arsyetuar versionin përkatës, qoftë duke cekur përparësinë logjike ose normëzuese të ndonjërit variant në shqipe.

Sidoqoftë, ja konstatimet tona, bazuar në realitetin tonë gjuhësor, aq sa mundem me e ndjekë dukurinë lidhur me këtë trivariantësh, veç e veç.

a) Rreth versionit të parë: *Bismil-Lah-i*

Është i njohur fakti se çdo term tekniko-shkencor ose publicistiko-filozofik nga gjuhët e huaja dhënëse ose origjinale fillimisht vjen sipas mënyrës transfer, pra vjen sipas shqiptimit ose shkrimit origjinal, po ndërkohë mund të kalkëzohet, të përkthehet ose edhe të zëvendësohet me barasvlerësin adekuat në gjuhën marrëse.. madje prof. Hasan I. Nahi (1905-1991) në përkthimin e plotë të **Kur'anit të Madhërishëm**. këtë formulë fillimisht e përdori kryesisht sipas mënyrës transfer të transkriptuar: **Bismil-Lahirr Rrahmanirr Rrahim**, por në ribotimin e veprës së tij nga nga IASHMQ Islam, e ndeshim të përkthyer: **Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit** (Shih: **Kurani i madhërishëm, kuptimet e tij në gjuhën shqipe**, botimi i njëmbëdhjetë, 2014.)

Sidoqoftë, ne këtu vëmë theksin në përdorimin e pjesës së parë (bismilahi) si huazim transfer, të cilin e ndeshim të shkëputur nga pjesa e dytë. Kështu fjala *bismilahi*, kishte dhe ka përhapje të gjere në ligjërim të përditshëm, por e ndeshim edhe në këngë popullore e burime të tjera. Po cek fillimisht sa për ilustrim vetëm dy vargje nga një këngë popullore:

U çue Rrushja me sabah
Rroki sitën me **bismilah**...
Bismilahi mori sitë
Me duer të bardha ta kam ngjitë...

Ka edhe raste të tjera, po serioziteti i temës na dikton të përmend vetëm edhe një rast nga Mevludi i H. Ali Ulqinakut:

***Bismil-lahi** emnin e Zotit ta thomë
Borxh e kemi n' gjitha pun't kur t'i fillojmë...*

Po e ndeshim edhe në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare, siç del e shënuar edhe në Fjalorin e Mikel Ndrecës:

Bismilah (ar. Bismi-lah) – *në emër të Zotit ose Ndihamo Zot! (me rastin e fillimit të çdo pune a veprimi te muhamedanët)*. (Aty f. 94.).

Madje jo vetëm njihet si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë, por, siç e cek më sipër, del i domosdoshëm me u përdorë si term-fjalë e parë e Bismeles në çdo falje namazi nga besimtarët islamë të mbarë botës.

Nuk po zgjatëm më shumë, kur dihet fakti se namazi dhe lutjet e tij bëhen në gjuhën arabe dhe kjo traditë ka zënë rrënjë me shekuj dhe siç thuhet

asgjë nuk pengon as shqiptarisht, pasi sqarimet e lutjet jashtë namazit lexohen e komentohen zakonisht shqip nga vetë imamët, madje thuhet se cilado nga komunitet islame (jo arabe) që ka tentuar që namazin ta bëjë në gjuhën e vet ka dështuar, prandaj njëherë për një here edhe formula jonë në shqyrtim është shumë e gjallë e frekuentuese nga besimtarët shqiptarë. Megjithatë, edhe pse përdorimi i kësaj trajte transfer propagandisht arsyetohej e arsyetohet mbase ende edhe sot nga dikush se çdo fjalë e Kur'anit famëlartë, si fjalë e Zotit, ashtu si edhe lutjet e namazit, nuk duhet ose nuk mund të përkthehet në gjuhë tjetër me të gjitha vlerat që ka në origjinal, megjithatë ajo në interpretime, siç u tha, shpjegohet edhe me fjalë të gjuhës së komunitetit përkatës, por edhe përkthehet ose i zëvendësohet koncepti me fjalë të shqipes: “*me emër të Zotit*”, “*në emër të Zotit*”, “*ndihmo Zot*, por ndërkohë, siç do të shohim edhe në gjuhën e shkrimit *teksti kuranor* del i përkthyer.

b) Rreth versionit të dytë: *Me emër të All-llahut...*

Kur kemi parasysh atë që u tha pak më sipër nuk ka qenë lehtë të arsyetohet përkthimi i formulës në gjuhën tonë nga disa mendjefanatike, megjithatë hoxhët tanë nga tradita fillimisht e kanë komentuar në ligjërata e tyre përmbajtjen edhe të kësaj formule, dhe kështu më në fund edhe në gjuhën e shkrimit doli shprehja në përkthim **Me emrin e Allahut..**, mënyrë kjo të cilën e ka përvetësuar prof. **Sherif Ahmeti** në përkthimin e **tekstit integral të Kur'anit (1987)**, ashtu si edhe ak. Ekrem Murtezai në fjalorin e tij ***Fjalor i feve***, (Prishtinë 2000) e të tjerë. Kështu kjo zgjidhje ka mjaft ithtarë, të cilët e mbështesin si tekst barasvlerës të **bismeles** në shqipe. Së këtejmi, duke u bazuar, siç thuhet, në traditën e formëzuar sipas logjikës së kontekstit, ngase fraza: **me emër të...** mendohet se mund të kuptohet edhe edhe *të përmendurit* e emnit ose **emrit** të Zotit (**Lah**) (!), por njëherazi nënkuptohet edhe koncepti i **2-të** i *urdhër-udhëzimit* të Tij (**emrit * el amrum-it**)?! dhe së andejmi një formulim i tillë "me emër të All-llahut (Zotit, Perëndisë), siç thuhet, edhe pse nocioni i *urdhërit* (emrit) del drejtpërdrejt më i fuqizuar, nuk mund të quhet i pambështetur fetarisht e shqiptarisht (!).

Me fjalë të tjera mendojmë se në gjuhën shqipe kur kemi të bëjmë me konceptin e "urdhërit" (porosisë) dhe njëherazi edhe respektit të të cekurit të emrit hyjnor, formulimi në fjalë duhet me dalë i përqafoeshëm, apo jo?

Po shtojmë edhe këtë se Pavli Qesku, në fjalorin e tij (***Fjalor themelor...***, Tiranë 2012), në zërin **emër (emën)**, për konceptin *në emër apo emën të dikujt* ka sqarimin: ***me autoritetin ose lejen e dikujt***. Kështu

shikuar nga ky këndvështrim del e mbështetur shprehja **me emrin** (*emnin*), d.m.th.: (them këto fjalë) **me autorizimin ose lejen e...**(*Sovranit...*), pra në kontekstin tonë **sovran** del: Zoti, Perëndia, Hyji - *Allahu*.

Siç po shihet, zgjidhja e tillë: **me emër të Zotit**, më tepër ka të bëjë me përshtatje se me përkthim të fjalëpërfjalshëm të pjesës së parë të Bismeles.

c) Rreth versionit të tretë: *Në emër të All-Llahut ...*

Si me thënë përkthyesi bashkëkohor i Kuranit shqip, **prof. dr. Feti Mehdiu** (*Kurani*, Prishtinë 1985 dhe *Kurani dhe hija e tij*, Shkup 1999), parapëlqeu përkthimin më të fjalëpërfjalshëm të Bismeles, kështu, ky vuri në përdorim versionin e tretë, "**në emër të All-Llahut...**" që ka gjithnjë e më shumë mbështetës, ngase ka ngjashmëri barasvlerësie me gjuhët e tjera të zhvilluara të botës dhe qëndron, si me thënë, si një barasvlerës kalkëzues formalisht i qëndrueshëm ndaj përgjegjësit përkatës edhe të vetë arabishtes, kur kemi parasysh emrin **-is-, ism** (emën). Gjithsesi në shqipe duhet kuptuar jo me kuptim – **emrun-** (emër-urdhër).

Krahaso:

ar. "**bismil-lah-i...**"

ang. "**in the name of Allah...**";

it.. "**in nome di Allah...**";

gjerm. "**im Namen Allahs..**";

fr. "**au nom d'allah...**";

serb. "**u ime Alaha...**"

turq. "**Allah'in adiyla...**"

shq. "**Në emër (emën) të All-llahut...**"

Siç po shihet në të gjitha këto gjuhë përmendet emni si kategori morfo-gramatikore, si: **name, nome, nom, ime, ad-** ashtu si edhe në arabishte: **b'is...(ism)**, andaj edhe në shqip: "**në emën të...**". Ky version: "**në emër të...**" ka mbështetje edhe në FGJSSH-së (1980, f. 1231), ku jepet sqarimi, si vijon:

Në emër:

"flas (veproj) me porosi të dikujt, i ngarkuar nga dikush "

ose

"flas (veproj duke u mbështetur diku (në një ligj etj)."

Kështu barasvlerësimi (përkthimi) shqip "**në emër të...**" nuk mund të jetë as i qortueshëm as i diskutueshëm, ngase shprehja "parafjalore: "*në emër të ...*" e paraprirë nga parafjala **në**, tregon se personi i caktuar vepron në saje të autorizimit të paradhënë, këtu konkretisht: në Kur'an nga vetë Allahu (Hyji, Zoti, Perëndia), apo jo? Madje nënkuptohet se fillimisht kishte autorizimin e plotë vetë Pejgameri Muhammed, madje, edhe pse këtu mund të ketë diskutime që një autorizim të tillë e kanë edhe të gjithë deklamuesit dhe interpretesit e fjalë së Zotit (Kur'anit) apo vetëm specialistët e Ixhdihadit.

Sidoqoftë, ne sa u përket konstatimeve dhe venerimeve tona në aspektin gjuhësor lidhur me trevariantëshin e pjesës së parë të Bismelës në shqip quajmë të mbyllur, sepse që të tri versionet mund të arsyetohen, ndërkaq islamologëve ose e interpretuesve të tjerë (ixhdihadistëve) u takojnë sqarime të tjera eventuale, apo jo?

2. Konstatime rreth pjesës së dytë të Bismeles

Edhe sa i përket pjesës së dytë të Bismeles, do të përmendim ca venerime tona. Për të kuptuar më mire çështjen fillimisht, përveç shënimit të krejt formulës arabisht, po japim shembuj konkretë të *Bismeles* të përkthyer në dy gjuhë të huaja (anglisht e boshnjakisht dhe versionet në shqip, ku pjesa e dytë e saj del e bolduar:

a) arabisht: Bismilahirr-**Rrahmanirr-Rrahim**.

b) anglisht: In The Nome of Allah **the Most Gracuous, the Most Merciful**.

c) boshnjakisht: U ime Allaha **opshteg dobronitelja, milostivoga**

ç) versionet shqip:

1) Me emrin e Allahut, **Mëshiruesit, Mëshirëbërësit**

2) Në emër të All-LLahut, **të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**

3) Me emër të Allahut, **i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti**

4) Në emër të Allahut, **të Mëshirshmit, të Perdëllyesit(!)**

5) Në emën të Zotit, **Mëkatfalësit, Mëshirëmadhit (!?)**

Së këtejmi, vështruar nga këndi i shqipes mund të japim këto konstatime:

Së pari, trajta origjinale e pjesës së dytë ... **Rrahmani Rrahim**, e pandarë bashkë me pjesën e parë nuk del e qortueshme në përdorim, si huazim transfer, për arsytet që u thanë për pjesën e parë.

Së dyti, por ne më tepër zgjojnë interes pesë versionet e përkthimit në shqipe, andaj lidhur me këtë po japim ca sqarime:

E para, teksti në versionin nën 1) është pëdorur nga prof. Sherif Ahmeti, ndërkaq ai nën 2) nga prof. dr. Feti Mehdiu.

E dyta, tekstin nën 3) **Me emër të..** e ka përdorur po ashtu një grup përkthyesish në librin **Shpjegim i kuptimeve të Kur'anit të lartë** (Riad, 2000, të cilët në të vërtetë për pjesën e parë të **Bismeles** e kanë shfrytëzuar përkthimin e Sherif Ahmetit, ndërsa për pjesën e dytë (epitetet e kanë shfrytëzuar zgjidhjen e prof. Feti Mehdiut, por me ndryshim të njëjës së përparme nga: **të në i**:

1) ... të **Gjithmëshirshmit, Mëshirplotit**

2) ... **I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.**

E treta, nën 4) për pjesën e dytë, në internet, e ndeshëm versionin: ...**të Mëshirshmit, të Përdëllyesit**, ndërkaq tekstin nën 5) **Mekatfalësi** (Gjynahfalësi) dhe **MëshirMadhit** e kemi dëgjuar në kudër të normës së situatës, mbase rastësisht, nga në të folme të stilit bisedor.

Sidoqoftë, lidhur me versionet e mipërme dhe përgjithësisht shtrojmë këto dy pyetje:

E para, për mendimin tonë, nuk zgjon interes vetëm **risimi** i zëvendësimit të njëjës së përparme **të në i**, duke ndërruar edhe kategorinë përkatëse morfo-leksikore të fjalës, si p.sh.,: (Zotit) **Të Gjithëmëshirshmit** në (Zotit) **I Gjithëmëshirshmi** etj., dhe njëherazi njëjës së përparme **i** në kontekst jo të lidhur me emrin e parë pse mos të krahasohet me zgjidhjet e zyrtarizuara, si **De Rada**, **De Vega**, **O Kejsi**, **Van Gog**, pra **I** Gjithëdituri (Zoti), si (djali) **Ivogli**, **Imadhi**, (Dara) **Iriu** etj. dhe

E dyta, gjithsesi për ne del çështje e hapur edhe zëvendësimi i trajtës përkatëse të përkthyer me një trajtë tjetër sinonimike, ku një përpjeke e tillë sipas nesh nuk mund të quhet e qortueshme në parim, por shikuar në rastet konkrete një zëvendësim i tillë duhet bërë më mirë, me kompetencë, apo jo?

Krahaso:

1) Er Rrahman –**I Gjithëmëshirshmi** (nën 2) e 3).

2) Er Rahim – **Mëshirëploti** (nën 2 e 3)

- 3) Mëshiruesi (nën 1) / Mëshirëbërësi (nën 1)
 4) I Mëshirshmi (nën 4) / Përdëllyesi (nën 4)
 5) Mëkatfalësi (nën 5) / Mëshirmadhi (nën 5).

Natyrisht si barasvlerës për këto dy attribute mjafton vetëm njëra nga trajtat sinonimike të shqipes. E thamë zëvendësimi mund të jetë jo i mirë, sidomos në ato raste kur nuk është marrë parasysh tërësia strukturore e shqipërimin të 99 attributeve të Allahut. Sidoqoftë, ne më sipër përzgjedhën trajtën përkatëse vetëm pse ashtu ishte parapëlqyer nga dy burime (nën 2 e nën 3), por nuk do të thotë se edhe kjo përparësi nuk mund të diskutohet. Natyrisht është e nevojshme të rishikohen, bashkë me disa shprehje fetare në përdorim shumë të shpeshtë, si dhe përkthimi i 99 attributeve të Allahut. Në të vërtetë, me sa pamë siç ngjan edhe në këto dy attribute që u cekën në punimin tone *Er-Rrahman* e *Er-Rrahim*, pati ndryshime teksti në shqipe, qoftë në aspektin drejtshkrimor, qoftë në atë përmbajtësor e stilistik. Kështu mendojmë edhe lidhur me ngritje cilësie të emrit (atributit) përkatës ka vend për përmirësime, apo jo?

Sidoqoftë, me forca të përbashkuara edhe tekstet e të gjitha lutjeve (dova e dua) jo vetëm nga arabishtja ose latinishtja, greqishtja etj. gjithsesi mund dhe duhet të kenë në shqipe edhe gjuhë më të arrirë bazuar në natyrën e saj. Duhet kërkuar vlerat ende të panjohura mirë brenda gjuhës sonë, apo jo?! Së këtejmi edhe sa i përket rivlersimit të attributeve të Zotit (Allahut, Perëndisë) në gjuhën shqipe, pasi konstatoam se edhe në Dhjatën e Vjetër dhe në Dhjatën e Re në gjuhën shqipe dilnin attribute shumë cilësore të shprehura në shqipe, mendoj që si islamologët shqiptarë ashtu edhe studiuesit e kristianë (katolikë, ortodoksë e protestanë) duhet t'i shfrytëzojnë krjimet përkatëse në burimet e caktuara të versioneve fetare dhe kështu, kur kemi të bëjmë me të njëjtën koncept të Krijuesit të Gjithçkafes (universit), emërtimet e tilla t'i hamonzojnë dhe kështu atributet e tilla të dalin sa më të arrira si përmbajtësisht, ashtu edhe gjuhësisht e stilistikisht në gjuhën shqipe.

Përfundim

Në përmbyllje mbetet të arsyetohet ajo që është thënë gjatë shtjellimit të kësaj teme, pse ne e quajtmë të qëndrueshme të tri versionet e formulës së Bismeles në përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe:

E para, versionin ***bismil-lahi rrahmani rrahim*** e arsyetojmë, ashtu siç arsyetohen edhe shprehjet latine e lashtogreke si dhe të gjuhëve të huaja, të

inkorporuara në gjuhën tone, ngase ato në kontekstin përkatës paraqesin kulturë universale ndërkombëtare që duhet të zotërohet edhe nga intelektualët tanë, por kuptimin, kalkëzimin ose përkthimin e tyre e quajmë veprim normal dhe me interes në të mire të kultures dhe të shprehjes sonë të gjuhës shqipe, edhe pse për dikend teksti i përkthyer mund të konsiderohet si hije e origjinalit.

Sidoqoftë, as origjinali as përkthimi i asnjërit version natyrisht kur interpretimi i cilitdo version del me arsyetimin e duhur, në shqipe, madje huazimi transfer i Bismeles, assesi si në pjesën e parë nuk konsiderohet i qortueshëm.

Edhe sa i përket pjesës së dyti të Bismeles dhe sidomos të së tretës mund të themi që të gjitha versionet edhe origjinali arsyetohet, por bashkë me tekstet e lutjeve dhe të doëve e duave të përdorura shpesh si edhe versionet e përkthyer të 99 attributeve të **Atij që vranë e kthjell**, lypset verifikuar nga ana cilësore stilistike e përmbajtësore jo vetëm nga islamologët e albanologët, por edhe nga ekspertë të tjerë, zotërues të gjuhëve përkatëse, në mënyrë që gjuha shqipe edhe në segmente të tilla të jetë sa më e arrirë.

Po përfundoj me shprehejn e ngjashme “ndihmo Zot”, pasthirrmë që konceptisht është e ngjashme me vetë përmbajtjen e Bismeles, apo jo?

20) RRETH PËRCAKTIMIT TË TRAJTËS FOLJORE LIDHUR ME NDËRKOMBËTARIZMËN ASOCIACION NË SHQIPE

Me ndërkombëtarizimën **asociacion** (lat. associatio - shoqërim) si term i fushës së filozofi-psikologjisë, ashtu si në gjuhë të tjera (it. associazione, fr. e angl. association, gjerm. Associations, rus. asocijacija, serb. asociacija), edhe në gjuhën tonë kuptohet një ndërlidhje funksionale e dukurive a të proceseve psikike që mund të manifestohen si *bashkim përfytyrimesh, ndjenjash, ideshë, mendimesh* etj., të cilat ndërshoqërohen në mënyrë të posaçme sipas parimeve të *fqinjësisë, ngjashmërisë, kontrastit* si dhe të *kauzalitetit (shkakut dhe efektit)* dhe zgjojnë, ndërnxisin apo aktivizojnë procese të tjera jo të largëta të nënfushave të caktuara përkatëse përfytyrimesh, ndjenjash, ideshë, mendimesh etj., shtytës këta të cilët janë të një rëndësie të veçantë për njeriun dhe qenien e tij. Aq më tepër kjo rëndësi rritet kur dihet fakti se edhe të menduarit, si shkalla më e lartë, "në procesin e njohjes e të pasqyrimin të botës reale në ndërgjegjën e njeriut" (FGJSSH f. 1113), nuk është gjë tjetër, "pos një lidhje e përfytyrimeve sipas ligjeve të asociacioneve" (Shih: B. Spahiu, *Psikologjia*, Prishtinë 1983 f. 167).

Në FGJSSH (f. 63) fjala asociacion është shënuar nën cilësinë e termit special, por duke referuar në vend të tij si më të parapëlqyer barasvlerësin "shoqërim" të burimit vendës. Ndërkaq në Fjalorin e Pajazit Nushit (P. N., *Fjalor i psikologjisë*, Prishtinë 1987 f. 26) fjalë-termi asociacion del i shpjeguar si zë i veçantë, edhe pse lidhur me të referohen tri sinonimet e burimit të shqipes: "*shoqërim, bashkim, lidhje*", të cilat në raste të caktuara edhe mund ta zëvendësojnë termin në shqyrtim, qoftë pjesërisht, qoftë plotësisht. Me fjalë të tjera, sipas kësaj që u tha më sipër, fjala e huaj *asociacion* në raste të caktuara del e zëvendësueshme me sinonimet: "*shoqërim*", "*bashkim*", "*lidhje*" - pa e përjashtuar edhe ndonjë sinonim tjetër që mund të dalë varësisht nga konteksti, mirëpo kur është fjala te gjuha a stili shkencor-profesional, sidomos në rrethana që ndërlidhen edhe me gjuhët e me kulturat e tjera në kontakt, fjala "*asociacion*" jo vetëm se del e nevojshme të jetë e njohur nga kuadrat e caktuar të gjuhës sonë, por ajo si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë që është del e domosdoshme mbase edhe të përdoret. Ky fakt, mendoj unë, as që del i kontestueshëm, me fjalë të tjera, s'ka nevojë të diskutohet. E diskutueshme lidhur me këtë në shqipe del parësorisht vetëm trajta foljore, e cila mbi këtë bazë ndërlidhet me procesin e atij emri. Në të vërtetë, trajta foljore që i referohet nocionit të fjalë-emrit asociacion në shqipe del në forma të ndryshme. Kjo edhe është arsyeja pse pikërisht trajta e foljes lidhur me emrin **asociacion** në shqipe u mor si objekt trajtimi në këtë punim.

Para se të japim trajtat foljore mbi këtë bazë ashtu siç i ndeshim të përfutuara a nënkuptohen si të tilla, në disa nga burimet tona që pata rast t' i konsultoja, po i shënoj trajtat foljore të nocionit në fjalë në gjuhë të ndryshme, të cilat i referohen trajtës foljore neolatine: **associare**, nga e cila edhe mund të jetë motivuar e gjithsesi ndërndikuar edhe emri **associato** prej nga rrodhi në njëfarë mënyre edhe ndërkombëtarizma **asociacion** d.m.th. me -CI/ON fundor që është fjalë aktive e disa gjuhëve, sidomos atyre neolatine, ku del e ngarkuar edhe me nuanca të tjera kuptimore, por edhe me nocionin që po theksohet këtu.

Ja si u përfutuan në gjuhë të tjera trajtat foljore mbi bazë të nocionit në shqyrtim:

it. associare,
fr. associer,
sp. asociar;
gjerm. assoziieren;
rus. asociirovatj,
serb. asociirati;
angl. (to) associato.

Në shqipe në burime të caktuara i ndeshim këto katër trajta foljore, si të thuash, paralele:

asocoj, asocioj, asocionoj dhe asociacionoj, madje edhe *asociatoj*, qëndrueshmërinë e të cilave do ta diskutojmë e vlerësojmë më poshtë:

1. Siç po shihet te trajta e parë **asocoj (me asocue)** prapashtesa foljore -OJ e shqipes del si barasvlerëse për mbaresat a formantet fundore të gjuhëve përkatëse:

-i/are, -i/er, -i/ar, -i/iren, -i/irovatj, -irati.

Një praktikë e tillë, d.m.th. kjo e huazimit hibrid të foljeve nuk është e panjohur në historinë e gjuhës sonë, sepse, si trajtë përfaqësuese si më transparente, huazohet forma e infinitivit të gjuhës përkatëse (zakonisht nga latinishtja a italishtja) pa mbarësë-prapashtesën përkatëse, e cila ndërkëmbetet me prapashtesën e gjuhës shqipe –Oj (***On/ue**). Nga shembulli i mësipërm "asocoj" shihet se edhe mbështetësja -i- është konsideruar si pjesë përbërëse që i takon formantit fundor. Sa për ilustrim po përmend faktin se trajtën "asocoj" e ndeshëm së voni edhe në revistën "Zëri" të Prishtinës (11.II. 1995 f. 15 /"asocojnë në tragjedi dhe vdekje"/); te gazeta "Bujku" /... "marrëveshja e asocimit/, më 29. IV. 1995, f. 1, 2 etj.

2. Trajta "**asocioj**" (**me asociue!**) del e nënkuptueshme nga emri prejfoljor "asociim" i shënuar në "Fjalorin shqip - serbokroatisht", Prishtinë, 1981 f. 55, por e ndeshim edhe në mjete të tjera si p.sh. te gazeta "Bujku", më 15. V. 1995, f. 12 etj. Edhe kjo trajtë si trajta "asocoj" shihet se është përftuar nën ndikimin e infinitivit të trajtës përkatëse foljore të ndonjërës nga gjuhët e huaja, duke e ruajtur si temë fjalëformuese elementin mbështetës -i-: asoci+OJ asocioj.

Nëse kjo trajtë mbi këtë temë fjalëformuese dëshirohet të parapëlqehet në shqipe, ajo për të qenë më e pranueshme në sistem, duhet të marrë edhe një -j- epentetike si element mbështetës: **asocijoj** asocijim, sikurse foljet më -JO- si p.sh. **skijoj, brijoj, flijoj, lijoj, hijoj** etj., edhe pse trajta asocioj dallon nga ky grup, sepse asaj si dhe trajtës asocoj i mungon tema e qartë prodhuese motivuese ose ta shndërrojë në -J- në "-I-", siç është vepruar me shembullin e vetmuar kopjoj në shqipe (it. capiare).

3. Në *Fjalorin shqip - serbokroatisht* (1981) si barasvlerës për trajtën "asocirati" të serbokroatishtes në shqipe del e shënuar trajta "**asocionoj**" (**me asicionue**), formë kjo që nuk përkon me asnjërën nga trajtat foljore të gjuhëve të huaja. Edhe trajta "asocionoj" ndeshet në burime të caktuara në përditshmërinë tonë, siç e hasëm edhe në gazetën "Bujku" të datës 27. III. 1995 f. 5; në librin "Etni e modernitet" të R. Ismajlit, f. 95 etj.

Te trajta foljore asocionoj vihet re se në mes të temës "asoci-" dhe prapashtesës "-OJ" del i përftuar infiksi "-ON-": asoci/on/oj asocionoj. Pasi që ky infiksi, ta quaj kështu kushtëzimisht, del si veçori vetëm e gjuhës sonë shtrohet nevoja të sqarohen dy gjëra që janë të lidhura ngusht njëra me tjetrën:
e para, prej nga u shpif ky element dhe
e dyta, çfarë qëndrueshmërie ka elementi në fjalë?

Si duket trajta asocionoj e ndërtuar nga asoci+ON+OJ ka dalë nga emri osociacion + prapashtesa -OJ: asociacionoj, duke pësuar afereze haphologjike për shkaqe fonetike (ortoepike) me zhdukjen e rrokjes së parë përsëritëse -CI(a)- të fundtemës primitive të foljes, e duke e ruajtur rrokjen tjetër -Cion që i takon emrit referues, kështu që nga trajta asociacionoj doli: aso/CI(a)/cionoj: asocionoj. Një proces i tillë haphologjik nuk është i panjohur në gjuhësi, mirëpo për rastin tonë këtu përgjithësisht mbase nuk del aq i kuptueshëm, madje edhe i arsyeshëm, pasi që nuk dihet sesa ka shtrirje përdorimi përftrimi i tillë. Ç'është e drejta, me një veprim të tillë është mundësuar përftrimi i një procesi fonetik, por semantikisht nuk është fituar

asgjë, përkundrazi me një veprim të tillë folja ka humbur motivimin nga tema e qartë prodhuese dhe si e tillë, forma "asocionoj", sikurse dy trajtat e para "asocoj" e "asocioj", semantikisht del jo e qartë pasi që nuk motivon tema fjalëformuese e saj. Madje për t'u përligjur procesi haphologjik, siç u cek më sipër, trajta e tillë do të duhej të kishte përhapje më të gjerë e përdorim më afatgjatë në gjuhën tonë, gjë që, me sa di, nuk argumentohet me asnjë burim tjetër leksikografik normativ të gjuhës sonë, pos rastit që sapo u cek.

4. Siç e pamë më sipër trajta **asociacionoj** doli e përftuar si argument paraprirës kundrejt trajtës asociacionoj. Madje atë edhe si folje edhe si emër prejfoljor më -IM e ndeshim në burime të ndryshme, si p.sh. në librin *Psikologjia* (Dr. N. Rot), Prishtinë 1985 f. 80 etj.

Ç` është e vërteta, trajta asociacionoj (asociacionim), d.m.th. formimi i foljes më -OJ mbi një emër si temë të qartë fjalëformuese ka model të gjallë aktiv e prodhimtar në gjuhën tonë letrare si p.sh.: punë+OJ punoj, sharrë+OJ sharroj, ditë+OJ ditoj etj., madje edhe mbi bazë të emrave të huazuar nga gjuhët neolatine më -ION fundor, ku bën pjesë edhe emri asociacion, si p.sh.: emocion+OJ emocionoj, pension+OJ pensionoj, tension+OJ tensionoj, revolucion+OJ revolucionoj, pasion+OJ pasionoj, revizion+OJ revizionoj, sanksion+OJ sanksionoj etj., prandaj qëndrueshmëria e trajtës së tillë as që ka farë baze të vihet në dyshim.

Së këtejmi, me paraqitjen dhe arsyetimin që bëmë më sipër lidhur me trajtat foljore rreth nocionit të emrit asociacion mendoj se arritën ta përmbushim objektivin e parë të kësaj trajtesë, por jo edhe qëllimin kryesor që është përcaktimi dhe rekomandimi i trajtës së caktuar të përzgjedhur si normë standarde, e cila do të shërbente si një zgjidhje parimore e rekomandueshme edhe për shembuj të tjerë që ende nuk e kanë të zgjidhur trajtën foljore. Dihet se për përzgjedhjen e trajtës së caktuar si normë standarde duhen pasur parasysh disa kritere, por ndër to spikat kriteri i motivimit. Motivi apo motivimi si asociacion mund të thuhet se është vetë arsyeja që e shtyn njeriun për të marrë një qëndrim, përkatësisht që e nxit dhe orienton të menduarit e njeriut për të dhënë gjykime sa më të arrira. Në këtë kompleks rol të rëndësishëm luan perceptimi i mbështetur në përvojën, nevojën, dëshirën dhe interesimin ndaj stileve funksionale të shqipes përgjithësisht.

Pa hyrë në probleme më të thella, edhe pse e di se edhe ato nuk janë të parëndësishme për logjikën gjuhësore, për rastin konkret mendoj se në gjuhën tonë të sotme standarde del e domosdoshme të huazohet vetëm emërtimi i konceptit **asociacion**, si koncept strumbullar, kurse konceptet e tjera që rrjedhin nga ai, siç është koncepti që shprehet me anë të foljes, me ndonjë emër të prejardhur, me ndonjë mbiemër, ndajfolje etj. kanë mundësi të përftoheshin në gjuhën tonë në bazë të atij strumbullari. Kështu pra njësitë e tjera leksiko-semantika nuk dalin të domosdoshme të huazohen nga gjuhët e huaja, madje aq më tepër secila veç e veç. Me fjalë të tjera trajtat foljore: asocoj, asocioj edhe pse janë motivuar nga trajtat foljore të gjuhëve të tjera nga njohësit e gjuhëve të tilla, dhese në gjendjen e sotme asnjëra nuk mund të quhet lajthitje, nuk e kanë motivin aq të fortë saqë e ka b.f. trajta **osociacionoj**, e cila mbështetet në emrin, d.m.th. temën e qartë motivuese fjalëformuese. Parimisht a faktikisht në krahasim me dy trajtat e para të huazuara të mbështetura mbi bazë të infinitivit të latinishtes a të ndonjë gjuhe neolatine, si p.sh. evoluoj: fr. *évoluer* /*evolucion*/, por edhe po të dilte edhe ndonjë trajtë e bazuar në trajtën e participit latin, siç mund të supozohet *associat-um* asociatoj, siç ka gjetur zgjidhje b.f. trajta konstruktoj /lat. *construc-tum*/ etj), trajta asociacionoj (si folje) ka disa përparësi, ndër të cilat po ritheksoj dy:

1. Nuk është huazim, qoftë edhe i pjesshëm, por është formim origjinal i gjuhës shqipe. Është përfitim i kapshëm në strukturë, ngase i përket modelit të gjallë foljeformues të gjuhës sonë, të ravijëzuar, sipas skemës: temë emërore + prapashtesa -Oj, siç u cek më sipër, si te rastet: punoj, emocionoj, tensionoj, pensionoj etj., tip ky që përfshin potencialisht numrin më të madh të shembujve të gjuhës sonë të sotme standarde.

2. Fjala e tillë duke u pranuar në fondin aktiv të shqipes me cilësinë e ndërkombëtarizëm merr karakteristikat e fjalës vendëse dhe duke iu përshtatur ligjeve morfologjike përkatëse shërben si fjalë-temë për të formuar çerdhe fjalësh të reja si p.sh. foljen: **asociacionoj** (e cila zëvendëson plotësisht trajtat: *asocoj*, *asocioj*, eventualisht: *asociatoj*; emrat prejfoljorë:

asociacionim, *asociacionësi*, *asociacionimësi*, *asociacionueshmëri*, *asociacionues* (qoftë si zëvendësim qoft krahas formave: *asociativitet*, *asociacionist*, *asociacionizëm* etj.); mbiemrat: *asociacionor*, *i asociacionuar*, *i asociacionueshëm* (në vend ose krahas: asociativ); ndajfoljet: *asociacionisht*, *asociacionimisht* (në vend ose krahas: asociativisht) etj.

Trajta asociacionoj, pëkundër rrokjegjatësisë, edhe ndaj trajtës asocionoj ka përparësi, jo pse kjo del e regjistruar vetëm në një burim leksikografik, siç u cek më sipër, por për arsye se kjo përparësi shprehet pikërisht me temën e qartë prodhuese motivuese: *asociacion*. Procesi haphologjik që u cek më sipër është diçka tjetër. Ai vërtet mund ta lehtësojë shqiptimin, varësisht nga aspekti që vështrohet, por nuk del i dosmosdoshëm me u aplikue. Madje po të sforcohet në vetëdije si nevojë çështja e temës së qartë motivuese, atëherë sikurse në gjuhën e shkrimit ashtu edhe në shqiptim (në gjuhën e folur) nuk do të paraqitet nevoja për veprim haphologjik. Sidoqoftë në parim gjithsesi përparësi ka tema e qartë prodhuese motivuese e proceset e ndryshme fonetike a fonologjike mund të zgjidhen në rrugë të tjera edhe gjatë procesit të përdorimit.

Sipas kësaj që u paraqit këtu mund të nxirret si përfundim që kur është fjala te nevoja e përfutimit ë foljeve lidhur me emrat ndërkombëtarizma më -ION fundor (për rastet që nuk kanë gjetur zgjidhje më përpara, qoftë mbi bazë të infinitivit, qoftë mbi bazë të participit) apo nuk njihen nga shqippërdoruesi i rëndomtë, atëherë më së miri është të shfrytëzohet vetë emri i huazuar, i cili do të shërbejë si temë e qartë motivuese fjalëformuese për formimin e folje përkatëse më -OJ (*On). Prandaj sipas rastit konkret që u trajtua këtu më i drejtë del përfutimi i foljes asociacionoj nga emri asociacion sesa trajtat secila veç e veç, si "asocoj" a "asocioj" apo "asociatoj", madje edhe "asocionoj", të cilat, siç u tha disa herë, nuk motivohen nga tema e qartë fjalëformuese, por janë përfutur nën ndikimin e formave foljore të gjuhëve të huaja. Me fjalë të tjera, po përsërisim, nëse nga gjuha e huaj për nevojë jemi të detyruar ta huazojmë ndonjë emër si emërtim të nocionit të caktuar, nuk do të jemi të detyruar të huazojmë patjetër edhe trajtën foljore e prejfoljorët përkatës, kur kemi mundësi që ato t'i krijojmë vetë me elemente të gjuhës shqipe, duke u mbështetur në trajtën e vetme të huazuar.

Pra sipas mendimit tim më drejt del përfutimi i foljes asociacionoj nga emri asociacion sesa të huazohet veç folja, qoftë nga infinitivi i latinishtes (italishtes): asocoj a asocioj, qoftë nga participi i latinishtes asociatoj, veç mbiemri asociativ etj, kur struktura fjalëformuese gjuhës sonë mundëson fare lehtë dhe natyrshëm formimin e një çerdhe fjalësh të reja mbi temën e qartë motivuese sipas vargut:

asociacion: asociacionoj, asociacionim, asociacionues, asociacionor, asociacionisht, e kështu me radhë,

gjë që del, vërtet, një pasurim i natyrshëm i gjuhës sonë sipas rasteve të njohura fjalëformuese që tashmë njihen si të zgjidhura në këtë mënyrë si p.sh. sanksion sanksionoj, subvencion subvencionoj, pasion pasionoj etj. e jo mbi tri-katër tema të paqarta fjalëformuese, siç dalin shembujt që u diskutuan këtu, por nëse për arsye të ndryshme praktike e të traditës, ende dëshirohet të përdoret ndonjëra nga trajtat e tjera foljore, atëherë krahas trajtës **asociacionoj (asociacionim)** përparësia i takon trajtës **asocoj (asocim)** ndaj: asocioj (asociim) a asocijoj (asocijim), asociionoj (asociionim), asociatoj (asociatim), për derisa të dyja këto dhe të tjerat të mund të zëvendësohen nga trajtë-folja eventuale e shqipes më -O/j mbi bazë të temave përkatësisht: "bashkim" a "shoqërim", e ku ta dimë.

(Prishtinë, 1996)

21) ALFABETIM APO ALFABETIZIM?

(Lidhur me artikullin "*Jo alfabetim po alfabetizim*")

Në një tribunë të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, më 14.III.'85, duke qenë i sfiduar nga një diskutues akad. Rexhep Qosja, sa më kujtohet, pati thënë se "gjuhën e krijojnë shkrimtarët e jo gjuhëtarët", mendim ky që në

të përditshmen "Rilindja", mbase i stilizuar jo vetëm nga gazetari tekstorisht doli i shprehur kështu: "Duke marrë pjesë në diskutim R. Qosja tha se përkitazi me gjuhën, ndërkaq, do thënë, se atë e krijojnë krijuesit e jo gjuhëtarët, të cilët në këtë plan na dalin konservatorë, sepse duan t'i ruajnë normat në mënyrë të ngurtë" (Aty, 16.III.85 f. 11). Natyrisht ndaj një gjykimi të tillë, të paqartësuar mirë, si atëherë edhe tashti mund të shprehet rezervë e ligjshme, ngase, askush s`mund të pajtohet me konstatimin kuturu se gjoja vepra e gjuhëtarit nuk qenka krijuese, përkatësisht gjuhëtarët nuk marrkan pjesë në krijimin e gjuhës?!

S`do mend, se si në çdo fushë të organizuar të dijes në raport me normat shoqërore përgjithësisht, edhe në veprimtarinë gjuhësore në vija të trasha veprimtarët mund të kategorizohen në tri grupe:

1) Në grupin e parë, pra mund të radhitën "**të dëgjueshmit**", d.m.th. ata që i zbatojnë apo edhe i ruajnë "normat në mënyrë të ngurtë", të cilët edhe mund të cilësohen normalisht se ruajnë elemente konservatore.

2) Në grupin e dytë mund të përfshihen "**të kuptueshmit**", ata të cilët e zbatojnë normën dhe sa është e mundur nuk e shkelin atë, por njëherazi e kuptojnë faktin se varësisht nga rrethanat që imponohen në përputhje me zhvillimin e veprimtarisë së caktuar shoqërore, çdo normë mund të pësojë ndryshime, plotësime, së paku në aspektin interpretues etj.

3) Grupin e tretë e përbëjnë veprimtarët "**inventivë e kreativë**", të cilët janë të dëgjueshëm sipas rastit, janë të kuptueshëm sipas arsyes, por njëherazi edhe vetë si krijues a risimtarë u prijnë ndryshimeve a plotësimeve përkatëse që do të pësojë norma e caktuar shoqërore, qoftë nga shtytës të brendshëm, qoftë nga shtytës të jashtëm.

Me fjalë të tjera normalisht edhe gjuhëtari i mirëfilltë duhet të jetë i pajisur me të tria këto veçori, sepse nëse mbetet vetëm si i **dëgjueshëm** lind droja që ai të ngelë si rob i normës dhe kështu vërtet e bën veten të mbetet në suazat e një konservatori, siç e cek prof. R. Qosja, madje edhe në ato raste kur nuk duhet. Sigurisht gjuhëtari si krijues për të qenë i **kuptueshëm** dhe **inventiv** duhet ta njohë lëndën, jo vetëm në gjerësi e thellësi, por duhet t'i njohë edhe prirjet e zhvillimit të dukurive të caktuara që mund të ofrohen, qoftë për shkaqe brendagjuhësore, qoftë për ato jashtëgjuhësore dhe vetëm pastaj mund të japë gjykime e konstatime që mund të qëndrojnë. Fundi i fundit, siç dihet, gjuhëtarët janë ata krijues *sui generis* me kompetencë e autoritet të veçantë, të cilët, pasi të bëhen paraprakisht konstatimet, verifikimet e vlerësimet e nevojshme, ata më në fund kanë nderin të japin

fjalën përfundimtare në (ri)formulimin gjuhësor të rregullave ndaj normave të reja në përgjithësi dhe të rregullave standarde gjuhësore në veçanti. Mirëpo jo të gjithë gjuhëtarët arrijnë të cilësohen si gjuhëtarë të profilit inventivë a bashkëkohorë. Mjerisht ka raste që në pika të caktuara edhe ndonjë gjuhëtar i zellshëm dhe me ambicie pozitive padashje të mbetet jolargpamës në ndonjë paraqitje. Kështu mund të thuhet edhe për mesazhin e shprehur në artikullin "*Jo alfabetim, por alfabetizim*", të botuar në gazetën **Bujku**, të datës 7.IV.'97, f. 11, ku autori nuk e diskuton çështjen, por në mënyrë kategorike ia tërheq vërejtjen akad. Rexhep Qosjes pse ky e paska përdorur disa herë në një libër të tij emërtimin **alfabetim** (alfabetimi i gjuhës) e jo paralelen **alfabetizim** (alfabetizimi i gjuhës) dhe se me një veprim të tillë ai paska bërë shkelje të rëndë të normës letrare, saqë meritua të rikujtohet detyrimi, si të themi, qytetar se "zbatimi me përpikmëri i normës letrare obligon të gjithë ata që e flasin shqipen, që nga qytetari i thjeshtë deri te akademiku" dhe përfundon me thënien e një autori italian: "Quaj njeri atë që është zot i gjuhës së vet amtare". Me një qëndrim të tillë, që unë e quaj pa mëdyshje të nxituar, më duket se autori i artikullit mbetet në nivelin që e cek akad. R. Qosja në gjykimin e sipërcekur të tij, pra ngel paksa nën korniza të një konservatori. Pse e themi kështu dhe ku qëndron arsyeja që gjykimi i autorit të quhet i nxituar do të përpiqem ta sqaroj më poshtë.

Së pari autori, për të dhënë gjykimin e tij nuk do të duhej të mjaftohej vetëm me faktin se në **Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe** (1974) nuk e ndesh të regjistruar trajtën **alfabetim**, por vetëm atë **alfabetizim** (alfabetizoj), trajtë kjo që del edhe FSHSK (1981) si barasvlerës i fjalës alfabetiranjë (abecediranjë) të serbishtes, ngase siç dihet, përveç kriterit drejtshkrimor ka edhe kritere të tjera që duhet pasur parasysh në rastet kur përcaktohet norma standarde siç është kriteri drejt-fjalëformues, ai leksiko-semantik e të tjerë.

Së dyti, për mendimin tim, para se ta japë një gjykim të tillë të prerë, autori është dashur të thellohet më shumë edhe në shkakun, siç e ka vërejtur vetë, pse trajta alfabetizim nuk del e regjistruar në FGJSSH (1980).

Së treti nuk ka bërë mirë që nuk është përthelluar apo nuk është përpjekur që ta bëjë sadopak zbërthimin fjalëndërtues ndërmjet prejfoljorëve paralelë kontestues: **alfabetim** / **alfabetizim** duke pasur parasysh sistemin e përgjithshëm fjalëformues të shqipes, qoftë në aspektin tradicional, qoftë në atë aktual.

Siç dihet fjala **alfabet** (nga etimoni: alfa + beta) si fjalë ndërkombëtare me cilësi ndërkombëtarizmi që ka përhapje në shumë gjuhë të botës si p.sh.: fr. alphabet, it. alfabeto, serb. alfabet etj., në shqipe e ka të fituar qytëtarinë e një fjale aktive të fjalësit të gjuhës sonë, madje si e tillë mbi bazë të saj në shqipe janë zhvilluar dy mënyra vargje-fjalësh paralele:

1) me elemente të huazuara: alfabetiz/oj (fr. alphabetiser, it. alfabetizzare, serb. alfabetirati); alfabet/ik (fr. alphabetique, it. alfabetico, serb. alfabetiski), alfabetikisht, etj. dhe

2) me elemente të shqipes: alfabet/oj: alfabet/im, alfabet/are, alfabet/ues/e, alfabet/or/e, alfabet/isht etj.

Siç po shihet në kolonën e parë fjalët janë huazuar nga gjuhët e huaja, qoftë pjesërisht siç është folja: alfabetIZ/oj, alfabetIKisht, qoftë plotësisht, siç është mbiemri alfabet+IK, sepse elementet *-IZ-* si dhe *-IK* këtë rast u takojnë gjuhëve dhënëse, prandaj edhe prejfoljori **alfabetizim** del po mbi këtë bazë, ndërsa në kolonën e dytë të gjitha fjalët e prejardhura: *folja, emrat, mbiemrat e ndajfolja* janë formuar me elemente prapashtesore autoktone të gjuhës shqipe, pra edhe emërtimi **alfabetim**. Kjo ndoshta mund të jetë edhe njëra nga arsyet pse në FGJSSH nuk i është vazhduar pa rezervë normëzimi trajtës më *-IZ-IM*, edhe pse ishte e shënuar në Fjalorin drejtshkrimor, ndërsa ajo tjetra më *-IM* edhe pse nuk del e shënuar, nuk do të thotë se në të ardhmen nuk do të zërë vendin e merituar, ngase del e vetëkuptueshme se do të dalë më e favorizuar në saje të vetë strukturës tradicionale fjalëformuese të shqipes, sepse dihet sirregulla se çdo fjalë-emër mund të shërbejë si temë fjalëformuese për formimin e foljeve më *-OJ*, sipas modelit të mirënjohur: *punë punoj, mund mundoj, rrugë rrugoj, lugë lugoj* etj. etj., gjedhe kjo që, në të vërtetë, në letrarishten e sotme ka gjetur e po gjen përdorim gjithnjë e më të madh edhe mbi temat fjalë-emra të huazuar, siç janë ndërkombëtarizmat, si:

nivel: niveloj, portret: portretoj, model: modeloj, profil: profiloj, alfabet: alfabetoj etj. ,

duke u konkurruar apo edhe duke i nxjerrë jashtë, kur është fjala për të njëjtin koncept semantik, trajtat paralele më *-IZ/oj: nivelizoj, portretizoj, modelizoj, profilizoj, alfabetizoj* e të ngjashme, sepse në rastin e parë emri si temë fjalëformuese motivon drejtpërdrejt përfitim të foljes me *-Oj*, ndërsa në rastin e dytë të trajta më *-IZ-O, jo*. Te këto raste nuk duhet ngatërruar elementin *-IZ/O-* me prapashtesën e mirëfilltë foljeformuese të shqipes *-(ë)ZO*, me të cilën mbulohet një koncept krejt tjetër semantik i foljeve në shqipe.

Prandaj edhe koncepti i shprehur me togfjalëshin: "bërje e alfabetit" apo "vendosje e themelimit të alfabetit", siç e përkufizon qartë autori, është e lejueshme të foljezohet (njëfjalëzohet) në trajtën **alfabetoj** mbi bazë të emrit **alfabet**, fjalë kjo tash në funksion të temës së qartë motivuese fjalëformuese pa pasur nevojë të futet në përdorim huazimi **alfabetiz + oj** (me infiksin **-IZ-** të shpifur), që si temë fjalëformuese jo motivuese është përfutur, siç e pamë më sipër, mbi bazë të trajtës foljore të gjuhës së huaj dhënëse.

Vërtet, është afër mendsh, nëse gjuha jonë për arsye *savante* ka pasur, ka apo do të ketë nevojë të huazojë ndonjë emër me cilësinë e fjalës ndërkombëtare nga ndonjë gjuhë tjetër, ajo njëherazi nuk ka nevojë dhe as detyrim të huazojë b.f. të gjitha trajtat e kategorive të tjera morfologjike, siç janë trajtat përkatëse: foljore, mbiemërore, ndajfoljore, kur ato mund t'i krijojë shumë natyrshëm sipas modelit fjalëformues që e ka, model ky që ekziston në kuadër të sistemit të vet mbi bazë të emrit të përvetësuar temëprodhues, siç u dëshmuua edhe nga shembulli ynë i sipërdhënë: **alfabet alfabetoj, alfabetim, alfabetor, alfabetare, alfabetisht, të alfabetuarit**, e kështu me radhë.

Është e vërtetë se sistemi foljeformues i gjuhës sonë, sipas burimeve normative, me sa di unë, ende nuk del i studiuar sa duhet, madje ka raste që raporti i formanteve **-IZ/O** dhe **-(ë)ZO** e **-O-**, del ngatërrueshëm, prandaj nuk është çudi që edhe ndonjë gjuhëtar yni, sado zell e ambicie pozitive të ketë padashje mund të nxitojë në gjykime apo të bjerë pre e ndonjë lajthitjeje të paqëllimtë.

Ta kemi të qartë, në gjendjen e sotme të gjuhës sonë, nuk është kurrfarë "lëshimi" apo shkelje e normës nëse ndeshen në përdorim edhe trajtat më **-IZ-** të tipit **alfabetizoj alfabetizim**, mirëpo kur kemi të bëjmë për të njëjtin koncept semantik, atëherë duke qenë ndërtimisht më shqipe trajtat më **-IM**, të tipit: **alfabetoj alfabetim**, atëherë është krejt normale që të parapëlqehen pikërisht këto të tipit të fundit, edhe pse, siç u tha, ende nuk pasqyrohen sa duhet në burimet e caktuara leksikografiketë letrarishtes së sotme.

Pra, me ndejtë shtrembët e me folë drejt, siç i thonë fjalës, le të gjykohet cilin "e stolisë" ndërgegjësisht më tepër kuptimi i shprehjes: "Quaj njeri atë që është zot i gjuhës së vet amtare" përdoruesin apo kritikuesin?

Prishtinë, 25.IV.'97

2) Libri *Filozofia e gjuhës*, vepër interesante me shqipe të përdëshiruar

Hyrje

Njeriu si qenia më e lartë zhvillimore e botës së gjallë, "që është e aftë të mendojë dhe të flasë, të bëjë vegla e t'i përdorë ato në procesin e punës shoqërore" (FGJSSH f. 1282.), gjatë rritës së vet prodhuese e krijuese, jo vetëm se ka arritur ta formojë dhe ta kuptojë, siç thuhet në filozofi, "objektin për subjektin, por edhe subjektin për objektin", që do të thotë ndër të tjera, se

ai ka arritur ta bëjë objekt studimi edhe të qenët e vetvetes, mendimin dhe gjuhën, përkatësisht të *qenët e qenies*, madje edhe ta përsosë konceptin për të. Me sa dihet, të gjitha studimet e njeriut mbi qenien e vet që u përkasin fushave të ndryshme, jo vetëm të karakterit ontologjik, ravijëzojnë një tërësi (totalitet), që, për mendimin tim, vështruar nga poshtë lartë, në vija të trasha, mund të specifikohen në këto pesë rrafshë studimore: 1. njeriu si *qenie fizike*, 2. njeriu si *qenie biologjike*, 3. njeriu si *qenie psikologjike*, 4. njeriu si *qenie shoqërore* dhe 5. njeriu si *qenie hyjnore* (më drejt: *me veti hyjnore*). Secili rrafsh ka veçoritë e veta. Ne këtu, duke u nxitur konkretisht nga vepra "*Filozofia e gjuhës*" e **dr. Avni Preshevës** (Prishtinë, 1998) dhe duke e vlerësuar atë, do të ndalemi vetëm në ndonjë segment të veçorisë së rrafshit të pestë, d.m.th. të njeriut si trashëgues dhe krijues i dijes dhe të vetëdijes njerëzore, qoftë në shkallë kombëtare, qoftë në atë universale, të shprehur me anë të gjuhës, rrafsh ky që i takon vetëm njeriut e jo edhe qenieve të tjerat; të gjalla të natyrës. Autori sqaron se vepra e tij "fillim e mbarim" ka objekt trajtimi "*të qenët e qenies*" që është përcaktuar qartë me temën: *filozofia e gjuhës*. Me fjalë të tjera, në vepër trajtohet edhe gjuha edhe filozofia, dy komponente këto të pandara, edhe pse jo identike. Vepra në fjalë shikimisht ka të gjitha cilësitë formale për të joshur kërshërinë e lexuesit tonë intelektual, së pari, temën e ka të konkretësuar qartë që në titull: *filozofia e gjuhës*; së dyti, e ka të përmbledhur dhe të mbarështruar, si të themi, ajkën e dijes botërore a të një pjese të mirë të saj, dedikuar kësaj teme; së treti, vetë libri është hartuar në shqipe dhe nga një autor vendës dhe së katërti, materiali i tillë mjaft voluminoz, si tekst universitar, del i vlerësuar dhe i lejuar për botim nga organi më i lartë kompetent i institucionit përkatës te ne. Mirëpo, siç dihet vlerën e vërtetë veprës nuk ia jep ana e jashtme sipërfaqësore e saj, por, në radhë të parë, ajo e brendshmja, vlerë kjo që, pos lëndës përmbajtësore që përfshin, sendërtohet:

- nga aftësia e ndërthurjes së kompozicionit,
- nga gjuha dhe stili i përdorur,
- nga rëndësia shkencore që ravijëzon vepra në kohë-hapësirën e caktuar si dhe
- nga jehona propaganduese aktuale që mund të ketë ajo në të mirë, qoftë për kulturën kombëtare, qoftë për atë shoqërore universale.

Dihet se çdo vepër për t'i shpëtuar vlerësimit subjektiv duhet t'u shtrohet kritereve objektive, të cilat mund të kundrohen nga këndvështrime të ndryshme. Meqë tema "*filozofia e gjuhës*" si vepër e profilit të tillë, me sa di

unë, del e trajtuar kështu në gjuhën tonë për herë të parë, autori si fillimtar, qoftë si trasues rrugë, qoftë si seleksionues i materialit, duhet të jetë i parapërgatuar për ndonjë të metë a për vlerësime kritike, që mund t'i bëhen asaj, jo vetëm nga të dyja fushat profesionale që ceken në vetë titullin e veprës, do të thotë nga filozofë e sociologë ose nga linguistë, profesionistë të gjuhësisë së përgjithshme, por edhe nga ata të tjerët, si çifti im, që sadopak merren me "*çështje të shqipes standarde*". Pikërisht, pra, në kuadër të këtij këndvështrimi, d.m.th. në *raportin gjuha e veprës / shqipja letrare*, por edhe për ndonjë të dhënë tjetër anësore me ndikim lidhur me veprën, do të bëhet fjalë në këtë vlerësim tonin jo thjesht të karakterit recensionor.

1) Vërejtje rreth raportit gjuha e veprës / shqipja letrare

Nga secili kapitull, prej gjithsej XIV sosh që ka vepra *Filozofia e gjuhës*, lexuesi mund të gjejë material të ri që sadokudo e kompletton konceptin lidhur me temën bosht "*filozofia e gjuhës*" duke filluar që nga filozofia kineze, indiane, arabe, greke e në një farë dore deri në ditët tona. Në përgjithësi, mund të themi se autorit nuk i mungon metoda e shtrimit dhe e kompozicionimit, por si çdo veprë njerëzore, me marrë në përgjithësi, edhe veprës së tij mund t'i bëhen vërejtje në aspekte të ndryshme. Në këtë kompleks çështjesh, pa hyrë në përhollësi të caktuara rreth harmonizimit në mes të fazave të caktuara kohore, ngase në këtë pikëpamje më duket se vepra nuk del përherë aq e goditur, unë do të shkëpus ndonjë vërejtje që për mendimin tim ia vlen të vihet në pah. Më duket se "Fjala e autorit", edhe pse jo pa vlerë, lë vend edhe për një *parathënie a hyrje* të mirëfilltë. Pos kësaj, natyra e lëndës së shtruar meriton të kishte edhe një *përmbyllje a një përfundim* solid përmbledhës, qoftë të rezultateve të veçanta, qoftë atyre të përgjithshme të punës. Gjithashtu veprës i mungon *rezymeja* përkatëse në njërën nga gjuhët botërore.

Përveç kësaj veprën e lëndojnë edhe, si të themi, edhe disa *lëshime teknike*, shumica të bëra mbase nga pakujdesia si b.f.:

- te *tryeza e lëndës* kapitulli XIII *Demiraj - Panini shqiptar* është harruar nëntitulli *Probleme*. (Shih f. 288 dhe f. 29.)

- nëntitulli i paralajmëruar si p.sh. *Filozofia taoiste* (f. 21) nuk shënohet veçan si nëntitull, edhe pse e kërkon vendi, pasi flitet për disa përfaqësues sipas fazave përkatëse të asaj filozofie.

- mosrespektimi i radhitjes së pikave të paralajmëruara shqyrtuese, përkatësisht ka raste kur njëra pikë shënohet tjetra jo, qoftë e para, qoftë e dyta e kështu me radhe. (Shih f. 41, 46, 144.)

Nuk sqarohet fare arsyeja pse autori shkel kronologjinë, kur filozofinë arabe e trajton para asaj lashtogreke, kur dihet fakti, siç e thotë edhe vetë, se filozofia arabe në një farë mase pati ndikim nga dija helene.

Për mendimin tim në vepër nuk është dashur të bëhet anashkalimi i mendimeve të klasikëve të *materializimit dialektik* (Marksit, Engelsit dhe pasuesve të tyre kryesorë) mbi gjuhën, të cilët me kontributin e dhënë, pikërisht rreth filozofisë së gjuhës, kanë pasur jehonë, mbase edhe të tepruar, jo vetëm te Bahtini (fjalën e parë të veprës së të cilit "Marksizmi dhe filozofia e gjuhës" autori e modifikon në barasvlerësin e mundshëm "Dialektika ..."), por edhe në meset e caktuara të intelektualëve tanë, prandaj interpretimi a riinterpretimi kritik i mendimeve të tyre do të ishte me interes të veçantë, jo vetëm për momentin e përsotshëm, por edhe për të ardhshmen.

Në vepër ndeshim raste, që mund të cilësohen si "dalje jashtë teme" ose si "formulime jo aq të qëndrueshme", të cilat lypset rishikuar, siç janë b.f. disa të dhëna biografike të dorës së dytë për filozofët e caktuar, përkatësisht disa qëndrime joneutrale të autorit si dhe ndonjë shprehje ekzaltuese e tij për rrymat a personat e veçantë.

Në listën e literaturës së konsultuar do të duhej të figuronte edhe ndonjë titull nga tekstet normative të shqipes standarde, qoftë nga fusha e filozofisë, qoftë edhe nga fusha e gramatikës, e semantikës dhe ajo e leksikologjisë ose e enciklopedisë shqiptare etj., ngase, siç do të shohim në vazhdim, pikërisht në këtë pikë vërehen mangësi, sidomos në sintaksën e gjuhës së veprës.

2) Rreth kategorizimit të “lëshimeve” gjuhësore të veprës

Raporti: *gjuha e veprës / shqipja letrare* del si çështja më problemore e këtij libri. Që nga rreshtat e parë të tekstit bien në sy mjaft të meta gjuhësore, sëmundje kjo e pranishme tek disa intelektualë tanë, të cilët, pa fajin e tyre, kanë qenë të detyruar të shkollohen në gjuhë të huaja dhe si pasojë veprat e veta t'i hartojnë fillimisht në ndonjërin nga ato gjuhë dhe pastaj t'i përkthejnë a t'i përshtatin në shqipe. Edhe për veprën në fjalë si duket vlen po ky konstatim, por e keqja këtu qëndron në faktin se përshtatja e veprës në fjalë nuk është bërë në mënyrë profesionale dhe nën përkujdesjen e duhur ortologjike. Sidoqoftë, faji për shkarje të tilla gjithsesi nuk i përket vetëm autorit, por të gjithë përgatitësve të materialit për botim.

Disa nga "lëshimet" e tilla, jo të tërat, po i paraqit më poshtë duke i kategorizuar në tri grupe:

a) Si lapsus calami

Si lapsus calami ndeshëm: në f. 289 përmendet si filozof emri i *Karl Poperit*, kurse në kontekst del se është fjala për *Karl Foslerin*; në f. 62 përmendet Arabia si "*shkretëtira më e madhe në botë*", mbase është fjala për "*siujdhesë*"; në f. 116 del e dhëna: "në botë ekzistojnë tri *religjione*: budizmi, katolicizmi dhe islamizmi (mbase është fjala si *religjione më të përhapura!*); në f. 87 thuhet se "përgatitjen e bëri Al Esvedi (alias: El Asvadi!) "që nga *bashkëtingëllorja a parë A e arabishtes(!)*, mbase është fjala për *shkronjën e parë* të alfabetit të arabishtes e jo për *zanoren a shenjën a (!)*; në f. 82, 83 është shkruar: "janë formuar shumë *religjione*, në kontekst del fjala për *regjione* (rajone!); në f. 14 "filozofia kineze është filozofi e një *kontinenti*", mbase është fjala për përhapje të kufizuar *kontinentale* (apo: kontinueale!); në f. 61 "nëpërmjet *mësitimit* të plotë të tejkalojë vetveten", duhet të jetë: nëpërmjet *meditimit*; në f. 128 dhe 128 "Bekoni përkundër metodës *edukative* (duhet: *deduktive*) përdori edhe atë *induktive*; në f. 26 "aforizma e *fjalë të shkurta*", duhet: *fjalë të urta*; etj.

b) Si lajthitje të normës leksiko-semantike,

Si lajthitje të normës leksiko-semantike ndeshëm si p.sh.: *mendonte*", më drejt: *meditonte*; f. 185 në vend "*formë e përfitimit*", duhet: *formë e përftimit*), ndërsa f. 299 del e kundërta, në vend *përfton* duhet: *përfiton a nxjerr*; në f. 176 është "H. një sukses të tillë *nuk e kishte menduar...*, më drejt: *nuk e kishte parashikuar (besuar a pritur)*; f. 59, te togfjalëshi "teologji e vjetër arabe" elementi "e vjetër" nuk qëndron pasi që është fjala për islamit si fe "e re" edhe pse kontinueale, edhe termi "mbretëria *muhamedane*" (f.60) s'di sa qëndron; f. 123 është "ta *formojnë* një gramatikë", më drejt: ta *hartojnë* a përpilojnë...; në f. 32 në vend "kinezishtja gjuhë *origjinale* që përdor hieroglifet" më drejt: gjuhë *unike*; f. 9, 14 etj. ndeshim: "*formimi e zhvillimi i problemit të gjuhës!*" më drejt: *trajtimi, zbërthimi a konceptimi i problemit të gjuhës*, gjithashtu në mjaft raste ndeshet togfjalëshi: *problemi filozofia e gjuhës*, sipas kontekstit në shumicën e rasteve më drejt do të dilte: *filozofia e*

gjuhës si problem (a si çështje); në f. 132 ndeshim: "Bekoni... do të hyjë në analet e filozofisë ... *ballkanike(!)*...,(s'di çfarë ka të bëjë me diçka të veçantë për filozofinë ballkanike(!)); f.18, është "Një-ja është *krijesë* e çdo gjëje", mbase më drejt: Një-ja (njëshmëria!), *krijuese* e çdo gjëje; ngatërrohen trajtat *ofroj* me *afroj* (f. 306, 320), *përkujtoj* me *kujtoj* a *rikujtoj*, *përpunoj* me *punoj* f.73, *shënimet* me *të dhënat* f.137 etj.

Gjithashtu lypset rishikuar edhe rastet si p.sh. f. 70 *shpirti dhe spirti*, më drejt: *fryma dhe shpirti*; f. 145 "duhet nxjerrë *dy porosi*", sipas kontekstit më drejt: *dy konstatime*; f. 202 "fjali të thjeshta dhe *të ndërlikuara* (mbase duhet: fjali (dygjymtyrëshe) *të zgjeruara!*); f. 15, në vend: *shprehja e fjalës*, më drejt: *domethënia* a *nocioni* i fjalës, etj.

c) Lajthitje si pasojë e përvojës së pamjaftueshme të shkrimit në shqipe

1. Ndonjë shkelje drejtshkrimore a drejt-fjalëformuese si pasojë e përvojës së pamjaftueshme të shkrimit shqip: *teatër*, duhet: *teatër*; konception, më drejt: koncept, konceptim a koncepcion; *lima*, në vend *liman* (detar), konstruim, duhet *konstruktim*; etj., pastaj fizicien, logjicist a logjicent f.202,198,199), më drejt: *fizikan*, *logjikan*; pastaj: jo *idol* po *idhull* (f.66), jo *preformulim* po *riformulim* (f.207) etj.

2. Me rastin e përdorimit të grafisë së emrave të përveçëm të gjuhëve të huaja, në vepër nuk respektohet rregulli, qoftë në fillim të shënohet emri në grafinë e shqipes e në kllapa sipas grafisë origjinale ose anasjelltas e jo njëherë ashtu e njëherë tjetër kështu, pa kriter.

3. Pothuajse, nis e sos, nuk ka sekuencë a fjali-periudhë në vepër që të mos ketë nevojë për ndonjë intervenim gjuhësor të natyrës së llojllojshme, prej më të thjeshtave deri tek më të ndërlikuarat, të cilat s'mund të cilësohen dhe as të përjashtohen se janë shkaktuar vetëm nga pakujdesia apo jo?! P.sh.:

- përdorimi pa vend i shenjave të pikësimit: *pikës* f. 30 etj, *presjes* f. 48 etj.; *kllapave* 36, 96, 158, 217 etj.; të *shkronjës së madhe* (shih f. 11 etj.;

- mospërputhje rasash dhe gjinish të pjesëve të lakueshme të ligjëratës, në zgjedhimin e trajtave kohore të foljeve sipas numrit, gjinisë, përdorimi enorm i mënyrës përcjellore etj.;

- mospërputhje logjike e fjalëve homogjene etj, p.sh. inauguron: arsimin, arsyen, refleksionin, mendjen (!) (f.7); çdo art, çdo muzikë, çdo arkitekturë... (f.9) etj.

4. Për shkak të përdorimit pavend të lidhëzave, pjesëzave, parafjalëve etj. kuptimi i mjaft fjalive nuk del i qartë, kështu që ndeshim në afro 100 raste ku fjalia e zgjeruar, periudha a tërë sequenca kuptimisht del konfuze, ngase ndodh t'i mungojë, qoftë fjalia kryesore (koka), qoftë diçka tjetër(!).

5. Janë nja dy raste kur përdoret paskajorja me + pjesore e tipit *me thënë* (f. 34, 228), trajtë kjo e diskutueshme, por për mendimin tim jo e gabueshme. Të gabueshme dalin rastet e tjera (12 sosh) kur nuk bëhet si duhet zëvendësimi i paskajores së mirëfilltë me + pjesore me trajtat përkatëse barasvlerëse të shqipes letrare, qoftë të lidhore ose të paskajores së dytë, p.sh. tipi: "kisha thënë", në vend: kisha me thënë = kisha për të thënë apo *do të thosha*, pastaj bëhet pa nevojë lakimi i foljes (gjysmë)ndihmëse të ngurosur të tipit: *mundet të dihet*, në vend: mundet me u ditë = *mund të dihet*; *mundet të jetë*, në vend: mundet me genë = *mund të jetë* etj.

Çështje e drejta, shumica e lajthitjeve të kësaj natyre (nën: **a**), **b**), **c**) e të tjera janë të ndreqshme. Mendoj se pas një redaktimi të hollësishëm profesional, ato duhet të përmblihen në një fletë të veçantë të tipit: **ndreqje gabimesh** dhe atë (fletë) duhet bashkangjitur çdo ekzemplari të veprës që ende nuk është shpërndarë. Me një veprim të tillë sadopak do të zbutej mangësia përkatëse gjuhësore e veprës. Në të vërtetë, nëse ka mundësi ribotimi, përveç a krahas korigjimeve që u cekën këtu e të tjera, del e nevojshme të bëhen edhe riformulime, modifikime dhe përplotësime të tekstit përgjithësisht.

3) Konstatime rreth disa vlerave të çmuara të kësaj vepre

Megjithë lëshimet e mësipërme, mund të themi me plot gojë se vepra mund të cilësohet si tekst i suksesshëm, jo vetëm për arsye se autori ka arritur që në veprën e tij të sjellë material me interes si dhe interpretime të qëndrueshme nga kultura botërore lidhur me problemin "filozofia e gjuhës", por edhe pse ai duke vjelë e sjellë materialin nga burimet e ndryshme në shkallë botërore, ka shpërfaqur edhe mjaft gjykime të veta origjinale me vlerë jo të vogël që u takojnë nënfushave të ndryshme të interesimit. Këtë rast po veçoj diçka nga këto vlera:

a) Disa nga konstatimet dhe përkufizimet e tij lidhur me gjuhën, edhe pse në dukje të guximshme, mund të cilësohen me vlerë antologjike. Pos thënies aforistike: "Gjuha rritë e mendimit, ndërsa mendimi jetë e gjuhës" dhe modifikimit të konstatimit të mirënjohur se "gjuha është si e vetmja formë dhe mënyrë (më e mirë) e marrëveshjes së njerëzve", e cila "shërben edhe për

të shprehur kulturën e atij kombi (a të bashkësisë folëse) që e ka krijuar atë", kanë vlerë edhe formulimet e tjera si b.f: *gjuha si njëmendësi... gjuha si organizëm i gjallë... gjuha si formë e praktikës së njeriut...*, *gjuha shumë më tepër sesa një sistem shenjash... gjuha si formë e ekzistimit të mendimit... gjuha shtëpi e të qenit në të cilën njeriu rron... gjuha bërthamë e asaj kulture, e cila lidh këndet e homogjenitetit të të gjitha kulturave të tjera ose me anë të gjuhës shprehet, jeton dhe rritet kultura e çdo populli etj.*

b) Është i rëndësishëm edhe dallimi dhe përkimi i koncepteve të ndryshme që bëhen aty mbi filozofinë e gjuhës edhe në raportin *filozofi / gjuhësi*. Zgjon interes sidomos përcaktimi i qartë i temave përkatëse studimore që edhe sot e gjith ditën janë aktuale dhe joshteruese. (Shih f. 317.)

c) Në fushën e terminologjisë autori kryesisht ka parapëlqyer terminologjinë e gurrës vendëse si p.sh. njëmendësi, mendësi; kuptim, kuptimësi, kuptueshmëri; gurrim, rrojtje, rrjedhë, jashtësim, etj., por ka meritë gjithashtu edhe për faktin se mjaft mirë i shpjegon kuptimet e filozofemave të huazuara, me cilësi të termave ndërkombëtarë si b.f.:

1) tao (ligj), ming (urdhërim) etj. - të filozofisë kineze; dharmë (dukuri, ligj), dorsana (pikëpamje filozofike), mukti (lirimi i shpirtit), avidya (dituria), yoga (lidhja), tantra (filozofi e fjalës), veda (vepra diturie) etj. - të filozofisë indiane; kur'an, hadith, vahje, ikre, mual-lekat etj. - të filozofisë arabe (fesë islame); transcendent (njohja me kërkimin e objekteve) e transcendental (të njohurit mbi objektet) të filozofisë së Kantit, Geist (botë shpirtërore e mendore) në filozofinë e Hegelit etj., pa e përmendur edhe terminologjinë tjetër paksa më të njohur me origjinë helene e latine të rrymave të ndryshme filozofike europiane etj;

2) Ndër të tjera, përveç se ka bërë përzgjedhjen e termit "logjika simbolike" ndaj sinonimeve të tjera ka bërë përpjekje edhe rreth gjetjes së barsvlerësit përkatës për *Dasein*-in e gjermanishtes; pastaj, në raport me barsvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja, ka bërë dallimin e nocioneve në shqipe të termave: *qenie* (të gjitha veprat materiale dhe intelektuale të njeriut) ndaj *të qenët* (kuptimi i asaj që është e përgjithshme ashtu si është) etj. Gjithashtu bën dallimin formal: gjuhë induse nga gjuhë indiane, edhe pse për mendimin tim më drejt do të ishte që populli i Indisë të quhet populli *indias* (jo hindus), ndërsa gjuha të quhet gjuhë *indisht(e)* për dallim nga ajo indiane e indianëve (të Amerikës) etj.

ç) Gjithsesi mund të quhet pozitiv fakti i diskutimit të titullit të veprës "*Gjuhësi ballkanike*" (f.295) dhe sidomos konstatimi i tij lidhur me paskajoren e mirëfilltë të tipit me + pjesore të gjuhës sonë, të cilën e quan

problem të hapur, jo vetëm në kuadër të shqipes letrare, por edhe në suaza të ballkanistikës e më gjerë (Shih f.309).

Ç'është e vërteta, të gjitha këto që u cekën më sipër, por që mund të ketë edhe të tjera, mund të cilësohen ndihmesë jo e vogël për shkencën tonë filozofike në përgjithësi si dhe për gjuhësinë shqiptare në veçanti, prandaj t'i mohohet apriori tërë vlera përmbajtësore studimore e veprës, jo vetëm se nuk më duket gjykim i drejtë, por më duket se bëhet mëkat ndaj autorit, intelektual ky i lartë i kalibrit të veçantë. Dihet fakti se një vepër mund të quhet e sukseshme edhe për faktin nëse arrin të shtroj problemin e këtë autori e ka arritur me siguri.

4) Rileximi i veprës i domosdoshëm

Në fund e shoh të arsyeshme të rrëfhem para opinionit lexues për këto tri gjëra: *së pari*, veprën në fjalë, posa më ra në dorë, e lexova deri në fund më tepër për hir të kureshtjes intelektuale, *së dyti*, e rilexova me simpati dhe keqardhje, ngase për të kapur jo pak kokrra margaritari, brenda atij drithi ditunor, duhej spastruar ai drith nga byku e pluhuri i të metave evidente dhe *së treti*, pas konsultimit të sërishëm të veprës vendosa ta shkruaj këtë vlerësim jo thjesht recensionor me qëllim që sadopak t'u dalë në ndihmë, nëse mund të shprehem kështu, tre vetave: lexuesit, autorit dhe vetë çështjes.

1. *Lexuesit*, që mos të zhgënjehet a të ftohet, nëse gjatë leximit ndesh në ndonjë paqartësi a përqartësi të rastit, por të jetë këmbëngulës deri në fund, ngase mjaft vlera të veprës nuk dalin të kuptueshme drejtpërdrejt sa dalin të kapshme nga konteksti;

2. *autorit*, që duke ia vënë në pah si të metat si anët e mira të veprës ia rikujtoj faktin, që ai vetë sigurisht mund ta dijë më mirë se unë, se lexuesi ka të drejtë që nga secili krijues yni, të presë vepra sa më të arrira, si nga ana shkencore ashtu edhe nga ajo gjuhësore, prandaj ai pa kurrfarë shkurajimi dhe me vullnet të shtuar, duhet t'i bëjë korrigjimet e nevojshme dhe sigurisht për punime a vepra të tjera patjetër duhet ta shtojë kujdesin;

3. *vetë çështjes*, ngase dihet se nga diskutimi i gjërave të hapura në kuadër të disiplinave të caktuara filozofike e të tjera, siç është edhe "filozofia e gjuhës", ndihmohet më së miri, qoftë njohja, qoftë zgjidhja e problemeve të shtruara, mirëpo lidhur me pikën e tretë do të duhej ndonjë trajtesë e veçantë, ngase vërtet çështjet e cekura në atë vepër nxitin për një punë të tillë.

Sidoqoftë, nga leximi dhe rileximi i veprës mjaft interesante të Dr. A. Preshevës *Filozofia e gjuhës* lexuesi ka pse të vrasë mendjen.

Përfundim

Vepra *Filozofia e gjuhës* e dr. A. Preshevës (Prishtinë 1998) edhe pse përshkohet nga mjaft të meta, të karakterit kompozicionor (më pak) e të karakterit gjuhësor (më shumë), të shkaktuara qoftë nga pakujdesia, qoftë për arsye të tjera, ajo mund të quhet vepër interesante dhe me vlerë në gjuhën tonë, jo vetëm pse është e para që i kushtohet ekskluzivisht temës atraktive *filozofia e gjuhës a të qenët e qenies*, por edhe pse përmbledh në mënyrë kronologjike një pjesë të mirë të ajkës së diturisë botërore mbi këtë temë si dhe për faktin se gjatë paraqitjes autori ka shpërfaqur edhe mjaft mendime origjinale, të cilat gjithsesi mund e duhet të vlerësohen si të dobishme.

Sidoqoftë, autori ka mundësi që veprën ta bëjë edhe më cilësore, nëse i bën korrigjimet dhe përplotësimet e nevojshme të karakterit gjuhësor, kompozicionor edhe vende-vende edhe të atij përmbajtësor.

Prishtinë, më 28.XI.1998

23) Fjalë-termi *spirt* sajësë e trilltë në shqipe

Në veprën *Filozofia e Gjuhës* (Prishtinë 1998), në kapitullin VIII, nën titullin e veçantë: "*Mendime dhe propozime rreth përkthimit të termit gjerman Geist*", autori, Dr. Avni Presheva, meqenëse, nuk del i kënaqur, me traditën e përkthimit të deriatëhershëm që i është bërë fjalë-termi *Geist* të gjermanishtes në shqipe, qoftë me barasvlerësin *frymë* (në botimet e Prishtinës), qoftë me atë *shpirt* (në botimet e Tiranës), ai, për konceptin në fjalë, në mbështetje të etimonit të fjalës *spiritus* të latinishtes, e "krijon" trajtën **spirt**. Në të vërtetë, gjithnjë sipas arsytimit të tij, edhe pse *Geist*-i i gjermanishtes "në gjuhën latine e ka kuptimin e dy fjalëve *spiritus* dhe *animus*" (*shpirt e frymë*), ai megjithatë, mjaftohet vetëm me trajtën *spirt* (në biçim të fjalës së parë të latinishtes, *spiritus*), të cilën (trajtën *spirt*) edhe e ka të futur në përdorim në veprën e tij, ngase ashtu qenka vepruar (!) edhe në gjuhën frënge: "*l'esprit*", *it. spirito*, edhe në atë angleze *spirit*".

"Të përdoret fjala **spirt**, - ngulmon autori, - *derisa të krijohet termi adekuat*", -

duke e shtuar alergjikisht edhe këtë:

"në fund të fundit, nëse patjetër duhet të jetë fjala shqipe, le ta përdorin ose fjalën shpirt ose fjalën frymë, me gjithë përgjegjësinë dhe akuzën që u takon atyre që e përdorin"(!).

Kështu, ndonëse në paraqitje autori nuk del fort i qartë dhe bindës në kërkesën e tij, madje raportin "*fjalë shqipe/akuzë*" e përdor fort pa vend, megjithatë, mendoj se ai ka arritur të shtrojë për diskutim aktualisht një çështje jo pa interes gjuhësor fjalëformues e terminologjik në përgjithësi dhe për fushën e filozofisë në veçanti. Meqë nga ana filozofike nuk kemi tagër me u pëzie, qëndrueshmërinë fjalëformuese të fjalës së tillë **spirt** gjuhësisht do ta vënerojmë nga këto tri këndvështrime:

E para, sajesa *spirt*, sipas kriterëve përkatëse a mund të konsiderohet si fjalë e huazuar mirëfilli në shqipe dhe nga cila gjuhë?

E dyta, meqë fjalët përkatëse *frymë* dhe *shpirt*, i sheh të ngatërruara, për konceptin në fjalë, madje edhe pse nuk e mohon mundësinë e zgjidhjes me njërën nga to, nuk përpiket t'i zhngatërrtojë, po kërkon që atë konfuzion terminologjik ta zgjidhin të tjerët me *ose ose* dhe kështu çështja e specifikimit të fjalë-termave të tillë mbetet hapur dhe

E treta, po shtojmë ne, pasi autori nuk deklarohet për asnjërën nga trajtat sinonimike, **shpirt** ose **frymë**, dhe zgjidhjen me *spirt* e quan të përkohshme, atëherë vetvetiu nga logjika imponohet nevoja që duhet vlarë mendjen, për të provuar rrugë-zgjidhje të re pikërisht në konsultimin e sistemit fjalëformues të shqipes dhe së andejmi, nga brumi i saj, duhet me dalë farkëtimi *adekuat*, apo jo?!

Sidoqoftë, ne do të përpiqemi që në vijim të përgjigjemi në tri pyetjet e sipërshtuara, vështuar më tepër nga aspekti logjiko-fjalëformues, për çka kërkojmë mirëkuptim.

I

Në të vërtetë, ne fillimisht, duke u ndihmuar nga konsultimi që u bëmë disa burimeve përkatëse dhe nga materiali që sjell vetë autori, po japim tabelën e sajuar prej nesh në dy kolona në mënyrë që sadopak të njihemi me barasvlerësit paralelë sinonimikë të shqipes **shpirt** /**frymë** ngjitangjitas pas atyre të latinishtes *spiritus*, përkatësisht *animus* (jo aq të saktësuar) që cek autori dhe në varg shënojmë përgjegjësitet (paksa të qëndrueshëm) të disa gjuhëve të njohura:

Krahaso:

lat. 1. **spiritus** 2. **animus**(!) -

(shpirt, frymë!) (frymë, shpirt!)

hebr.	rauh	nephsh
gr.	psyhe	pneuma
gjer.	Geist	Seele
angl.	spirit	soul
fr.	esprit	ame
it.	spirito	anima
sp.	espirita	alma
sll.	dusha	duh
ar.	ruh	nefs
turq.	can	tin

shq. *shpirt* (spirt!) *frymë* (spirt?)

Nga tabela shohim se tek asnjë gjuhë si *rrënjë teme* nuk del trajta *spirt*, prandaj qëndrueshmëria e një trilli të tillë del fort e diskutueshme, sepse s'mund të quhet as fjalë e huazuar e as përfitim i drejtpërdrejt nga asnjëra gjuhë. Ajo, në të vërtetë, pretendohet të jetë modifikim i trajtës *spiritus* të latinishtes, po nga konstrukt, siç po shihet, më së miri, ngjason me trajtën *shpirt* të shqipes, me ndryshim vetëm në bashkëtingëlloren nistore!

Ç'është e drejta, edhe fjala *shpirt* e shqipes është pikërisht interferencë e lashtë e trajtës *spiritus* të latinishtes. Madje ka mendime që mbase që të dyja, mund të kenë *trashëgimi të përbashkët nga* protoshqipja, apo jo?!

Por, sido që të ketë qenë, shkenca jonë e ka të njohur fare mirë procesin fonetik të ndërshndërrimit të bashkëtingëlloreve **S** e **SH** në raportin latinisht / shqip. Lidhur me këtë është me interes të dihet fakti se edhe në gjermanishte përdoret trajta *Spiritus* (*Sprit*), jo vetëm si emërtim alkooli, por figurativisht, në ndonjë rast, edhe si sinonim i fjalës *Geist* (e cila ka disa kuptime), mirëpo edhe në atë gjuhë si edhe në kroatishte, ashtu si në shqipe, s-ja nistore shqiptohet **sh** (Krahaso: *spiritus* (**shprit*) - shqip: *shpirt*).

Edhe diçka duhet pasur parasysh në këtë kontekst. Tashti, ç'është e vërteta, nuk del e nevojshme të merret *peshore* mbështetëse *koncepti*, nëse mund të themi kështu, i fjalës latine *spirit/us*, me kuptimin paralogjik që kishte ajo dikur, po pikërisht, nëse del i domosdoshëm kuptimi i fjalës gjermane *Geist* (shqipto: *gaist*) si filozofemë në shqipe, duhet huazuar po ajo fjalë me nocionin e vet, apo jo?!

Është krejt gjë tjetër nëse sqarimi ose krahasimi bëhet me barasvlerësin *spirit* të anglishtes (me etimon latin) apo të ndonjë gjuhe tjetër (romane)

momentalisht ndikuese nga frëngjishtja *esprit* apo, pse jo, edhe nga italishtja *spirito*, analogjikisht siç është vepruar b.f. me ndërkombëtarizimën *spiritizëm*, *spiritualizëm* (*spiritual/e*), që ka për bazë etimoni po fjalë-temën latine *spirit/us*, por tashti me kuptimin aktual të italishtes *spiritualismo* (*spirituale*) që përdoret edhe në shqipe. Kështu autori me trillin **spirit** jo vetëm nuk e ndrit po e errëson edhe më tej konfuzionin terminologjik që ekzistua në gjuhën shqipe në raportin **frymë/shpirt**, apo jo?!

II

Sidoqoftë, është e vërtetë se në latinishte (tashtimë gjuhë e vdekur) kuptimi i *animus*-it, po sidomos ai *spiritus*-it që i takonte fazës paralogjike as për së afërmi nuk mund ta ketë pasur nocionin që e kanë sot gjuhët e tjera mbi atë etimon, qoftë si term feje, qoftë si term filozofeme, siç e ndeshim sot në këto gjuhë:

anglisht (*spirit*), *frëngjisht* (*esprit*), *spanjisht* (*espíritu*), *italisht* (*spirito*) dhe *shqip* (*shpirt*),

por prejardhja e përbashkët latine e tyre nuk mund të mohohet dot, madje edhe nocioni i sotëm, varësisht nga rrethanat në kohë-hapësirë që kanë përjetuar gjuhët (kombet) përkatëse, nuk mund të jetë dhe aq identik, apo jo?

Së këtejmi, duke pasur parasysh konstatimin e mësipërm, lexuesi i vëmendshëm menjëherë mund të ketë vënë re që në kolonën e parë e vendosëm fjalën *shpirt*, edhe pse ne si arsye parësore patëm etimonin e përbashkët me katër gjuhët euro-perëndimore (anglisht, italisht, frëngjisht, spanjisht), pa u thelluar në anën përmbajtësore fillimishte, ngase, siç dihet, shqipja, duke qenë në bashkëjetesë me gjuhët sllave, greke e turko-arabe nocionin i fjalës **shpirt** ligjërisht e fetarisht mund ta ketë pasur ndoshta më të afrueshëm me ato gjuhë se me gjuhët romane (frëngjishten b.f. etj.), mirëpo ne kemi bindjen se kur është fjala te terminologjia shkencore filozofike-psikologjike konsolidimi ose hamonizimi i saj me nocionin që ka termi përkatës në gjuhët perëndimore (anglisht etj.), kur është fjala për stilin shkencor, arbitrariteti ynë mbase mund të arsyetohet, apo jo? Gjithsesi, përcaktimi dhe arsyetimi i specifikimit të tillë varet zakonisht nga kuadrot e specializuar aktualisht të gjuhës shqipe, ku duhet të ketë hise edhe autori, kur kemi parasysh profilin e përgatitjes së tij profesionale, apo jo?!

Sido që të jetë, për ne del i drejtë gjykimi se në kohë-hapësirën që i duhet autorit para se të kërkojë një term të ri është dashur së paku ta provojë specifikimin kuptimor nga trajtat **shpirt** ose **frymë** si barasvlerës të trajtës

Geist dhe Seele (zele). Andaj ne pikërisht lidhur me këtë, gjithnjë në mbështetje të gjuhës, do të përpiqemi me dhënë një ndihmesë të tillë. Në të vërtetë, pas qëmtimit që bëme në burime të caktuara që patëm mundësi t'i konsultonim, po japim edhe këto konstatime tona.

1) Është interesant se në Fjalorin e Frang Bardhit raporti *latinisht / shqip* i fjalëve në shqyrtim del kështu: *spiritus* – *frymë*; *anima* – *shpirt*, pra i kundërt me atë që vendosëm ne kolonat përkatëse. Edhe në Fjalorin e **Bashkimit** si barasvlerësi i parë i fjalës **shpirt** del **anima** e italishtes. Po ashtu në Fjalorit latinisht - shqip (Lacaj - Fishta), rib. Prishtinë 1980, si barasvlerës i parë në shqipe për *spiritus*-in, pra, sipas kuptimit të konservuar të latinishtes letrare, del fjala *frymë* e shqipes, ndërsa për *animus* del *shpirt*, përkatësisht për *anima* – nën 2. del: *frymëmarrje*, *shpirt*, ndërsa për *spiritus* del nën 1. **të frymët** (asnjanës), *erë*, *jetë* dhe nën 4. *shpirt*, *jetë*. Ndërkaq, aktualisht sipas Fjalorit shqip-italisht e anasjelltas të F.Toçit (Tiranë 1993) dhe të tjerëve del e kundërta nga sa pamë më sipër. Tashti për **shpirt** si barasvlerës i parë del **spirito**, ndërsa për **frymë anima**, ashtu siç qëndrojnë baravlerësit në të dyja kolonat që e paraqitëm më sipër.

2. Mirëpo, ashtu siç ndodh edhe në gjuhë të tjera të gjalla, sinonimet e tillë, pos ndërkëmbimeve semantike të ndërsjella, kanë pësuar dhe pësojnë edhe zhvillime të brendshme kuptimore polisemike, secila veç e veç. Kështu në shqipen e sotme me fjalën **frymë**, pos tjerash, kuptohet jo vetëm koncepti i ajrit, frymëmarrjes etj, por fig. edhe ai i "ndërdijes dhe vetëdijes" individuale që është produkt i **frymës së tërësisë**", d.m.th. në një farë dore del edhe koncepti i *Geist*-it. Krahaso thëniet: *in Geist der Freundschaft* = në frymën e miqësisë ose *der Geist der Zeit* = në frymën e kohës etj. Është interesant fakti se K. Kristoforidhi në Fjalorin e tij fjalën *frymë* e shënon në dy skeda, d.m.th. e shënon, pra, si dy fjalë të veçanta homonime: a) *frymë-a* - me kuptim frymëmarrjeje dhe me kuptime të tjera si: *Frymë e Shenjtëruar* (= Shpirti Shenjtë) etj. dhe b) *frymë-a - erë-a*. (Aty f. 108.) Po ashtu fjala **shpirt**, e cila në fazën e zhvillimit paralogjik të mendimit njerëzor shprehte mbase gjendjen deri sa qenia e caktuar merrte frymë, ngase frymëmarrja ishte shenja më e dalluar e jetës, sot shpreh edhe aso konceptesh abstrakte ku përfshihet edhe koncepti i *Geist*-it të gjuhës gjermane, apo jo, siç janë fjalë-konceptet *mendim*, *jetë* dhe më gjerë, madje edhe emri *Geist* polisemantikisht në gjermanisht, me sa pamë, kishte disa sinonime. Kështu që në shqipen e sotme letrare, me fjalë-termin **shpirt** "emërtohen edhe forma të ndryshme përmbajtjesh mendore", nga të cilat dallohen: përmbajtja *substanciale*, ajo *hijnone*, *vitaliste* si dhe përmbajtja *mekaniste*, ndërkaq me *frymë si shenjë jete*

– kuptohet një sitërësi që mbisundon mendimin... ndjenjat, motivet te njeriu... Kjo, në fakt, përbën pjesën kuptimore të psikës... të ndërdijes dhe vetëdijes (universale, kombëtare, individuale) si produkt i frymës tërësore... (Shih: *Fjalori i Psikologjisë* i P. Nushit, Prishtinë 1987, f. 289). Edhe në *FGJSSH* (1980) kuptimi i nënzërit të parë të fjalës *shpirt* jepet po me konceptin e Geist-it, d.m.th. të arsyes, të të menduarit apo të mendjes, siç e shpjegon autori, përkufizim ky që, në fund të nënzërit, përmbledhet me togfjalëshin: **botë mendore**. (Shih aty f. 1904.) Ashtu ndodh edhe në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2006), madje me përkufizime edhe më të qarta specifikuuese. (Aty, f. 293, 1041.) Së këtëjmi, del se fjalë-termat përkatësisht: *frymë* dhe *shpirt*, gjatë zhvillimit kuptimor të tyre, në mënyrë të përligjur funksionalisht janë formëzuar në shqipe si fjalë e terma edhe të disiplinave të tjera të veçanta fetare-shkencore ashtu edhe si filozofema. Ta kemi të qartë, se procesi i formëzimit të fjalës së caktuar si term, siç dihet, mund të bëhet parësorisht edhe pa e ndryshuar formën shkrimore e shqiptimore të saj, edhe pse semantikisht pajiset edhe me një kuptim të ri të specifikuar plus. Është e vërtetë se përveç trajtave *frymë* e *shpirt* ekzistojnë edhe sinonime njëfjalësha e togfjalësha të tjerë përkatës, si *psikë* a *psikikë*, *arsye*, *gjeni* (*genius), *botë mendore* (mendje), *botëkuptim*, *botë shpirtërore* e ndonjë tjetër, me të cilat ka mundësi që në kontekste të caktuara, pothuajse normalisht, të shprehen nocione që kanë të bëjnë edhe me përcaktimin e konceptit të *Geist-it* (ashtu mbase siç i duhen autorit apo jo?!), mirëpo hëpërhë funksionin e barasvlerësit të parë për nocionin në shqyrtim në shqipen letrare të ditëve tona, me sa shohim ne, mjaft e mbulon gjithsesi fjalë-termi **shpirt**, që del më i specifikuar edhe kundrejt fjalës *frymë*. Sidoqoftë, harmonizimi terminologjik (Tiranë-Prishtinë) në gjuhën shqipe, mund të arrihet me një ballafaqim argumentash nga ekspertët, pa pasur nevojë për kurrfarë *akuze*, apo jo?

3. Por, me thënë të vërtetën, ngatërresë kuptimore rreth nënfushave të caktuara në mes të këtyre dy fjalë-termave me karakter filozofeme, jo vetëm në gjuhën tonë, për çka *ankohet* jo vetëm autori, A, Presheva po edhe të tjerë si akademik Ekrem Murterzai. (Shih, Prof. dr. Ekrem Murtezai, *Fjalor i feve*, Rilindja, Prishtinë 2000.), por ndeshim edhe në gjuhë të tjera, madje, paqartësi të tilla interpretimi, sipas Bibles (hebr. **rauh**, greq. **pneuma** - **frymë** ndaj po hebr. **Nephsh**, gr. **psiche** - **shpirt** si dhe arabishtes kuranore (**ruh** – **frymë**, **nefsi** - **shpirt**), dalin që nga zanafilla, ngase konsiderohen si fjalë-ide perëndie ose fjalë-simbole hyjnore, si fjalë të Zotit, dometheniet e të cilave i di vetëm **Krijuesi**, mendja e njeriu, nga domeni fetar, nuk mund ta përthekojë aq lehtë një reflektim të tillë joqartësues. Dhe kështu po këtë paqartësi e

ndeshim të bartur edhe në sferën e terminologjisë filozo-psikologjike, pra, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera. Pra le të krahasohen sadokudo edhe me konceptin e tretë plus një sinonim tjetër i diskutueshëm:

Krahaso:

arab.	gjerm.	boshnjak.	anglisht	turqisht	shqip
nefs	Geist	dusha	spirit	can	shpirt
ruh	Seele	duh	soul	tin	frymë
rih	Atem?	dah	breath?	nefes?	frymim? ('ah!)

Edhe pse që të dy termat: **frymë** e **shpirt** i takojnë fushës së lartë të abstraksionit, megjithatë, si në gjuhë të huaja edhe në shqipe, bëhet ose mund të bëhet njëfarë dallimi. Kështu jo pse unë guxoj të propozoj ndonjëfarë ixhtihadi, po në shqipe te **fryma** parësisht imponohet konkretja ajri - *lëndë e gazte*, por duke pasur në nënvetëdije karakterin vëllimor në llojshmërinë e saj dhe nënfushën semantike që zë në kontekste të caktuara paskëtaj figurativisht shfaqet edhe si filozofemë ose si term fetar hyjnor me karakter *jolëndor* pa limit të caktuar (që mbase sot konceptin e tillë në shqip më mire e mbulon trajta prejfoljore **frymim**), në njërën anë, si dhe duke pasur parasysh fjalën **shpirt**, në anën tjetër, e cila drejtpëdrejt vjen si koncept *jolëndor*, atëherë vetëvetiu imponohet njëfarë dallimi se kjo fjalë del paksa më e specifikuar në fushën e abstraksionit të lartë, kundrejt fjalëtermit **frymë**, e cila mbetet më e afërt me nocion universal, kombëtar e individual në raport frymë kombëtare, frymë miqësie, frymë vëllazërie etj.

Në të vërtetë, **fryma** konsiderohet edhe një sishpallje (emrun, revelatë e parapërcaktuar, si *jetë, frymim, forcë gjallimi në tokë të një trupi* (njeriu, kafshe apo bime), ndërkaq edhe **shpirti**, nuk qëndron larg kuptimisht, kur kemi parasysh zberthimin: *shpirt njeriu, shpirt kafshe, shpirt bime* dhe pastaj profilimin funksional vetëm brenda njeriut, si: *shpirt i qetë, shpirt qortues e shpirt me prirje* nga e mira, *nga e keqja*, ku fjala shpirt në këto raste nuk mund të zëvendësohet me fjalën frymë dhe ku, sadokudo kuptimisht shfaqen shkëndija lëvizjeje konkretësie që i përthekohen tek vetë koncepti i **frymës hyjnore**, përkatësisht te **frymimi njerëzor**, po gjithnjë brenda botës subjektive të vetë njeriut, apo shpirtit të tij. Me fjalë të tjera në raport *njeriu/shpirti* dallohen tri periudha të ekzistimit të *shpirtit*, dy në trupin e njeriut, e para vjen me **frymën gjalluese** që nga mosha *120 ditëshe(!) deri në moshën e vetëdijësimit*, e cila jep *jetë po nuk e obligon bartësin me përgjegjësi dhe e dyta, kur trupi pajiset me botën subjektive të njeriut normal, kur fizikisht*

*e mentarisht udhëheq me vetitë më të larta hyjnore, siç janë: **vullneti, kujtesa historike dhe vetëdija**, të cilat njëherazi i mundësojnë njeriut pavarësi relative jete, por edhe e obligojnë ndërlidhshmërisht me përgjegjësi kryesisht morale që ai duhet të veprojë sipas urdhrave ose udhëzimeve të Krijuesit, sepse nga veprat e tij varet edhe mirëqenia e shqirtit për periudhën e tretë, kur ndahet nga trupi dhe kalon në amshim, si të themi nën patronatin e Krijuesit, apo jo?!*

Së këtejmi pra, **shpirti** edhe pse inorganik si edhe **fryma** gjithsesi paraqitet me shkëndi vepruese dalluese në kuadër të **frymisë**, aq më tepër kur ka raste që fryma identifikohet me vetë **Krijuesin** dhe shpirti konsiderohet si entitet, njëri nga mjetet e tij (!), së këtejmi, shpirti ndërlidhet me *unin, me mendje, me intelekt*, i cili frymon e frymëzon inventivisht në mbështetje të **shtratit burimor të Krijuesit**, ku duhet ta gëzojë atributin e amshueshmërisë: mire ose kaq, varësisht nga veprat e individit, apo jo?!

Andaj, ç'është e vërteta, specifikimi i cilësdo trajtë **shpirt** ose **frymë** (apo **frymim**), me arsyetimin përkatës gjuhësisht mund të qëndronte mbase si barasvlerës i Geist-it, apo jo, por më tepër, sipas asaj që doli nga kjo analizë, qëndron trajtë-emri **shpirt**, shpirt i mirë shpirti i keq, siç del edhe te nocioni i *Geistit* në atë gjuhë?! Megjithatë, dallimi, përkimi dhe ndërlidhja në mes të këtyre dy termave mbetet konfuz, andaj detyrë e njeriut është që të kërkojë zgjidhje a mundësi plotësuese gjuhësore e mendore në kuadër të sistemit të gjuhës së vet.

III

Pra, meqë edhe pas analizës së mësipërme, ku besoj se u argumentua qindpërqind se trilli *spirt* dilte, si lindje e parakohshme, jetën e së cilës nuk mund ta ndihmojë kurrfarë inkubatori manipulues gjuhësor, ngase nuk i qëndron kuptimisht asnjë rrezeje përdorimi kontekstor, por në njëfarëdore, në anën tjetër, pasi as nga analiza jonë rreth zhngatërrimit të përmbajtjes së fjalë-termave sinonimikë **frymë/shpirt** apo **frymim** nuk doli gjithçka e qartë, atëherë, siç e kemi parashikuar, normalisht imponohet meditimi për të gjetur zgjidhje të reja me fjalë të reja, pa u larguar nga fjalëtermat në shqyrtim, apo jo?! Sidoqoftë, kështu ofrohet mundësia me kërkue dhe me marrë ndihmë në sistemin fjalëformues po të gjuhës sonë amtare.

Në të vërtetë, ne duke e respektuar dhe vlerësuar autorin si kuadër deficitar në profilimin e profesionit të tij rreth *gjuhës e filozofisë ose rreth filozofisë e gjuhës*, me ambicje të fortë pozitive që të kontribuojë më me

lehtësi në këtë fushë në të mirë të shkencës dhe të gjuhës shqipe, edhe pse ne nuk e ndiejmë veten aq të përgatitur, sepse nuk jemi pjesë e ndonjë institucioni zyrtar destinuar për të ndihmuar kuadrot e tillë, megjithatë mbështetur në nevojën dhe përvojën e fituar aktualisht në fushë të përkthimit dhe si autodidakt, mësues-studiuës i gjuhës shqipe, do të përpiqemi me e shprehë mendimin tone, qoftë edhe guximtarisht, rreth disa gjedheve ose mënyrave të njohura emërformuese të gjuhës sonë, që do t'i shtjellojmë paksa në pikën vijuese, të cilat besojmë se kanë me i ndihmue autorit e shokëve si ai, të cilët pa fajin e tyre nuk kanë pasur mundësi të pajisen me njohuri rreth emërformimit të gjuhës shqipe, sidomos në fushën e abstraksionit. Kështu qëllimi ynë është që së paku orientimisht t'i ndihmojmë kuadrot e tillë që ta kenë më lehtë të gjenden ose të thellohen më tej në avancimin e stilit përkatës shkencor duke u mbështetur në mundësitë që jep vetë sistemi fjalëformues i gjuhës shqipe. Lidhur me këtë ne të dyja fjalët: **shpirt**. dhe **frymë**, po i shfrytëzojmë si tema fjalëformuese, dhe kështu siç do të shohim, si janë formuar ose mund të formohen po emra abstraktë mbi bazë të këtyre dy fjalëtemave:

a) Fjala shpirt si temë prodhuese

Për fjalën **shpirt** vlen konstatimi se përveç mënyrës polisemike kjo fjalë mund të sherbejë si temë prodhuese fjalëformuese. Tash fill po konstatojmë zhvillimin e dy foljeve ekzistuese mbi këtë bazë, si:

- 1) **shpirtëroj** (*shpirtëri shpirtërim*), dhe
- 2) **shpirtëz** (*shpirtëzim*).

Edhe pse prejfoljorët e tillë në kllapa, për rastin në shqyrtim mbase nuk mund të shfrytëzohen, sepse dalin të konsumuar ose të zënë për koncepte të tjera, i rëndësishëm duhet të jetë fakti për lexuesin vetë modeli strukturor fjalëformues që qëndron si i tillë, nga i cili shembëllisht mund të na ofrohen trajta të tjera të mundshme, si: *shpirtim (shpirtoj) shpirtni, shpirtnim (shpirtnoj), shpirtësi (shpirtësoj* ose edhe trajtat: *sishpirt, përshpirt* etj.

b) Fjala frymë si temë fjalëformuese

Edhe për fjalën **frymë**, vlen konstatimi i mësipërm që përveç mënyrës së polisemisë, mund të shfrytëzohen prejfoljorët tashmë të përfutur, nga foljet përkatëse, siç janë:

- 1) **fryj**, b.f. në FGJSH 2006 (*fryjë-a*),

- 2) **frymëtoj** (*frymëtim-i*),
- 3) **frymëzoj** (*frymëzim-i*),
- 4) **frymoj** (*frymi-a, frymim-i*).

Përveç këtyre, nga *pjesorja* (ose *paskajorja* përkatëse me + pjesore) mund të përftohen normalisht fjalë të reja, si:: *me fry, me frymë* (**frymë-a, frymzë-a*), *me frynën*, (nga **frynë fryr fryrje*, pastaj modeli ofron edhe paralelet: (*me frymos frymosje, me u frymavë (frymavje!*), *fryjim (fryjoj) fryjimsi, frymësi frymësim (frymësoj)*); *e fryra, të fryrët* etj.

Së këtejmi, pa hyrë në hollësi të tjera, të vihen re shembuj ekzistues që ofrohen mbi bazë të temave përkatëse prodhuese, si p.sh.:

a) nga **shpirt-** doli edhe trajta, **shpirtësi**, e formuar me prapashtesën – **SI**, e cila del më prodhimitare dhe ndonjëherë paksa më speciale, kundrejt sishoqeve të veta: **-i, -ri, -shmëri** e të tjera si: **-ni, -ti, shpirtni**, pastaj me – **JE: shpirtje, shpirtje** ose–**IM: shpirtim** (shpirti+im);

b) nga **frymë-** siç na ofron modeli, normalisht mund të shërbejnë për destinim abstraksioni me ndajshitesat përkatëse **-I, -NI, -TI, -RI, -SHMËRI**, e pse jo edhe nga –**JE** dalin shembujt: *frymje*, me –**IM: frymim**, trajtë të cilën, siç mund të shihet, ne e përzgjedhëm si mundësi sinonimi për konceptin në shqyrtim, po i lamë si pjesë rezerve trajtat: **frymni, frymëti**, madje edhe **frymësi**, që mund të aktivizohen në rast nevojë.

Ndër të tjera tërheqim vëmendjen me prapashtesën –**SI**, si: **shpirtësi, frymësi**, emrat e rij fitojnë përshkallëzim cilësor të ri kuptimor të specifikuar akstrakt. Krahaso, modelin fjalëformues të termave tashmë të përqafuar, të cilat përdoren me sukses edhe nga vetë autori, si: *kuptim - kuptimësi, njëkuptimësi, shumëkuptimësi; mend - mendësi, njëmendësi; ligj - ligjësi; (e) vërtetë – vërtetësi, të vëretësuarit; (i) zot(i) - zotësi; konkret - konkretësi; veprim – veprimësi, të veprimësuarit; (e) mbarë - mbarësi* etj.

Prandaj si barasvlerës për ndonjë pjesë të *Geist*-it nga fjalë-tema **shpirt-** mund të dalë normalisht ndonjëra nga: trajta *shpirtësi a shpirtni*, ose edhe më mire, nga fjala **frymë-**: **frymësi** (a **frymësim, të frymësuarit**) ose edhe **frymim**, ngase kjo e fundit sotpërsot mund të konsiderohet më e kapshme.

Por, s’ duhet harruar se përveç formimeve me prapashtesën –**SI**, është i lejueshëm, sipas modelit edhe zgjerimi i të njëjtës fjalë me prapashtesën – **IM**, p.sh. *shpirtësim a shpirtnim* (ku nënkuptohet edhe folja *shpirtësoj a shpirtnoj*), pastaj, *frymi, frymim*, po nëse duam të futemi edhe më thellë në përshkallëzime kuptimore, natyrisht nëse paraqitet nevojja. E kemin fjalën edhe për raste të tjera, nocioni përkatës do të mund të mbulohej, qoftë pjesërisht, qoftë tërësisht, përveç me togfjalëshin si *botë shpirtërore, botë*

(e brendshme) subjektive e ndonjë tjetër edhe me kompozitën, si: *shpirtmendësi* (tip i lejueshëm) etj., ngase duke e futur në përdorim emrin e përbërë ashtu si edhe togfjalëshin mund t'i nënkuptojmë të ngërthyera kuptimisht të dyja konceptet: edhe *botë shpirtërore* edhe *botë mendore* të njeriut, por edhe *shpirt e mend*, apo jo?

Sidoqoftë, të gjithë shembujt si p.sh.: *frymësi, të frymësuarit, frymësim frymëshejtëri, frymëshejtni; shpirtësi - shpirtësim - shpirtmendësi etj.*, ashtu edhe ata, në formë asnjanesi me të + ... –uarët?uarit) apo me –I–, NI e –IM, si: *frymi, frymim shpirtni, shpirtnim etj.*, varësisht nga konteksti, sigurisht kuptimisht si terma janë shumë më të pranueshëm dhe më të motivueshëm nga ajo sajesa e përkohshme spirt, pjellë e çastit pa model, **spirt**, ndërkaq trajtat që dolën nga analiza jonë mund të konsiderohen si neologjizma të mundshëm të lejueshëm, të cilët sotpërsot qëndrojnë të pashfrytëzuar në gjuhën tonë, por janë krijime të ligjshme dhe të kapshme, andaj çdo studiues një mënyrë të tillë fjalëformuese duhet ta ketë parasysh dhe ta shfrytëzojë.

Sido që ta marrësh, qëllimi ynë në këtë diskutim është, siç e thamë, t'ia kujtojmë jo vetëm autorit, por të gjithë krijuesve tanë të nderuar të fushave përkatëse shkencore, që s'kanë pasur mundësi të kryejnë shkolla të larta e specializime në gjuhën shqipe që si rrugë më e mirë orientuese për zgjidhjen e problemeve terminologjike (mbase edhe të përkohshme) si tema në shqyrtim duhet mbështetur parësisht në mënyrat tashmë të verifikuara të emërformimit të shqipes.

Siç po shihet, shqipja aspak nuk është gjuhë e varfër. Në sistem ofron shumë zgjidhje potenciale të pashfrytëzuara edhe për terminologjinë filozofike, por po vuan nga mosnjohja ose nga mosshfrytëzimi i modeleve të tilla fjalëformuese nga kuadrot tanë përkatës. Mjerisht disa mësimdhënës edhe të punësuar në institucione me gjuhë mësimore shqipe më mirë po i njohin pasuritë fjalëformuese të gjuhëve të huaja se ato të gjuhës së vet amtare.

Me sa jemi në dijeni, gëzon fakti se pikërisht prof. dr. A. Presheva, pasi i ka tejkalluar ato shtërzimet fillestare gjuhësore-terminologjike, po hapëron bindshëm drejt majave më të larta shkencore të profilit që posedon dhe për këtë ne e përshëndesim dhe përzemërsisht i urojmë suksese dhe së këtejmi, mbase ky shkrim që për ne më tepër ka karakter dokumentues, më shumë do t'u ndihmojë të tjerëve dhe atij do t'i japë zemër për suksese të reja, prandaj edhe kërkujmë mirëkuptim.

Përfundim

Është e vërtetë se në vetë paraqitjen e autorit lidhur me fjalën **spirit** si dhe në tërë veprën *Filozofia e gjuhës* dalin edhe mjaft çështje të tjera të përgjithshme e të veçanta tejet të vlefshme, por edhe të diskutueshme, jo vetëm të natyrës gjuhësore, por edhe më gjerë, vlerësimi dhe diskutimi me kompetencë i të cilave nuk do t'i sillte asnjë të keqe autorit, përkundrazi përsiatjet filozofike rreth "filozofisë së gjuhës" në përgjithësi dhe rreth terminologjisë filozofike e linguistike shqipe në veçanti, gjuha jonë dhe autori dhe vetë shkenca jonë do të kishim vetëm dobi dhe shtysë për veprimtari e suksese të reja.

Nga sa u tha më sipër mund të nxjerrim këto përfundime:

a) Sajesa *spirit*, si rast i vetmuar, për konceptin e *Geist*-it të gjermanishtes nuk del e mbështetur as sipas mënyrës së huazimit të mirëfilltë të fjalëve të huaja në shqipe, as si krijim me vlerë, sipas rregullave formëzuese a fjalëformuese të shqipes, prandaj si e tillë do ta ketë pasur vështirë t'i qëndrojë as për një çast frymës së kohës, apo jo?!

b) Fjalë-termi *shpirit* del si barasvlerësi më i qëndrueshëm ekzistues i fondit aktiv të fjalësisë të shqipes për kolonën e parë dhe në bashkëveprim me sinonimet e tjera, *frymë*, *botë mendore*, *botë shpirtërore etj.* gjithsesi me fjalë-terma shqipe mund të mbulohet mjaft natyrshëm nocioni në shqyrtim, apo jo?.

c) Sido që të jetë, nëse ngulmohet patjetër në zgjidhje të reja, d.m.th. në trajtë-terma edhe më të specifikuar, atëherë, nga nevoja për qartësim, përthellësim a përshkallëzim të mëtejshëm kuptimor, duhet kërkuar ndihmë e mbështetje në modelet aktive prodhimtare emërformuese të struktues fjalëformuese të shqipes, për çka në këtë punim u dhanë disa shembuj sa për orientim, në mënyrë që lexuesit, po edhe studiuesit i japin sadopak ndihmesë. Kështu, për kolonën e dytë ndaj barasvlerëse përkatës të gjuhëve të huaja fjalëtermi *frymë*, **del i qëndrueshëm**, por në raste edhe sinonimi: *frymësi*, madje edhe ai **frymim** e ndonjë tjetër që mund të farkëtohet pa e zbehur fare anën shkencore të lëndës në shqyrtim. Edhe për fjalë-termin **frymë** munden me dale si barasvlerës korrekt sinonimikë ndaj fjalë-termave të gjuhëve të tjera, varësisht nga profilimi i lëndës që trajtohet, apo jo?!

Po përsërisim, gjithsesi duke iu përshtatur natyrës së sistemit fjalëformues e formëzues të shqipes, nëse njihet e zotërohet mirë, mund të zgjidhet çdo çështje e diskutueshme, si kjo që u trajtua këtu, apo jo?.

24) Rreth përligjjes së foljes kalëroj dhe parapëlqimit të emrit kalërues në shqipen e sotme

Në mjetet tona të informimit, por edhe në titllimin e filmave për konceptin që ka të bëjë me foljezin e emrit **kalë-i** po përdoren zakonisht disa trajta foljore me rrjedhojat përkatëse: *kalaroj kalarim kalarues, kaliroj kalirim kalirues, kaloroj kalorim kalorues dhe kaluroj kalurim kalurues*, si baravlerës për trajtën *jahač jahanje jahati të serbokroatishtes*.

Ne, lidhur me këtë, edhe pse të katër trajtat e sipërcekura në shqipe i quajmë trajta jo të gabueshme, megjithatë i quajmë, në njëfarë mënyre, të diskutueshme, ngase në vend të tyre sipas FGJSSH 1980, parapëlqehet trajta **kalëroj**, me derivatet: **kalërim kalërues**, andaj meqë kjo trajtë nuk del e shënuar në Fjalorin shqip-serbokroatisht 1981, tërheqim vëmendjen përkthyesve, gazetarëve e kujt jo që ta futin në përdorim këtë trajtë emërtimi edhe te ne.

Me sa dime folja **kalëroj** në këtë trajtë shkrimore, është relativisht e re në gjuhën tonë letrare. Madje te ne, në kohën kur po shkruhet ky artikull, ende nuk ka përhapje masive sa pritej të kishte. Ç`është e vërteta, dalja e një trajte të tillë foljore për konceptin në fjalë është shumë e mirëpritur, ngase një leksemë e tillë përkatëse e njëtrajtshme që me autoritetin e vet ndërtimor do të mund të zëvendësonte të katër trajtat e sipërcekura, pothuajse na mungonte. Ose e kishim të panjohuer. Në të vërtetë, me thënë të drejtën, për konceptin në shqyrtim, përkatësisht për **jahati** (jahanje, jahač) të serbokroatishtes, e cila ka kuptimin "*kretati se sedeći na jahačoj životinji*" / *eci hipur mbi një kafshë*

bartëse/ (RSHKJ 2 f. 572⁴⁰) ne i kishim të reflektuar po të katër format barasvlerëse të sipërcekura:

1) *kaliroj* (kalirim kalirues), 2) *kaluroj* (kalurim kalurues), 3) *kaloraj* (kalorim kalorues) e në raste edhe 4) *kalaraj* (kalarim kalarues), trajta këto që edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të përdoren nga individë të caktuar, jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në atë të shkruar. Ja disa shembuj sa për ilustrim:

1) **kaliroj** (kalirim): revista "*Jehona*" (Shkup), nr. 6/85 f. 97; vepra "*Kënga e hutinit*" (A. SH.) f. 44; gazeta "*Rilindja*", 14. XII. 1985 f. 16; revista "*Pionieri*" (Prishtinë) nr. 10/89 f. 1) etj.⁴¹

2) **kaluroj** (kalurim): revista "*Jehona*", nr. 6/85 f. 68, 92; "*Fjala*" nr. 1/86 f. 16, nr. 21-22/86 f. 5; "*Zëri i rinisë*" (Prishtinë), nr. 11/85 f. 31, 8/84 f. 21; "*Bota e re*" nr. 20/85 f. 16; gazeta "*Rilindja*", 1-2. I. 1985 f. 13, 24. VII. 1986 f. 13, 10. I. 1985 f. 16, revista "*Zëri*", 26. VIII. 1995 f. 26 etj.⁴²

3) **kaloraj** (kalorim): *Përveç në të folmen e ndonjë invidi, pata rast ta lexoj disa herë në titllimin e një filmi të TVP-së më 28. IX. 1986, rreth orës 16.00 etj.*

4) **kalaraj** (kalarim), *e ndeshim më shpesh se tri trajtat e mëparshme, sidomos në gjuhën popullore, qoftë si gjymtyrë kompozite, sidomos në gjuhën e fëmijëve, qoftë edhe thjeshtligjërimit: kalaraj kaladroj, kaladredhoj etj.*

Shembujt e mësipër besoj se mjaftojnë sa për të argumentuar praninë e trajtave të mësipërme edhe në gjuhën tonë të shkruar si edhe në atë të folur dhe njëherësh na japin të drejtë të tërheqim vërejtjen rreth një dukurie të tillë, ngase, siç u cek më sipër, për konceptin e njëjtë semantik që shprehet, b.f. me trajtat përkatëse: kaliroj (kalirim kalirues), kaluroj (kalurim kalurues), caloraj (kalorim kalorues), kalaraj kalarim kalarues tashti në gjuhën tonë letrare e

⁴⁰ Shih: Rečnik srpskohrvatskoga književnog jezika 2, Matica Srpska, Novi - Sad, 1967.

⁴¹ Këtë trajtë foljore e ndeshim edhe në "Fjalorthin e fjalëve të rralla të A. Zymberit, Prishtinë 1979, f. 58: "kalirue me (u) kalirohem - përdreqnohem", pra me kuptim keqësues. Pothuajse po me këtë kuptim e ndeshim edhe në tekstin "Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore" (grup autorësh), Prishtinë, 1982, f. 147, ku fjala kaliroj përdoret si sinonim i fjalës "kaladroj". Edhe në Fjalorin serbokroatisht - shqip (1974), f. 266 ndeshet trajta kalirim si barasvlerës i fjalës jahanje të serbokroatishtes.

⁴² E hasim gjithashtu në burime të tjera si p sh. në tekstin përcjellës të Fjalorit të F. Bardhit nga E. Sedaj (f. 61, 332, si dhe në titllimin e filmave të ndryshëm të TVP-së, siç ishte edhe rasti në serialin "Dinastia" etj.

kemi të normëzuar a të përligjur normativisht vetëm trajtën **kalëroj** (**kalërim**, **kalëruës**).

Përparësia e trajtës **kalëroj** kundrejt trajtave të zëna në gojë më sipër, nuk qëndron vetëm në faktin pse kjo, për ne, del e regjistruar si trajtë e re e normëzuar në *Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe* (f. 269) si dhe në FGJSSH (f. 264), siç u cek më sipër, por kjo përligjet edhe nga vetë sistemi fjalëformues, më saktësisht nga modeli i gjallë aktiv ekzistues i foljeformimit të shqipes me prapashtesën -RO-, siç do të sqarohet paksa në vazhdim, pasi t'i përimitojmë paksa ndërtimisht tri–katër trajtat sinonimike që u quajtën të diskutueshme në krahasim me trajtën *kalëroj*, të cilat zbërthehen kështu:

- 1) kaliroj ; kal(ë) + (I)RO/j;
- 2) kaluroj: kal(ë) + (U)RO/j;
- 3) kaloroj kal/or + O/j dhe
- 4) kalaroj: kal(ë) + (A)RO/j

ku, siç po shihet pas temës fjalëformuese kal(ë) dalin këto fundore-prapashtesa:

-IRO/j, -URO/j, -ORO/j, përkatësisht *-ARO/j*,

ndërkaq tek rasti: kalëroj: **kalë+ro/j**, shtohet vetëm fundorja **-RO/j**.

Prandaj, siç mësojmë nga një zbërthim i tillë, duke pasur parasysh ligjësitë që veprojnë sot në gjuhën e sotme standarde për formimin e katër foljeve të diskutueshme prej nesh mund të nxirren konstatime që po e sjellim në vijim:

a) Jo vetëm foljet me prapashtesën -RO-j, të cilat në asnjë rast nuk marrin -I- mbështetëse si në rastin **kaliroj**, por asnjë tip foljesh në gjuhën tonë nuk është praktikuar të marrë një messhtesë të tillë para formantit të caktuar prapashtesor të "-O-së me zgjerim", prandaj nga kjo pikëpamje trajta **kaliroj** në strukturën e sotme fjalëformuese del e paqëndrueshme. Mbase del e nevojshme të rikujtohet fakti se mbështetësja -I-del si element (infiks) brenda prapashtesor vetëm te një grup i vogël foljesh më -IZO/J si kombëtarizoj, pluhurizoj etj., por një formant i tillë më tepër është refleksi i ndikimit të modelit foljeformues nga gjuhët e huaja sesa si zhvillim i brendshëm vendës.

b) Gjithashtu nuk kemi raste përveç një pjese të foljeve më -RO/J, në tërë sistemin foljeformues të gjuhës së sonë, që të përdoret një -U- mbështetëse para formanteve prapashtesore të caktuara të varianteve si zgjerim i prapashtesës -O/J si te trajta **kaluroj**. Është e vërtetë se kemi foljet si murmuroj, glluguroj, guguroj etj., por në rastet e tilla -U- para -RO-së është

pjesë përbërëse e temës foljeformuese (onomatopeike), prandaj edhe trajta kaluroj/kalurim, sipas strukturës së sotme foljeformuese nuk qëndron.

c) Trajta **kalorj** ka për temë prodhuese temën (emrin) **kalor**, kaluar, kalor/ës emër ky që ka të bëjë me profesionin e caktuar të njeriut, mirëpo një formë e tillë foljeformuese goditet nga dy faktorë:

së pari, nuk është e praktikueshme në gjuhën tonë përgjithësisht, por edhe në letrarishten e sotme veçantisht të formohen folje mbi emrat që janë emërtime të njeriut sipas veprimtarisë, sidomos kur ka mënyra të tjera më të parapëlqyeshme dhe

së dyti, vetë fjala **kalor** (me variantet: kaluar kaluer kalur) ka kaluar në shtresën pasive të leksikut, përkatësisht siç shihet në FGJSSH, është zëvendësuar plotësisht nga trajta **kalorës (kal+or+ËS)**, prandaj edhe nga kjo pikëpamje ka pengesë të ketë jetësim si trajtë e qëndrueshme.

ç) Edhe trajta **kalorj** ngjashëm si trajtat e sipërtrajtuara *kaliroj, kaluroj* dhe *kalorj*, del me një –A mbështetëse, prandaj edhe kjo nuk doli e parapëlqyeshme nga Qendra.

Ndërkaq trajta **kalëroj** nga kalë- plus prapashtesa -RO- ka përligjje në vetë modelin e gjallë foljeformues ekzistues të gjuhës sonë si p.sh. burrëroj, vejëroj, flakëroj, leskëroj etj. Mirëpo, meqenëse trajtat **kaliroj, kaluroj**, madje edhe **kalorj** e **kalorj** i hasëm më tepër në "*gjuhën poetike*" ose në stilet përkatëse atëherë doli e domosdoshme që trajtat e caktuara të vlerësohen edhe nga kriteri "licencia poetica", d.m.th. nga "liria" që gëzon poeti për të "cunguar ose modifikuar formën e fjalës për nevojat e vargut" etj. (Shih Klaič, VRSR f.768⁴³.), përkatësisht për të përdorur fjalën e caktuar edhe jashtë normëzimit për qëllime të caktuara stilistike, së këtejmi, ne, nuk e quajtmë të gabueshëm përdorimin e tyre, por kur është çështja e stilit neutral, pikërisht në këtë kontekst trajta **kalëroj** del mbizotëruese, andaj si të tillë lypset respektuar, sidomos kur kemi të bëjmë me stilin neutral.

Sidoqoftë, ç'është e drejta, ne pa e lënduar lirinë krijuese edhe "të drejtën" që gëzojnë autorët në këtë drejtim, nga shembujt që konsultuam, të sipërcekur dhe të tjerë, plasojmë të vërtetën se edhe në krijimtarinë letrare artistike ofrohet trajta **kalërim (kalëroj)** si trajtë e normëzuar me të cilën, me trajtën e përligjur **kalëroj/kalërim**, mund të manipulohet më me parapëlqim

⁴³ Shih: Veliki rječnik stranih riječi, izraza i kratica, Zora, Zagreb 1968.

se me trajtat *kaliroj kalirim*, *kaluroj kalurim*, *kaloruj kalorim* apo *kalaroj kalarim* në kontekstet e caktuara, ngase me një veprim të tillë, nuk do të humbnin asgjë nga efekti shprehës stilistikor, por përkundrazi, do të fitonin edhe bazën e normëzimit.

Për të pasur ide edhe më të qartë rreth barasvlerësve përkatës në raport jo vetëm me gjuhën serbokroate, por edhe me disa gjuhë të tjera, po japim skemën me shembujt barasvlerës përkatës në disa gjuhë:

Skemë shembujsh në shtatë gjuhë

shqip	serb.	angl.	gjer.	fr.	it.	rum.
kalëroj	jahati	to ride	reiten	monter a cheval	andare a cavallo	calarese
				(chevaucher)	(cavalcare)	(merg cu cal)
kalërues	jahač	rider	Raitter	cheavalier	cavaliere	calaret
(kalorës)	(konjanik)	(horseman)				

Sidoqoftë në këtë trajtesë së pari bëhet me dije botërisht, sidomos te ne, se për konceptin **jahati/jahač** të serbokroatishes në gjuhën tonë kemi barasvlerësin tashmë të kristalizuar dhe të përligjur në çdo pikëpamje: **kalëroj/ kalërues**, ndërsa për **konjanik** kemi barasvlerësin **kalorës**.

Sa më lartë tërheqim vëmendjen, që së pari, një barasvlerësi e tillë duhet të repektohet dhe të mbahet mend për dy arsye:

së pari, sepse në fjalorët përkatës dygjuhësh ende nuk e kemi të regjistruar një barasvlerësi të tillë dhe

së dyti, tërhiqet vërejtja se trajtat *kaliroj/kalirim kalirues*, *kaluroj/kalurim/kalurues*, *kaloruj/kalorim kalorim*, *kalaroj/kalarim kalarues*, nuk është e nevojshme të përdoren më për konceptin përkatës, pos për ndonjë arsye tejet të veçantë stilistike nuk përjashtohen, ngase, siç u theksua më sipër, për konceptin në fjalë në stilin neutral mjafton vetëm trajta **kalëroj/kalërim/kalërues**, ashtu siç rekomandohet nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe(1980).

Përveç vërejtjes që u tërhoq më sipër lidhur me këtë ne kemi për qëllim të tërheqim vëmendjen edhe rreth mundësisë së zhvillimit të derivateve mbi këtë trajtë foljore. Kështu që në mbështetje të foljes **kalëroj** mund të dalë fare natyrshëm prejfoljori **kalërues**, si sinonim potencial i fjalës **kalorës**, për të shprehur mbase jo vetëm kuptimin e termit *jahač* të serbokroatishes, por edhe

të ndërkombëtarizmës **xhokej** "profesionist në vrapime me kuaj" : *kalërues - xhokej = jahač - džokej*, në serbishte.

Edhe ky fakt le të shërbejë si mostër brenda modelit se si zhvillohet, përkatësisht pasurohet leksiku ynë me foljet me prapashtesën **-RO-** në sistemin foljor të shqipes mbarë, mënyrë kjo fjalëformuese, e cila del mjaft aktive dhe produktive në gjuhën tonë të sotme letrare.

Sidoqoftë trajta foljore **kalëroj** edhe pse është relativisht me e re se trajtat *ngalkoj, kaliroj, kaluroj dhe kaluroj*, sipas sistemit të sotëm foljeformues të shqipes del më e përligjshme, andaj duhet të shtrihet përdorimi i saj dhe i derivative të saj si **kalërues** etj. edhe te ne, sidomos, kur është fjala për barasvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja e sidomos për atë *jahač* të serbishtes.

Prishtinë, 20 gusht 1998

25) Kalku *binjakëzim* (qytetesh) - rast i diskutueshëm

Viteve të fundit, sidomos, në të ashtuquajturën kohë transicioni, si duket, së pari në masmediat në Shqipëri e së andejmi edhe te ne, kemi raste të ndeshim në përdorim fjalë-termin *binjakëzim* (*binjakëztoj*, *binjakëzohen*), me të cilin mbulohet koncepti kur dy asociacione (qytete, bashkësi lokale apo shkolla etj.) të vendeve të ndryshme, qoftë për interesa politike-kombëtare e ndërkombëtare, qoftë për ato humane, ekonomike e të tjera, si me thënë, sivëllazërohen apo, solemnisht ndërsjelltazi.ndërlidhin miqësi të ngushtë të respektuar. Ja disa shembuj:

Binjakëzohen Shkodra me Ulqinin (Zëri, 30.10.2000, f. 14); Universiteti i Shkodrës është binjakëzuar me atë të Grafit të Austrisë (Dita, nëntor 2000, f. 11); Shkolla Thimi Mitko (Gjilan) është binjakëzuar me një shkollë gjermane të Baden Vujtenbergut (Shkëndija, nëntor 2001, f. 6); Mushtishti (i Therandës) u binjakëzua me komunën Troisdort të Gjermanisë (Rilindja, 5.04.2001, f. 17); Të binjakëzohet Prishtina me Nju Jorkun (Rilindja, 11.IV.2001, f. 24 etj.

Duke u nisur nga gjendja e sotme, sipas burimeve përkatëse të gjuhës sonë letrare, kuptimësia e sapocekur e fjalë-temës fjalëformuese *binjak-binjakëzim* nuk del e zhvilluar për konceptin në fjalë, prandaj lindja e një *risimi* të tillë me të drejtë, jo vetëm zgjon interes të njihet, por njuhëherazi shton edhe rezervën rreth qëndrueshmërisë së tij. Vërtet, jo vetëm nga humoristët, por edhe nga njerëzit e rëndomtë mund të shtrohen pyetje provokuese: Si ka mundësi që një qytet, një bashkësi lokale, një shkollë etj. të bëhet binjake (*të binjakohet*) me një të një vendi tjetër, kur dihet fakti se s'ka pasur kurrfarë mundësie logjike që asociacionet përkatëse të kenë pasur lidhje binjakimi, d.m.th. “të jenë të lindura njëkohësisht nga një mëmë”, përkatësisht (figurativisht) “të jene sende që t'i ngjajnë aq shumë njëra tjetrës“ apo në një kohë-hapësirë “të jenë pjesë të lidhura a të ngjitura ose të rritura bashkë”?! (Shih FGJSSH f. 147). Gjithsesi kur dihet fakti se një koncept i tillë si në shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaja edhe në kuptime

figurative e ka të zhvilluar si mbështetje jo fjalë-temën binjak-, por atë vëlla- krahaso:

shq. vëllazëri, vëllazërim (me vëllaznue, vëllazëroj, vëllazërohen);

angl. fraternization, (to) fraternize;

gjerm. Bruderschaft, sich verbrudern;

fr. fraternisation, fraterniser;

serb. (z)bratimljenje, (z)bratimiti se;

it. fratellaza (fraternizzazione) fraternizzare,

atëherë shpifja sinonimike e fjalës binjak- binjakëzim këtu del e diskutueshme. Mirëpo, kur dihet fakti se çdo risim patjetër do të ketë një nxitje a shkak, ne u përpoqëm ta gjejmë dhe ta vlerësojmë pikërisht atë pretekst. Dhe për të gjetur arsyen e përfimit të trajtës *binjakëzim* në shqipe konsultuam burimet e caktuara barasvlerëse në gjuhë të huaja lidhur me zhvillimin mbi bazë të fjalës binjak-, përkatësisht:

angl. twin, gjerm. Zwilling, fr. jumeou, serb. blizanac e it. gemello

dhe nga konsultim i tillë doli se vetëm në italishte në raport me gjuhën tonë nga fjala gemello (binjak), përveç termit astrologjik (në horoskopi): Gemelli, serb. Blizanci, shq. Binjakët) dilte e zhvilluar edhe folja *gemellare* (me binjakue) sinonim i fjalës *fraternizzare* (me vëllaznue), kështu shprehja: **Gemellare due citta** në Fjalorin e F. Lekës dhe Z. Simonit përkthehet me barasvlerësin **Vëllazëroj dy qytete**, mirëpo po aty emri **gemellaggio** i italishtes shpjegohet në shqipe me trajtën **binjakëzim** (i dy qyteteve) (Shih: Fjalori italisht - shqip, Tiranë 2000, f. 478.) Së këtejmi, pra, *u zbulua* se në gjuhën tonë fjala *binjakëzim* është refleks nga një cep anësor i italishtes *gemellaggio*, rast ky që ne e quajtmë pa rezervë *kalk i diskutueshëm* për arsyet që do t'i shprehim më poshtë.

Sigurisht adhuresit e fjalë-termit *binjakëzim* mund t'i kenë arsyet e veta, por nuk më duket aspak bindës anashkalimi i fjalë-termit *vëllazërim* në dobi të kalkut të saposhpifur *binjakëzim* me arsyetimin se gjoja në epokën e ashtuquajtur të socializmit janë bërë manipulime aq të mëdha me fjalën vëllazërim, sidomos në sferën politike (partiake, idelogjike etj.), sa që në fazën “e re” të transicionit dilka e zbehur kuptimësia e vërtetë e fjalë-termit vëllazërim(!), prandaj stili i ri i shprehjes kërkoi zgjidhje të re dhe kjo sinonimi. si zgjidhje e tolerueshme, që u ofrua nga nga italishtja me kalkun binjakëzim qenka fat e fakt i mirëpritur?!

Ne duke u bazuar në zhvillimin e brendshëm të gjuhës sonë standarde, pa e mbrojtur me çdo kusht pacenueshmërinë e konceptit që shpreh fjalë-temi

vëllazëri vëllazërim vëllazëroj, paraqesim dy argumente të tjera që bien ndesh me arsyetimin e mësipërm rreth qëndrueshmërisë së kalkut binjakëzim.

E para, njohësit e mirë të fjalëformimit për koncepte të përafërta nuk kërkojnë ndihmë nga jashtë, po parësorisht shfrytëzojnë potencialin e brendshëm të gjuhës dhe pikërisht për këtë qëllim del ose ofrohet siparashitesa speciale fjalëformuese *si-*. Pra, në rastin konkret, nëse trajta *vëllazërim vëllazëroj* duket e konsumuar për stilistin, atëherë për konceptin paksa të ri të përafërt do të mund të dilte më e pranueshme trajta *sivëllazërim sivëllazëroj*. Pra, gjithsesi më e drejtë do të dilte shprehja se dy asociacione të vendeve të ndryshme (shkolla, qytete etj) u *sivëllazëruan* a u bë *sivëllazërimi* i tyre se sa u bë binjakëzimi i tyre, apo jo?!

E dyta, nëse edhe zgjidhja e mësipërme duket jo e vetëmjaftueshme, atëherë më e drejtë do të ishte të shfrytëzohej trajta më e afërt (shkrimore e kuptimore) e së njëjtës rrënjë që shpreh koncept të ngjashëm, madje edhe më të përcaktuar për nocionin e dëshiruar, siç është trajta **vëllam-** (me rrjedhojat që dalin mbi këtë temë fjalëformuese motivuese). Kështu në vend të vëllazërimit (*vëllaznimit*) a të sivëllazërimit (*sivëllaznimit*) të dy asociacioneve fare natyrshëm mund të futet në përdorim fjalë-termi *vëllamim a vëllamërim*, d.m.th. *U bë vëllamimi a vëllamërimi* i dy asociacioneve (shkollave, qyteteve, bashkësive lokale etj.).

Gjithsesi fjalë-termat e sapopropozuar prej nesh janë më afër logjikës së të shprehurit shqip të konceptit përkatës se kalku *binjakëzim*, apo jo?

Siç dihet në fjalë-termin: *vëllam- vëllamëri*, në gjuhën tonë e kemi të trashëguar nga tradita popullore shekullore (është term i fushës së etnografisë) dhe me të sipas burimeve tona normative, kuptohet procesi ritual kur “dy shokë të ngushtë... që i pinë nga një pikë gjak njëri tjetrit, bëhen si vëllezër besnikë gjer në vdekje” (FGJSH). Mirëpo, siç dihet, në realitetin tonë shoqëror ajo shoqëri, sivëllazëri e miqësi e ngushtë *beset* nuk mbetet faktikisht në suaza të dy vetave, por ajo zgjerohet në familje, fise e më gjerë, pra merr karakter të një interesi vërtet human e masiv. Ne e dimë se vëllamëria, përkatësisht *kumbaria a nunëria, pobratimìa, burazerllëku a kardashllëku* e shoqërimet e ngjashme, që vende-vende ende vazhdojnë të kenë lënë gjurmë të ndryshme, madje në të kaluarën kanë luajtur rol paqetimi me interes jo të vogël në mbarëvajtjen e mirëkuptimit sivëllazëror të segmenteve të caktuara të bashkësisë sonë kombëtare e më gjerë. Mirëpo, kuptohet, kur kemi parasysh ndryshimet e normave shoqërore në kohën tone, ne, tashti ato procese mund t’i shikojmë më sy tjetër vështirimi, por pa ua mohuar e këputur ndërlihdjen e karakterit historik human që kishin. Prandaj

ripërtëritja simbolike semantike në kohën tonë *moderne* e fjalë-termave të tillë duke e shfrytëzuar mënyrën polisemike të kuptimësisë për konceptin në shqyrtim nuk më duket gjë e panatyrshme. Prandaj sivëllazërimi i tillë s'ka arsye të mos shfrytëzohet a ripërtërihet edhe sot e kësaj dite po me ato emërtime, kur është fjala te vëllazërimi i dy asociacioneve të vendeve të ndryshme (sidomos ndërshqiptare), siç u cek në këtë artikull. Vërtet, tash në mes të përfaqësuesve të asociacioneve të reja përkatëse në shenjë simbolike s'ka pse të kërkohet të pihen reciprokisht dy pika gjaku për vëllamërim, po sigurisht nënkuptohet se në këtë ceremoni do të pihet e përjetohet në mënyrë solemne pirja e "*shërbetit*" të miqësisë së ngushtë, duke u shoqëruar edhe me *ziafetin (koktejn) e rastit*.

Pra sipas procesit të ngjashëm në vend të kalkut binjakëzim, mund të përdoret gjithsesi barasvlerësi **vëllazërim**, përkatësisht **sivëllazërim**, por mbase edhe më *profesionalisht vëllamëzim* ose **(si)vëllamim**, **(si)vëllamërim**, varësisht nga hijesa stilistike që duam t'i japim kontekstit, sidomos kur është fjala te asociacionet ndërshqiptare.

Në favor të mendimit tonë sjellim shembuj të regjistruar në burimet e caktuara tradicionale të gjuhës sonë letrare: vëllam vëllamëni e vëllamëri (K. Kristoforidhi); vllam (n'Tenzonë) vllamni (F. i Bashkimit), vëllamnoj (për fraternize) (T. Man); vëllam vëllami vëllamërim,(FGJSH) etj., kurse vetë sistemi fjalëformues na i bën të lejueshme fare natyrshëm trajtat foljore me prejfoljorët përkatës si vllamnoj (vëllamnim) vëllamëroj (vëllamërim), ashtu edhe vëllamësoj (vëllamësi/m), vëllamëzoj (vëllamëzim) e ndonjë tjetër.

Para se të përfundoj po e cek e dhe një fakt tjetër, sipas kuptimësisë që priren të shprehin **foljet më -zo-**, mund të themi se trajta **vëllamëzoj** ka mbështetje të ligjshme për konceptin në shqyrtim, ndërsa trajta *binjakëzoj binjakëzim* jo aq, ngase me binjakëzim priret të shprehen procese tekniko-teknologjike (kimike), ku nënkuptohet bashkëdyzimi (binjakëzimi) i komponenteve të caktuara substanciale (kimikisht), veprime këto që s'kanë të bëjnë aspak me binjakimin(!) e asociacioneve shoqërore.

Sidoqoftë, qëllimi i këtij artikulli është që të tërhiqet vërejtje se edhe kalket e paqëlluara nganjëherë mund të jenë po aq të dëmshme, madje edhe më shumë se sa fjalët e panevojshme të huaja, të cilat kur e lëndojnë natyrën e gjuhës sonë letrare, mund të flaken jashtë sigurisht më lehtë se disa kalke të paqëndrueshme, të cilat më me vështirësi kuptohen dhe më me zor mund të nxirren jashtë. Me një dukuri të tillë, kur personi i caktuar ka menduar në gjuhë të huaj e ka kalkuar shqip, kemi qenë të ballafaquar mjaft ndjeshëm në në Kosovë, siç është rasti *kyç kyçe* nga *ukluçiti ukljuçenje* të serbishtes,

shembull i keq ky nga i cili edhe sot e kësaj ditë s'po mund të lirohen edhe disa nga akademikët tanë të dëgjuar. Po e kësaj natyre më duket se është edhe kalku i shpifur nga italishtja *binjakëzim* (*gemellaggio*), prandaj në këtë drejtim duhet pasur kujdes, jo vetëm përkthyesit a gazetarët e pa përvojë, por edhe gjuhëtarët standardologë, të cilët duhet të reagojnë me kohë dhe që në zanafillë të luftojnë barin e tillë të keq që mos ta lënë të lëshojë rrënjë pirre në kopshtin e bukur të gjuhës sonë standarde.

Po përfundojmë me rikonstatimin se fjalë-termi **binjakëzim**, për konceptin e vëllazërimit, përkatësisht sivëllazërimit në mes dy asociacioneve (qyteteve, institucioneve përkatëse) të shteteve të ndryshme, nuk del e nevojshme të përdoret fare, kur për konceptin e tillë, pos **vëllazërimit** a **sivëllazërimit**, mund të futen në përdorim edhe trajtat përkatëse si (si)**vëllamim**, **vëllamnim**, **vëllamërim** a **vëllamëzim**, të sforcuara, në rast nevoje edhe me siparashitesën **si-**, varësisht nga hijesa semantike e stilistike që dëshirohet të arrihet me të shprehur.

E them, jo pa keqardhje se pikërisht këtë kalkëzim e ndeshim të përkrahur në burimet tona normative nga Qendra, mjerisht!

Prishtinë, 13.04.2001

26) INFIKSI -IR, FORMANT I SHPIFUR FOLJOR NË GJUHËN SHQIPE

Në gjuhën e folur te ne, po edhe në atë të shtypit, here pas herë, ndeshim ndonjë folje me infiksin -IR- si p.sh.:

1. *serviroj*: "janë serviruar" (*Kosovarja* nr 5-6/88, f. 11; *Zëri i rinisë*, 16.VI.1990, f.36); *Bujku*, 27.6.'94, f.6, 26.11.'94, *Fjala jonë*, mars '95, f. 8;

2. *armiroj*: "elemente të armiruara -prodhim kosovar", armirues (*Rilindja* dt. 25.V.1990 f.1; *Shkëndija*, 10.II.1992; 17.02.'92; *Bujku*, 24.06.'94, f.10; 8.07.'94, f.11; 10.04.'95, f.16,16;

3. *pariroj*: *Shkëndija* pariroj, janar '91, f. 22; "për të pariruar mbrojtjen e ..." (*Fjala jonë*, 26.XII.1994, f.22; shkurt '95, f.2); "po pariron" (*Dielli* 8.IV.1992);

4. *graviroj*: "dyqanet vulëpunuese graviruese" (*Rilindja*, 28.V.1986, f.14; 8.III.2000 f. 12);

5. *gaziroj*: "pije të gaziruar" (*Shëndeti* nr. 8-9/84 f.20; *Rilindja*, 11.III.2000, f. 24; 12.08. 2000, f. 13);

6. *variroj*: "u bë varirimi" (*Bujku*, dt. 29.XII.1991); "të ketë varirime në aspektin e përcaktimit" (*Rilindja*, 17.XII.1988, f.15).

7. *furniroj*: (*Bujku*, 27.09.'93, f.6,8);

8. *poliroj*: mobilet e poliruara (*Kosovarja*, 20.02., f.29).

Ndonëse ndeshim edhe shembuj të tjerë si *renoviroj*, *parkiroj*, *betoniroj* etj etj., ne nuk e pamë të arsyeshme të sjellim raste të tjera, ngase besojmë se ilustrimet që u dhanë më lartë mjaftojnë sa për ta paraqitur problemin, i cili kërkon trajtim të posaçëm. Për medimin tonë, lidhur me këtë dukuri del e nevojshme të sqarohen këto tri çështje:

e para, ku e ka zanafillën formanti -IR- dhe si përftohet ai në gjuhë të tjera;

e dyta, formanti -IR në gjuhën tonë a mund të arsyetohet si element i nevojshëm, qoftë si pjesë e temës së huazuar, qoftë si pjesë mbështetëse e prapshitesës -O- dhe

e treta, çfarë qëndrimi duhet mbajtur për rastet e tilla?

1. Skemë shembujsh në disa gjuhë

Për të pasur më të qartë problemin po japim nja shtatë folje-shembuj të këtij nëntipi, ashtu si dalin të zgjidhura në disa gjuhë të huaja:

serbisht	rusisht	gjermanisht	frëngjisht	italisht	shqip?!
1) servirati,	servirovatj	servieren,	servir,	servire;	<i>servoj</i>
2) varirati,	variurovatj,	variieren,	varier,	variare;	<i>varoj</i>
3) asocirati,	asocirovatj,	associeren,	associer,	associare	<i>asocoj</i>
4) gazirati,	gazirovatj,	gasieren,	gazer,	gassare;	<i>gazoj</i>
5) armirati,	armiurovatj,	armieren,	armer,	armare.	<i>armoj</i>
6) parirati,	parirovatj,	parieren,	parer,	parare;	<i>paroj</i>
7) grupirati,	grupirovatj,	grupieren,	grupper,	gruppare;	<i>grupoj</i>

Siç mund të shihet nga shembujt më sipër kemi të bëjmë me fjalë që në thelb kanë cilësi të fjalës ndërkombëtare. Nga shembujt shihet se vetëm në gjermanishte prapashtesa **-IR** del e ndryshuar në **-IER-** para formantit karakteristik foljor **-EN**, por në gjuhët e tjera sufiksi **-IR-** del i pa ndryshuar para formanteve përkatëse karakteristike **-ATI**, **-OVATJ** të serbishtes e rusishtes. Në frëngjishte shembulli i parë del **-IR** pa ndonjë fonemë shtesë, ndërsa në italishte **-IRE**, si në latinishte. Ndërkaq te shembujt e tjerë (4-7), ndonëse në frëngjishte e italishte ndryshojnë prapashtesat foljore, përkatësisht **-ER**, **-ARE** në gjuhët e tjera vazhdon të përdoret po ai formant i pandryshuar, siç përdoret për shembullin e parë. Tek dy shembujt pas të parit (2-3) vihet re se në të gjitha gjuhët, përveç serbishtes, del e shënuar një **-I** e temës fjalëformuese, ndërsa prapashtesat mbesin të pandryshuara, d.m.th., si te shembujt e mëparshëm. Barasvlerësin në shqip e shënova pa infiksin **-IR**, ngase ashtu e lyp natyra e gjuhës shqipe.

Pra, kur është fjala te formanti **-IR**, rreth përcaktimit të burimit të tij, me përjashtim të shembullit të parë që dilte edhe në frëngjisht e italisht që ishte i trashëguar nga forma e latinishtes *servire*, te shembujt e tjerë del qartë vetëm në gjuhët sllave: serbokroatisht e rusisht për të gjithë shembujt, prandaj mund të konstatohet se ky infiks siç u quajt në titullin e artikullit tonë në shqipe ka hyrë nga ndikimi i këtyre gjuhëve. Mirëpo, siç mësojmë nga studiuesi R. Filipoviq:

Sufiksi foljor -IR/ATI, siç është b.f. te folja betonirati në gjuhën

serbokroate, përbëhet nga formanti -IR- i adaptuar nga ai i gjermanishtes -IER- plus formanti -A/TI, (autokton) si karakteristikë e infinitivit të serbokroatishtes. (Shih:Teorija jezika u kontaktu, Zagreb 1986.)

Pra, për temën tonë që po e trajtojmë është me interes konstatimi se formanti -IR- në serbokroatishite ashtu edhe në rusishite e gjuhë të tjera sllave është adaptim i trajtës -IER- të gjermanishtes, e cila, ç'është e vërteta, në atë gjuhë shqiptohet -IR.

Kështu mësuam për origjinën e këtij formanti, i cili në gjuhën tonë do të jetë shpifur nga gjuhët sllave dhe jo drejtpërdrejt nga gjermanishtja.

2. Në asnjë rast nuk mund të arsyetohet elementi -IR- si pjesë e nevojshme e foljes në shqipe

Kur është çështja se elementi -IR- a mund të arsyetohet si pjesë e nevojshme e temës në shqipe apo si një element mbështetës i prapashtesës -O/j me zgjerim të shqipes, përgjigjja do të dalë edhe më e kuptueshme, pas sqarimeve që po japim më poshtë:

E para, siç e kemi të njohur, me rastin e huazimit të foljes nga një gjuhë e huaj në shqipe që moti është praktikuar dhe praktikohet edhe sot i ashtuquajtur i huazim hibrid që do të thotë huazohet tema (leksema) e qëndrueshme, ndërsa zëvendësohet automatikisht tërësisht morfema sufiksore barasvlerëse zakonisht me prapashtesën -O/j ose -E/j të shqipes. Sa për ilustrim po i cek faktin se shembulli i parë **servire** i latishtes në shqipen e hershme doli **shërbej (me shërbye, shërbyer)**, e më vonë **servoj** (servir) (**me servue, servuar**) dhe në të dyja zgjidhjet del e zëvendësuar vetëm prapashtesa **-ire**, pra me formantin barasvlerës të shqipes **-E/j, (YE/r)**, përkatësisht **-O/j (UA/r)**. Krahaso edhe disa shembuj të tjerë të huazuar po nga latinishtja:

durare - duroj, cantare - këndoj, laudare - lavdoj, affricare - fërkoj, benedicere - bekoj, capere (it. capire) - kuptoj, certale - qortoj etj.

Gjithashtu krahaso edhe këto folje të huazuara më vonë:

montoj - it. montare, fr. monter; frezjoj - it. fresare, fr. freser; paketoj - fr. paqueter; aprovoj - it. approvare; aktivoj - gjerm. aktivieren.

Pra siç mund të shihet prapashtesa -O/j e shqipes del si barasvlerës i plotëfuqishëm ndaj formave prapashtesore të gjuhëve të tjera, prandaj kur kemi parasysh shembujt që diskutohen këtu, është dashur që huazimi të bëhet sipas rregullës që u cek më sipër, d.m.th. të huazohet tema e pamodifikuar

dhe të zëvendësohet tërë sufiksi i gjuhës së huaj me prapashtesën shqipe -O/j, prandaj barasvlerësit e diskutueshëm në shqipe duhet të dilnin normalisht:

servoj, varoj, asocoj, gazoj, armoj, paroj, grupoj

dhe kurrsesi me ndërshtesën **-IR-**, madje edhe pa elementin -I- të temës fjalëformuese që del i shfaqur në gjuhët e tjera për dy rastet pas të parës.

Me fjalë të tjera, prapashtesa -O/j (-UA/r) për këtë tip foljesh ka barasvlerësi të plotë me sufiksats e gjuhëve përkatëse: gjerm. -IEREN, -I/IEREN, fr. -IR, -ER, -I/ER it. -IRE, -ARE, I/ARE, prandaj edhe serb. -IRATI e rus. -IROVATJ, -I/ROVATJ, pa marrë parasysh se në akëcilën gjuhë sufiksi i caktuar ka më shumë ose më pak fonema.

E dyta, për të mos pasur ngatërresë të tillë semantike e morfofonetike në të ardhmen, për shkak të përputhjes numerike -O/j (-UA/r) të shqipes me formantin -A/TI të serbokroatishtes, për arsye thjeshtë formale (numri pothuajse i njëjtë i fonemave etj. në vazhdim po japim disa shembuj që ilustrojnë raportin e foljeformimit të shqipes me atë të serbokroatishtes:

Së pari, sa për dijeni të përgjithshme po përmendim faktin se në serbishte (si edhe në gjuhët e tjera të konsultuara) si formë përfaqësuese e foljes del infinitivi e në shqipe forma e së tashmes së dëftores, por, siç dihet edhe te infinitivi i shqipes edhe te ky nëntip foljesh -O-ja del e zbërthyeshme nga *-O/n në -UO- e së këtejmi në: UE(m) ose UA/r(*n), siç u shënuar edhe në shëmbujt pak përpara. Krahaso p.sh. nga **pun(ë)- punoj (me punue(m), punua/r *n)** ngjashëm me serbokroatishten: **rad -(radim): raditi**, prandaj edhe shëmbujt e tjerë duhet të kuptohen drejt.

Së dyti, t'i kujtojmë disa huazime të vjetra nga serbishtja, me formantin -I/TI, si p. sh. poručiti (naručiti, poručivati)- porosit (me porositë, porositur); čuditi - čudit (me čuditë, čuditur), grabiti (zgrabiti) - grabit (me grabitë, grabitur) etj., të cilat në shqipe etimologjikisht shpjegohen si huazime sllave, por në gjuhën e sotme mund të zbërthehen duke e nxjerrë formantin -IT si prapashtesë të identifikuar nga tema e qartë fjalëformuese e shqipes: çudi, porosi, grabi.

Së treti, formanti i tillë nga huazimet sllave del i zëvendëndësuar me barsvlerësin -O-j të gjuhës shqipe si p.sh.: besedeti – bisedoj (me bisedue biseduar), obogatiti (obogačivati - begatoj (me bagatue begatuar), brazdati (brazditi, brazdovati, brazdicati) - brazdoj (me brazdue, brazduar) etj.

Së katërti, po i përmendim disa nga huazimet e përbashkëta nga turqishtja dhe këtë rast të vihet re prapashtesimi në gjuhët përkatëse serbisht - shqip, si: p.sh. begenisati - begenis (me begenisë, begenisur), ujdiasati - ujdias (me ujdiasë, ujdiasur), dalldiasati - dalldias (me dalldiasë, dalldiasur), kallajisati -

kallajis (me kallajisë, kallajisur), degdisati - degdis (me degdisë, degdisur) etj., ku shihet qartë se serbishtja ia shton formantit autokton A/TI edhe infiksin -IS-.

Së pesti, të krahasohen edhe disa shembuj më -ISATI të serbishtes që në shqipe marrin prapashtesën -O-, si: kaparisati – kaparoj(me kaparue), sapunisati – sapunoj me sapunue ose me sapunisë, katranisati – katranoj (me katranue), dembelisati - dembeloj (me u dembelue, me u dembelavë dembelosur etj.

Së gjashti, po i ripërmend edhe disa nga huazimet e ngjashme me ato që u cekën më sipër, nëntipi me infiksin -IR-, nga gjuha latine a paslatine, si p.sh.: formoj - formirati, adjustirati - axhustoj, blokirati - bllokoj etj., ku marrin pjesë, pra, edhe shembujt që u trajtuan më sipër me infiksin -IR: servirati - servoj, parirati - paroj, grupirati - grupoj, gazirati,- gazoj, varirati - varoj, asocirati - asocoj.

Nga sa u paraqit më sipër kuptohet lehtë se shqipja letrare në raport me gjuhën serbokroate në foljeformim i ka qëndruar fort natyrës së vet. Pra as nga formantet prapashtesore të gjuhëve të huaja dhe as nga serbishtja, në të kaluarën nuk e ka përvetësuar asnjë element, siç ka vepruar p.sh. serbishtja me **-IS** të turqishtes (greqishtes) dhe me **-IR-** të gjermanishtes, madje duke formuar edhe trajta dyjare paralele të cilat shihen të shtrira edhe te nëntipi i foljeve në shqyrtim, të cilat njëherazi njihen si trajta të normëzuara në atë gjuhë.

Skemë shembujsh në tri gjuhë

latinisht (italisht)	shqip	serbokroatisht
1) informare	informoj	informisati, informirati
2) integrare	integroj	intergrisati integrirati
3) intervenire	intervenoj	intervenisati intervenirati

Siç mund të shihet edhe nga këta tre shembuj shqipja të gjitha prapashtesat e huaja i ka konvertuar me barasvlerësin e vet zakonisht me prapashtesën -O- (UA/r), e cila sidomos në kohën tonë del shumë më aktive dhe prodhimtare se prapashtesa -E/j e ndonjë tjetër.

Me fjalë të tjera, infiksi -IR- i serbishtes vërtet del si një mish i egër, i shpifur dhe si i tillë fare i panevojshëm për strukturën foljeformuese të shqipes.

3.Çfarë qëndrimi duhet mbajtur për rastet e tilla?

Tash lidhur me pyetjen se çfarë qëndrimi duhet mbajtur për rastet e tilla, përgjigjja del e vetëkuptueshme: **duhen flakur tej**. Kështu nuk mendojmë vetëm ne, por edhe të tjerë. Kështu plotësisht ka pasur të drejtë studiuesi Xhevat Lloshi, i cili në artikullin "*Për pastërtinë e gjuhës*", të botuar në përmbledhjen "*Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*", Tiranë 1973, lidhur me sllavizmën "**grupirim**" (**grupiroj**) të shpifur atëherë në gjuhën tone, qoftë te ne nga serbishtja: **grupiranje grupirati**, qoftë andej nga rusishtja: **grupirovka grupirovatj**, kërkonte që në zanafillë të përfitim rastet si këto, jo vetëm se "*nuk duhen lënë në heshtje*", por bashkë me sllavizmat e tjerë, si thotë ai, pa hamendje **"duhet të fshihen pa na u dhimbsur"**. Sigurisht, një reagim i tillë, madje më i ashpër vlen edhe sot për rastet që u diskutuan prej nesh.

Sidoqoftë, nga kjo paraqitje mjaft gjëra besoj se u sqaruan, prandaj edhe rasteve të tilla nuk duhet lënë vend as në ligjërimin e thjeshtë dhe assesi as në gjuhën e shkrimit.

Përfundim

Në fund si përgjigje se si duhet vepruar për t'iu ikur rasteve të tilla problemore, me qëllim që shfaqjet e rastit mos të kalojnë në dukuri, mendoj se mund të na shërbejnë këto dy këshilla parimore:

E para, mos të huazohen aq lehtëzi foljet e këtij tipi (edhe në qofshin të karakterit ndërkombëtar), sidomos kur konceptet e tilla ka mundësi të shprehen me sinonime a fjalë të tjera ekzistuese nga burimi i shqipes, varësisht nga konteksti. P. sh. për *servoj* (servir) në shumë raste më mirë është të përdoret **shërbej**; për gravoj **skalit** (gëdhend); për varoj **ndryshoj**; për paroj - "**shmang goditjen**" etj.

E dyta, nëse paraqitet nevojë e domosdoshme, atëherë të veprohet sipas traditës së huazimit d.m.th. të shfrytëzohet mënyra hibride e huazimit, zakonisht të respektohet tradita e përkthimit nga gjuhët romane: italishtja e frëngjishtja e të tjera, d.m.th. tema huazohet e pandryshuar, e cila në raste duhet t'i përshtatet natyrës së fjalëformimit të shqipes, ndërsa sufiksi të zëvendësohet me prapashtesën -O- pa zgjerim, ashtu siç rekomandohet tek

shembujt e diskutuar këtu: **servoj, paroj, gravoj, gazoj, armoj, grupoj, varoj, asocoj.**

Gjithsesi trajtat me infiksin -IR duhet të cilësohen si shkelje e normës së shqipes letrare, andaj nga shembujt e tillë duhet flakur pa mëdyshje meshtesa e tillë –IR- si nga gjuha e shkrimit ashtu edhe nga ajo e folur.

Prishtinë, mars 2002

**27) RRETH IDENTIFIKIMIT TË FORMANTIT –AV
SI PRAPASHTESË E SPECIFIKUAR
FOLJEFORMUESE NË SHQIPE**

Në burimet e sotme normëzuese teorike të shqipes standarde formanti –AV, edhe pse nuk ceket fare, del i identifikuar më tepër si infiks ose konglutinat prapashtese sesa si një prapashtesë e mëvetësishme, madje në asnjë rast nuk e ndeshim të pohuar, për çudi, as si infiks prapashtese foljeformuese(!). Mirëpo meqë në realitetin tonë gjuhësor këtë formant jo vetëm e ndeshim si konglutinat prapashtesor në kategoritë e sistemit emëror edhe të atij foljor, por e ndeshim edhe në funksion thjesht si prapashtesë të mirëfilltë foljeformuese, ne, kësaj teme po ia kushtojmë këtë trajtesë, punim ky, të cilën e kemi merenduar në këto gjashtë pjesë, që po i paraqitim në formë pyetjesh:

E para, si trajtohet ky formant nga D. Nikollë Gazulli dhe Xhuvani-Çabej?

E dyta, si qëndron raporti ndërndikues shqip-serbisht i shembujve me këtë formant (ngjasime dhe dallime)?

E treta, ky formant del i identifikueshëm, në fjalorët normative të shqipes së sotme letrare, apo jo?

E katërta, në cilat burime leksikografike ndeshim shembuj, ku formanti –AV në zëra të veçantë, figuron si prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese?

E pesta, pse ka mbetur e patrajtuar nga standardologët tanë deri tashti një dukuri e tillë foljeformuese?

E gjashta çfarë i imponohet shqipes së sotme dhe standardit të saj lidhur me këtë dukuri?

Natyrisht, meqë kemi të bëjmë, si me thënë, me një temë të parrahur më parë nga studiuesit tanë, përpjekjen tonë e quajmë skicë trajtimi ose sprovë të parë ballafaqimi, teorikisht e praktikisht, lidhur me këtë dukuri, andaj nga lexuesi i nderuar dhe sigurisht edhe nga studiuesit kërkojmë konsideratë për këtë punë tonë filltare, por njëherazi ngulmojmë që ata (studiuesit) varësisht nga specializimi që kanë, t'i shtojnë vetes obligim që këtë çështje ta zbardhin sa më mire dhe zgjidhjen e saj ta bëjnë sa më të lehtë.

1. Nga konstatimet e Dom Nikollë Gazullit dhe Xhuvani-Çabejt rreth formantit -AV

Formanti –AV si prapashtesë fjalëformuese e mëvetësishme, me sa dimë, së pari është cekur nga **D. Nikollë Gazulli** në *Fjalorthin* e tij (1941) dhe pastaj edhe nga **Xhuvani-Çabej**, në monografinë, *Prapashtesat e gjuhës*

shqipe (1962, por aty ky formant trajtohet, jo si prapashtesë e mëvetësishme, por si konglutinat në 8-9 variante.

Sidoqoftë, e pamë të arsyeshme që konstatimet e tyre dhe tonat lidhur me ato vepra, paksa të parafrazuara prej nesh, t'i sjellim në vijim.

a) Konstatime nga *Fjalorthi i D. Nikollë Gazullit (1941)*

D. Nikollë Gazulli, në veprën **Fjalorth i ri (fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnisë)**, Tiranë, 1941, formantin –AV dhe atë –AVRË? (këtë me pike pyetje) i shënon si prapashtesa të mirëfillta të gjuhës shqipe dhe për ilustrim jep këta shembuj:

a) –AV: arrgj-av-istë (i rrgjavët, pal-av-itë (palue), mbuh-av-itë (mbuhatë), guj-avë (guall-i, zhgyrrëç-i), çgallavitë (sgallë), bardh-av-el (bardhë).

b) –AVRË (?): pet-avër-a (petavër).

Meqë, nga studiuesit e deritashëm paraqitja e të nderuarit D. N. Gazulli rreth identifikimit të formantit –AV si prapashtesë e mëvetësishme e shqipes, madje e specifikuar si foljeformuese nuk dimë se është shoshitur si duhet. Ne, veprën në fjalë, e konsultuam me vemendje të shtuar dhe konstatimet përkatëse po i shprehim në vijim:

Së pari, edhe pse autori në shembujt përkatës formantin –AV nuk e shënon veçan, por si konglutinat me prapashtesën përkatëse, megjithatë nga zberthimi i shembujve perceptimi i mëvetësisë së saj bëhet i mundshëm. Kështu, me këtë punë ky dijetar mund të cilësohet si pararendës i dijes së sotme lidhur me ndërtimin e foljeve me prapashtesën e mirëfilltë –AV. Kjo që u tha vërehet te mbiemrat: **i rrgjavët, bardhavel** dhe tek emri **petavër**, sepse kuptimisht mbiemrat e tillë nuk tregojnë aq cilësi sa koncept veprimi, madje edhe ndërtimisht kuptohet se janë formuar mbi bazë të pjesores së foljes përkatëse: **rrgjavë (me rrgjavë)**, ashtu si edhe **bardhav(ë) (bardhavë, me (u) bardhavë)** + *-el*, ashtu si edhe shembulli *petavër* si prejpjesor > petë +AV/ër - **petav/ë+ËR (me petavë)**, prej nga del edhe mbiemri **i petavtë, peta(v)ç**.

Së dyti, është me interes të dihet se edhe brenda tekstit në nja dy raste autori mbron formantin –AV si prapashtesë të mëvetësishme të shqipes.

E para, këtë e shpreh mjaft qartë kur foljen **palav/itë**, d.m.th. **pal/av**, pa –itë fundore, e krahason me pjesoren e shqipes **palue** (me palue) “**e palaviti me fjalë**” d.m.th., siç e shpjegon ai, “**E paloi, s’e la me folë**, me ç’rast formantin –AV e krahason me prapashtesën – **Oj (*On/ ue)** të shqipes, folje

kjo që del e formuar nga emër-tema **pal/ë**-a. Së këtejmi, na imponohet krahasimi i këtyre katër trajtave foljore mbi emrin temëfoljeformues **palë-a**:

Pal/OJ me pal/UE
Pal/AV me pal/AVË
Pal/IT me pal/ITË (!)
Pal/OS me pal/OSË

Dy trajtat e para edhe trajtën **palit(i)** me mbaresë sllave i ka shënuar vetë autori, ndërsa atë **palos me palosë** (të letrarishtes së sotme) e shtuam ne.

Të jemi më të qartë, vihet re, se autori te folja: **palav/itë**, duke e krahasuar formën e foljes pa fundoren **-itë**, vetvetiu na jep për të kuptuar se formantin **-AV** njësohet me prapashtesën **-O (UE)**, **paloj, palue (palavë)**. Në këtë mënyrë me vetëdije formantin **-AV** e konsideron me origjinë anase, sinonim me prapashtesën **-Oj (/UE)**, duke i sfiduar kështu historianët e gjuhës sonë, të cilët patjetër duhet ta vrasin (cysin) mendjen se ky element mos ka të bëjë, apo jo, me ndonjë farë ngjasimi me zhvillimin e prapashtesës **-Oj** nga ***On *UO, UA, UE / -Oj** dhe së këndejmi edhe diftongu i vjetër ***AU** mund të ketë ndjekur të njëjtën rrugë zhvillimi, duke u shndërruar në **AV**, proces ky i zhvilluar ndoshta që nga protoshqipja, apo jo? Sido që të jetë, autori si përforsim të mendimit të tij se formanti **-AV** është prapashtesë shqipe, ai pas foljes **arrgj/av**, të cilën e cilëson si formim të rregullt të shqipes, në kllapa qartëson: **mbaresa -AV**, duke shtuar argumentimin: **“mandej shihet ndikimi i gjuhës sllave me verbat që sosin në -iti dhe -ati”**. Pra, siç po shihet, autori e shpjegon mbaresën **-TI** të infinitivit të serbishtes veçmas jo në konglutinim me formantin **-AV**, siç del te shembujt e tij dhe në variantet e Xhuvani-Çabejt(!). (Shih aty, f. 297.)

E dyta, gjithashtu këtë mendim e përforcon edhe te shembulli **çerav/de** (i çgallavitun), ku fundoren **-de** e shpjegon si mbaresë sllave të tipit **çela/de**, ku shton sqarimin: **me ide të përbashkët (kolektive)**, ndërsa tërë fjalën **çerav** e konsideron trajtë të rregullt në shqipe. (Po aty, f. 229.)

Si përfundim, pra, në të dyja këto raste autori nuk e vë në dyshim prejardhjen autoktone të formantit **-AV-** te foljet e tipit **palav(-itë)**, ndërsa te fjalët përkatëse të këtij tipi, vetëm fundoret ose **soset**, siç i quan ai: **-i/ti** dhe **-de**, i konsiderom me prejardhje sllave.

Sido që të jetë, nga paraqitjet e tilla kuptohet se formanti **-AV(Ë)**, duke u ndarë veçmas nga shembujt me mbaresat ose fundoret infinitivore të

serbishtes –I/TI ose –A/TI, në fjalët e shqipes, ai (formanti –AV) del në funksion të qartë të prapashtesës foljeformuese, apo jo?!

Ne, këtë veprim të autorit e vlerësojmë si ide të mire ose kriter të mjaftueshëm që formanti foljeformues –AV(Ë), pa marrë parasysh se si do të argumentohet në analizat e ardhshme, qoftë si mjet i përbashkë, kryesisht anas i shqipes, qoftë si huazim transfer nga serbishtja ose ndonjë gjuhë e vjetër, ai gjithsesi në shqipe, siç po imponohet, duhet të cilësohet, apo jo, si një prapashtesë e mirëfilltë e specifikuar për formimin e foljeve të një tipi të veçantë?

b) Nga konstatimet e Xhuvani-Çabejt

Në monografinë *Prapashtesat e gjuhës shqipe (Tiranë 1962)*, profesorët tanë të nderuar e përfshijnë edhe formantin –AV, por, si të themi, jo veçan, po në funksion infiksi a si një ndërlidhës të temës fjalëformuese me prapashtesën përkatëse kryesisht të mbiemrit me të cilën, siç e shohin ata, ky formant del i konglutinuar në disa variante.

Së këtëjmi, për të parë se si del formanti i tillë në atë punim, bashkë me konglutinatet prapashtesore përkatëse, po japim edhe shembujt ilustrues që i shoqërojnë:

1) –AV/EC: burrav/ec, grindav/ec, ligav/ec, llapav/ec, qullav/ec, qyrrav/ec;

2) –AV/EL: bardhav/el, bashtav/el, kaçav/el, paçav/el, qyrrav/el; shurdhav/el, shushav/el, xarnav/el;

3) a) –AV/Ë: arrav/ë (arrë), gujav/ë (guall gujatë), myzav/ë (myzë a mizë) dhe shushav/ë (nga folja shushas);

b) –AV/ËT: i gurav/ët (gur), i hekurav/ët (hekur), i killavët (killë) i lizavët (li-a, lizë-a), i rrëgjavët (rrëgjuar) dhe i tërpiavët (terpi);

4) –AV/IK: grindavik, ndyravik dhe

5) –AV/IQ: lagaviq, lucaviq, ndyraviq, shurraviq.

Gjithashtu autorët e nderuar kanë në konsideratë edhe shembuj me prapashtesat:

–AV/I, –AV/ICË dhe AV/INË,

të cilat referohen në kuadër të prapashtesave përkatëse –I, –ICË, –INË, por, në tekst vetëm për variantin e parë jepen këta dy shembuj: *larav/i, palav/i*.

Dhe, siç konstatohet aty, të gjithë shembujt përkatës të gjininisë mashkullore e formojnë gjininë femërore me -E, si p.sh.: *ligavece; bardhavele, shurdhavele; ndyravike, lucaviqe* dhe *e guravët*.

Sidoqoftë, edhe pse këtu, siç e pamë, kemi të bëjmë me 8 a 9 prapashtesa konglutinuuese dhe shembujt janë dhënë, kryesisht, nga fjalët e brumit të shqipes, megjithatë autorët, këtë dukuri e shohin të ndërndikuar me format përkatëse të gjuhës serbe dhe si argument lidhur me këtë sjellin këta shembuj serbisht -shqip:

a) emra prejfoljorë: **grmljava** nga *grmljeti* (bubullimë), **država** nga *držati* (shtet), **mrkava** nga *mrknuti* (kaçubë);

b) mbiemra denominativë: **bodlikav** nga *bodlika* (me gjemba), **gizdav** nga *gizda* (i stolisur), **grbav** nga *grba* (kurrizdalë),

dhe në fund sjellin konstatimin jo aq kategorik: “**Prandaj mund të thuhet se prapashtesat tona: -AVË dhe -AVËT, janë prej burimit sllav**”.

Pra, siç vihet re, prapashtesat –AVË dhe –AVËT (që shënohen në një pike (pika 3)), quhen **prapashtesa tona**, por supozohen *me prejardhje sllave*, vetëm pse këtë formant e ndeshim edhe në gjuhët sllave tek emrat me –AV/A dhe mbiemrat me –AV, por nuk futen më thellë.

Sidoqoftë, nga sa më sipër, për ne, dalin disa çështje që kërkojnë sqarim e njëherazi edhe trajtim më profesional, p.sh.:

E para, pse autorët, nuk e paten në konsideratë dallimin e fjalëve me –AV të konglutinuara me këto prapashtesa **-el, -ë, -(i,e) -ët dhe -i** që kanë më tepër frymë vendese, nga ato **-ec, -ik, -iq** nënkupto edhe **-icë** dhe **-inë** të implikuara edhe në fjalët serbishte (madje për këto dy të fundit nuk e sjellin asnjë shembull me prapashtesë që ka edhe elementin –AV?

E dyta, del, apo jo, i identifikueshëm formanti –AV(Ë), qoftë si infiks, qoftë si prapashtesë e mirëfilltë e specifikuar edhe në sistemin foljor të shqipes apo vetëm në sistemin emëror, pasi ky fakt nuk ceket në studimin e tyre?

E treta, shikuar sipas dijes së sotme, përveç prejardhjes sllave për çka ne shprehim rezervë, kur është fjala te tema foljore, autorët kishin konceptet jo të qarta, apo jo, kur nuk e pohojnë temën foljore në formimin e fjalëve të tilla, edhe pse ajo vetvetiu imponohet, siç do ta vërtetojmë, edhe në shembujt sinonimikë të tyre?

Këtë që e thamë që disi atbotë studiuesit tanë nuk kishin koncepte të qarta për këtë çështje konkretisht e hetojmë te shembujt e shënuar prej tyre, si:

a) Jo vetëm tek të gjitha rastet e shembujve nën 1) dhe 2) por edhe nën 3), pika b), po edhe te mbiemri **i rrëgjavët**, si sqarim shënohet trajta sinonimike **i rrëgjuar**, ku shihet qartë pjesorja e shqipes së sotme **rrëgjuar** te mbiemri **i(e) + rrëgjuar**, dhe nga kjo del e kuptueshme se edhe tema prodhuese e të gjithë mbiemrave me –AV fundore të paranyjzuar **me i(e) – TË** është pjesore e mirëfilltë: **rrëgj+avë - i(e) rrëgjav+ët** ose **i(e) rrëgjav+TË (me rrëgjavë)**.

b) Së këtejmi, lypset një sqarim i domosdoshëm edhe lidhur me emrat e shënuar në kllapa prej tyre te shembujt: i nguravtë (**gur**), i hekuravtë (**hekur**) i killavët (**killë**), i lizavët (**lizë**), ngase kemi vërejtjen se ata (emra) nuk kanë të bëjnë me temën prodhuese të mbiemrave përkatës të shënuar aty, sepse, siç dihet, mbi bazë të emrave të tillë dalin këto trajta mbiemërore: **gur - i gurtë, hekur - i hekurt, killë - i killtë, lizë - i liztë**, ndërsa si tema prodhuese për shembujt me –AV shërbejnë, apo jo, pjesoret e foljeve përkatëse: **(me) nguravë – i(e) nguravtë, (me) hekuravë – i(e) hekuravtë, (me) killavë - i killavtë, (me) lizavë - i(e) lizavtë**, e kështu me radhë.

c) Madje ata faktikisht duke e pranuar të vërtetën se me prapashtesën –AVË janë formuar pak emra konkretë si **arravë**, nga arrë, **gujavë** nga guall gujatë si dhe **shushavë** nga folja shushas (variant foljor), nuk dimë pse aty bëjnë të njëjtin lëshim, ngase nuk sqarojnë drejt dukurinë, sepse siç e thamë, emri përkatës nuk shërben si temë fjalëformuese të emrave përkatës me –AVË-A: **arrive-a, gujavë-a (gujatë) dhe shushavë-a (shushas)**, ngase sipas dijes së sotme kemi të bëjmë me emërzimin e shembujve të tillë me mbare zero (me konversion) të pjesores e jo nga rrënjori, andaj formimet e tilla quhen **prejpjesorë pandajshtesorë**.

ç) Edhe sinonimet sqaruese **gujatë** për **gujavë**, dhe **shushas (me) shushatë** për **shushav shushavë** – përforcojnë sqarimin që u dha prej nesh në pikën e mësipërme.

Sidoqoftë, këto dhe çështje të tjera, siç është edhe raporti ndërndikues i prejardhjes (sllave) të formantit, për çka ne shprehëm rezervë, do të përpiqemi t'i zbardhim gjatë analizës në vijim, me synim që edhe përgjigjja në fund të trajtesës të jetë më e tejdukshme dhe më e pranueshme, sidomos për standardologët e gramatikanët tanë.

2. Raporti ndërndikues shqip - serbisht i shembujve me formantin -AV

Nga sa u parashtrua deri këtu del e nevojshme që shembujt me –AV të trajtohen në raport ndërndikues serbisht-shqip. Dihet mirëfilli se që nga shek IX – XIV shqipja ishte në kontakt me gjuhë sllave (bullgarisht, serbisht), andaj ndërndikimi i tillë, në intervale edhe me presione administrative e ceremoni kishtare etj. ka vazhduar me shekuj, madje vise-vise po vazhdon edhe në ditët e sotme. Kjo nuk mund të mohohet, megjithatë siç mund të konstatohet lehtë, secila gjuhë deri në ditët e sotme ka ruajtur në sistem thelbësoren e identitetit të vet.

Që në fillim të kësaj trajtese u cek mendimi i Xhuvani-Çabejt, të cilët edhe pse jo aq në mënyrë kategorike, u shprehen se formanti -AV(Ë), **mund të thuhet se ka prejardhje sllave**, ndërkaq D. Nikollë Gazulli, pak përpara tyre, u përpoq ta argumentonte se formanti –AV është prapashtesë shqipe, andaj e trajton ndaras nga mbaresat e infinitivit të serbishtes **-i/ti**, **-a/ti**, mirëpo edhe ky në finesa, te shembujt përkatës, nuk i mohon elementet e sllavishtes.

Meqë me sa dimë kjo dukuri ndërngjuhësore serbisht – shqip, nuk del e trajtuar, jo vetëm në thellësinë e gjerësinë e duhur, por as në shkallë normale, andaj edhe rreth konstatimit të burimit a prejardhjes sllave të formantit –AV, siç paralajmëruam pak përpara, duke u lënë vend studiuesve më kompetentë, për mendimin tone, mund të shprehet rezervë e ligjshme, kur kemi parasysh këto fakte:

Së pari, edhe para dyndjes së sllavëve në këto anë formantin -AV e kishte gjuha e folësve të këtyre trevave, së paku kjo vërtetohet me dy emra fisesh ilire: **kandav/ët** dhe **parauej/të ose paravej/të**, po ashtu edhe me dy emra qytetesh që kishin fundoren –AVA: **Setidava e Baridava**. si dhe emrat e lumejve. **Drava, Sava** etj. Madje edhe më bindës del emërtimi i qytetit të Prizrenit: **Dhermidava (Termidava)** që nga shekulli II (harta e Ptolemeut): d.m.th. para emërtimit Theranda, madje edhe Iliria e lashtë quhej **Kunavia**, (Kundavia) me rrjedhojat përkatëse toponimike.(Shih L. Alia, ZSH dt.11.08.2023.), shembuj këta e të tjerë që dëshmojnë se ky formant fundor ishte i pranishëm në gjuhën e këtyre viseve disa shekuj para dyndjes së sllavëve këndeje (shek. XII-XIV).

Së dyti, është i njohur shkencërisht fenomeni i shndërrimit të diftongut *AU indoeuropina në –AV, pra edhe në shqipe dhe si shembull ceket fjala

lauden e latinishtes që në shqipe reflektohet **lavd (me lavdue)**, fenomen ky që ka ndodhur gjithsesi para ardhjes së sllavëve në këto vise.

Së treti, dihet se -v- ja në shqipe është konsonant epentetik që dokumentohet edhe në sistemin foljor si b.f. te folja: **laj** (me la) **lava lave lau lafsh**, pastaj **pava** (pashë) me pa etj dhe në atë emërore, si: **kuajt kvaltë, evropë /europë, softuer / softver, harduer/hardver** etj.

Së katërti, kjo dukuri e shndërrimit të diftogut -**au** në -**av** shfaqet në mjaft shembujt në gjuhën tone të sotme, po i përmend vetëm nja dy raste nga shprehjet e gjalla (popullore) lidhur me emrat **shka shkav(i) dhe ka kau / ka kav(i)** etj. dhe kjo argumentohet edhe sot e kësaj dite në shprehjet::

Besa e shkavt si bishti i kavt (nuk rri pa lëvizur) ose

Lëkura e kavtë – opanga e qullavtë.

Së pesti, edhe pasthirrma habitore e dy gjuhëve AU-AU, zakonisht, sidomos te ne, shqiptohet **AV-AV!**

Së gjashti, kemi vërejtur se prof. Çabej kur përmend huazimet sllave në shqipe nuk e cek asnjë rast huazimi nga serbishtja me -AV fundore.

Së shtati, madje edhe shembujt ilustrues që japin Xhuvani- Çabej dalin shumë të diskutueshëm, madje edhe të pambështetur, kështu të tre emrat **grmljava, država** dhe **mrkava** nuk janë formuar me prapashtesën -AV, po me -VA. Ja si shpjegohet formimi i emrit **država (shtet)**, ashtu si edhe ai **davač (dhënës)** në serbishte: Nga tema e infinitivit bie -**TI, drža-ti** ose **da-ti**, dhe tani temës **drža-** ose **da -** i shtohet prapashtesa -**VA drža+VA, da-VA+ č**, pra **A-ja** para -V-së i takon temës së foljes, jo formantit -**AV**, ashtu disi shpjegohet edhe ndërtimi i emrit **grmljava**, (grmljati) ndërsa shembulli i tretë **mrkava** është inekzistent për serbishten letrare. Në serbishte për fjalën **kačubë** të shqipes nuk del barasvlerësi *mrkava*, por të tjerë si **žbun, šikara** e ndonjë tjetër. Edhe lidhur me mbiemrat mund të bëhet ndonjë vërejtje, po sidoqoftë ata dalin, si me thënë, të qëndrueshëm. Me fjalë të tjera, konstatimi rreth prejardhjes sllave nuk ka mbështetje nga shembujt e tillë ilustrues, por mbase në parim autorët kishin të drejtë, apo jo(!), le të vlerësohet.

Së teti, sipas studiuesit të njohur Nezir Myrtaj, studiuesit serbë, për të dëshmuar prejardhjen thrake jo ilire të shqipes dhe njëherazi për të vërtetuar vendlindjen e shqipes në Thraki e jo në Iliri paskan cekur si fakt pikërisht prapashtesat toponimike -ova dhe -ava që shqipja i paska marrë nga trolli i Thrakisë. Siqoqoftë, edhe ky fakt i jep përparësi formantit -AV në dobi të prejardhjes shqipe ndaj serbishtes, apo jo?

Së nënti, po ashtu studiuesit bashkëkohorë serbë (shih Wikipedia) e pranojnë që para shtrirjes së sllavëve në viset përkatëse të Ilirisë formanti –

AV që më parë e kishin pasur disa qyetete, veç tjerash cekin Domavi'a (Bajna Bashta), Landavi'a (Bjelasica) etj. dhe sidomos lumejtë: *Drava, Sava, Morava*, po edhe lumi **Dunav**, me prejardhje nga shprehja "donovi" (*donava - uji i madh). Me fjalë të tjera formanti –AV, paska qenë pronë e gjuhës më të hershme në këto troje dhe pastaj qenka përvetësuar nga gjuha tjetër, apo jo?!

Sido që të ketë qenë, besojmë se këto fakte janë të mjaftueshme sa për t'u sjellë në rishikim konstatimi e tillë rreth prejardhjes serbe të formantit –AV në fjalët shqipe **en bloc**, por më e rëndësishmja lidhur me këtë konstatim do të dalë nga analiza e mëposhtme, ku jo vetëm trajtat barasvlerëse nga fjalori, por edhe ato eptimore e të tjera do të preken dhe do të krahasohen, duke theksuar edhe disa nga fushat e nënfushat semantike që mbulojnë fjalët me –AV në të dyja gjuhët. Sido që të jetë, pra, meqë këtë formant e ndeshim, aktualisht në të dyja gjuhët serbisht e shqip, ne, për të pasur një ide më të qartë rreth këtij ndërnikimi shikuar kryesisht në rrafshin sinkronik, duke pasur në spikamë përkimet dhe dallimet, konsultuam shembujt përkatës nga fjalorët dygjuhësh serbisch-shqip dhe anasjelltas të botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës (*Fjalori serbokroatisht-shqip* (1974) dhe *Fjalori shqip-serbokroaitisht* (1981)) dhe nga ky konsultim, dhe jo vetëm nga ky, na u imponuan disa konstatime mjaft interesante dhe të rëndësishme që sjellin dritë rreth temës sonë, ndër të cilat, po spikasim këto:

E para, ç'është e vërteta, ndërsa në gjuhën serbokroate më drejtë në gjuhën serbe, formanti –AV, del i identifikuar si prapashtesë, kryesisht tek **një tip mbiemrash** dhe së andejmi si sufiks konglutinues del prodhues në formimin e disa foljeve, emrave dhe mbiemrave në atë gjuhë, në gjuhën shqipe **formanti –AV** del i implementuar parësisht si **prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese e një tipi të veçantë kuptimor e ndërtimor** dhe së andejmi ndeshet si infiks edhe në kategori të tjera si derivate siç janë edhe mbiemrat prejfoljorë e preppjesorë të tjerë.

Pra, ky është dallimi i parë që bie në sy aktualisht në mes të këtyre dy gjuhëve lidhur me përfitimet me formantin –AV. Pra, në serbishte **mbiemri me –AV**, është prodhues, por ndeshet në konkurrencë me trajta të tjera mbiemërore sinonimike, ndërkaq në shqipe **folja me –AVË** është vepruese dhe prodhimitare dhe, për konceptin përkatës, nuk ndeshet në konkurrencë me forma të tjera sinonimike.

E dyta, nga sa pamë, numri i mbiemrave të regjistruar në burimet përkatëse më –AV fundore në serbishte kalon 100-shin, të cilët mbulojnë kryesisht *kuptim neutral*, por mbizotërojnë ata të fushës përkatëse pejorative,

por jo të gjithë shembuj janë aktivë, ndërkaq në gjuhën shqipe edhe pse numri i regjistruar i mbiemrave me –AV në fjalorët normative nuk del aq i madh (hë për hë ende nuk është vjelë në masë, andaj në fjalorët popullorë edhe nuk dihet numri), pjesërisht ka përputhje konceptesh me një pjesë të mbiemrave të serbishtes pikërisht për fushën pejorative, por i dallon konglutinimi dhe përshkallëzimi përkatës kuptimor, mirëpo nëse shikohet folja shqipe si bosht fjalëformues edhe për këtë nëntip, atëherë numri i përfitimeve i foljeve potenciale me –AV(ë), siç do të shohim, mund të kalojë shumëherë 100-shin dhe kuptimisht del e specifikuar pothuajse plotësisht për një koncept të përshkallëzuar në kuadër të fushës pejorative.

E treta, pikërisht sa i përket fushës kuptimore që mbulojnë, mbiemrat me –AV serbisht e shqip, vetëm në fushën pejorative kanë njëfarë përkimi, por jo të plotë, siç u tha. Në të vërtetë dallimet shihen kur kemi të bëjmë me hijesa përshkallëzuese semantike brenda asaj fushe. Për ndryshim nga shqipja, pothuajse të gjithë mbiemrat e tipit me –AV në serbishte shprehin kuptimësi pak a shumë elemente neutrale edhe brenda fushës pejorative, ashtu si edhe mbiemrat e gjuhës shqipe me prapashtesat konglutinate: -AVTË, -AVEC, -AVEL, -AVIQ etj. por ky dallim kuptimor ndryshon, siç u tha, tek përshkallëzimi i shembujve përkatës.

E katërta, për të parë më mire përkimet e dallimet strukturore fjalëndërtuese në këtë raport ndërgjuhësor brenda fushës pejorative po i paraqitim disa shembuj mbiemrash barasvleres sinonimikë në dy versionet: shqip-serbisht e anasjelltas.

a) Versioni shqip – serbisht:

1) *fëlliqan, fëlliqash* - **i(e, të) fëlliqavtë** - prljav, kaljav, blatnjav, glibav, mrljav, škrbav, musav, škarnjav, smoljav.

2) *çalaman, topall*, - **i (e, të) topallavtë(!)** - bagav, çopav, šepav (topallast),

3) *marrash, budalla*, - **i (e, të) budallavtë(!)** - blesav, šaşav, tupav, manjkav, manjičav, glupav, benav, tvdoglav, budalav (budala, budalast).

4) *i belbët, belban* - **i (e, të) belbavtë(!)** – mucav, mutav, bekov, topav.

Siç po shihet zakonisht të gjithë shembujt në serbishte dalin me **prapashtesë të njëjtë -AV**, në shqipe nuk ndodh ashtu. Mirëpo edhe në shqipe, ashtu siç po e shohim te shembujt e mësipërm të serbishtes, për

mbiemrin e caktuar të asaj gjuhe dalin disa barasvlerës sinonimikë, por për dallim, siç do ta shohim, në shqipe mbiemrat dalin me **prapashtesa të ndryshme**.

b) Versioni serbisht – shqip

1) **slinav** – qyrrash, qyrravec, qyrranjës, përqyrran, qurrac, qurramadh, qurran, i qurrosur, - **i (e)qyrravtë, i(e)përqyrravtë**;

2) **mlitav** – i (e) qullët, qullac, qullan, qullamc, qullamaç, qullash, i(e) mveshtë, i(e) ngathët, ndiferent, përtac, i plogët, indolent, i (e) qulltuar, i(e) qulllosur, – **i (e) qullavtë**;

3) **gušav** – gushan, gushëdalë, gusharak, gushosh, gushacak, gushëfryrë, gushiq, gushëmadh, gushacak, gushak, gushar, gushok, – **i (e) gushavtë**;

4) **žutičav (bledunjav)** – i(e) verdhë, verdhac, verdhacak, verdhcuk, verdhëzak, verdhacuk, verdhak, verdhuk, verdhash, i(e) vërdhemët, i(e) verdhët verdhush, verdhosh, verdhuk, verdhul, i(e) verdhëm, i(e) verdhullëm, verdhacak, verdhok, verdhan, i(e) verdhuar, i(e) vërdhemë, – **i(e) verdhavtë**.

Siç po shihet në të dyja versionet, ne, grupit të shembujve të regjistruar në burimet përkatëse i kemi shtuar të nënvizuar (bolduar) mbiemrin e paranyjzuar në diskutim të shqipes, prapashtesa e të cilit ka në përbërje elementin -AV:

i (e, të) fëlliqavtë, i (e) topallavtë, i (e) budallavtë, i (e) përqyrravtë, i (e) qyllavtë, i (e) gushavtë, i(e) verdhavtë, i (e, të) belbavtë

të cilët nuk ndeshen, hë për hë, në burimet e konsultuara, por siç do të shohim bashkë me foljet përkatëse mbi bazë të pjesores nga e cila shpjegohen të formuar dhe në realitetin tonë gjuhësor kanë përdorim të rregullt, andaj edhe sfidojnë jo vetëm të njihen më mirë, por në ndonjë farë mënyre ose gjithsesi, gëzojnë të drejtën universale edhe të futen edhe në shqipen letrare për nënfusha të caktuara kuptimore.

Të jemi më të qartë, të gjithë mbiemrat barasvlerës të shqipes ndaj mbiemrit të serbishtes, si p.sh: **slinav** – të dhjetit, **mlitav** – të 15-it, **gušav** të 12-it dhe **žutičav**, të 22-tit, si më sipër, asnjërin nuk e quajmë të tepërt, ngase janë formuar sipas gjedheve përkatëse të fjalëformimit shqip dhe shprehin ose

mund të shprehin një ngjyresë dallimore përshkallëzuese brenda konceptit të gjerë përkatës të nënfushës semantike, qoftë të natyrës neutrale ose edhe të përshkallëzuar, ndërkaq shembulli i fundit me **–AV/TË fundore** në shqipe, si: *i(e, të) fëlliqavtë, i(e të) topollavtë, i(e, të) budallavtë, i(e, të) përqyrravtë, i(, të) gushavtë, i(e, të) verdhavitë, i(e, të) belbavitë* - sigurisht i ngarkuar edhe me kuptim figurativ, e themi me plot gojën, mbulon, pa konkurrencë, shkallën më të lartë, atë të fundit të konceptit përkatës pejorativ, zakonisht përçmues, keqësues, gjithsesi mospëfillës. Pse ndodh kështu, si është formëzuar ky specifikim si rregull, nuk mund ta dijmë për cok, ngase kjo dukuri lypset studiuar. Mirëpo, neve na shkon mendja se kjo ka të bëjë me kushtëzime emocionale të karakterit sociolingustik të ravijëzuar në periudha të caktuara historike. Sido që të ketë qenë, tani kjo dukuri del e formëzuar më tepër në shqipe se në serbishte, siç e thamë, dhe ky fakt vërtetohet nga vetë stili i të shprehurit, nga i cili vetëdijshëm ose edhe nënvetëdishëm aksiomativisht arsyetohet në parim kjo e vërtetë e padiskutueshme.

E thamë edhe në serbishte, e vërtetë kjo që pranohet edhe nga tericienët e asaj gjuhë, edhe pse si duket edhe në atë gjuhë si edhe në shqip një specifikim i tillë i mbiemrave me **–AV** për fushën pejorative do të ketë lindur më vonë, sepse në perudhat e hershme nuk do të ketë ekzistuar kuptimi mbizotërues pejorativ i këtij formanti në asnjërën nga këto dy gjuhë.

E pesta, për ta kuptuar edhe më mirë diferencimin që bëjnë rreth përshkallëzimit kuptimor, në pikën e mësipërme, në kuadër të fushës pejorative, sipas raportit: **shkallë e gjerë neutrale/ shkallë më e lartë** e veçantë **përçmuese mospëfillëse**, po i japim nja tre shembuj mbiemrash serbisht me barasvlerësit përkatës të fushës neutrale (pejorative) në disa gjuhë të huaja dhe shqip:

Skemë shembujsh në disa gjuhë

serb	angl.	gjerm	fr.	It.	shq.
1) brblav	chatty	geschwatzig	causeur	ciarliero	fjalaman
2) qelav	bald	kahl	chauve	calvo	qelan (qeros)
3) šugav	mangy	raudig	galex	rognoso	zhugan (i zgjebosur),

Siç po shihet në rubrikën e fundit, shqip, për kuptimin neutral pejorativ vlejné a mund të vlejné si barasvlerës mbiemrat në shqipe jo në trajtat me **–AV**, por

të tjerë sinonimikë, si p.sh. për fjalën **fjalaman**, mund të vlejnjë shembujt sinonimikë që i ndeshëm të regjistruara në burime përkatëse:

llafazan, fjalacak, fjalatar, fjalaç, gojc, gojec, gojqen, përgpjaç, përgojc, përgojues, përgojç, përgojac, e ndonjë tjetër,

të cilët, mund të kenë (secili për vete) ndonjë shenjë a hijesë përshkallëzuese në fushën neutrale natyrisht me ngjyime përkatëse stilistike, por për shkallën më të lartë të ngjyimit përkatës mospërfillës, pra, po në fushën e kuptimësisë pejorative, që zakonisht bartin edhe kuptimësi të fytyruar, vjen në konsiderim vetëm trajta me –AV i **flamanavtë** ose **fjalamanavç**. Kështu për rastet e mësipërme, nëse nuk ndeshen të gatshme trajtat e tilla atëherë automatikisht, në realitetin tonë gjuhësor mund të improvizohen lehtë gjegjëset sipas modelit, si:

i(e) fjalamanavtë (fjalamanavç), i (e) përgojavtë (përgojavç), i (e) qelavtë (qelavç), i(e) zhugavtë (zhugavç),

dhe kështu kjo zgjidhje vlen për të gjitha rastet.

Si shprehen përshkallëzimet e tilla në gjuhë të tjera ne nuk mund ta dimë, por për gjuhën tonë, kjo që e thamë del shumë e praktikueshme, ngase ravijëzimin e tillë e kemi të trashëguar dhe pa mëdyshe, në realitetin tonë ligjërimor, gjallon.

Me sa kemi vërejtur, në ndonjë rast në toskërisht (letrarishite e sotme) koncepti i tillë, i shkallës më të lartë, qoftë te folja, qoftë te mbiemri a emri priret të shprehet me prapashtesën –OS (me prejardhje greke), si: zhubravit – zhubros, sklepav – sklepos, qelav/em – qeros/em etj., por dallimi i tillë përshkallëzues assesi nuk del i plotkuptimshëm në profilim sikurse shprehet me trajtat me –AV.

E gjashta, nga sa pamë te shembujt në serbisht, vërehet se nga seria e mbiemrave me kuptim kryesisht pejorativ të asaj gjuhe, ndahet një grup jo aq i madh i shembujve, me të cilët nuk shprehet kuptimësi pejorative, si:

hubav ose ubav - i kënaqshëm ose i bukur, zdrav - i shëndoshë a i shëndetshëm, , prav - i drejtë, žilav -muskuloz, pepeljav - i perhitur. gizdav - i stolisur. mirisav – aromatik ose erëmues, blistav - i shkëlqyeshëm etj.,

ashtu siç ngjan edhe te disa emra me formantin –AV, në atë gjuhë, tipi *ljubav* (dashuri), *pozdrav* (përshëndetje), *žerav* (kalë), *pojav* (dukuri), *rukav* (mëng), *narav* (natyrë) etj.

Këtë fakt po e spikasim, sepse me sa kemi vënë re në shqipe assesi nuk del i përshtatshëm mbiemri ose e emri me më –AV, si barasvlerës ndaj shembujve të tillë të serbishtes, d.m.th., për ata që nuk shprehin kuptimësi

pejorative, kështu b.f. për *hubav* ose *ljubav* (ljubak) thuhet *i kënaqshëm*, *dashuri* (*i dashuruar*) dhe kurrsesi *i kënaqavtë!*, *dashuravë*, *i dashuravtë(!)*, e kështu me radhë. Është krejt tjetër gjë, kur kemi të bëjmë me ngjyresa të jashtëzakonshme stilistike brenda shqipes.

E shtata, në kuadër të kësaj vistre mbiemrash të serbishtes vumë re se në afro 20 raste rekomandohet një shembull me konstrukt tjetër si më i parapëlqyer po me të njëjtën prapashtesë, tipi *blatav* në vend *blatinjav*, *manjiçav* ndaj *manjkav* etj., me fjalë të tjera numri i tyre (mbiemrave me –AV) mbi këtë bazë, sipas këtij rekomandimi, priret të reduktohet, gjë që nuk mund të ndodhë në shqipe, për shembujt që dalin me elementin **-av**, ngase koncepti i shprehur me –AV, i përket asaj natyre që zakonisht nuk mund të zëvendësohet me ndonjë konstrukt tjetër, sepse këtë punë e ka në dorë pjesorja përkatëse e foljes si bazë mbështetëse diriguuese.

E teta, janë disa ose, me sa pamë, mbi 10 shembuj me prapashtesën –AV, për të cilët në serbishte rekomandohet sinonimi barasvlerës me prapashtesë tjetër, si :

bodlikav – bodlikast, budalav – budalast, gizdav – ljubak, skrbav – skrbast, rundav – rundov, pljesnav – pljesniv, ljukav – bolešljiv, herav – razrok, gnjidav – prezir, burbljav – bucmast, tupav – tupan, tvrdoglavac, sklizav – sklizak, halav – halapljiv, e ndonjë tjetër.

Gjithsesi mund të thuhet se formanti –AV në raste të tilla konkurrohet për të njëjtin koncept nga prapashtesa e forma të tjera më të favorizuara në letrarishten e sotme të serbishtes, siç janë: prapashtesat e mësipërme **-ast**, **-ov**, **-iv**, **-ir**, **-an**, **-ak** dhe të tjera, që në atë gjuhë madje dalin edhe më të specializuara, për ngjyresa ose nënfusha të caktuara kuptimore si: **-ič**, **-kast**, **-ar**, **-ac**, **-ski**, **-ast**, **-ok**, dhe ky zëvendësim bëhet në mënyrë normale varësisht nga specializimi i nënfushës semantike që mbulojnë fjalët me prapashtesat përkatëse, nënfusha këto që për prapashtesat e gjuhës shqipe e specializimin e tyre ende dalin çështje jo të trajtuara sa e si duhet, por sidoqoftë, sipas asaj që u konstatua më sipër mund të thuhet se numri i mbiemrave me –AV në serbishten letrare priret të reduktohet, gjë që në shqipe, kur kemi parasysh nënfushën e qartë të specifikuar që mbulojnë mbiemrat e tillë ose foljet me -AVË, një reduktim i tillë, hë për hë, nuk vjen në konsideratë, ngase në shqipe kuptimësia e mbiemrit ndërlihet, siç u tha, jo vetëm me emrin, por gjithsesi me atë të foljes përkatëse prodhuese, gjë që në gjuhën serbe ka natyrë tjetër ndërndikuese.

Madje, po theksojmë e ritheksojmë në mënyrë të veçantë se në shqipe shembulli me formantin –AV nuk mund të zëvendësohet me kontrukt tjetër prapashtesor, pa prekur në nënfushën ose në ngjyrimin përkatës semantik.

E nënta, pra në gjuhën serbe raporti mbiemër më -AV ndaj foljes infinitivore me –a/VA-ti del me dallime sa i përket trajtëformimit dhe fjalëformimit, por ekziston edhe një ndarje tjetër. Janë vërtet disa folje që nuk duket se formohen mbi këtë bazë, por disa të tjera po, sepse edhe formalisht disa duken e disa jo të formuara mbi bazë të mbiemrit më –AV.

a) Krahaso mbiemër / folje në serbisht:

Së pari, disa shembuj nga foljet “**svršenog vida**” (perfektive) që sipas formës, s’ka përkim mbiemër/infinitiv:

budav / budati, backav / backati, buktav / buktati, čupav / čupati, klizav / klizati, lajav / lajati, gubav / gubati, gušav / gušiti, govnav / govnniti etj

Së dyti, nga foljet “**nesvršenog vida**” (imperfektive) sipas formës ka përkime:

brašnjav / brašnjaviti, baljav / baljaviti, ćelav / ćelaviti, grbav / grbaviti, kilav / kilaviti, mršav / mršaviti, ćorav / ćoraviti etj

Sipas regjistrimit në burimet përkatëse që konsultuam numër më i madh i shembujve del sipas mënyrës së parë sesa të dytës.

Për të qenë edhe më e qartë çështja në raportin e **dallim/përkimit** serbisht-shqip, po i krahasojmë disa shembuj me barasvlersit përkatës në të dyja gjuhët:

b) Krahaso: mbiemër /folje në trajtën përfaqësuese serbisht e shqip:

serbisht	/	shqip
.....	
ćorav ćoraviti ćorav-im	/	i qorravtë me u qorravë (qorrav/em)
kilav kilaviti kilav/im	/	i killavtë me u killavë (killav/em)
gušav gušiti guš/im	/	i gushavtë me u gushavë (gushav/em)

Pra, siç po shihet mbiemri i serbishtes më –AV në rastet e mësipërme është formuar mbi një temë emërore, por ai mund të dalë edhe mbi një temë foljore e mbiemërore dhe anasjelltas, nga mbiemra të tillë mbi bazë të një

mbiemri me –AV mund të formohen emra mbiemra e folje, ndërkaq këtu, te shembujt tanë më sipër, në shqipe, del e mjaftueshme **pjesorja e foljes (paskajores) përkatëse, ajo (paskajorja) qëndron si bazë dirigjuese kuptimore e ndërtimore.**

Sidoqoftë, siç po shihet konkretisht, siç u tha, si temë prodhuese të mbiemrit me –AV në serbishte ka shërbyer një emër: **ćor, kilo, guša** dhe kështu e ndeshim të përftuar mbiemrin përkatës: **ćorav, kilav, gušav**, madje po kjo trajtë mund të trajtohet formalisht edhe si morfemë foljeformuese e infinitivit të foljeve imperfektive: **ćoraviti, kilaviti, gušiti a gušaviti** ose e prezentit të dëftores të diatezës pësore: **ćorav/im (se), kilav/im (se), gušav/im (se).**

Ndërkaq, në shqipe, po përsërisim, mbiemri shpjegohet ose nënkuptohet si i tillë gjithsesi si prejpjesor, edhe në qoftë se përftohet spontanisht pa pasur folje të përftuar më parë.

c) Krahaso barasvlerësit (mbiemër e folje) serbisht - shqip

Nga krahasimi ose zhvillimi i barasvlerësve të serbishtes me ata në gjuhën shqipe vërejmë:

Së pari, mbiemri i serbishtes **ćorav** nuk është identik me atë të shqipes, edhe sa u përket treguesve të njëjësit e të shumësit, ngase në shqipe mbiemri i paranyjësuar si b.f. **i (e, të) qorravtë**, me nyjat e përparme shpreh gjininë dhe shumësin, ndërkaq mbiemri në serbishte këto kategori i shpreh me fundoret:

Njëjës: m. ćorav – i qorravtë, shumës: ćoravi - të qorravtë
f. ćorava – e qorravtë, ćorave - të qorravta
as. ćoravo – të qorravtë/t ? ćorava - të qorravtë ?

Siç po shihet secila gjuhë ndjek rrugën, sipas natyrës së vet, ndërsa në serbishte infinitivi: **ćoraviti** nuk del i identifikuar, në gjuhën shqipe gjithsesi bazë fjalëformimi mbetet pjesorja e foljes (paskajores) **qorravë: me qorravë / me u qorravë,**

Së dyti, kur e kemi fjalën te folja e serbishtes dhe e shqipes vërejmë se në serbishte infinitivi formohet me mbaresën speciale –**TI**, siç janë edhe shembujt e mësipërm: **ćoraviti, kilaviti, gušiti**, por në disa raste del edhe mbaresa –**ći**, si: **peći** (nga pek-ti) - **me pjekë**, **strići** (nga strig-ti) - **me**

qethë, në shqipe, paskajorja e mirëfilltë formohet me pjesëzën **me + pjesore e shkurtër**, siç janë shembujt e mësipërm: **me (u) qorravë, me (u) killavë, me (u) gushavë**, përkatësisht: **me pjekë, me qethë** etj.

Në rastin konkret gjuha jonë popullore atavikisht ka shfrytëzuar formantin –AV(ë) si fundore foljore ose, më mire me thënë, pjesorja me –AV(ë), shërben si prapashtesë e mirëfilltë konsonantike dhe mbi bazë të saj, (pjesores së paskajores) dalin rrjedhojat përftuese. Kështu mbi këtë bazë shpjegohet se është formuar mbiemri i paranyjzuar (**i,e**) -**të**, tipi **i gushavtë**, pra nga *gushav(ë)- me (u) gushavë*), sikurse: **i pjektë**, **i pjekur**, nga: *pjek(ë) me pjekë* ose **i vendostë**, **i vendosur**, nga *vendos(ë) me vendosë, vendosur*.

Gjithsesi mbi këtë bazë pjesoreje me –AVË shpjegohen edhe formimet e kategorive të tjera përkatëse si: **emra** (*gushavë-a, të gushavët, të gushavtët, të gushavtit* etj.), **mbiemra** (*gushavç, gushavel, gushavec, i gushavtë* etj.), **ndajfolje** (*gushavët, gushavur*).

Në të vërtetë, në këtë dukuri vërejmë edhe dallime të tjera në raportin serbisht /shqip, si dhe njëfarë përkimi të prezentit të indikativit të serbishtes me të tashmen e dëftores së shqipes, andaj krahaso edhe një here këto dallime e përkime që po i paraqitim në pikën vijuese.

ç) Krahaso mbaresat eptimore:

serbisht	shqip
.....	
1) Mbiemri gušav	- i gushavtë ose <i>i gushavët,</i>
2) Inf. gušaviti (gušiti)	- me u gushavë
3) Prezenti i dëftores njëjës / shumës (sipas vetave):	
I. Ja gušavim, mi gušavimo	- (unë) gushav, ne gushavim,
II. Ti gušaviš, vi gušavite	- (ti) gushav, (ju) gushavni,
III On gušavi, oni gušave	- (ai) gushav, (ata) gushavin.

Vihet re se tema e formave të foljes në serbishte del me formantin –AV+I (gušAVI-), në të gjitha vetat, njëjës e shumës, formë e ngjashme me infinitivin pa -TI fundore të asaj gjuhe, veç shumësit veta e tretë, ndërsa në shqipe formanti –AV është konstant, megjithatë përkimet sipas parimit teknologjik nuk janë të përjashtueshme.

Sidoqoftë, dihet mirëfilli, se këto dy gjuhë, shqipja e serbishtja, me shekuj ishin në kontakt, në raporte ndërndikimi, siç janë edhe sot, andaj nuk përjashtohet e vërteta se ka pasur edhe ndërndikime gjuhësore, kjo ka ndodhur

edhe në gjuhë të tjera, por siç po shihet rreth temës në shqyrtim, secila gjuhë (serbishtja e shqipja) ka shfrytëzuar natyrën e eptimit të vet. Edhe ky fakt vërteton se gjuha shqipe që para shekullit IX, si duket e kishte të formëzuar sistemin e vet foljor, ku bënte pjesë edhe paskajorja me + pjesore e shkurtër, apo jo?

Natyrisht, rreth raportit ndërndikues serbisht-shqip lidhur me formantin –AV e të tjera mbesin çështje të paprekura, por ne po mjaftohemi me kaq, për të vazhduar trajtimin e kësaj teme për çështje brendapërbrenda shqipes.

3. Del, apo jo, i identifikuar formantI –AV në shembuj përkatës në kuadër të fjalorëve tanë normativë?

Edhe pse është e vërtetë se prej se mbahet mend, ne, kemi të trashëguara fjalë me formantin –AV, jo vetëm si infiks te emrat e mbiemrat e foljet, por edhe në funksion të prapashtesës së mirëfilltë foljeformuese, mirëpo që nga Gazulli e këndeje foljet e tilla i ndeshim edhe paksa të studiuara ose edhe të regjistruara, megjithatë në Gramatikën e Akademisë dhe në burime të tjera relevante teorike normëzuese të gjuhës shqipe, me sa pamë nga konsultimi, nuk dilte asnjë shembull i favorizuar as në kategorinë e emrave as në atë të mbiemrave me formantin -AV, por në fjalorët tanë normative; që konsultuam, duke filluar nga FGJSH 1954, FGJSSH 1980, FGJSH 2006 deri te Fjalori drejtshkrimor 2011, ndeshim mbiemra e emra, madje aq më tepër ndeshim edhe folje, edhe pse në numër jo aq të konsiderueshëm, ku duket se del i implikuar ky formant konglutines prapashtesor si infiks, shembuj këta, që jo të gjithë ceken edhe nga Xhuvani –Çabej, por del edhe ndonjë rast i ri, të cilët po përsëriten nga burimi në burim.

Sa për ilustrim ne do të mjaftohemi me paraqitjen e disa shembujve nga të dyja sistemet (emëror e foljor), që i volëm nga burimet përkatëse normëzuese:

a) Disa shembuj nga sistemi emëror (emra, mbiemra e ndajfolje):

1) më–ec: *burravec e mburravec, grindavec, jargavec, ligavec, qyrravec, rroskavec, zhargavec*. - 8 shembuj;

2) më –el: *baltavel, bardhavel, jargavel, shurdhavel, karavel(e), shushavel, xarnavel, zgarravel; garravel* - 9 raste;

- 3) më -ë : *shushavë, përkavë, gujavë, mëzhdravë* - 4 shembuj
 4) më -i: *kacavi, çarravi, palavi, garravi* - 4 shembuj;
 5) më -inë: *shkarravinë, gllavinë, zhargavinë* - 3 shembuj;
 6) më -iq: *shurraviq, shalavriq, kaçaviq; kakaviq, shkalqaviq, ndyraviq* - 6 shembuj;
 7) *ngurafët (v/f)* (ndajfolje) - 1 rast.

b) Disa shembuj nga sistemi foljor që asociacionojnë:

1)) **më -it**: *buhavit, çuknavit, davarit, gackavit, gojavit, hallavit, jargavit, seravit, stavit, valavit, llagavit, ravit, shkumbavit, shkarravit, zhargavit, koklavit, zbavit, shkoklavit, zhdavarit, zharavit, zhubravit* - 21 shembuj;

2) **më -AT e ndonjë tjetër**: *karav/at, kavatoj, palavoj, shkalav/iq, ballavesh, çaravesh, shkalav/esh, shkarrav/esh, kalav/ar/em, kacav/ar/em, kacav/irr/em, (!)* - 11 shembuj.

Me thënë të drejtën, për foljet e thamë se infiksi -AV- *asociacionon*, ngase siç e kemi vënë re në serbishte në disa folje nuk pranohet -AV si infiks, por trajta -VA (tipi *dati - davati da-VA-ti*, por edhe në shqipe të diskutueshme dalin disa shembuj të pikës **b**), sidomos rastet e nënpikës 2), si **palAVOJ (me palavue)** e **ballAVESH (me ballaveshë)** me fundoret **-avatoj, -avoj, a-vesh, -avar**, por edhe disa nga grupi i foljeve -AVIT fundore përveç rasteve: **gojAVIT (me gojavitë)**, **jargAVIT (me (u) jargavitë)** dhe **shkumbAVIT (me shkumbavitë)**, dalin të diskutueshme, ngase ndërtimisht mund të zbërthehen ndryshe, sepse nuk kanë temë të qartë fjalëformuese motivuese, ndërkaq trajtat: *me (u) gojavë, me (u) jargavë, me (u) shkumavë* – nuk janë të huaja në ligjërimet tona të përditshme.

Sidoqoftë, edhe me aq shembuj që janë të padiskutueshëm që njëherazi janë edhe obligues për përdorim pasi i ndeshim në burimet e standardizuara, dëshkohet se jo vetëm në sistemin emëror, siç trajtohen nga Xhuvani-Çabej, po edhe në sistemin foljor, formanti -AV del i identifikueshëm, edhe pse vetëm si konglutinat foljeformues.

Lexuesi i vëmendshëm ka mundur me vërejtje se nga prapashitesat që cekën në punimin e Xhuvani -Çabejt, sipas shembujve në sistemin emëror, gjashtë të tilla dalin të pranishme në fjalorët tanë normativë: AVEC, -AVEL, -AVË, -AVIQ, -AVI dhe -AVINË sepse me to janë shënuar disa shembuj (sipas tipit përkatës; *burravec, baltavel, shushavë, shurraviq, kacavi,*

shkarravinë), por nuk dalin fare shembuj të tri prapashtesave të tjera: -AVËT, -AVIK dhe -AVICË.

Me thënë të drejtën nuk brengosemi fare për shembujt me -AVIK dhe -AVICË, sepse nuk i rrinë fort natyrës së gjuhës shqipe, por për shembujt me -AVËT po, duhet të brengosemi fort, ngase kemi të bëjmë me mbiemrat e nyjshëm të gjuhës shqipe me prapashtesën -TË, të tipit prejpjesor **i ngurravtë** nga *nguravë me u nguravë*, **i hekuravtë** nga *hekuravë, me u hekuravë* etj, të cilët assesi nuk mund të krahasohen kuptimisht me mbiemrat e tipit **i (n)gurtë, i hekurt** që formohen mbi tema emërore (gur, hekur). Së këtejmi, pse nuk janë shënuar shembuj me prapashtesën -AVËT e në përgjithësi me formantin -AV dhe sa ka ndikuar ose është keqkuptuar mendimi i Xhuvani- Çabejt me konstatimin se “*mund të thuhet se prapashtesat tona -AVË dhe -AVËT janë me prejardhje sllave te hartuesit e fjalorëve normative, është çështje që kërkon përgjigje dhe meriton trajtim të veçantë, sepse e quajmë të pamjaftueshme vërejtjen që bëmë ne më sipër lidhur me këtë.*

Sidoqoftë, ne reduktimin e shembujve me formantin -AV, në fjalorët tanë normativë nuk mund ta quajmë punë të mbarë, andaj edhe po e konsiderojmë silajthitje a si çështje të hapur, gjithsesi të diskutueshme.

Nga materiali i vjelë si më sipër nga fjalorët tanë normative, për ne zgjuan interes këto dy çështje, t’i quajmë pozitive.

E para, trajta **ndyraviq** (e bartur nga punimi i Xhuvani -Çabej), zgjon interes, ngase për të parën here hasim një mbiemër me -AV që del i formuar mbi pjesoren e rotacizuar Pra, nga pjesorja **ndyrë** del mbiemri **i ndyrë**, përkatësisht nga pjesorja **ndyravë (me ndyravë, për t’u ndyravë (!))**, munden me dalë mbiemrat si **i ndyravtë, ndyravec, ndyravel**, pra edhe **ndyraviq**, siç është dhe shpjegohet i përfutur nga **tema: ndyrav+iq**.

E dyta, zgjon interes gjithashtu edhe trajta **ngurafët**, si ndafolje, ngase është trajtë e mbiemrit **i nguravtë**, përkatësisht e pjesores **ngurav/ë+të (me nguravë)**, ku V-ja e formantit -AV del e zbutur në F.

Pra, nga shembulli i parë doli i identifikuar mbiemri me -AVËT, i përjashtuar në burimet e tjera mbi temë të pjesores së ish gegërishtes letrare, por mbi temë të pjesores së letrarishtes së sotme mbi bazë toskërishte dalka i legalizuar ky rast i rotacizuar (!), apo jo!? Ndërkaq, nga shembulli i dytë **nguravë/t** identifikohet, dritë me diell, pjesorja e foljes me prapashtesën -AVË **me nguravë**, formë kjo ekzistuese, por që nuk del e shënuar, për habi, në asnjë rast tjetër në ato burime.

Së këndejmi, siç është paralajmëruam në titullin e kësaj trajtëse, dhe paksa siç vepruam nga pjesa e parë e punimit dhe në raport me disa barasvlerës foljorë të serbishtes dhe madje kalimthi e cekëm edhe në sqarimin tone më sipër për rastet **ndyrav/iq** dhe **nguravë/t**, në pjesën vijuese do të sjellim edhe argumente plus në bazë të **fakteve shkrimore** që formanti – **AVë** në realitetin tone gjuhësor, pa mëdyshje, del si prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese, madje kjo argumentohet mjaft bindshëm, ngase del e shënuar edhe në disa burime përkatëse leksikografike.

4. Po në cilat burime leksikografike vërtetohet formanti -AV(Ë) si prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese?

Për të vërtetuar se formanti –AV-, siç u pa më sipër, nuk del vetëm si rast i konglutinuar në formimin e emrave, të mbiemrave, si dhe të foljeve me –av/IT, -av-AT etj., por, del, jo rastësisht, edhe si prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese, në konsultuam tri burime leksikografike, ku me shembuj konkretë (**dëshmi shkrimore**), argumentohet ekzistimi i një dukurie të tillë në ligjërimet tona me cilësi e prirje mjaft të lartë të pakufizuar vepruese e prodhimitare.

a) Konstatime nga Fjalorthi i Abdullah Zymberit (1979)

Prof. Abdullah Zymberi në veprën **Fjalorth i fjalëve të rralla**, Rilindja, Prishtinë 1979, edhe më qartë se D. N.. Gazulli, madje gjithsesi edhe se Xhuvani-Çabej, e vë në spikamë përdorimin e formantit –AV në formimin e fjalëve të shqipes, qoftë si emra ose mbiemra, qoftë edhe si folje. Në këtë Fjalorth, të vlerësuar lart edhe nga prof. A. Kostallari, jo vetëm vërtetohen shembuj me -AV të cekur edhe në burime të tjera si:

bardhavel, pandravel, copavel, pacavel, shkarravel, pastaj i cuklavt, i kaçarrrelavt etj,

por dalin edhe shembuj të rij me prapashtesën –Ç, si:

marravç, pinlavç, pandlavç, shkalakavç, trenavç (f/v),

madje asociacionojnë edhe ndajfoljet: *çaravesht dallavesht* dhe mbiemrat prejfoljorë, si:

i çaraveshun, i kaçarravun,

por për trajtesën tonë aq më tepër zgjoi interes fakti, se aty dalin të regjistruara edhe nja dy folje karakteristike me prapashtesën e mirëfilltë –AVË:

me u kaçarravë, me u lulsavë.

Këtë fakt po e theksojmë në mënyrë të veçantë, ngase është hera e pare, me sa dimë, që studiuesi i caktuar t'i identifikojë nga gjuha popullore foljet e tilla me prapashtesën –AVË dhe t'i shënojë në zëra të veçantë në fjalor, duke dhënë për të kuptuar kështu që fjalët e tilla të rralla duhet të shtrihen edhe në gjuhën letrare (standarde), apo jo?! Ne një veprim të tillë e quajmë të rëndësishëm sepse, si me thënë, në këtë mënyrë i është hequr velloja jo e bardhë nga fytyra një dukurie të fshehur nën duvakun e arkaikëzuar artificialisht një pasurie me vlerë të ligjërimit popullor, dukuri kjo realisht ekzistuese, por e pa vënë (!) re ose e privuar arbitrarisht, duke mos i dhënë prestigjin e duhur kësaj pasurie reale në kuadër të shqipen globale kombëtare, apo jo?

Në të vërtetë, edhe nga vepra tjetër e prof. Abdullah Zymberit “Fjalor popullor”, Prishtinë 2014, të hartuar mbi bazë të të dhënave nga terrene të ndryshme, ndeshim material me shumë interes të kësaj natyre, në bazë të të cilit mbështeten ose përforcohen të gjitha konstatimet tona të sipërcekura. Kështu përveç foljes, së mirëfilltë shqipe: **me u brymavë**, e cila përforcon si me thënë dy shembuj me mëparshëm: **me u kaçarravë dhe me u lulësavë**, por aty shtohen edhe nja dy folje të reja me zgjerim të prapashtesës –avë:: **me garravitë, me laravisë**, ku siç po shihet, **prapashtesa –AV** del e sforcuar përkatësisht me –ITË, –ISË. Gjithashtu aty ndeshim edhe mbiemrat prejpjesorë: **kukavç (nga kukavë), panlavç (nga panlavë) pinlavç (nga pinlavë)**, pastaj: *buzavel, copavelç, shalaverç, skarravel, pacacvel, valavel* e ndonjë tjetër. Nuk mungojnë me dhjeta shembuj me *v-në* e zbutur në *f, si*: *papafç, skalagafç, përzaçç, palafç, arrnafç, hukafç, spillafç etj.*, por edhe më tepër ka shembuj, kur krejt togu –**AV**, për shkak të shqiptimit të zonave përkatëse ka kaluar në –OF, si b.f. harrofç (harravç), pluhnofç (pluhnavç), shkoklofç (shkojklavç), shkordhovç (shkordhavç) etj., shqiptim ky që në zona të tjera shqiptohet qartë me –AV (ashtu siç i shënuam ne shembujt mes kllapash).

Sidoqoftë, autori sjell material me interes edhe për shumë nënfusha e segmente të tjera, siç janë edhe shembujt kur formanti –AV dhe –AU ndërkombëhen, siç është rasti *avavaj* etj, por për ne për punimin tone nuk dime sa mund të ketë asociacinuar ndërndikimi në foljet e mirëfillta me AV(ë) fundore nga rastet siç janë ato me –AU fundore të shënuara ashtu nga autori:

me u dampau, me u llamtau, me përgjau, me prapsau, me nalcau me tangllau etj.

Me fjalë të tjera ka mundur me pasë fare ndërndikim, apo jo, kalimi i trajtës me –AU fundore në –AV(Ë) si b.f. me llaptau në *me llaptav(ë)*, me prapsau *me prapsav(ë)*, e kështu me radhë?!, megjithatë sipas fjalëve të autorit ai ka dëgjuar edhe jo pak shembuj foljesh të mirpëfillta me –AV në terrene të ndryshme të ndryshme, po ka pasur hezitim, ngase ishte nën ndikimin e atyre që thoshin se rastet e tilla janë nën ndikimin e gjuhëve sllave?!

Sidoqoftë, pa marrë parasysh këtë që e pranon autori ne për vjeljet e të shënuarët e shembujve të sapopërmendur në Fjalorthin e tij e quajmë punë të mire e qëndrim *guximtar* të autorit, ngase si duket veprimi i tij do të ketë ndikuar që të *legalizohet*, si me thënë, të vënë re ose të regjistruarët e foljeve ose të shembujve të tillë që atëherë nga gjuha e popullit nga disa kolegë të tij, punonjës të Institutit Albanologjik të Prishtinës, të cilët tre vjet më vonë në fjalorin përkatës të tyre, siç do ta shohim tash fill, kanë prezentuar një material të tillë në numër më të konsiderueshëm.

b) Konstatime nga “Fjalor fjalësh e shprehjes popullore” të IAP 1982

Nga Instituti Albanologjik i Prishtinës në vitin 1982, u botua vepra me titull **Fjalor fjalësh e termash popullore**, kryesisht i vjelë nga trevat shqipfolëse në ish-Jugosllavi. Gëzon fakti se lidhur me temën tone aty del i regjistruar një material relativisht më i bollshëm në krahasim me burimet e mëparshme. Botuesi nuk e fsheh synimin, ngase sipas titullarit, këto fjalë të burimit atokton, pra edhe fjalët me –AV, do të jenë “*sadopak një ndihmesë e mire, jo vetëm në fushën e kërkimeve dialektologjike, por edhe në atë të pasurimit e të freskimit të gjuhës sonë në përgjithësi*”.

Sidoqoftë, siç do të shohim tani, disa shembuj me formantin –AV, që i ndeshim aty, edhe pse jo të gjithë, nuk i sjellin vetëm “**pasurim e freskim gjuhës sonë në përgjithësi**”, por, kanë ose duhet ta lozin po atë efekt edhe për shqipen standarde në vaçanti, madje për temën tone bashkë me **freski e kënaqësi** ajo lëndë solli edhe **mbështetje edhe ndihmesë trasimi** për të arritur drejt cakut: **tryezës** për diskutim e vlerësim të mbarë, sepse:

Së pari, aty, mbi bazë të temës prodhuese më –AV, ndeshim këta emra e mbiemra (prejpjesorë), të formuar konglutivisht me prapashtesat përkatëse si:

-EL: bardhavel e bardhavele, bishtavel e bishtavele, garravel, panravel;
zgatavell, zhavell;

-TË: (i,e) buhavitë, i(e) gemavitë, i(e) gutavitë, i(e) gobavitë, i(e) hullavitë,
i(e) krrubavitë,

i(e) ujcavitë, i(e) leshavitë, i(e) nguravitë, i(e) panlavtë, i(e) spihavitë,
i(e) roshavitë, i(e) zgjyrvitë, i(e) zllagavitë, i(e) rrebaftë (v/f) - 15 shembuj;

-C: shushkavc, kalavanc, kakavac, pungavc;

-Ç: grrivaç, garravaç, çakavç, moravç;

-INË: shijavinë;

-IMË: gjaravimë;

-AMË: daravamë, valavamë;

-I : gjidavi, zhavi;

-ICË: dunjavicë, gravanicë, vajavicë, piskavicë;

-Ë: agllavë, ngucavë, valavitë;

-INKË, -K(Ë): stavinkë, gavkë, garrabaçkë (b/v), calavak, pavrak e
ndonjë tjetër.

Së dyti: ndeshim këto folje, të cilat i ndamë në dy grupe: së pari, mbi
bazë, konglutinuose dhe së dyti, me prapashtesë të parme të mirëfilltë: AV(Ë):

1. me fundore-prapashtesat përkatëse si konglutinate:

-IT: buav-it/, baravit, rrxhavit, shkarravit, palav/it, zavit/em(!);

-AT: llackavat, xhakavat, gravalat/em(!);

-ESH dallavesh, çaravesh, çallavesh;

-IS kalaveshtis; zllavis, palavis;

-O/j: kavatoj,

2. me prapashtesën e mirëfilltë -AV(ë):

brymav/et (me brymavë), **buhav/em**, (me u buhavë), **bumav/et**

(me u bumavë), **tumhav/et** (me tumkavë), **mushav/em**

(me u mbushavë), **lulësav/em** (me u lulësavë) - 6 shembuj.

Disa nga foljet e pikes **1.** mund të shpjegohen alternativisht edhe mbi bazë
tjetër, jo si folje me temë në -AV(ë), por ne i përfshimë më tepër si asociacion
për hir të fushës semantike që mbulojnë, ashtu si edhe foljet e mirëfillta me -
AVË nga pika **2.**

Sidoqoft, ne, për karakteristikat e veçanta që kanë dhe interesin që
zgjojnë për temën tone *bollduam* (nënvizuam) mbiemrat e paranyjësuar, të
tipit **i leshavitë** (i(e) - të), **15 shembuj** dhe foljet me -AV(ë), tipi **me u
lulësavë 6 shembuj**, sepse nga mbiemrat e tipit të tillë, dëshmohet pjesorja

e foljes me –AV/ë ndërsa nga grupi foljeve nënvizuam foljet e pikes **2**, ku formanti –AVË, del në funksion të qartë foljeformues.

Natyrisht nevojiten edhe sqarime e plotësime të tjera, por ne, paralajmërojmë se konceptet lidhur me nënfushën semantike që mbulojnë foljet me –AVË, me siguri, do t'i kemi edhe më të qarta, pasi ta konsultojmë materialin përkatës nga fjalori i M. Elezit dhe nga ai i sjellë prej nesh nga një pjesëz e realitetit tonë gjuhësor, si dëshmi individuale jona mbështetur në visarin konkret të përditshëm nga ligjërimet tona jo vetëm popullore.

c) Konstatime nga Fjalori i M. Elezit (2006)

Në veprën e Mehmet Elezit, **Fjalor i gjuhës shqipe**, Tiranë 2006, edhe pse materiali i tillë as për së afërmi nuk është shterrues, formimet me formantin –AV, aty, megjithatë shikuar nga të gjitha segmentet, pasqyrohen në mënyrë më reale se në çdo burim tjetër, edhe sa i përket shtrirjes së fjalëve me –AV si në sistemin emror, ashtu edhe në atë foljor, por ne, për mos me zgjatë punë do të përqëndrohemi vetëm në të shënuarit e foljeve me prapashtesën e mirëfilltë –AV(Ë).

Së këtejmi, për të fituar idenë se si autori ka vepruar (afro 30 vjet pas botimit të Fjalorthit të A. Zymberit) rreth regjistrimit të përfitimeve të tilla, të trajtave përkatëse me formantin –AV(Ë), fillimisht po japim një shembull konkret tipik, pikërisht shembullin e pare të këtij tipi **balushë-a** që e ndeshëm në *Fjalorin* e tij bashkë me rjedhojat ose me tërë çerdhën fjalëformuese, si me thënë, paradigmore që dalin mbi bazë të këtij emri të foljezuar.

Ç'është e vërteta, kuptimi i fjalës **balushë-a** në FGJSH 2006 i referohet fjalës **balë-a**, për kuptimin e së cilës është dhënë ky përkufizim: **pullë e bardhë në kokë a në trup të kafshëve, balishë, baliskë; kafshë me pulla të tilla.** (Aty f. 67.)

Po autori për fjalën **balushë**, përveç përkufizimit të mësipërm, jep edhe 8 kuptime të tjera polisemantike, por për ne, për temën tone, zgjojnë interes, siç u tha, vetëm fjalë-trajtat e përfuara mbi bazë foljore (prejpjesorët) që jepen aty me formantin –AV, përkatësisht po japim sipas kategorive përkatëse të gjitha fjalët me formantin –AV të përfuara mbi këtë bazë, mbi temën-fjalën: **balushë:**

- 1) Folje:
1, kal.

a) **balushav** (trajtë përfaqësuese, e tashme, veta e pare njëjës e dëftores)

b) **balushava**, (e kryer e thjeshtë, veta e pare njëjës e dëftores)

c) **me balushavë** (paskajore e mirëfilltë)

ç) shembull fig.: **e balushavi keq**.

2. vetv.

a). **u balushava, me u balushavë**

b) **balushav/em** (pës.)

2) emra:

a) **balushavje** (prejpesor, emër veprimi, gjinia femërore),

b) **të balushavët(!)**, të balushavtit ose të balushavurit(?) (prejpesor, gjinia asnjënjës),

c) **e balushavta** (emër abstrakt, gjinia femërore);

ç) **i balushavti**, (e balushavta) të balushavtit (të balushavtat) (emërzim mbiemri);

d) **balushavë-a** (prejpesor pandajshesor).

3) mbiemra

a) i (e) balushavtë

b) **i (e) balushavur**

4) ndajfolje: **balushavë/t(?)**, **balushavur(!)**

Meqë në shembuj të tjerë të foljeve me prapashtesën –AV(Ë) ndeshim të përfshirë edhe emërzimet e mbiemrave të nyjzuar me prapashtesën T: (tipi *i balushavti*, *e balushavta*), emri abstrakt, tipi *e balushavta*, përfitimet në trajtën e asnjënjësit të paranyjzuar me TË (tipi *të balushavët*), trajtën e prejpesorit pandajshesor, tipi *balushavë-a* si dhe atë të ndajfoljes mbi këtë bazë (tipi balushavët), ne shënuam edhe këto pesë forma, pasi nënkuptohet që modeli lejon dhe mbase vetëm rastësisht mungonin pa u shënuar nga autori.

Sidoqoftë, ne, pa cekur shembujt me foljet më –avit, tipi **gjall/av-it**, me –avis, tipi **arrgj/avis-em**, dhe me –atë, tipi **mbar/av-atë**, si dhe emrat e mbiemrat e mundshëm, si: *balushavel*, *balushavec*, *balushaviq*, *balushavç* e të tjerë, tipa këta me prapashtesat -el, -av/ec, av/iq, -ç etj. që më sa pamë nuk mungojnë në këtë burim ashtu si edhe ndajfoljet me formantin –AV, që i hasëm në veprën në fjalë, jo pse nuk paraqesin interes, por për hirë të përmasës së një trajtës si kjo, më poshtë po i shënojmë, siç e cekëm më

sipër, vetëm **foljet me prapashtesën e mirëfilltë –AV(Ë)**, që i ndeshëm në këtë burim.

Në të vërtetë, edhe pse aty ka raste të regjistruara vetëm në trajtën vetvetore ose vetëm pësore, ne po i shënojmë më poshtë në **trajtën e pjesores së paskajores së mirëfilltë**, d.m.th. mund të lexohen shembujt në trajtën përfaqësuese, tipi **balushav/ë** ose si paskajore, tipi **me balushavë** ose **me u balushavë**:

balushav/ë, bërrylavë, bjeshkavë, breshkavë, brymavë, cangalavë, cikatavë, ckurravë, coftavë, cokatavë, cuklavë, curravë, çafaretavë, çaraveshavë, çekeravë, roçkavë, duglavë, andavë, gemavë, gërbavë, gungavë, gushavë, haparavë, hurpavë, kabloshavë, kaçarotavë, kalaboshavë, kalaveshavë, kataroshavë, kërthijavë, killavë, klluçavë, kokrrizavë, korubavë, krrutavë, kukavë, leshavë, lëkuravë, ligavë, lishavë, lulsavë, lyrthavë, lluçkavë, mbushavë metiavë, myjavë, ndelavë, ngridhavë, pandlavë, përvjeçavë, përllaçavë, përqyrravë, pështymavë, piklavë, prishavë, pshurravë, puçrravë, pusavë, qelavë, qullavë, rogavë, rudavë, rrejktivë, rrejepavë, rrudhavë, rrugavë, rrypavë, spirravë, sturavë, sutavë, sykavë, shejavë, shulavë, shpiravë, shytavë, tenjavë, terpiavë, trenavë, tulavë, tumhavë, ushllavë, xekrravë, zgueravë zgoravë , zhangavë, zhellavë, zhugavë, zhutavë.

Kështu në këtë burim ndeshim të regjistruar gjithsej 88 shembuj, folje këto me prapashtesën e mirëfilltë –AVË, por nëse i shtojmë këtij numri me dhjeta shembuj mbiemrash të paranyjëzuar, tipi: *i ndylllavitë*, pastaj edhe të atyre jo të paranyjëzuar më –EL, tipin *gucavel* , dhe prapashtesa të tjera, ku si temë prodhuese e të cilëve nënkuptohet që shërben pa ndërzyje **pjesorja e foljes përkatëse me –AV(Ë)**, ose po t'i shtojmë këtij numri së paku një ose dy trajta nga **tetë sosh**, *emra mbiemra ndajfolje* si rrjedhoja prej pjesorësh, sipas modelit a zhvillimit fjalëformues që pamë te shembulli **balushavë**, atëherë numri i fjalëve me prapashtesën –AVË, rritet me dhjeta herë, madje edhe më shumë që mund të kalojë disa herë 100-shin.

Në të vërtetë, për të dëshmuar faktin, siç e thamë më sipër se numri i fjalëve, madje edhe i foljeve me formantin –AV në këtë fjalor, as për së afërmi nuk del shterrues, ne i volëm e po i sjellim poashtu disa shembuj nga realiteti ynë gjuhësor, që pa dyshim është një pjesë e vogël nga thesari madhor ligjërimor i trevave tona që dëshmon se vërtet numri fjalëve të tilla

potencialisht, varësisht nga konteksti, del me mundësi të pakufizuar shumimi apo ekzistimi

ç) Disa shembuj foljesh nga realiteti ynë gjuhësor si dëshmi personale

Ja, pra, edhe disa shembuj aksiomativisht dëshmues që padyshim ndeshen në përdorim e sipër në realitetin tonë gjuhësor:

(me u) buzavë, baglavë, besheretavë, belbavë, beteravë, biravë, bubrravë, budallavë, trullakavë, çallaveshavë, çakllazavë, çatallavë, dredhavë, dreqavë, dushkavë, fëlliqavë, futavë, gabelavë, galavë, gropavë, hekuravë, hingirizavë, ibretavë, hirravë, hullavë, kaladredhavë, lopavë, kokrravë, kopilavë, kryqavë, krupavë, krrylavë, kurthavë, përçudavë, përdreqavë, pështjellavë, plancavë, pluhnavë, pykavë, qenavë, rreshkavë, rriqnavë, shalakavë, shkretavë, shkrolavë, shkullavë, terravë, truçavë, thadravë, vyshkavë, zgurdullavë, zhyllavë etj.

Nga krejt këto që u parashtruam, dëshmohet katërçipërisht, se përkundër faktit se në gramatika tona normative nuk pohohen folje me formantin –AV(Ë), si prapashtesë e mirëfilltë foljeformuese, në realitetin tonë gjuhësor një dukuri e tillë nuk mund të mohohet dot, ajo ekziston që nga thellësitë e kohës, por ne e argumentuam të trashëguar edhe shkrimisht që nga fjalorthi i D. Nikollë Gazullit (1941), pastaj nga dy-tre shembujt karakteristikë që dalin në Fjalorthin e A, Zymberit (1979): **me u kaçarravë, me u lulësavë, me u brymavë**, si dhe nga gjashtë shembujt që i ndeshëm në Fjaloriin e IAP-së, si:

(me) buhavë, (me) brumavë, (me) tumhavë,

(me) bumavë, (me) mushavë, (me) lulësavë

që me temat e nënkuptueshme foljore të 15 mbiemrave prejfoljorë të nyjshëm me prapashtesën –TË, tipi, *i(e) gemavtë*, atëherë, padyshim numri rasteve mbi bazë të foljes me –AVË fundore, kap shifren mbi 20 raste. Ndërkaq edhe më qartë dhe më bindshëm formimet e tilla u dëshmuar nga **Fjalori i gjuhës shqipe** i Mehmet Elezit (Tiranë 2006), jo me pak shembuj, të cilët bashkë me rastet që u sollën prej nesh nga realiteti ynë gjuhësor si dëshmi aksiomativisht të padiskutueshme japin për të kuptuar se numri tyre, varësisht nga konteksti,

nuk mund të kufizohet në qinda raste, ngase vërtet, modeli jejon që numri i tyre të jetë i pakufizuar.

Së këtejmi, mund të thuhet se pasi çështja e kësaj dukurie me këtë punim del e shpërfaqur për të parën herë para opinionit shqipfolës dhe në veçanti para studiuesve e standardologëve tanë si një pyll a një sinxhungël e pashkelur, por njëherazi sigurisht edhe si një pasuri e patundshme gjuhësore me vlerë të papakrahasueshme dhe se i takon gjuhës së natyrshme shqipe, atëherë, jo vetëm duhet ta konstatojmë faktin se jemi të ballafaquar me një dukuri a *zbulim* të tillë brendagjuhësor të shqipes, por atë duhet ta vlerësojmë dhe ta zbardhim e ta zgjidhin si duhet standardologët tanë, mbase me implementim të pjesshëm ose të plotë në letrarishten e sotme, apo jo?!

Gjithsesi ndaj kësaj dukurie apo më drejt kësaj pasurie gjuhësore nuk mund të mbyllen as sytë as veshër, apo jo?!

Pse ka mbetur e patrajtuar nga standardologët tanë deri tashti një dukuri e tillë foljeformuese?

Natyrisht, jo vetëm nga ndonjë studiues i huaj, por edhe nga njerëzit tanë, me habi, mund të shtrohen pyetje: Pse ka mbetur e partrajtuar kjo temë nga standardologët e gjuhës tonë? Pse ka ndodhur një zvarritje e trajtimit të kësaj dukurie nga shkenca jonë gjuhësore për një kohë kaq të gjatë, sidomos që prej viteteve të '60-a të shekullit të kaluar e deri sot, kur shqipja letrare kombëtare del mjaft e stabilizuar!? Madje, aty nuk qenka fjala për një numër të vogël, por për me mija fjalë aktive shqipe që ende dalkan të patrajtuara ose aq më keq të pakonstatuara gramatikiisht!?

Në të vërtetë, siç dihet, në *Gramatikën e Akademisë* dalin të identifikuarra sadokudo mirë 9 prapashtesa foljore, ndërsa e patrajtuar gramatikiisht nuk është vetëm kjo prapashtesë foljeformuese por janë edhe 18 të tjera. Së këtejmi del se gjuha shqipe ka në përdorim 28 prapashtesa të identifikuarra foljeformuese, të cilat nuk figurojnë siç duhet në burimet tona përkatëse normëzuese. (Shih: N.V. *Foljet me –O në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2002.)

Lidhur me këtë, rreth zvarritjes së trajtimit të kësaj lënde, mendojmë që është e drejtë dhe e nevojshme, apo jo, të kërkohej përgjigje dhe përgjigjen duhet ta japin pikërisht studiuesit e standardologët kompetentë, megjithatë ne supozojmë se **përveç mungesës së konceptit**, janë edhe nja tre faktorë që kanë ndikuar në zvarritjen studimit edhe të kësaj teme:

E para, mbase si shkak i një zvarritje të tillë ose mosnjohje të fakteve ka ndikuar vetë qëndrimi si platformë nga politika gjuhësore zyrtare i marrë në vitet para e pas mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit (1972) të miratuar *vullnetshëm* nga studiuesit, kur me rastin e formëzimit të shqipes letrare mbi bazë të toskërishtes, që përjashtuar komplet struktura foljore e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, andaj sipas asaj logjike ligjërisht standardologët e studiuesit e kohës kishin për detyrë, jo të studionin prurjet nga gegërishtja, por vetëm ta propagandonin, por edhe ta arsyetonin (*shkencërisht!*) me tërë forcën e dijes, mjaftueshmërinë e sistemit foljor të toskërishtes, tani të konvertuar si **sistem foljor i shqipes letrare kombëtare**, i cili, sipas tyre ishte ose duhet të ishte i aftë plotësisht për të përfaqësuar denjësisht tërë sistemin foljor të gjuhës së natyrshme kombëtare shqipe, pa lënë keq asgjë dhe së këtejmi u lanë nën hije ose u lanë jashtë standardit pa rrezatim e përkujdesje shkencore edhe disa vlera nga gegërishtja si paskajorja e disa të tjera e bashkë me to edhe kjo temë normalisht mbeti pa interes trajtimi deri tash, apo jo?!

E dyta, përveç atij qëndrimi, për mostrajtimin e kësaj teme do të ketë ndikuar edhe supozimi tjetër si ai i Xhuvani –Çabejt, mbase edhe i keqkuptuar e i stërfryrë subjektivisht nga të tjerët, që formanti i tillë **-AV**, në fjalët shqipe ishte i huaj, kishte prejardhje sllave, andaj rastet e tilla konsideroheshin, në mos pjellë e serbishtes, patjetër ishin përfitime të shpifura nën ndikimin e asaj gjuhe, andaj si të tilla ishte punë përçmuese ose as që ia vlente të humbej kohë rreth vlerësimit të rasteve të tilla, apo jo?!

E treta, mbase edhe nuk dihej nga studiuesit kompetentë të asaj kohe si edhe nga disa të sotëm për përmasat e shtrirjes së rasteve në fjalë në realitetin tonë gjuhësor, madje nuk dihej as për nënfushën e veçantë semantike që mbulohet me to, sepse para eksploruesve të visarit popullor ose para studiuesve, edhe pse nuk janë fjalë të pista, edhe vetë dhënësit e marrësit e informacionit ashtu të *edukuar me mësimet e kohës, kur seleksionoheshin gjërat sipas udhëzimeve nga lart*, do të kenë hezitur me pyetë e me marrë nëpër gojë fjalë të tilla të fushës pejorative, keqësuese, përçmuese, të cilat shprehen vetëm në çaste prekëse emocionuese që ndërliken me përshkallëzimin më të lartë të fushës kuptimore mospërfillëse. apo jo?!

Sidoqoftë, ndërkaq pasi raporti i shembujve të shqipes me ata të serbishten u sqarua sadokudo, me ngjasimet dhe dallimet që nuk ishin të

pakta, sigurisht u vërtetua se nuk kemi të bëjmë me kopjime ose kalkëzime të vrazhda nga serbishtja, dhe pasi e pamë se edhe në burimet e deritashme normëzuese, edhe pse lënda e tillë dilte e reduktuar, megjithatë shembuj me këtë formant nuk mungonin, dhe sidomos veç gjuhës popullore folje me formantin e mirëfilltë –AV(ë), tash së voni gjithnjë e më tepër po dalin edhe në gjuhën e shkrimit ose në vepra leksikografike, etj.

Së këtejmi, atëherë mbase edhe pa pritur përgjigje, pse ka ndodhur një zvarritje e tillë lidhur me studimin e kësaj dukurie nga standardologët kompetentë të gjuhës sonë, ne duke dashur të ndihmojmë që ky problem të gjejë zgjidhje sa më të përkapshme, marrim guxim që në vijim (në pjesën e fundit të këtij punimi) të shprehim opinionin tonë.

6. Çfarë i imponohet shqipes së sotme dhe standardit të saj lidhur me krijimet me formantin –AV(Ë)?

Nga sa u trajtua deri këtu, gjithnjë duke pranuar të vërtetën se gjithçka nuk është thënë lidhur me këtë temë, madje as për shkaqet e zvarritjes së shqyrtimit të saj e të tjera, megjithatë ne po e shfrytëzojmë rastin që ndonjë mendim a ide konkrete tonën ta shprehim në vijim, me qëllim që sadokudo t'u lehtësohet puna standardologëve tanë, të cilëve u takon ose u bie barra që në kuadër të sistemit përkatës të shqipes sonë standarde ta sqarojnë e ta zgjidhin edhe çështjen e foljeve me formantin –AV sot, menjëherë, pa e lënë punën për nesër:

Së pari, për mendimin tone, në këtë kontekst nga standardologët e sotëm, kërkohet të pranohet e vërteta, se përjashtimi ose anashkalimi i sistemit foljor të gegërishtes me rastin e formëzimit të standardit në periudhën para e pas Kongresit të Drejtshkrimit 1972, gjithsesi ishte një veprim joshkencor dhe shumë me pasoja negative, ngase u zhvesh standardi nga prurjet nga dialekti me shtrirje më të gjerë relievoe, i cili edhe e kishte njëfarë përvoje jo vetëm formale edhe si standard, kështu me një veprim të tillë mbeten jashtë standardi vlera të pakompensueshme të shqipes natyrore, siç ishte rasti i paskajores me + pjesore e vlera të tjera dhe si viktimitë e një veprimi të tillë si duket mund të radhitet edhe mostrajtimi i deritashëm i foljeve më –AVË, pasi që edhe kjo dukuri bën pjesë në karakteristikat themelore të dialektit gegë, prandaj si pike e pare shqipja e sotme zyrtare e standardi i saj patjetër duhet të pajisen me paskajoren e mirëfilltë, ngase e ka vendin e

zbrazët dhe nga mungesa e saj kanë mbetur nënfusha të caktuara semantike pa u mbuluar kënaqshëm, madje edhe kjo analizë jona, po të përjashtojmë paskajorja, do të dilte një sipunë e gjymtë, apo jo?.

Së dyti, edhe pse çështja rreth foljeve me –AVË, ndoshta, mund të konsiderohet si një çështje minore, në krahasim me problemin e paskajores etj., megjithatë edhe për këtë lypset qasje e re e esëllt. Besoj se tashti është e kuptueshme për të gjithë njerëzit e pjekur që e duan shqipen të sforcuar dhe shqiptarinë më të bashkuar, se integrimi i paskajores dhe qasja e re ndaj prurjeve nga dialekti i gegërishtes, pra tashti edhe vlerat e foljeve me -AV në standard, aspak nuk e lëndojnë letrarishten e sotme mbi bazë të toskërishtes, përkundrazi atë e shpëtojnë nga zvetnimi, nga drunjëzimi i mëtejshëm, dhe se atë bazë e bëjnë më të fortë, e bëjnë edhe më shqipe, edhe më kombëtare dhe aspak nuk e prekin keqas strukturën e saj si gjuhë zyrtare dhe njëherazi gegërishten me vlerat e saj, e cila është krahu i djathtë i shqipes natyrore, e shpëtojnë nga arkivimi i mëtejshëm arbitrar i saj.

Së treti, ka ngjarë çfarë ka ngjarë më përpara, keq e mire, mire e keq rreth formëzimit të shqipes zyrtare, s'kemi nevojë me hapë gjyqe për të gjykuar apo me shqiptue qoftë edhe përgjegjësi morale, kundër askujt për të kaluarën. Me këqyrë hollë e hollë është fatmirësi që tashmë e kemi një gjuhë të ravijëzuar standarde, e cila fatmirësisht ka mundësi me u bë edhe më aftë, duke u pajisur me fjalë e forma që nuk i ka, të cilat s'ka pse mos me i pranue nga e ama e vet, shqipja e natyrshme, pa e prishur fare kornizën vetjake. Në këtë kontekst, kurrsesi nuk duhet lejuar vazhdimi i injorimeve ose i keqinterpretimeve ndaj vlerave të shqipes natyrore të mbetura jashtë standardit. S'do mend, nga çdo dialekt, e folme, sociolekt a idiolekt duhet përthithur vlerat dhe ato duhen integruar për ato nënfusha të veçanta semantike, ku del e nevojshme pa krijuar pasoja, siç është paskajorja, tashti edhe foljet me –AV. Paranoja e krijuar me vite nga propaganda përherë jo e bardhë ose për mungesë konceptesh në mendjen e ndonjë fanatiku, qoftë edhe me emër standardologu se gjoja prurjet e reja të domosdoshme në normën e shqipes standarde e shkatërruakan atë dhe së andejmi norma e re u dashkërka rinisur nga gërmadhat, duhet shëruar. Mendjeve të tilla, u duhen doza jatrokimie, apo jo, le të vlerësohet. Fundja, nga përdorimi i paskajores në këtë punim, me çfarë e ku është *damkavë* standardi, përveç damkosjes së paranojës së ndonjë fanatiku mjeran, apo jo?!

Gjithkujt duhet t'i flejë në mendje e zemër se asnjë vlerë nga gjuha amë nuk e shkatërron standardin, por përkundrazi, atë e përplotëson, e bën më të aftë në aspektin e brendshëm dhe njëherazi e bën më të fortë në luftën e

konkurrencës ndaj sfidave që paraqiten e do të paraqiten nga globalizmi i sotëm dhe i nesërm botëror.

Së katërti, kur është fjala të foljet më –AVË, duhet pasur qëndrim serioz e qasje të qartë. Tashmë, pas kësaj paraqitjeje prej nesh e kemi mjaft të qartë, apo jo, se prejardhja sllave e saj del me rezerve të ligjshme, madje përparësia e shqipes as që mund të injorohet, ndonëse raporti ndërndikues i këtyre dy gjuhëve nuk mohohet dot, por shikuar në aspektin sinkronik, siç është cekur edhe më përpara, çështja e prejardhjes nuk paraqet kurrfarë pengese, kur është çështja e vlerave reale të ngulitura në kohë e hapësirë, ngase të gjitha gjuhët në kontakt edhe ato që sot konsiderohen si më të zhvilluarat në botë kanë pasur ndërndikime me gjuhë të tjera, madje edhe huazime fjalësh e formash me përqindje të lartë deri 70-80% si anglishtja, turqishtja etj., andaj edhe raporti serbisht-shqip lypset vlerësuar nga pikëpamja e vlerave, jo nga emocionet e përmjegullavta të rastit.

Sido që të jetë, duke e lënë këtë çështje teorike hapur, theksojmë se nga materiali që e kemi në dispozicion në ndonjë rast shihet se ishte aktiv edhe ndikimi i shqipes, në ndonjë të folme të serbishtes. Pikërisht nga fjalë e shprehje të tilla të shqipes përmendet fakti se në disa të folme sllavishtfolëse ka shtrirje pikërisht shprehja: **ne keçavi se**, e cila sigurisht është krijuar sipas shembullit të shqipes **mos u keqav**, që në letrarishten e sotme të gjuhës sonë shprehjes së tillë i përgjigjet sadopak barasvlerësi **mos u keqos** e në serbisht **ne ološavi se(!)**, shprehje këto që i lejon modeli, por që nuk i ndeshim të shënuara në burimet përkatëse të asnjërës gjuhë.

Lidhur me këtë e shoh të nevojshme të përmend faktin se studiuesi serb Bozhoviq Marinko, në punimin *Disa dukuri të përbashkëta gjuhësore shqipe dhe serbe në Kosovë...*, veç tjerash cek këto fjalë shqipe që kanë hyrë në të folmet serbe:

besë, goruzhdë, dadë, çikë, droçkë, dreq, bard(h)okë, bacë etj. si dhe keqav...,

duke theksuar në fund se dukuritë e tilla jo aq të pakta ndërndikuese gjuhësore gjithsesi kanë ndodhur reciprokisht në mënyrë spontane dhe disi pa u ndjerë, pa ndonjë presion. (Shih: *Zbornik 1*, FFP, Prishtinë 1991, f. 107.)

Edhe në shkrimet e prof. Mustahaf Ibrahimit lexuam se edhe në maqedonishte në fjalët e huazuara shqipe bën pjesë edhe fjala *keq*, maqedonishte

Fundi i fundit nga materiali i ekspozuar në këtë punim kuptohet, se në aspektin sinkronik në shumicën e rasteve nuk kemi të bëjmë fare me shprehje

të një kulture gjuhësore të huaj, pasi shihet qartë se pothuajse të gjitha rastet (fjalët e shprehjet) me –AV janë zhvillim i brendshëm i shqipes.

Së pesti, e thamë që lidhur me temën tone ndërndikime sllave-shqipe ka pasur, por nga një dukuri e tillë lidhur me fjalët më –AV në aspektin fjalëformues, shqipja ka epërsi. Mjafton të krahasojmë fjalën boshtprodhuese fjalëformuese për shembujt me –AV që në serbishte është **mbiemri** i një tipi të veçantë, i cili siç e kemi vërejtur sadokudo del **me kuptimësi e formë ndërtimore heterogjene**, në shqip del **folja** (pjesorja apo paskajorja) po ashtu e një tipi të veçantë, por **me kuptimësi e formë ndërtimore homogjene**. Dihet gjithashtu se **folja (kallëzuesi)** është koka kuptimore e fjalisë dhe **pjesorja** e saj, është vetë **tipari themelor i strukturës fjalëformuese**, ndërsa **mbiemri**, siç dihet në fjali (në të dyja gjuhët) nuk del si fjalë e mëvetëshme, apo jo?! Pra, së këtejmi, vetë **folja** në gjuhën shqipe ndërtimisht e kuptimisht motivon dhe arsyeton dhe njëherazi mundëson, varësisht nga konteksti, si me thënë, prodhimin serik pa kufizim, të fjalëve të tilla (prejpjesorëve) të cilat atavikisht dalin të ravijëzuara që në kohë e hapësirë kamot në kuadër të sistemit të gjuhës së natyrshme shqipe, madje përkundër anashkalimit a përjashtimit nga standardi aktual, ato edhe sot, në realitetin tone gjuhësor, dalin shumë vepruese e prodhimtare, sepse te fjalët e tilla:

e para, **dalin të qarta si prapashtesa –AV, si formant foljeformues, ashtu si edhe tema prodhuese** mbi bazë, emërore, mbiemërore ose foljore, si p.sh.: qen-i (qen+av – qenav, me (u) qenavë), i keq (keq +av keqav, me (u) keqavë), shkokloj me (u) shkoklue (shkokl+av shkoklav, me (u) shkoklavë);

e dyta, i motivon nënfusha e qartë semantike me kuptimësi pejorative të shkallës më të lartë, konceptet e së cilës mbuloohen me fjalët e tilla;

e treta, i karakterizon **modeli i qartë fjalëformues mbi bazë të pjesores**, e cila me strukturën e vet paradigmore, automatikisht pa mundim improvizimi, **mundëson formimin e fjalëve** të reja për fushën e caktuar semantike, **pa kufizim shumimi**.

Andaj, duke i pasur parasysh këto kritere:

- 1) *formantin e qartë foljeformues*,
- 2) *temën e qartë prodhuese (emër, mbiemër, folje)*,
- 3) *fushën e qartë semantike pejorative si dhe*
- 4) *modelin fjalëformues mbi bazë pjesoreje*,

që janë fakte të forta të pamohueshme motivuese, formohet bindja që pikërisht këto të vërteta bënë të mundshëm ruajtjen e kësaj pasurie, por edhe krijimin e gjallimin e formimeve të tilla si në të kaluarën, ashtu njëherazi sigurojnë edhe aktualisht rigjallimin dhe të ardhmen e sigurt të fjalëve dhe të shprehjeve të tilla.

Së këtejmi, formimet me fomantin -AV në gjuhën shqipe standardologët tanë edhe teorikisht duhet t'i vlerësojnë drejt, duke u dhënë fjalëve të tilla vendin e merituar në sistem, madje edhe duke i përcaktuar domosdo edhe sirregullat e nevojshme teorike edhe në burimet tona normative.

Së gjashti, studiuesit tanë tashmë duhet të esëllohen dhe ta shohin të vërtetën që sistemi foljor i gegërishtes dhe përgjithësisht ku bëjnë pjesë edhe përfitimet me -AV, siç u përpoqëm ta prezentojmë ne, paraqitet, hë për hë, si një minierë e pashfrytëzuar gjuhësore, ku disa margaritarë gjuhe vetëm po shihen me sy e po kapen me dorë, si paskajorja e ndonjë tjetër, por ende lënda e tillë përgjithësisht nuk ka filluar së përpunuari në impiantet gramatikore, andaj nuk kemi as gjysmëfabrikate, madje ende nuk ka kaluar së studiuari as në në laboratorët e analizave të thella logjike e sociolinguistike, sipas fushave semantike, për të kaluar pastaj e me dalë si prodhim final brenda strukturash përkatëse legale ligjërimore. Prandaj duhet njohur e shfrytëzuar ky thesar, jo vetëm nga krjuesit e artit letrar, por edhe nga gazetarët, e mos të flasim për humoristët e komedishkruesit, por edhe për mësuesit e për kë jo, të cilët, sikurse edhe ne personalisht, deri më tash, i kanë ndrydhur në vetvete vlerat përkatëse të formimeve me -AV, duke kujtuar se vërtet fjalët e tilla, pasi nuk i rekomandonte gramatika e stilistika e letrarishtes së sotme, duhej zhdukur ose duhej hedhur tej si një plaçkë e pavlerë a si një pjellë të keqe, të shpifur nga ndikimi i serbishtes etj.(!!!)

Së shtati, meqë foljet me prapashtesën -AVË dhe përgjithësisht fjalët me këtë formant, dalin të privuara, jo vetëm nga prestigji, por faktikisht edhe nga e drejta përdorimit, qoftë për mungesë koncepti, qoftë nga faktorë të tjerë, tashti, kur kanë ndryshuar raportet politiko-shoqërore, ngase edhe standardi nuk shihet njëanshëm më me shkurtpamësi, atëherë në interes të pasurimit ose kompletimit të gjuhës sonë standarde edhe me prurje të domosdoshme nga gegërishtja, edhe foljet, përkatësish fjalët e shprehjet me formantin -AV, jo vetëm duhen ofruar opinionit të gjerë, por edhe duhen ndihmuar e udhëzuar për shtrirjen e përdorimin e tyre sipas kritereve të qëndrueshme e jo të mbetet jetësimi i tyre në mënyrë stikike.

Sigurisht, pas kësaj paraqitjeje prej nesh edhe ky problem duhet pare esëll dhe fjalët e tilla duhet me i shfrytëzue në përdorim normal si në gjuhën popullore, ku duhet dhënë prestigji, por aq më tepër duhen ndihmuar për ta gjetur rrugën më të përshtatshme:

Së pari, në gjuhën e krijimtarisë poetike, siç ka bërë edhe poeti e intelektualit i mirënjohur **Agim Gjakova**, i cili në një poezi shprehet kështu:

haparaven (kokrrizat në rërë)... (Shih: *Koha ditore* dt. 19.08.'2002, f. 2.).

Ashtu, ka vepruar mire, edhe poeti **Çerkin Ismajli**, i cili në një strofë të një poezie e ka implementuar bukur këtë formë:

As fjetur, as zgjuar

Krejt mjegullavt...

Po ashtu edhe Ramiz Lushaj në një jetëshkrim të një të njohuri ka përdorur shprehjen me vend: ...(vetëm) *pse ishte i derës së mirë dhe i punës së mirë ...iu turravën dhe e sakatavën ...* (zsh, 23.03.2015.)

Shtrohet pyetja, pse mos t'i shfrytëzojnë fjalët e tilla edhe poetë e shkrimtarë të tjerë, në kontekste të caktruara, apo jo?!

Së dyti, madje pse mos ta përdorin këtë mënyrë shprehjësore edhe gazetarët e humoristët, përkthyesit, politikanët e kush jo, kur kanë nevojë me shprehë nuanca të tilla kuptimore pejorative ose të ngjashme, andaj lidhur me këtë marr guxim me i improvizue nja tri raste, që nuk i quajmë model, por sprovë nismëtare, si b.f. :

1) *Ja, si e tregon fotografia momentin se si u mërrolav N.N. me rastin kur u kritikua, por mjerisht nuk mujta me kapë çastin me blic, kur ai u keqav edhe më shumë në surrat në çastin kur mori vesh se për atë punën e flliaftë të tij ishte hapur procedure e thikavtë penale...*

2) *I thashë, o i shkretë, as mos u shtihav, as mos u belbav, por ec e thuaje të vërtetën qysh e di, pa u tutë e pa u ngutavë, por ai, frikavçi i pusavtë në vend se të vepronte si i thashë, e shkretavi krej: u budallav e u lopav më zi se lopa që fle mbi bagla të veta, nuk qe i zoti me thënë as gjysmë të vërtetën. Kështu nga friga, tucavçi i dreqit, se mos do t'i hakmerrej ai fare qenavçi që lehav e i turret gjithkuj, sa here e prekin kah podina, kah ai kulltuku i butavtë, që e ka zënë bythavçi i dreqnillavtë, në zyrën e shtetit dhe kështu ky shtihavçi ynë e lloçavi edhe më shumë veten, por më përllaçavi edhe mua, shtihavçi i zanavtë...!*

3) *Me iu sklepvavë sytë dërlavecit nuk është dëm i madh, pastrohen me ujë e sapun, po me iu sklepvavë sytë e mendjes kaçarotavçit mendjeqykav që e mban veten dijetar, atëherë keqavet e qykavet krejt puna, sepse të*

shtrebnavtët e thuprave të mendjes së tij tashmë të thadravta nuk zbuten dot edhe me i shti në ujëvale, ato tashmë veç therravin e me to, nuk mundet kush me thurë asgjë të mire....

Sigurisht ai që i ka fjalët e tilla me **AV** në sistemin e vet ligjërimit, edhe pse në gjuhën e shkrimit ende nuk i janë mësuar sytë me i pa, ka mundësi me improvizue shembuj, madje shumë më të goditur e më natyrshëm se këta që i bëmë ne. Ndërkaq ata që mbase i kanë tretur nga sistemi ndërkohë, duke i dëgjuar dhe duke i pare me sy në të ardhmen, besoj se do të mësohen dhe do t'i përdorin, madje më me vend se ne, sa here që stilistikisht u duhen.

Sidoqoftë, të gjitha këto dhe të tjera, që u përmenden prej nesh pa gjurmuar më thellë është dashur t'i dijnë e duhet t'i dijnë edhe sot e nesër standardologët tanë, në mënyrë që mos të bëhen gafe të tilla siç ka ngjarë në vitet para e pas **Kongresit të Drejshkrimit**, kur nga gramatika dhe fjalorët normative u përjashtua **en bloc** pothuajse tërë sistemi foljor i gegërishtes, madje si rrjedhojë edhe shembujt me infiksin –AV u reduktuan shumë në fjalorët normative, ndërsa foljet me -AV u përjashtuan krejtësisht, apo jo? (!!!?).

Përfundim

Në fund na mbetet të rrumbullakësojmë me pak fjalë këtë vështrim tonin të analizuar në gjashtë pjesë, andaj edhe përfundimin nga kjo trajtesë po e përmbledhim po ashtu në gjashtë pika:

1) Me sa dimë formanti –AV si prapashtesë foljore edhe pse e trashëguar që nga thellësitë e kohës në gjuhës shqipe, teorikisht identifikohet si e tillë nga D. Nikollë Gazulli (1941), i cili e mbron mëvetësinë anase të saj. Pas tij edhe studiuësit e mirënjohur Xhuvani –Çabej (1962), e dëshmojnë këtë formant në fjalët e sistemit emëror të shqipes, por vetëm si konglutinat në 8-9 variante, duke e konstatuar si prapashtesë vendëse po ndoshta me prejardhje sllave, por pa u futur më thellë në trajtimin e saj.

2) Meqë formanti –AV ndeshet edhe në gjuhën serbe raporti ndërndikues i shembujve në këto dy gjuhë u trajtua mjaft në hollësi në pjesën e dytë të këtij vështrimi. Nga lënda e konsultuar nga fjalorët përkatës dygjuhësh, serbisht-shqip e anasjelltas, doli se, vërtet, ka fjalë e shprehje në të dyja gjuhët me formantin –AV, ndërndikim ky që nuk mohohet, por sa u

përket fushave semantike që mbulojnë dhe nga pikëpamja e ndërtimit dhe e përfaqësimit të fjalëve të tilla më shumë ka dallime se ngjasime, ngase në serbishte si fjalë bosht në funksion të tillë del **një tip mbiemri**, ndërsa në shqipe del **folje me prapashtesën e mirëfilltë –AV(Ë)**, Së këtejmi, nga kjo analizë fitohet përshtypja se në gjendjen aktuale, shumica e përfitimet në shqipe nuk vijnë nga ndikim po janë zhvillime të brendshme të saj, ngase në asnjë kategori eptimi ose në finesa nuk kemi kalkëzime të vrazhda, andaj edhe sa përket prejardhjes sllave të formantit –AV shprehet rezere e ligjshme.

3) Sidoqoft, në periudhën e formëzimit të shqipes së sotme letrare, para e pas *Kongresit të Drejtshkrimit* (1972) fjalët më –AV nuk u favorizuan, madje jo vetëm foljet me prapashtesën –AV(ë) nuk përfshihen fare, por as mbiemrat e paranyjzuar me prapashtesëm –TË. të tipit **i ngurravtë**, nuk përfshihen në fjalorët normative të shqipes letrare kombëtare të kësaj periudhe, megjithatë si infiks (konglutinat) formanti AV, del i indentifikuar jo vetëm në shembuj të sistemit emëror, por edhe në sitemin foljor, sidomos te foljet me –AVITË fundore etj.

4) Për të parën here foljet me prapashtesën –AVË, të cilat në ligjërimet tona popullore kanë trashëgimi të kahershme përdorimi në kohë e hapësirë, si dëshmi shkrimore ne i kapëm dy–tri raste të mirëfillta nga veprat *Fjalorthi*(1979), dhe *Fjalor popullor* (2014) të prof. A. Zymberit, pastaj i ndeshëm në Fjalorin e IAP-së 6 raste, ndërkaq në Fjalorin e M. Elezit (2006) numri tyre arrin afro 90 shembuj dhe po aq e më shumë raste dalin nga gjuha e gjallë popullore, por edhe nga deshifrimi i prejppjesorëve përkatës si emra, mbiemra e ndajfolje, ku formanti –AV del kryesisht si konglutinat. Kështu, në realitetin tone gjuhësor numri fjalëve, mbi bazë pjesoreje ose si folje të mirëfillta me prapashtesën –AV, varësisht nga konteksti, del me mundësi të pakufizuar shumimi dhe nuk vihet në dyshim aktiviteti dhe prodhimtaria serike e tyre aktualisht.

5) Në pyetjen pse ka ndodhur një zvarritje e tillë e studimit të një dukurie të tillë deri në ditët e sotme si përgjigje, përveç mungesës së koncepteve theksohen këto tri shkaqe si komponente:

a) Përjashtimi i sistemit foljor të gegërishtes, me rastin e formëzimit të shqipes letrare zyrtare mbi bazë të toskërishtes para e pas *Kongresit të Drejtshkrimit* (1972), sepse edhe foljet me –AVË janë karakteristikë e gegërishtes.

b) Keqkuptimi i konstatimit të Xhuvani- Çebejt mbi gjoja prejardhjen sllave të formantit –AV, e si rrejedhje edhe fjalët me –AVË mund të jenë konsideruar si pjellë e një gjuhe të huaj?!

c) Mosnjohja e fushës semantike që mbulojnë fjalët me –AV, përmasat e shtrirjes së tyre dhe mosnjohja e vlerave përkatëse të një dukurie të tillë.

Sidoqoftë, arsyetimet e tilla nuk mund të jenë justifikim i zvarritjes së mëtejshme e studimit të foljeve me –AVË, prandaj edhe kjo pasuri e pashfrytëzuar duhet pare e vlerësuar sa më parë në kuadër të shqipes standarde.

6) Së këtejmi, kur kemi parasysh shumësinë e fjalëve me këtë formant në përdorim e sipër dhe sidomos çerdhën fjalëformuese mbi bazë pjesoreje, imponohet e vërteta që implementimi i foljeve me -AV në standardin e gjuhës shqipe sot del i obligueshëm dhe një integrim të tillë e mbështesin dhe e lehtësojnë këto fakte:

e para, dalin të qarta, si tema prodhuese mbi bazë, emërore, mbiemërore ose foljore, si p.sh.: qen-i (qen+av – qenav, me qenavë), i keq (keq +av keqav, me keqavë), shokloj me shoklue (shokl+av shoklav, me shoklavë). ashtu **edhe prapashtesa –AV, si parapashtesë e mëvetësishme foljeformuese,**

e dyta, del e qartë edhe nënfusha semantike me kuptimësi pejorative të shkallës më të lartë, konceptet e së cilës mbulohen në mënyrë më të plotë vetëm me fjalët e tilla dhe

e treta, një dukuri të tillë e motivon modeli i qartë fjalëformues mbi bazë të pjesores, e cila me strukturën e vet paradigmore, automatikisht, pa mundim improvizimi, **mundëson formimin e fjalëve të reja për fushën e caktuar semantike, pa kufizim shumimi.**

Së këtejmi, meqë foljet me prapashtesën –AVË, për shkaqe të ndryshme, kanë qenë të privuara nga përdorimi letrar zyrtar, ne mendojmë se përdorimi i tyre sot e në perspektive duhet ndihmuar e udhëzuar, duke sugjeruar e yshtur, poetët, shkrimtarët, por edhe gazetarët, humoristët e komedishkruesit, mësuesit, politikanët, e kë jo, për mundësinë e shfrytëzimit të kësaj pasurie gjuhësore jo mjaft të njohur normativisht, pa të drejtë, apo jo?!

Së fundi, dukeqenë që fjalët me formantin –AV, edhe pse kryesisht si konglutinate, dalin të përfshira në fjalorin normëzues të shqipes, si emra,

mblidhet, e sidomos folje me prapashtesën –IT, -AT, madje edhe –me O, –OS etj, në përdorim e sipër, që si të tilla nuk janë vetëm të rekomandueshme, por janë edhe obliguese me u përdorë në shqipen standarde, andaj një obligim i tillë vetvetiu kuptohet si rregull-detyrim që duhet shtrirë, pse jo, edhe te foljet me prapashtesën –AVË, të cilat deri tash, mjerisht, ishin të panjohura (!) për standardin.

Gjithsesi kjo pasuri gjuhësore kombëtare duhet futur nën përkujdesje të gjuhës standarde, ngase edhe me këtë element kompletohet e sforcohet në njëfarë mënyre standardi i shqipes në luftën e konkurrencës në raport me gjuhët e huaja.

28) RRETH RRËNJËSISË DHE SHTRIRJES SË FJALËS KALË NË SHQIPEN E DOKUMENTUAR

Në këtë trajtesë bëhet fjalë rreth konceptit që ka të bëjë me fjalë-emrin **kalë kali**, në shqipe e përgjithësisht, koncept ky që lidhet gjithsesi me këtë kafshë shtëpiake, qi ishte *aq e nevojshme dhe e afërt për njeriun*, të cilin e ndihmoi gjatë zhvillimit historik të tij: si forcë e pandashme shoqëruese në lëvizje e sipër, qoftë *si mjet pune, si mjet lufte, qoftë edhe si mjet argëtimi* dhe që shërben edhe sot në rrethana të caktuara *për të hipur mbi të, për të bartur diçka, për të tërhequr karrocën* etj. Së këtejmi, ne, në këtë trajtesë bëjmë fjalë:

së pari, rreth rrënjësisë së fjalës **kalë** të shqipes në krahasim me barasvlersësit përkatës të gjuhëve i.e. dhe atyre romane në veçanti;

së dyti, rreth shtrirjes në kohë-hapësirë të kësaj fjale dhe derivateve të saj në sistemin foljor dhe atë emëror të shqipes në krahasim paksa me gjuhët romane dhe

së treti, rreth larushisë ndërtimore, paradigmore e fjalëformuese të shembujve në shqipe si dëshmi autoktonie të kësaj fjale

1. Rreth rrënjësisë së fjalës kalë të shqipes

Me sa dimë, studiuesit e indoeuropeistikës rreth konceptit të fjalës **kalë**, duke u mbështetur në trajtat emërore të dokumentuara si b.f.: pers. **asp**, lat. **equus**, sanskr. **açvas**, angl. **horse**, gjerm. **Pferd**, rus. **loošad**, gr. **agolo(s)**, **ippos**, **ikos**, serb. **konj / kobylo**, shq. **kalë/pelë**, etj., etimonin e kësaj fjale e (ri)konstruktuan në trajtën i.e. ***(h)ekkwos**. (Shih edhe te: Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë 1989, f. 155.) Në të vërtetë,

konstruktin **kalë** të gjuhës shqipe, studiuesit e ndërlidhin me trajtën e latinishtes vulgare **caballus**, prej nga edhe e kanë prejardhjen fjalët e konceptit të tillë në gjuhët e gjalla neolatine (romane) si: fr. **cheval**, it. **cavallo**, sp. **caballo**, port. **cavalo**, rum. **cal**). E thamë që konstrukti **kalë** ndërlidhet, jo pa të drejtë, me trajtën e latinishtes vulgare **caballus**, gjë që nuk mohohet, por sa i përket raportit ndërndikues huazues: **latinishte vulgare / krijim autokton** i shqipes rreth kësaj fjale ka mendime të ndara që *lënë vend për diskutim*.

Sa për t`u shtuar kërshërinë lexuesve tanë e ndonjë studiuesi në veçanti, po *shpjegohemi* pse thamë **lënë vend për diskutim**. Për mendimin tonë ka gjëra të diskutueshme, jo vetëm në raportin e shqipes me rumanishten (**cal/kal-**) me gjuhën homerike *kel/is* dhe me greqishten (alog-os /*agalos* /*n/gal (!), përkatësisht *ippos* /hipës (me hipë), *ik-os* /ikës (me ikë), por edhe sa i përket raportit **latinishte vulgare/ protoshqipe** të kësaj fjale dhe si pretekst kontestimor po përmendim këto tri fakte:

e para, studiuesi A. Meje konstaton se fjala **caballus** ka origjinë diskutabile ("origine discutée"), pra nuk i përket për nga origjina gjuhës latine, ngase ajo për këtë koncept kishte fjalën **equus**; (Shih: Antoine Meillet, *Dictionnaire étymologique de la langue latine*, Paris 1967.)

e dyta, meqë A. Meje (dhe në burime të tjera) nuk përcaktohet konkretisht se cila nga gjuhët e vjetra të asaj kohe vulgare (popullore), pra jo latinishtja, mund të jetë "amë" ose ndikuese në pëftimin e trajtave përkatëse të gjuhëve neolatine, për ne ky fakt sfidon ose duhet të sfidojë edhe më shumë historianët e gjuhës sonë në kuptimin se mos vallë protoshqipja do të ketë pasur hise, apo jo, në raportin **kalë/caballus?** dhe

e treta, studiuesi, **M. Huld** sipas A. Konushevcit, konstaton se fjalë-koncepti **kal**, vjen si reflektim nga rrënja i.e. ***kel**, me kuptimin "**me grahë, me vu në lëvizje...**", supozim ky që përkrahet nga A. Konushevcit e të tjerë. (Shih *Forumi shqiptar*, 23.02.2010.)

Sido që të jetë, edhe pse ne nuk jemi specialist dhe s`kemi aq kompetencë sa me marrë pjesë në këtë shtjellë diskutimi, megjithatë për të ndihmuar sadopak të zbardhurit e çështjes rreth autoktonisë brenda shqipes të fjalës **kalë**, qoftë edhe në mënyrë anësore, apo jo, duke u mbështetur edhe në faktet e sapocekura më parë, marrin guxim me shtrure pyetje dhe me kërkue paksa *sipjesëmarrje* në përgjigje rreth pyetjeve të shtruarra, pikërisht rreth synimit të sipërshprehur:

së pari, meqë fjala "kalë" e shqipes me sa u tha, nuk mund të cilësohet edhe më si një "latinizëm" i mirëfilltë i prejardhur as nga **equus**, madje as nga ajo **caballus**, apo jo, sepse kjo fjalë (sidomos e dyta), e cila konsiderohej si dhënëse latine për shqipen, edhe vetë nuk paska origjinë latine(!), por të një gjuhe tjetër, andaj hapet rrugë, apo jo, për të vrarë mendjen, vallë, cila gjuhë konkretisht mund të jetë *amë* ose *ndikuese* e këtij fjalë-koncepti?

së dyti, në vazhdë të këtij konteksti shtrohet pyetja tjetër, kur është fjala te latinishtja vulgare "popullore", sa mund të ketë lënë gjurmë fillimisht pellazgo-ilirishtja, pastaj edhe protoshqipja për raste të veçanta si kjo, kur dihet fakti se fiset pellazgo-ilire (*etruske, ligure*), përkatësisht ilire-protoshqipe: **mesape, japide, kalabre e toske-shqipe** (!) (Shih edhe te Shefki Sejdiu, *Gjurmë interferimesh..., Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK*, Prishtinë 2012 f. 231.), të cilët, ndaj vendësve e të tjerëve, siç thuhet kishin një farë epërsie kulturore për kohën, shtriheshin përtej territorit ballkanas që ka shqipja sot. Së këtejmi, në kontinuitet, pa u shkëputur nga konteksti del edhe një fakt tjetër, që ceket nga prof. Eqerem Çabej se në gjuhën e hershme italiane ka qenë e ngulitur shprehja *epirote equites*, d.m.th. *kalorës shqiptarë*, pra shqiptarët (si vazhdues të protoarbërore, të ashtuquajtur epirotë) ishin të njohur që atëherë, d.m.th., që në antikë, edhe atje, si *kalorës*, të cilët sigurisht fjalën *kalë* e bartnin me vete, apo jo? dhe

së treti, për të fituar ide më të mirë në kontruktimin e etimonit filltar, ose të përafërt, në këtë kontekst sa ndihmon të trajtuarit e variantëzimeve të emërtimeve të përfutuara, mbi bazë të fjalë-konceptit **caballus**, përkatësisht **cavallus** - *kaval (!), *kalë* /*ngal - duke u nisur nga variantet e gjuhëve të sotme të gjalla dhe duke ndjekur këtë shtrirje vertikale deri në majat më të larta të mundshme të kohë-hapësires historike?!

Pra, ne, pikërisht si përgjigje rreth pyetjes së tretë, pandehim me dalë paksa *sipjesëmarrës*, sepse nisur nga bindja se edhe në këtë mënyrë mund të jepet ndihmesë, qoftë edhe anësore, në gjetjen e rrugës për zgjidhjen e kësaj enigme, konsultuam variantizimin ose rrjedhojat përkatëse te gjuhët kryesore të gjalla, për me pa sa pati ndikim trajta **caballus**, te trajtat: *fr. cheval, it. cavallo, sp. caballo*, në njërën anë dhe sa në anën tjetër në përfutimin e fjalëve në rumanishte e shqipe **cal/kalë**, si izomorfemë, ku konstrukti filltar **kal-ë/cal** shqiptimisht e shkrimisht në këto dy gjuhë del i përbashkë, i njëjtë, apo jo?

Në të vërtetë, ne nuk patëm mundësi të konsultonim mjaft në hollësi e gjerësi lëndën nga gjuhët e cekura neolatine pasi patëm në dispozicion vetëm nga një fjalor normativ të gjuhës përkatëse dhe atë të profilit deri të mesëm,

por materialin në gjuhën shqipe për aq sa patëm mundësi, jo vetëm e konsultuam, por edhe u përpoqëm me e trajtue mjaft në hollësi e thellësi.

Sidoqoftë, nga materiali i tillë i konsultuar, i cili edhe duhet dhe mund të përplotësohet, sidomos me lëndë nga gjuhët neolatine, ne, siç do ta shohim më poshtë, arritëm, jo vetëm ta kompletionim më mire dijen tone rreth fjalë-konceptin **kalë** nga këndvështrimi i shtrirjes në kohë-hapësirë të shqipes së shkruar ndër shekuj, por bëmë të mundur që ky material të shërbejë edhe si provë mbështetëse, jo pa bazë, për të gjithë ata që janë të interesuar që këtë fjalë ta vërtetësojnë si fjalë autoktone të shqipes, apo jo? Ndërkaq sa i përket hises në ose nga latinishtja vulgare të fjalës **kalë** ndaj **caballus** nga krahasimi i sotëm, kur **b-ja** e theksuar në mes k/l- së, te njëjësi i shqipes nuk paraqet edhe aq problem, kur kemi parasysh shumësin e emrit **kalë** të shqipes: ***k'val**, **kuej kuaj**, së këtejmi nuk paraqet vështirësi as zbërthimi, sidomos kur kemi parasysh faktin, siç ceket në burime të caktuara (internet), se edhe në latinishten vulgare përveç trajtës mbizotëruese **caballus** dilte edhe ajo **cavallus**, megjithatë, hë për hë, ky fenomen ndërndikues mbetet vetëm çështje sfiduese ose si një sugjerim gërricës i përdëshiruar për ne, por njëherazi jo si ide e hedhur poshtë *a priori*, sepse vërtet ky fakt sfidon studiuesit e kësaj fushe dhe të gjithë dashamirët e gjuhës shqipe.

2. Shtrirja e fjalë-konceptit **kalë** me rrjedhojat përkatëse në kohë-hapësirën e gjuhës shqipe

Për të qenë, pra, me e qartë të shtrirët e fjalë-konceptit kalë me derivatet përkatëse në gjuhën shqipe, ne, nga burimet e caktuara volëm shembujt konkretë, të cilët, duke pasur parasysh strukturën ndërtimore, paradigmë dhe fjalëformuese të tyre, po i paraqitim, së pari, shembujt aktualisht të dokumentuar të sistemin foljor dhe së dyti, ata të sistemit emëror.

1) Nga sistemi foljor

Të ndjekim variantet e foljezimit të shembujve sipas burimeve përkatëse, që kuptimisht dalin qartë ose asociacionojnë sinonimisht a analogjikisht fjalë-konceptin rreth kuptimisë së emërtimit **kalë** të gjuhës sonë:

a) Nga punimi i Xhuvani-Çabejt (*Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962) ndeshim këto folje (të krijuara analogjikisht) po që asociacionojnë kuptimësinë mbi këtë bazë:

kalamendem, kalavar/em, kalavir/em, kalaro/hem, kalivar, kalivos, shkalavesh, shkalamit - gjithsej 8 shembuj.

b) Në FGJSH 1954 ndeshim këto folje:

kalamend, kalarohem, kaloj, ngallmoj, ngallnoj, ngalem, ngel/em, ngalirohem, ngalkohem, ngalosem, ngarend, ngarkoj, ngas (ngaj); shkalaris, shkalis, shkarmis, shkarko,j, shkel, shkelmit, shkarzej - 20 shembuj.

c) Në FGJSSH 1980, veç ndonjë shembulli nga FGJSH 1954, ndeshim raste plus:

kalavarem, kalëroj, kalisem, kalit, ngalem, ngalosem, ngalkohet, shkalafendem, shkalafit, shkalavesh, shkal, shkalit, shkallmoj, shkalloj, shkarravesh, shkarravit, shkas!, zgaj! - 18 shembuj.

ç) Nga FSHSK 1981 (*Fjalor shqip-serbokroatisht*, Prishtinë 1981) ndeshim këto folje:

kalaroj, kalavarem, kaloj, ngalosem, ngajkohet, ngalem, ngalkohem, ngalirohem; ngarrem, ngarkoj, ngarroj, ngarris; shkal, shkalis, shkalaris, shkalitem, shkallmoj, shkalloj, shkarkoj, shkarravesh, shkarravit, shkel, shkelvarem, shkelmit - 24 shembuj.

d) Nga Fjalori i IAP- së (*Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Prishtinë, 1982.):

kaladroj, kaliroj, kalafuq/em, kalaposh, kalaroj, kalashtis
- 6 shembuj.

dh) Në Fjalorin e M. Elezit qoftë me konstrukt tjetër, qoftë me nënfushë të re semantike ndeshim këto folje:

kalaboshav, kalaboshoj, kaladredh, kaladredhoj, kaladreqoj, kaladroj, kalavend, kalafend, kalafuq/em, kalakryqoj, kalamend, kalangërçoj, kalaposh, kalaroj, kalashtoj, kalavesh, kalaveshav, kalaveshoj, kalaveshtis, kalëroj, kaliroj, kaloj, shkelcoj, - gjithsej 23 shembuj.

e) nga FD 2011 (*Fjalor drejtshkrimor*, Tiranë 2011):

kalamend, kalandroj, kalarohem, kalavar/em, kalavirem, kalëshoj, kalëroj, kalit, kalis/em, kaloj; karavatem, karashtis, karrapitem; ngalkoj, ngall, ngallmoj, ngallashmoj, ngajkoj (ngajkohet), ngarend, ngarkoj, ngarmoj, ngas (ngaj), shkal, shkalafend, shkalit, shkalos, shkalafit, shkalaris, shkalavesh, shkalaviq, shkalos, shkalit,

shkarangjitem, shkaras, shkarëzej, shkarëzit, shkarkoj, shkarravesh, shkas(!), shkarravit – 41 shembuj;

ë) nga *Fjalor popullor* të A. Zymberit, Prishtinë 2014:

me kaladredhë, me kalakryque, me kalameditë, me kalarue, me kalaveshë, me kalue - 6 shembuj.

Nga sa më lartë, del se në gjuhën shqipe, manipulohet me mbi 80 -140 shembuj, folje këto të regjistruara, të formuara analogjikisht ose mbi bazë të emrit **kalë**, përkatësisht sipas konceptit që asociacionon *ecje, udhëtim, shëtitje* etj. gjithsesi **lëvizje** që në raste kuptohen metonimisht ose figurativisht se kemi të bëjmë me një *rrënjësi të tillë*, ndërsa në gjuhët romane perëndimore sipas fjalorëve përkatës që konsultuam, kryesisht për koncept - foljen **kalëroj** ndeshim vetëm nga një folje mbi bazë të emrit që mbulon konceptin e barasvlerësit *kalë të shqipes*, ndëkaq për **kaloj** (*me kalë*) ndeshim foljen përkatëse mbi temë tjetër që ne po i shënojmë në kllapa.

Krahaso:

fr. chevaucher (condire, se promener, voyager, monter a sheval),

it. cavalcare (montare, andare a cavallo, viaggiare, punëtare etj.),

sp. cabalgar (montar a caballo, andar ir ...) dhe

rum. calarese (merg cu cal...).

Në të vërtetë, në rumanishte mësuam se si sinonim i fjalës **cal** dalka emri **murg** (“bay herse”), ndërsa për pelë del trajta e latinishtes **equa** dhe si barasvlerës i shqipes **kalëroj mbi...**, dalka shprehja **ride de peste...**

Siç po shihet asnjëra trajtë sinonimike foljore (togfjalësha) në gjuhët e huaja nuk del me rrënjor të emrit përkatës *cheval, cavallo, caballo* apo *cal*. siç del shqip **kaloj**, po kjo nuk do të thotë se nuk duhet gjurmuar në këtë drejtim edhe në ato gjuhë edhe më tej dhe më në hollësi, seç bëmë ne në shqipe, por sidoqoftë, konstatimi rreth rrënjësisë së fjalës **kalë** në shqipe, e cila ilustruhet, me pothuaj 80-150 folje ose foljezime tashmë të përfutuara analogjikisht ose mbi këtë bazë, kemi bindjen se (koncepti rreth asaj rrënjësie) nuk do të zbehet aspak.

2) Nga sistemi emëror:

Po nga burimet përkatëse të sipërcekura e të tjera konsultuam shembujt nga sistemi emëror po mbi këtë kontekst. Në vijim po i paraqitim disa nga shembuj (jo krejt) që i ndeshim, ngase kur kemi parasysh modelet e qarta

fjalëformuese e sidomos përfitimet mbi temë foljore, numri i tyre potencialisht del më i madh se shifra që ne po e shënojmë më poshtë sipas burimeve përkatëse.

a) *Xhuvani – Çabej* (Shih A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 276 dhe 277.) manipulojnë me afro 40 raste, ku veç shembujve

kalapiç, kalabiç, kaliboç, kalaboza, kalaqafë,

që i pohojnë të përfutuara nga fjala **kalë**, por ata manipulojnë edhe me fjalë të tjera si:

kalush, kalas, galiç, kalavesh, kalafre, kalipiç, kaloshin; kalagjunjazi,; (n)galiç, (n)galuc, skalapouri, shkalavesh, shkalaviq, kalabisht, karabisht e karrabisht etj.

b) Në FSHSK 1981 ndeshim mbi 50 shembuj:

kaladredhas, kalangërç, kalas, kalaveshas, kalorthi, kaluarthi, i ngalët, ngarkues/e, shkalitje, ngalc, ngalakeq, shkelës etj.

c) Në Fjalorthin e A. Zymberit (1979) ndeshim mbi 20 shembuj:

kalabash, kalahute, kalakeq, kalaminare, kalanç(!) kalapec, kalaposh!, kalavec, kalaver, i(e) kalaveshun, kalagjah, kalaz, kalidash, kali i qyqes, kalingalë, kaliqafe, i kaliruem, e kalirueme, kalistrok, kalorës, kalosh, kalur;

Ndërkaq në *Fjalor popullor* (2014) dalin edhe më shumë raste, si:

kalabush, kaladredhë-a, kaladredhan, kaladedhajnë, kaladredhaz, kaldredhç, kaladremçe, kaldremçez, kalagat, kalagjahaz, kalagjysh, kalakaçkë, kalakush, të kalakryquemit, të kalamendunit, kalamen(d)ez, kalidhaz, kalingalet, kalshumaz, e kalueme, kalurëz, ngafç, ngajoshaj, ngajoshaz etj. –gjithsej mbi 40 shembuj;

ç) Në Fjalorin e IAP-së (1982), ndeshim 22 shembuj:

kalabuq/e, kaladash, kaladredhajnë, kaladredhan, kaladredhç, i(e) kaldredhtë, kalduc, kalafuq, kalagjysh, kalakeq/e, kalakryq, kalaush, kalavc, kalavanc, kalavesh, kalavër, kalbuçë, kale, kaligjok, kalistruse, kalival, kalithadër.

d) Ndërkaq në Fjalorin e M. Elezi ndeshim mbi 100 raste kategorish të ndryshme leksiko-gramatikore, si:

kalabosh, kalaboshan/e,, i(e) kalaboshavtë, i(e) kalaboshavur, kalaboshje, të kalaboshuarit, i(e) kalaboshuar, i(e) kalaboshur, kalabuçan/e kalabuq/e, kaladash, kjaladredh, kaldredh/e, kaladredhak/e, kaladredhajnë, kaladredhan, kaladredhës, kaladredhje, i(e) kaladredhtë, i(e) kaladredhur, kaladreqas,

i(e)kaladrequr, kaladuc, kalafendje, i(e) kalafendur, kalafuq, kalafuqe, i(e) kalaf, kalafurc, kalagat, kalagjah, kalagjysh, kalahum, kalahute, kalakeq, kalakryq, kalakryqim, i(e) kalakryquar, kalamand, kalamendas, kalamendje, kalamendshëm, i(e)kalemendtë, i(e) kalamendur, kalamiç kalaminare, kalamul, kalandryq/e, kalangërç, kalangërç/e, i kalangërçuem, kalanuse, kalaposh, kalaposhtje, i(e) kalaposhur, kalaqafas, kalari, kalarim, të kalavarurit, i(e) kalaruar, kalastrofc, kalastruc, të kalashtruarit, kalashun!, kalauke, kalaush, kalavanc!, kalavar, kalavere, kalavesh, kalaveshas, kalaveshavje, i(e) kaleveshavtë, kalaveshje, kalavesh-kalaveshë kalaveshtisje, i(e) kalaveshtisem, i(e)kalaveshur, kalavigj, kalvigjas, kalaz, kaleç, kaleqas, kalesë, kale, kaliçuk, kalidash, kalivenç, kaligjok, kalihum, kalikoq, kalikuse, kalim, kalikresh, kalingalë, (i(e) kaliruar, kalitruç, kalitrus,, kalithinc, kalivall, kalkuqe, kaloq, kalorazi, kalore, kalorës, kalori, kalorsisht, të kaluarit, kaluar, kaluce, kalur, kalush, kalvar.

dh) Në FD 2011 ndeshim mbi 70 raste të fjalëve mbi temë-konceptin e fjalës kal(ë), si:

kaladibrançe, kaladoras, kaladreshë, kalagjunjas, kalakiç, kalakryç, kalamendas, kalamendës, kalamedje, kalamendur, kalamendshëm, kalandrim, kalangërç, kalapelë, kalapiç kalaqafë, kalarim, kalarues, kalas, kalërim, kaldet, kaliboç, kalikiç, kalim,, kalojë, kalimtar, kalimtari, kalimtarësi, kalimthi, kalipiç, kaliqafë, kalitës, kalivare, kalor, kalorës, kaloras, kalorazi, kalorësi, kalorsiak, kalorthi, kaloshin, kalqyqe, kalrritje, kalshalë, kalth, kaluarthi, kaluç; karashtisje, i karrashtisur, karrapuc, karrabisht, karravesh, ngalakaq, ngalakeq, ngalaaq, ngelaq/e, i ngalët, ngalës, ngalje, ngalosje, ngalosë, ngarendas, ngarendje, ngarje, ngarkoçe, ngarkesë, ngarkicë, ngarkim, ngarkues, zgajtem(1), shkarravinë

Nga shembujt që konsultuam ose volëm nga burimet e mësipërm, numri i të cilëve kalon dukshëm 300-shin, konstatojmë se jo pak raste dalin të diskutueshme, po ne i shënuam si të tilla, ngase qëllimi ynë është që gjatë analizës të kihen parasysh të gjitha përfitimet e mundshme të diskutueshme e të padiskutueshme, të qëndrueshme e të paqëndrueshme ose të pranueshme e të papranueshme në dukje për kohën tone, sepse vërtet ndonjë rast mund të jetë jo i kapshëm mire sot për sot, megjithatë në analizë të imponueshmet mund të sqarohen, teprimet mënjanoen ndërsa të argumentueshmet mbeten të sakta, të kulluara. Në anën tjetër, me sa shihet, disa prejpjesorë ekzistues që

nuk janë shënuar këtu mund të shtohen, varësisht nga nevoja ngase, modeli fjalëformues i lejon.

Sidoqoftë, kur kemi të bëjmë me raportin **shqipe / gjuhë e huaj (romane)** mbi këtë fjalë-koncept konsultuam barasvlerësit e përftuar në ato burime dhe numrin e përfitimeve që i ndeshëm aty mbi bazë të emrit të caktuar, në zëra të veçantë, po i shënojmë më poshtë, fill pas titullit të burimit përkatës të konsultuar:

1) *Fjalor frëngjisht – shqip* (nga Vedat Kokona), rib. Prishtinë 1990, ku mbi temën **cheval** ndeshëm të përftuar nja 15 shembuj.

2) *Talijanski –hrvatsko-srpski rječnik* (M. Dejanović – J Jernej, Zagreb 1990), ku mbi temën **cavallo** ndeshëm 22 raste,

3) *Fjalor spanjisht – shqip* (nga Zef Sinani), Tiranë 1999, ndeshëm të përfuara afro 20 shembuj mbi temën **caballo**, si dhe

4) Fjalor rumanisht-anglisht “*Dixtionar explicativ/ dexonne.ro* “(internet) ndeshëm mbi 30 shembuj mbi bazë të rrënjë-temës **cal -**.

Gjithsesi edhe nëse numri në gjuhët e huaja mund të ndryshojë në dobi të sasisë, për çka nuk dyshojmë, kemi bindjen se në raport me shqipen nuk do të ndryshojnë konstatimet që u dhanë lidhur me specifikën që ka fjalë-koncepti **kalë** me derivatet përkatëse në gjuhën tone.

3. Larushia e shembujve nga pikëpamja ndërtimore, paradigmore e fjalëformuese si dëshmi autoktonie e fjalës kalë

Është e vërtetë se edhe larushia e shembujve vështruar nga pikëpamja ndërtimore, paradigmore dhe fjalëformuese tregon për rrënjësinë në kohë e hapësirë të fjalë-konceptit **kalë** dhe derivateve mbi atë bazë.

Meqenëse çështja e larushisë në fushat e sipërcekura kap një gamë të gjerë problemesh, të cilat lypsen trajtuar institucionalisht si nga pikëpamje historike ashtu edhe nga ajo aktuale, duke angazhuar studiues më me kompetencë e dije të duhur profilesh shkencore, megjithatë ne do të cekim kalimthi vetëm ndonjë fakt që shkon në dobi të temës sonë, siç është larushia paradigmore ndërtimore e fjalëformuese karakteristike e shfaqur te disa shembuj të regjistruar.

1) Larushia në ndryshimin e tingujve si dukuri të fonetikës historike

Nga lënda e trajtuar më sipër shihet qartë se si shembuj të ndryshëm nga sistemi foljor ashtu edhe nga ai emëror dalin të rrënjësor thellë në kohë-hapësirë të gjuhës së dokumentuar shqipe që faktohet edhe me ndryshime fonetike të thella dhe kjo përthellësi dëshmohet edhe nga shpërndërrimet e bashkëntingëlloreve dhe të zanoreve përkatëse, që shihet në shembujt përkatës si:

e para, fundorja e fjalës **kalë** si parashtesë temëprodhuese del tre – katër variantesh:

kal-, kala-, kalu- dhe **kali-**;

e dyta, nistorja **ng-** (**g**) shndërrohet në **k**, shih edhe rastet *n/gala –/kala-*, sikurse te rasti *ngaliroj / kaliroj*, po edhe nga **ngrah /n-krah** (sipas Xhuvani-Çabejt);

e treta, në disa raste tema merr shtesat nistore : **–n, s (z!)** ose **sh (!)**, si: *ngal. shkal, zgalem(!)*;

e katërta, qiellzorja **L** (ose *ll) fundore e temës shndërrohet në **j**, përkatësisht **r** ose **rr** (ngallkoj/ngalkoj; ngalkoj/ngarkoj; ngarros, ngarroj, ngarris, kalabishtoj, karabishtoj / karrabishtoj etj.);

e pesta, shndërrimi ose variacionet e zanoreve si **i, o, a, u, ë** te tema foljore p.sh. *kaliroj, kalaroj, kalaroj, kaluroj, kalëroj*.

Meqë ra fjala për foljezimin e kuptimësisë së konceptit që ndërlidhet me fjalë-konceptin **kalë**, me qëllim që të kuptohet më mire evoluimi shkrimor e semantik i trajtave të caktuara foljore, në vijim do të bëjmë fjalë paksa rreth ndërtimit dhe kuptimësisë së tri foljeve karakteristike mbi këtë bazë: **ngalkoj, kaloj** dhe **kalëroj**.

a) Rreth foljes **ngalkoj** (me ngalkue)

Në Fjalorin K. Kristoforidhit del trajta **ngallkoj ngallkohen** "pelat ngallkohen", d.m.th. "pelat hiqen", koncept ky që gjithsesi lidhet me fjalën **kalë**. Po aty ndeshim edhe foljen **ngalaroj** që në Fjalorin e Bashkimit del **kalaroj** (m`u kalarue) dhe **ngaliroj** (m`u ngalirue). Sipas E. Çabejt trajta **ngalkoj** i referohet trajtës *incaballicare* (incalca) të latinishtes "popullore" (Shih. E. Çabej, Studime gjuhësore IV f. 262). Në të vërtetë, foljen "**me ngalkuo**" për "shkoj kaluar" e hasim edhe te "Meshari" i Buzukut (Shih Çabej IV, po aty f. 82). E përdor edhe F. Bardhi për barasvlerësin **perequitare** të latinishtes. (Shih: Fjalori i F. Bardhit , f. 172.) Ndërkaq në burime të tjera ndeshim trajtat **j ngajkoj** ndaj **ngalkoj** (l/j), pastaj te ne ndeshet folja **ngaj** (*ngas*) **me nga** (si kali) ose **me ngajtë** (*me ngarendë, me vrapue*).

Nga trajtat e tilla kuptohet se nga shtrirja vertikale e këtyre fjalëve ndodhën edhe evoluimet ose shpërndërrimet **ng/k** ngal / kal *ngal (l/ll/j ngal(k)oj/ngallkoj // ngaj - ngarend, pastaj alternimi paradigmor i likuideve etj, si *l // r e rr* ngalkoj/ngarkoj ose kalabisht/karabisht / karrabisht –, ndryshime këto që vijnë nga thellësitë e moteve të kryera në periudha jo të shkurta kohore, por të njohura nga shkenca e gjuhës sonë. Madje edhe nëse ndodh që ndonjë trajtë a fjalë në gjuhën e sotme formale zyrtare të mos përdoret sot, ekzistenca e saj nuk mohohet.dot.

b) Rreth foljes kaloj (me kalue)

Folja **kaloj**, e cila, si të themi, sapo vihet re në Fjalorin e K. Kristoforidhit dhe në atë të "Bashkimit", por që nuk do të thotë se nuk ishte e ngulitur shumë kohë më përpara, dhe kjo ngulitje dëshmohet me faktin se në FGJSH 1954 del me pesë kuptime polisemantike, ndërsa në FGJSSH 1980 del me 19 kuptime të tilla dhe me nja 15 frazeologjizma. Është interesant se në të gjitha këto kuptime nuk del motivim i qartë fjalë-tema **kalë**, por gjithsesi dallohet kuptimi strumbullar që metonimisht lidhet në parim me një "lëvizje" *ecje, udhëtim, shëtitje (me kalë ose pa të)*, që me fjalë të tjera simbolikisht mund të referohet fare lehtë me kuptimin fillestar të shprehjes: "*shkoj me kalë*" = *lëviz, kaloj*, por që tash ka kuptimin: *kaloj (shkoj, lëviz) edhe pa kalë, më këmbë* etj. Po kjo del qartë edhe nga vetë fakti se tek arbreshët folja barasvlerëse e konstruktit **kaloj** del **ngaloj**.

Edhe nga këta tre shembuj: **kaloj, ngalkoj** dhe **ngaloj** del se trajtat përkatëse sa i përket etimonit a fjalë-temës rrënjë fjalëformuese, të cilat kuptimisht përkonin me barasvlerësit përkatës it. **calvacare**, sp. **calbacar**, fr. **chevalier**, dalin në njëfarë mënyre të desemantizuara në gjendjen e sotme, por po të thellohem i sadopak në analizë, kuptojmë bazën **kal-**, prej nga nënkuptohet se ndryshimet i janë shtruar një procesi zhvillimor për një kohë të gjatë që dëshmojnë shpërndërrimet e bashkëtingëlloreve: k : g; l /j, (ll): r (rr) e ndryshimet e tjera si shtesat nistore **n/s (z), sh/zh**, sot për sot, mbase kuptimisht të errëta për lexuesin e rëndomtë, por të kuptueshme me pak a shumë vështirësi për lexuesit e paparapërgatitur dhe të shpjegueshme me lehtësi për specialistët – historianët e gjuhës sonë. Nuk duhet të na hutojë fakti që edhe në italishte, spanjishte e rumanishte del e përftuar trajta foljore përkatësisht **cal/are, cal/ar** në biçim të shqipes **kal/oj**, por kuptimisht nuk përkohjnë. Në të vërtetë, folja **kaloj (me kalue)** në ato gjuhë (romane) ka këtë barasvlerësi: **fr. passer, it. passare, sp. passer, rum. merg.**

Sidoqoftë, edhe nga këta dy-tre shembuj argumentohet, sadokudo, konstatimi që u tha pak më sipër lidhur me autoktoninë e fjalës **kalë** dhe të foljes **kaloj**, autoktoni kjo e formëzuar në një periudhë të gjatë jo të afërt kohore, gjë që vërteton fakti se fjala **kalë** dhe derivatet lidhur me të, ishin formëzuar si fjalë shqipe që në lashtëni. Ishte kjo fjalë e përftuar dhe në çfarë forme në protoshqipe nuk dihet, por, dihet e vërteta, siç u tha më sipër, se një fjalë e tillë në konstruktin përkatës ekzistonte e *mëvetësuar* edhe në protoshqipe prej nga vjen e trashëguar ne shqipen e dokumentuar si fjalë e formëzuar me qartësinë e duhur semantike. Madje fjala e kontruktit të tillë ishte barabar në moshë ose edhe më e vjetër në krahasim me **caballus** (**cavallus**) të latinishtes vulgare mbetet në suazat e hamendjes, ndërsa për aderuesit e M. Huldit për rrënjën e saj i.e., mbetet sfidë.

c) Rreth foljes kalëroj (me kalërue)

Meqë rreth fjalë-foljes **kalëroj**, trajtë kjo e cila gjithsesi del e përligjur në letrarishten e sotme kemi bërë fjalë mjaft gjerësisht në një vend tjetër, këtu po rithesojmë vetëm nevojën që fjala e tillë, relativisht e re, duhet të shënohet në të gjithë fjalorët në përdorim e sipër te ne, ngase momentalisht mungon në fjalorët serbisht-shqipe e anasjelltas si dhe në burime të tjera, në mënyrë që, kur kemi të bëjmë për koncept të njëjtë, duhet të përdoret pa drojë në vend të trajtave: *kalaroj, kaliroj, kaluroj dhe kaloroj*, por edhe me zgjerim kuptim që e ka marrë ndërkohë në krahasim me baraslerësit përkatës të gjuhëve të huaja.

Sigurisht me sa u shtrua më sipër disa çështje mbesin enigma që kërkojnë zbërthim, andaj shtrojnë nevojën për sqarime plotësuese, gjithsesi më shumë e më bindshëm nga ato që janë dhënë deri tashti për këtë pikë.

2) Larushia paradigmore ndajshesore, fjalëndërtuese e fjalëformuese te disa shembuj rreth fjalës kalë

1. Prapashtesat foljore

Pa hyrë më thellë në analizë po cekim se prapashtesimi i shembujve përkatës në kategorinë foljeve del mjaft i larmishëm. Krahaso dhe konstato, prapashtesën foljore, në vijim, bashkë me shembujt e nëntipit përkatës:

-**Oj** (kaloj) dhe **O - me zgjerim**:: -**COJ** (shkalcoj), -**KOj** (ngalkoj, ngallkoj, ngajkoj ngarkoj), -**MOj** (ngarmoj, ngallmoj), -**RO** (kalaroj, kalëroj, kaliroj, ngaliroj), -**NOj** (ngallnoj), -**SHTOj** (kalashtoj);

-IT: kalit, karrapit, shkarravit, shkalit, shkarëzit, shkalavit, shkalamit, shkalafit (f/v),

-OS : kalivos, shkalos, ngalos;

-IS: kalis, shkarmis, shkalaris, kalashtis, kalaveshtis, shkalis;

-AS shkaras, shkas, ngas;

-AV: kalaboshav, kalaveshav;

-EJ: shkar(z)ej (***kel/cej**);

-AV/IQ : shkalaviq;

-AV/AT: karavat, shkaravat /shkarravat.

As shembujt as analiza nuk është shtruese, madje disa trajta dalin të paqarta aktualisht ose kanë kaluar dhe bëjnë jetë mbase vetëm me kuptim të figurshëm, fakt ky që tregon katërçipërisht, siç po përsëritet disa here, për ekzistimin, përkatësisht përdorimin e tyre në periudha deri lashtënore në ligjërimin shqip të fjalës **kalë** me rrjedhojat përkatëse.

2. Disa raste karakteristike të ndajshesimit emëror

Edhe ndajshesat e sistemit emëror dalin të llojlojshme dhe mjaft komplekse që përfshijnë një gamë të gjerë problemesh fjalëndërtuese e fjalëformuese. Së këtejmi ne nuk do të ndalemi në hollësi rreth trajtimit të ndajshesimit të llojlojshëm emëror, jo se nuk është temë me shumë interes, por pse do të na merrte shumë vend e kohë, që i tejkalon përmasat e interesimit të kësaj trajtese, por që njëherazi edhe kërkon përpjekje ose impenjime të jashtëzakonshëm me përmasa multidisiplinare, megjithatë, ne, që tani, lexues i nderuar, do të vështrojmë së bashku disa variante temëprodhuese parashtesore, të cilat gjithsesi ndërliken ngushtësisht ose në shkallë të gjerë me emrin **kalë**, siç janë trajtat alomorfe temëfjalëformuese vijuese:

shkal-, kali-, kala-, ngal-, ngar, karra, ngarr-, kara-, ngall-, shkal-, shkar-, shkarr-

nga të cilat reflektohet me kuptim të qartë ose qartësohet sadopak analogjikisht ose etimologjikisht trajta **kal- (n/gal-, sh/kal)**.

Ja disa shembuj sipas siparashësive përkatëse të sipërshënuara:

a) **kal-** me këtë siparashësën dalin afro 40 shembuj, tipi *kal-osh, kalesë, kalush, kalrritje, kalgjah, kalth, kalore* etj.;

b) **kali-** edhe mbi temë të kësaj siparashësive ndeshim afro 40 shembuj, si *kalirues, kalirim kalikresh, kalingalë, kalivall, kalikoç, kalipiç, kaliqafë, kalithinc* etj.;

c) **kala-** me këtë siparashtesën ndeshim më shumë shembuj, afro 130, tipi: *kala-z, kaladoras, kaladibrance, kalagjysh, kalamend, kalabisht, kalavesh, etj;*

ç) **ngal-** me këtë formant-siparashtesë, me sa pamë dalin 8 shembuj, tipi *ngal, (n)galiç, ngalec, ngalosh, ngaluc, i ngalët etj.;*

d) **ngar-** me këtë formant dalin nja 10 shembuj, tipi: *ngarkim, ngarkesë, ngarkicë, ngarend etj.;*

dh) **karra** – me këtë formant ndeshim jo shumë, 6 shembuj, tipi: *karrabisht, karrapuc, (sh)karravesh, shakarravit, karragat (kalagat), karravesh;*

e) **ngarr** – me këtë formant-siparashtesë ndeshim këta 4-5 prejpjesorë: *ngarrim ngarrosje, ngarrisur, ngarritje;*

ë) **kara-** me këtë formant ndeshim këta 5 shembuj: *i karashtisur, karabisht karabull, karavat, karabush, e ndonjë tjetër;*

f) **shkal-** me këtë formant ndeshim 9 shembuj, tipi: *shkalaris, shkalit, shkalos etj.;*

g) **shkar-** me këtë shënuam 6 shembuj, si: *shkaravat shkarkoj, shkarangjit etj.;*

gj) **shkarr-** me këtë ndeshim 3 shembuj si: *shkarravit, shkarravinë shkarravat e ndonjë tjetër;*

h) **ngall-:** me këtë formant-siparashtesë ndeshim këto 6 raste: *ngall, ngallafat, ngallazit, ngallec, ngallmohet, ngallshmoj;*

i) **ngala-:** ngalakaq, ngalakeq (2 raste).

Edhe lidhur me këtë, as numri i shembujve që këtu arrin afro 250 shembuj, madje as analiza nuk del shterruese.

3. Gjymtyrëzimi i trajtës kalë në togfjalësha e kompozita

Gjymtyrëzimin e trajtës **kalë-** në togfjalësha e kompozita po e trajtojmë në dy pika:

së **pari**, emra zakonisht të përgjithshëm, tipa të ndryshëm dhe
së **dyti**, emra të përveçëm kryesisht gjeografikë.

a) Emra të përbërë të përgjithshëm me fjalën *kal-i*

Siç mund ta shohim nga disa shembuj kompozita më sipër trajta **kal-** (si zoonim), në kohën tone del zakonisht si gjymtyrë e pare e kompozitës ose e pranëvënies, në emra të përgjithshëm, si p.sh.

kalrritje, kalgjah; kaliqaf, kalithinc; kaladoras, kalakryqje, kalëfuqi, kaladibrançe etj.,

por atë e ndeshim edhe si gjymtyrë të dytë të kompozitës përkatëse, që ne nuk e kemi përfshirë në shembujt e mësipërm, si:

rrapakal/i, kryekal/i, gurkali, sukal/e, sukaleni, sukallë(!).

Në të vërtetë, por si këto po në të njëjtën rrugë njëfjalëzimi janë duke e ndjekur edhe disa emra të përgjithshëm togfjalësha me kuptim të një sendi konkret ose me kuptim të figurshëm, që ne po i shënojmë të njëfjalëzuar, madje edhe pa vizëlidhëse, si:

këmbëkali, mishkali, frekali, vrapkali, strajcëkali, pordhëkali, qimekali, bishtkali, e ndonjë tjetër

P.sh. *Me një vrapkali e arrin cakun ose Mos m'u bën strajcëkali ose Kësaj pune i thonë: pordhëkali në derë të hanit!* etj.

b) Emra të përveçëm të përbërë gjeografikë me trajtën kal-i

Meqë në burimet që konsultuam më sipër, siç mund të shihet edhe nga shembujt e mësipërm, ne nuk ndeshëm ose nuk shënuam emra të përveçëm kompozita me fjalën **kalë**, lidhur me këtë pikë shfrytëzuam burimin "*Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, ASHSH IGJL, Tiranë 2002*, ku si emra të përbërë të përveçëm gjeografikë me fjalën **kal-i** si gjymtyrë të pare ndeshëm këta shembuj:

Kalbroshi, Kalcat, Kaldet, Kalgjegj, Kalenjë, Kalibaq, Kalibar, Kalimash, Kalis, Kalitoll, Kalivaç Kalivare, Kalmastrec, Kaludh,

por e ndeshim këtë emër edhe si gjymtyrë të dytë, si p.sh:

Prekal, Piskal Zorkal, Cukal, Zallkalis, Gurrëkalis, Vajkal, Gjurrëkali,

Ndeshëm dhe disa shembuj togfjalësha, të cilët, varësisht nga përdorimi, mund të thuhet se ecin drejt njëfjalëzimit, të cilët ne po i shënojmë siç janë të shënuar në burimin përkatës, si:

Maja e Kalit, Qafa e Kalit, Përroi i Kalit, Guri i Kalorit, Guri Kalit (Ulqin), e ndonjë tjetër.

Shembujt e mësipërm i shënuam me qëllim, sepse trajta **kal-** del e identifikuar, qartë, edhe pse ndonjëri shembull, për ndonjë arsye, mundet me dalë i diskutueshëm. Në të vërtetë, ne rreth emërtimit **kal-** (si *përcaktues* ose

si i *përcaktuar*) në emra toponimesh e patronimesh kemi lexuar punime të veçanta, duke i krahasuar edhe me barasvlerës të gjuhëve të huaja. Kujtojmë këtë rast qëmtimi rreth emërimit Kalabri Kalabria (Krahinë e Italisë) ku fjala **kal-** del më e qartë se te emri Gallap (Gallak) (*gal / kal) e ndonjë tjetër, për të cilët, për qëndrueshmërinë ose jo të tyre, ashtu si edhe për disa shembuj të mësipërm të shënuar prej nesh sipas burimit përkatës, nuk do të diskutohen këtu, megjithatë s'mund të mos e dallojmë punimin e prof.. Ruzhdi Ushakut, me titull **Sprovë për shpjegimin e prejardhjes së emërvendit Valkal, (Shih: ZSh 21.11.2008.)**, ku autori nuk përjashton mundësinë që fjala shqipe **kal-** të ketë ndërndikim nga **caballus** dhe njëherazi emërtimin **Valkalia**, trajtë latine të përdorur nga Barleti, fillim i shek. XVI e zberthen; **VAL+KAL** (val lat. *luginë+ fushë*) Ndërkaq, autori, trajtën **kal/ia** (si gjymtyrë të dytë) e konsideron, me të drejtë, si fjalë anase, të ngulitur si toponim, e cila së andejmi, del e trashëguar evolutivisht në trajtën **Vajkal** si toponim i sotëm i një fshati (a lagjeje) në rrethin e Bulqizës (Shqipëri). Autori vëren ndryshimin e fundores së gjymtyrsës së parë të kompozitës **-L** në **-J**, (Vajkal /Valkal), alternim ky i mirësquaruar sipas fonetikës historike që del edhe te trajta ngalkoj /ngajkoj, ngajosh, kual/kuaj etj. Lidhur me këtë, në favor të të autorit po shtoj edhe këtë se në Listën për ndryshimin e emërvendeve të papërshtatshme të Shqipërisë më 1938, emri Vajkal në Prefekturën e Dibrës, është ndryshuar në Vrapkali.

Sidoqoftë, në shqipe, shikuar sipas gjedhes së sotme fjalëformuese emërvendi Valkal merret me mend, në të mirë të z. Ushaku, të jetë quajtur natyrshëm **Fushkal-i** (Fusha e Kalit), sikurse shpjegohen edhe shembujt e mësipërm: *Zorkal, Piskal, Prekal, Zallkal(is)* etj., por edhe **Cukal**. Dihet se fjala **cukë** është sinonim i fjalës **çukë** dhe asaj **sukë**, andaj emri i përveçëm zberthehet Suka (Çuka, Cuka) + Kali , përkatësisht njëfjalëzimi del; Sukë e Kalit,*Suk+kal-, Sukal-i, sikurse ka dalë shekuj përpara shembulli **Cukali ose Valkali**. (i cili supozohet të ketë qenë **Fushëkali**). Siç po shihet te sinonimet **Cuka, Çuka, Suka**, vërehet fenomenin fonetik i shpërndërrimit të nistoreve **c/ç/s**, dukuri e gjallë kjo, që ndeshet në ligjërimet tona, madje ka raste që edhe bashkëjetojnë të tria trajtat edhe në emërtime të tilla, siç e kemi vërejtur ne në përdorim e sipër në fshatrat e Rrethbjeshtës së Therandës. Siç është **Cukali** i Korishës (kodër-mal), **Sukë**, lagja e Sukëve në Bllacë (kodrinë) dhe po aty një kodër më e vogël (tash lagje e re) quhet **Çukë**. Përveç kësaj një bashkëjetese të tillë e ndeshim edhe në burimin që konsultuam (*Fjalor të emrave gjeografikë të RSH*), ku ndeshim **5** shembuj

me emrin **Cukë**, afro 30 raste me emrin **Sukë** dhe afro 40 emra të përveçëm gjeografikë me emrin **Çukë**.

Në të vërtetë, ngjashëm me tipin Cukal ose Fushëkal (Valkal), po në burimin në fjalë ndeshim këta shembuj:

Fushëbuall, Fushëqen, Gurrëkalis, Fusharë dhe Fushë-Arës, Fushë-Lurë, Fushë-Mbret, Fushë-Shëngjergj, Fushë-Bulqizë, Fushë-Krujë etj.

numri i të cilëve kalon 40–shin.

Sidoqoftë, nga sa u pa e u tha për rrënjësinë e thellë të emrit **kali**, nuk flet vetëm sindajshtesimi fjalëformues, *kal-, kali e kala-* etj. në kohë e hapësirë, por flasin edhe edhe vetë paradigmata e shumësit të kësaj fjale, si:

kuej-t, kuel-t, kuaj-t, kvala-t, kvalt-ë, kjal-t, kvaj-t,

kfal-t, këval-t, kala-t, kual-ët, kuaj-të, kavala-t(!) -13 trajta.

Po sqarojmë se trajtën **kavala-t** e kam dëgjuar në gjuhën e fëmijëve dhe është ndoshta e vetmja trajtë ndërlihdhëse më e qartë se të tjerat me fjalën **kaballus** ose **cavallus** të latinishtes vulgare, përkatësisht të njëjësit të italishtes **cavallo**, gjurmë kjo që, siç u cek më sipër, del jo në njëjës po në shumësin e emrit kalë të shqipes, ndërkaq në rumanishte, si me thënë, kjo gjurmë nuk vërehet, ngase, si njëjësi si shumësi, në atë gjuhë dalin thjesht: **cal/cai**, me shndërrim **l/i**.

Është vendi me përmendë këtu mendimin shumë interesant e me vlerë të studiuesit **Abdullah Konushevc**i, i cili, trajtën **kalë** e shpjegon si shumës të singularizuar dhe njëherazi e quan të pa drejtë konstatimin rreth prejardhjes latine të kësaj fjale, ngase ky e konsideron të drejtë mendimin e studiuesit **M. Huld**, i cili këtë fjalë e sheh si element të shqipes si rrjedhojë nga rrënja ***kel**, **i.e.** me kuptimin, *me grahë, me vu në lëvizje të shpejtë*, siç është edhe fjala lat. **celer** –**is** – *i shpejtë*. (Shih A. Konushevc, *Ndihmë anatomologjike...* Forumi shqiptar, 23.02.2010.) Nuk di sa hyjnë në punë në këtë drejtim trajtat e sotme *sh/kal/sh/kel* ose *n/gal/n/gel* që kuptimisht janë e kundërta e levizjes me shpejtësi ***kel**, përkatësisht *cel/er (kel/kal +OJ)?!?!*

Sidoqoftë, jo vetëm nga pikëpamja e shumësit të fjalës **kalë** prej 13 trajtash (*nga kuel deri kavala-t*), ku shihet shtrirja e madhe e trajtave në kohë-hapësirë, po ashtu edhe nga pikëvështrimi i ndërtimit ose foljeformimit, siç u pa, para se të krijohet e përligjet trajta **kalëroj** në përdorim e sipër ishin dhe janë afro 80 trajta foljore, ndër to po i ritheksojmë vetëm këto

ngaløj – kaløj, ngalkøj-ngallkøj, ngarkøj, ngarrkøj; kalarøj, kaliroy,
kaluro,j kaloroj, ngal e ngel, shkaL e shkel ngajkøj e ngarkøj etj.

Edhe vet ekzistenca e të gjitha këtyre trajtave që në thellësi të kohës të përfuara mbi bazë të konceptit në fjalë në gjuhën tonë tregon autoktonine e kësaj fjale, apo jo?! Madje, nga kjo thellësi përdorimi shpjegohet edhe procesi i desemantizimit dhe ai i dekonstruktimit të fjalë-temave përkatëse prodhuese të shumëllojshme fjalëformuese të trashëguara në gjuhën tone.

Sidoqoftë, e themi me keqardhje se një ndryshueshmëri a larushi e tillë në të gjitha rastet nuk ishte rezultat i një evoluimi normal, por jonormal i gjuhës shqipe, ngase mjerisht folësit e protoshqipes si dhe këta të shqipes së sotme, me sa dihet, në epokën historike nuk e paten asnjëherë fatin ta kenë një qendër administrative rrezatuese të veten, për lakmi, madje fatkeqësisht prej se mbahet mend pothuajse deri në ditët e sotme shqipfolësit ishin të ndarë, të përcarë ose të shpërndarë e të sunduar zyrtarisht nga administratat e huaja Fundja, sot kur ky popull po frymon pak më lirshëm ky fakt duhet të nxisë e të motivojë edhe më shumë studjuesit e sotëm e sidomos të rijtë që ta mësojnë e studiojnë edhe më me vullnet gjuhën shqipe dhe t’ia sforcojnë prestigjin, duke gjurmuar në rrënjësinë e fjalëve të caktuara, duke ia kthyer kështu vlerat me shkencë e dije pragmatike, të cilat i janë mohuar shqipes arbitrarisht, qoftë duke shfrytëzuar servilizmin e disa studiuesve tanë, qoftë edhe për mungesë konceptesh ose nga mospuna e tyre.

Gëzon fakti se studiuesit tanë të rij gamën e studimeve e kan shtrirë edhe më gjerë, duke i krahasuar fjalët e shqipes edhe me familje të tjera, jo vetëm të familjes i.e., ku bënë pjesë shqipe bashkë grupin e gjuhëve romane neolatine. Kështu studiuesi Tomor Kastrati (Shih: Shqipja dhe arabishtja, Prishtinë, 2002) ka konstatuar se fjala *kale kali* e shqipes ka ngjashmëri me fjalën **h’ali** të arabishtes (kuranore). Nëse është kështu atëherë teoria pellazgo-ilire-etruske e protoshqipes merr argumenta fuqizimi shtrirjeje në përgjithësi, ndërsa autoktonia shqipe e fjalës **kalë** merr miratim përforcues në veçanti.

Sido që të jetë, për t’u konstatuar e vërteta duhet të trajtohen, jo vetëm ato dukuri që kanë ngjashmëri shkrimore, siç është fjala **kalë**, me rrjedhojat mbi bazë të saj, por për fjalë e dukuri të tjera studimi duhet shtrirë më tej edhe me gjuhë e gjurmë për të zbardhur edhe shumë e shumë fjalë të tjera (glosa) të natyrës së tillë që fatlumnisht studiuesit tanë të përgatitur shkencërisht e kombëtarisht kanë filluar me i vërejtë dhe me i vlerësue, të cilëve u urojmë punë të mbarë e suksese.

Përfundim

Përmbylljen e kësaj trajtесе po e përmbledhim në këto tri pika:

E para, nga trajtimi i kësaj teme del i diskutueshëm konstatimi se fjala **kalë** e shqipes ka etimologji latine nga trajta **caballus (cavallus)**, prej nga e kanë prejardhjen trajtat e gjuhëve romane: fr. *cheval*, it. *cavallo*, sp. *caballo* dhe rumanisht *cal*, jo vetëm pse shqipja është futur në atë grup gjuhësh, edhe pse nuk është gjuhë romane (neolatine), por edhe për arsye se edhe vetë fjala **caballus** nuk ka prejardhje të mirëfilltë latine, po të një gjuhe tjetër, d.m.th. të një gjuhe *popullore* (latinishte vulgare) dhe së këtejmi, shtrohet pyetja pse mos të sugjerohet, kishte ndërndikim fjala përkatëse e protoshqipes në atë gjuhë popullore, apo jo?!

E dyta, në të mire të këtij gjurmimi për t'u vërtetuar rrënjësia e fjalës shqipe **kalë** dhe raporti me gjuhët neolatine për këtë fjalë, u analizua shtrirja në kohë hapësirë e këtij fjalë-koncepti me rrjedhojat përkatëse në krahasim sadopak me gjuhët romane dhe nga analiza e tillë doli se në sistemin formëzues më tepër se në çdo gjuhë tjetër në shqipe fjalë-koncepti **kalë** ka shtrirje të thellë e të gjerë në kohë-hapësirë dhe se ka shërbyer drejtpërdrejt ose analogjikisht si temë prodhuese fjalëformuese në të dy sistemet formëzuese të shqipes, si në sistemin foljor, ku ndeshen afro 80 folje të regjistruara mbi këtë bazë dhe po aq më shumë në sistemin emëror, ku numri i fjalëve të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore mbi këtë mënyrë del disafish më i madh. Pra edhe nga ky këndvështrim vërtetohet mëvetësia e fjalës kalë ndaj trajtës **caballus (cavallus)**, dhe derivateve të saj në gjuhët neolatine, jo vetëm për nga sasia, por edhe për nga kuptimi. Së këtejmi më tepër ka gjasa që trajta *caballus (cavallus)* të jetë influencuar nga trajta e protoshqipes mbase ***kaval-** ose ***ngaval-** - ***ka(v)al** që i paraprin trajtës së sotme shumësi ***k'val kual (kuaj)** se sa anasjelltas, apo jo?

E treta, përveç shtrirjes në kohë hapësirë në të mire të këtij gjurmimi u analizua sadokudo larushia e trajtave të shembujve mbi bazë të fjalës **kalë** dhe rrjedhojave të saj, siç janë shpërndërrimet paradigmore, ndërtimore e fjalëformuese në strukturën fonetike (zanos e bashkëtingëllore), dhe në atë morfologjike (parashtesa e prapashtesas, gjymtyrëzimi në kompozita, pranëvënie e togfjalësha), dhe kështu edhe nga ky këndvështrim lashtënia dhe autoktonia e kësaj fjale në shqipe del mjaft e qartë dhe e sforcuar, fakt ky që e bën të diskutueshëm ose të paqëndrueshme prejardhjen latine të fjalës **kalë**, siç e ndeshim aktualisht në burime të caktuara (studimore) akademike, aq më tepër kur ka mendime si ajo e studiuesve M. Huld, A. Konushevci etj., që kjo

fjalë ka elemente rrjedhoje të prejradhjes nga rrënja ***kel** i.e., në kuptimin: e lëvizjes, ecjes: *me grahë, me vu në lëvizje të shpejtë*.

Si përmbyllje e krejt kësaj del fakti se manipulimi rreth prejardhjes jo vetëm latine, por edhe të lanishtes vulgare të fjalës **kalë** lypset rishikuar në dobi të autoktonisë shqipe të saj.

Së këtejmi, në raportin protoshqipe /latinishte vulgare ka edhe glosa të të tjera të kësaj natyre, sidomos që i ndeshim në gjuhën italiane e rumune etj., të cilat lypsen trajtuar shkencërisht, duke e konstatuar edhe rolin eventual të (proto)shqipes në këtë proces, apo jo, gjë që mbetet punë për studiuesit e tashëm dhe të ardhshëm.

Të dhëna bio-bibliografike për autorin



I.

Nuhi (Muharrem) Veselaj u lind në fshatin **Reçan të Therandës** (ish-Suharekë) më 20.08.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948), Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.06.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 03. 09.1959 në Prizren. Shkollën e lartë, përkatësisht Shkallën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës – Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.09.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe, më 23. 11. 1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 03. 04. 1980 mori gradën: *magjistër i shkencave filologjike*, ndërsa *tezën e doktoratës e mbrojti* më 24.12.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qendër në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës. Është Anëtar Nderi i SHAK “Elena Gjika Dora d’ Istria, Therandë.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por për moszbulim provash nga ai, u dënua vetëm 2 vjet. Pasi doli nga burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të ripunësohej në arsim që e kishte ideal veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës (8 herë): Mushtisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejëc (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Zllatar, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur për motive politike iu ndalua puna në arsim e organizata shoqërore-

shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në Ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put* të Beogradit – dega në Prishtinë, prej nga kaloi në *Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës*, përkthyes. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai përkundër pengesave e përndjekjeve, me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, arriti të korrë suksese, qoftë në jetën arsimore e shoqërore-politike, qoftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, gjetën strehim e shërim ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij qe objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë eksodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shkojë drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllaboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dekada, pasi, përkundër tentimeve, atij i qe ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë, ky pasi e bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t'i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut, kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyra të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest buroteknik. Ndërkohë kreu me nder çdo angazhim që iu besua, por nuk u ekspozua në parti politike, më tepër u përqendrua në veprimtarinë krijuese.

II.

Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s'ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashti botoi këto vepra:

1) Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylberta (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;

3. Me buzët në gaz (vjersha për fëmijë), Iliriku, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), Iliriku, Prishtinë) 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), Iliriku, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), Iliriku, Prishtinë 1997;
7. Shfrime nëpër mjegullnajë (reflekse poetike e mendimore), Iliriku, Prishtinë 1997;
8. Mësime nëpër pësime (shfaqje teatrore), Iliriku, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), Rozafa, Prishtinë 1998;
10. Bulëza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), Rilindja, Prishtinë 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), Rilindja, Prishtinë 2000.

2) Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Rilindja 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O – në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002;
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006,
5. Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktorate) MASHT e RK-së, Prishtinë 2014,
6. Rreth identitetit të gjinisë asnjësore në shqipen e sotme, Era, Prishtinë 2015,
7. Shumësi dhe shquarsia e emrave në shqipen standarde, Era, Prishtinë 2015,
8. Drejt standardizimit të gjuhës shqipe, Era, Prishtinë 2015,
9. Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, Era, Prishtinë 2015,
10. Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II, Era, Prishtinë 2015.

Këto të pestat të gatitura për libërtim:

11. Çështje të shqipes standarde rreth 28 temave të diskutueshme, III, Era, Prishtinë,
12. Çështje të shqipes standarde rreth emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë IV, Era, Prishtinë,
13. Çështje të shqipes standarde rreth disa termave nga fusha e teknikës dhe e ekonomisë V, Era, Prishtinë,
14. Çështje të shqipes rreth vendbanimeve, VI, Era, Prishtinë,

15. Fjalor pune (poslovni rečnik) shqip –serbisht, me shtojcën serbokroatisht – shqip, për ndërmarrjet metal-përpunuese – me theks terminologjia tekniko-teknologjike, VII, Era Prishtinë,

Sidoqoftë, edhe pse në moshë të shtyrë (ec në 84-shin) pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha e gjuhësisë, qoftë nga ajo letrare-artistike, për libërtimin e të cilave qëndron në pritje mirëkuptimi nga institucionet dhe organizmat përkatës të qeverisë sonë, por edhe prej sponzorëve eventuale vullnetmirë.

Prishtinë, 2016